



**TITULLI ORIGINAL**  
DAMLÄ VE DERYÄ  
DÜNYÄ VE ÂHÎRET

**PËRKTHEU**  
Alban Kali

**REDAKTOI**  
Albert Halili

**FAQOSJA**  
Bledar Xama

**BOTIMI I**  
Prill 2021, Shkodër

**PROGRESI BOTIME**  
Sheshi “2 Prilli”, Rr: Studenti  
Shkodër, Shqipëri  
Mob: +355 67 340 6182

# DYNJAJA DHE AHIQETI

**Osman Nuri TOPBASH**



### **Të nderuar lexues!**

*Falënderimet e pafundme i takojnë Pronarit të çdo krijese tek e cila shfaqet arti hyjnor që rroket e nuk rroket nga shqisat!*

*Salatet dhe selamet për mbretin e profetëve, pasqyrës ku reflektohen në mënyrën më të jashtëzakonshme bukuritë e artit madhështor të Tij!*

Allahu i Lartmadhëruar dëshiroi:

Që njeriu në mesin e krijesave, të jetojë me trup e me shpirt, në të dyja botët;

Në Dynja e Ahiret!

Allahu i Lartmadhëruar dëshiroi:

E të dyja botët u stolisën me manifestimet e ndarjes e bashkimit, me një mijë e një shembuj e urtësi.

Dynjaja e Ahireti!

Allahu i Lartmadhëruar dëshiroi:

U realizua krijimi i dy kontrasteve, i dy veprave të artit hyjnor;

Danjaja dhe Ahireti!

E vërteta që dihet më shumë, më e pazgjidhshmja fshehtësi.

Dy pasqyra.

Dy pasqyra me fshehtësi, brenda të cilave ka plot të ditura...



Dy pasqyra me të ditura, brënda të cilave ka plot të fshehta...

Se çfarë ka njëra pasqyrë do të kuptohet kur të shihet pasqyra tjetër...

Dy pasqyra që nuk gënjejnë askënd teksa janë përballë njëra-tjetrës.

Dy pasqyra që ekspozojnë të vërtetat dhe urtësitë vetëm kur shihen njëkohësisht me vëmendje.

Por ama;

Të shikuarit e vetëm njëres prej tyre është shumë iluzore. Sepse asnjëra nuk e ka cilësinë e të treguarit të së vërtetës në mënyrë të pavarur nga tjetra. Vetëm kur shihen bashkë formohen në trajtën e duhur mendimet, besimet, vizionet, të vërtetat dhe të pavërtetat, të cilat përbëjnë vullnetin dhe botën shpirtërore të njeriut. Kështu formohet bota e qëndrueshme e njeriut. Manifestohet në trajtën e saj më të plotë. Del në pah njeriu me të gjitha cilësitë e tij të vërteta. Ja pra;

Ekulibri hyjnor që Resulullahu (a.s.), synon të instalojë te njeriu;

*“Të punosh për këtë botë sikur nuk do të vdesësh kurrë, e të punosh për botën tjetër sikur do të vdesësh nesër.”*

Ekulibri i vërtetë i jetës me qendër përjetësinë.

Nëse nuk ndërtohet siç duhet ky ekuilibër atëherë të gjitha peshoret e njeriut do të peshojnë gabim, të gjitha pasqyrat do të gënjejnë, mash-trojnë.

Sepse;

Pasqyra e dynjasë dhe ajo e ahiretit larg njëra-tjetrës, nuk japin re-flektimin e saktë të së vërtetës. Kur shihet vetëm njera duke u neglizhuar tjetra, atëherë çdo gjë bëhet lëmsh e ngatërrohet. Duket e mirë e del e keqe. Perceptohet si e keqe, kur në fakt është e mirë. E drejta dhe e shtrembëra, e bukura dhe e shëmtuara, e vërteta dhe e pavërteta janë në pozicione të



gabuar brenda botëkuptimit, e jo në vendet e veta ku përkasin. Në vitrinë ekspozohet e pavërteta si e vërtetë. Etiketohej e vërteta si e pavërtetë. Sytë që shohin vetëm njërën pasqyrë nuk e kapërcejnë dot këtë udhëkryq...

Të shkretat zemra që shkatërrohen nga këto bredhje të kota. Ato fiken në kthetrat e të pavërtetës, ndërkohë që kujtojnë se kanë gjetur të vërtetën. Privohen nga të vërtetat e supozuara si të pavërteta.

Prandaj;

Është e domosdoshme të shihen së bashku edhe pasqyra e kësaj bote, por edhe ajo e botës tjetër. E atëherë do të kuptohen qartë e mira dhe e keqja, e drejta dhe e shtrembra, e vërteta dhe e pavërteta. Do të perceptohen siç realisht janë jeta, vdekja dhe e përtejmeja.

Atëherë njeriu arrin sekretin «**e të jetuarit e kësaj jete me vetëdijen e Kiametit**». Ai i drejtohet Allahut të Lartmadhëruar me gjallërinë e zemrës për t'u siguruar nga frika dhe shqetësimi i Ahiretit. Duke e organizuar mirë e nën vëzhgimin e miqve të Allahut të Lartmadhëruar raportin e tij si besimtar me këtë botë, të gjitha dashuritë e kësaj bote i kthen në shkallë për t'u ngjitur në dashurinë hyjnore, dhe bën përgatitje të shumta për natën e takimit me Të. Ai përpiket ta kalojë të gjithë jetën në një atmosferë Ramazani dhe kujdeset shumë t'u bëjë vend shumë **tre mirësive** dhe të ruhet nga **tre fatkeqësitë** e paralajmëruara nga Resulullahu (a.s.):

- Qoftë larg mëshirës së Allahut të Lartmadhëruar ai që e arrin Ramazanin dhe del i pamëshiruar nga ai!

- Qoftë larg mëshirës së Allahut të Lartmadhëruar ai që kur përmeendet i Dërguari i Allahut nuk bie salavat për të!

- Qoftë larg mëshirës së Allahut të Lartmadhëruar ai që nuk u rri pranë prindërve të tij të plakur e nuk fiton kështu xhenetin me sjelljen e mirë ndaj tyre!

Ai e konsideron Resulullahun (a.s.) si recetën e tij shpirtërore të shpëtimit. Është krejt i qartë se shpëtimi i tij në këtë dhe në tjetrën botë



arrihet **«duke e dashur fort atë»**, pra lidhet me faktin se sa ai përfiton shpirtërisht nga shpirtërorja e tij. Në çdo frymë ai fërgëllon me dashurinë dhe përgjegjësinë e të qenët **«umeti i Resulullahut (a.s.)»**. Sepse qëllimi i tij është **«të qenët bashkë me Resulullahun (a.s.) në të dyja botët»**, që nëpërmjet rrugëtimit të tij shpirtëror **«të bëhet nga të dashurit e Resulullahut (a.s.)»**.

Prandaj;

Për të qënë nga të diturit e vërtetë ai kalon **«një jetë në përgjërëm»**. Nuk mbytet në krizën e sistemeve të ndryshme njerëzore. Bëhet i meritueshëm për xhenetin dhe mirësinë e **«një jete të jetuar me qendër Kuranin dhe Sunetin»**.

Ja pra, një jetë e çuar në ekuilibrin mes kësaj bote e botës tjetër, e shpie njeriun në shpëtim.

Ja pra dy mëshira nga Allahu i Lartmadhëruar;

Kjo botë e bota tjetër.

Dy botët e rrugëtimit nga kurbeti për në takim.

Ja pra edhe tema e veprës që keni në duar;

Dynjaja dhe ahireti.

Sërish një fillim i një veprë të vëçantë...

**M. Ali Eshmeli**

(Stamboll, 2012)





Kushti i të qënir i sigurt nga frika  
dhe trishtimi i Ahiretit

TË JETOSH ME VETËDIJËN E KIAMETIT





Kushti për të qenë i sigurt nga frika  
dhe trishtimi në Ahiret

## TË JETOSH ME VETËDIJËN E KIAMETIT

### VULA E KIAMETIT NË ÇDO VEND E NË ÇDO KOHË

Allahu i Lartmadhëruar në ajetin e parë të shpallur na është drejtuar me:

**“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka).”** (Alak, 1)

Në këtë botë provimi, ngado që të hedhim shikimin, cilëndo fletë të librit të universit që të lexojmë, aq sa mund të rrokë perceptimi ynë, e aq sa mund të lexojmë në emrin e Zotit Krijues, shohim në çdo gjë të përkohshmen dhe kalimtare. Dëshmojmë kudo vulën e kiametit.

Kjo është jeta...

Çdo gjë në pronësinë e Tij...

Në njërën anë ardhja në tjetrën ikja...

Përditë miliona vijnë e miliona ikin. Qindra milionë, madje miliardë jetojnë në pronën e Allahut të Lartmadhëruar, furnizohen me begatitë e Tij. E kur të vijë exheli, koha e caktuar për ikje, vjen vdekja e kështu realizohet lindja në një tjetër botë.



Kur shohim me vëmendje vërejmë se edhe ardhja jonë në këtë botë ka ndodhur kështu:

Trupi ynë u krijua në barkun e nënës. Nuk dinim, e nuk njihnim kënd...

Allahu na prezantoi ata që nuk njihnim në këtë botë. Tani kjo botë na vjen e natyrshme sepse jemi mësuar me të... Por një ditë do të hedhim hapin drejt botës tjetër, ahiretit. Në një ajet kuranor thuhet:

***“Ata do të thonë:***

***«Kush do të na kthejë ne (në jetë?)»***

***Thuaj: Ai që ju ka krijuar herën e parë...”*** (Isra, 51)

Allahu i Lartmadhëruar, në krijimin tonë të parë, në vdekjen tonë, por edhe në ringjalljen tonë manifeston mëshirën e Tij ndaj nesh.

## **AI ËSHTË VAZHDIMISHT I MIRË ME NE...**

Në këtë botë ne erdhëm pa paguar asnjë çmim, me kapital zero, pra nuk patëm asnjë meritë prej të cilës përfituam ardhjen në këtë jetë. Kjo ndodhi krejtësisht nga mirësia e Allahut të Lartmadhëruar...

Eksiztenca jonë, gjallërimi ynë në jetën e kësaj bote është mirësi...

Ardhja në jetën e kësaj bote si njerëz është një mirësi tjetër...

Ardhja në jetën e kësaj bote si myslimanë është një mirësi tjetër e pafundme...

Ndërsa të qenët pjese e umetit të Resulullahut (a.s.) është një mirësi e pashembullt...

Pas të gjitha këtyre mirësive, Allahu i Lartmadhëruar dëshiron të na dhurojë edhe një tjetër mirësi:

Ai dëshiron të na mbrojë nga tmerri i ditës së kiametit.

Sepse fundi i kësaj botë dhe i jetës në të është:



## NJË SHPËRTHIM TMERRUES...

Allahu i Lartmadhëruar në lidhje me një etapë të kiametit shprehet:

***“Atë Ditë, Ne do të palosim qiellin, ashtu siç paloset letra e librit...”***

(Enbija, 104)

Reflektoni për pak në lidhje me fuqinë dhe madhësitinë që do t'i palosë e t'i bëjë shuk qiejt si letrat, qiejt e paanë, që nuk i nxë perceptimi njerëzor e as një varg i tërë teleskopësh që janë shpikur gjer sot... E gjithë ashtu mendoni tmerrin që do të prodhojë kjo palosje...

Ata qiej që janë trilionë galaksi... Yjet, sasinë e të cilëve nuk mjaftojnë gjuhët e as numrat për t'i shprehur. Vendet për të cilat Allahu i Lartmadhëruar betohet në librin e Tij:

***“Jo! Betohe me në vendin e yjeve, e ky është betim i madh, veç sikur ta dinit.”*** (Uakia, 75-76)

Qiejt ku drita shuhet edhe pse ajo ka një shpejtësi prej treqind mijë kilometrash në sekond...

Kur qiejt madhështorë do të kenë këtë përfundim, po njeriu që është një thërrimë në sipërfaqen e kësaj toke, ndërkohë që vet toka është një thërrimë përballë botëve të pafundme, çfarë përfundimi do të ketë!

Allahu i Lartmadhëruar na i sjell përpara syve tonë skenat që do të përjetohen nga njeriu:

***“...atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet.”*** (Abese, 34-36)

Kur njeriut i bie ndonjë hall në jetën e kësaj bote, vrapon te vëllai, prindërit, fëmijët për të kërkuar ndihmë.

Mirëpo gjatë kiametit dhe në ahiret, jo vetëm që nuk do të kërkojë ndihmë nga kush, por do të ikë e largohet prej tyre prej frikës së mos ata do t'i ngjiten atij.



Çfarë vetmie e plotë..!

Në jetën e kësaj bote nëna me dhembshurinë dhe mëshirën që e karakterizon atë, është gati të kapërcejë vështirësi të pafundme për fëmijët e saj. Mirëpo kiameti është një tmerr aq i madh saqë nëna, që është simboli i mëshirës, do ta lëshojë fëmijën e saj të gjirit. Në një ajet kuranor thuhet:

***“Ditën, që do të shihni atë, çdo grua me fëmijë në gji do ta harrojë fëmijën e saj dhe çdo grua shtatzënë do ta hedhë barrën e vet. Njerëzit do t’i shihni si të dehur, ndonëse ata nuk do të jenë të dehur, por dënimi i Allahut është i ashpër.”*** (Haxhah, 2)

Ndërsa në suren Muzemmil tmerri i ditës së kiametit përshkruhet kështu:

***“Qysh do të mbroheni ju, nëse mbeteni jobesimtarë, Ditën në të cilën fëmijët do të thinjen?”*** (Muzemmil, 17)

Allahu i Lartmadhëruar pyet:

## SI DO TË MBROHENI?

Sepse Allahu i Lartmadhëruar dëshiron më të mirën për ne. Ai dëshiron që ne të hyjmë në Darus Selam, pra në xhenetin e Tij, pa përjetuar tmerret e shpërthimit të frikshëm, kiametit. Ai na fton për në xhenet.

Mirëpo Allahu i Lartmadhëruar nuk dëshiron që robërit, që do t’i përfshijë në mëshirën e xhenetin e Tij, t’i kenë zemrat e papërpunuara e të pandjeshme. Dhe që zemrat të arrijnë në nivelin e plotësimit, përmirësimit e pastrimit që dëshiron Ai, na ka dhuruar të Dërguarin e Tij.

Allahu i Lartmadhëruar i frikson me xhehenem dhe i paralajmëron me tmerrin e kiametit ata që nuk e lartojnë zemrën e tyre në nivelin e kërkuar, që nuk përpiqen në rrugën e robërisë ndaj Allahut të Lartmadhëruar, e që kanë vendosur të bëjnë të shurdhërin e direktivave hyjnore. I fton ata që t’i frikësohen kiametit që po afrohet vazhdimisht. Në fakt,



në lidhje me jetën e botës tjetër e me kiametin të gjithë janë të friksuar, besimtarët e jobesimtarët.

## TË GJITHË TË FRIKËSUAR!

Në lidhje me vdekjen, kiametin dhe jetën e pasosur ka frikë besimtari, por një frikë të veçantë ka edhe jobesimtari.

Frika e besimtarit konsiston në shqetësimin: “Si do të vejë halli i im!”

Çfarë do të tregojë peshorja kur të vendosen veprat e të gjithë jetës? Në peshoren më precize ku do të maten edhe thërrmijat, cilat vepra do të peshojnë më rëndë ato të mirat apo të këqijat? Sa vepra të mira e sa vepra të këqija do të dalin? Cili do të jetë bilanci i veprave që do të peshohen me imtësinë absolute sipas ajetit:

***“O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh. Me të vërtetë, Allahu njeh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë.”*** (Lukman, 16)

Nga cila anë do të na serviret libri i veprave? Nga e djathta apo nga e majta? Me çfarë do të përballemi teksa do të merremi në llogari në lidhje me fletoren e veprave ku janë regjistruar të gjitha etapat e jetës sonë?

Këto të panjohura prodhojnë brenda besimtarit frikë e shqetësim.

“Ku do të jetë vendi im në jetën e pasosur?

Gjatë kalimit në urën e Siratit çfarë do të ndodhë me mua?

Po sikur atëherë kur nuk do të ketë më mundësi kthimi e kompensimi, fundi im të jetë dështimi e shkatërrimi?”

Këto shqetësime e frikëra burojnë nga imani, besimi. Të jesh krejt i sigurt për shpëtimin tënd në jetën e pasosur është kufër. Edhe sahabët që u përgëzuan me xhenet qysh se ata ishin në këtë botë, përjetuan shqetësimin e frymës së fundit e të ahiretit, nga frika se mos nuk do të jenë të zot ta



mbanin e ta ruanin deri në fund gjendjen e tyre të besimit. Nga frika se mos bie në syfaqësi, Omeri (r.a.), i cili kishte ngarkuar një person për t'i thënë atij vazhdimisht «Mos harro, o Omer! Vdekja është e pashmangshme!», e shpreh në mënyrë shumë kuptimplote faktin që besimtari duhet të jetë midis frikës e shpresës me këtë përshkrim ndjeshmërie:

“Nëse nga qielli vjen një zë e thotë;

«- O njerëz! Vetëm një njeri do të hyjë në xhehenem.»

«-A thua ai fatkeq jam unë?»- do të mendoja me vete duke qënë në gjendje frike/haufi.

Nëse zëri do të thoshte:

«- O njerëz! Vetëm një njeri do të hyjë në xhenet.»

Atëherë do të mendoja me plot shpresë/rexha:

«-A thua ai fatlum jam unë?»”

Kur Omeri (r.a.) u plagos dhe ishte në prag të vdekjes, disa sahabë shkuan për vizitë tek ai dhe filluan t'i shprehnin vlerësimet e tyre. Përballë këtyre komplimenteve, ai u shpreh:

*“Është mashtruar ai i cili përfshihet dhe i merr seriozisht komplimentet e njerëzve. Sikur të kisha ar sa kjo dynja, do ta jepja të gjithin vetëm për të shpëtuar nga frika e ditës së llogarisë.”*

Devotshëmria e shton këtë lloj shqetësimi tek besimtari.

Ekzistenca e këtij shqetësimi dhe shtimi i tij është cilësi e bukur. Kur shtohet shqetësimi për ahiretin, stabilizohet edhe qendrueshmëria në rrugën e Zotit.

Ndërsa indiferenti jeton larg këtij shqetësimi, është mundur nga nefsi, por nuk është i vetëdijshëm për këtë fakt. Ai jeton në një rehati të tillë sikur asnjë tmerr se pret atë. Mirëpo fundi i indiferencës është një zhgënjim i pamatë dhe pendim i padobishëm.





Në një ajet kuranor thuhet:

***“Agonia e vdekjes do të sjellë të vërtetën (e jetës tjetër); «ja, kjo është ajo së cilës përpiqeshe t’i ikje.» Dhe do të fryhet në Sur - kjo është Dita e kërcënimit.”*** (Kaf, 19-20)

Në të vërtetë brenda çdo njeriu jeton frika dhe shqetësimi për ahiretin.

Edhe jobesimtari, thellë-thellë, ka frikë dhe shqetësim për botën tjetër. Edhe pse e mohon atë, brendësinë e tij e bren dyshimi: po sikur të ketë botë tjetër, po sikur të ekzistojë ahireti?! Sepse sado që ai ia kthen shpinën të vërtetës, çdo gjë në univers bart vulën e madhështisë së Allahut (xh.sh.), çdo gjë është vitrinë ku ekspozohet madhështia e Zotit... Kjo madhështi me doemos ta kujton Kiametin.

Edhe nëse nuk e besojnë, Kiameti është në aktualitetin e mohuesve. Në një ajet kuranor thuhet:

## LAJMI I MADH!

***“Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin? Për Lajmin e madh, rreth të cilit ata kanë kundërshtime.”*** (Nebe, 1-3)

Kiameti është «Lajmi i madh» për të cilin jobesimtarët dhe mohuesit polemizojnë duke u shprehur «Po sikur të jetë i vërtetë?».

Në periudhën e injorancës, pra para së Resulullahut, (a.s.), t’i vin-te profecia, arabët nuk e kishin fare nocionin e ahiretit. Të vërtetat e kumtuara nga Ibrahim, (a.s.) dhe i biri i tij, Ismaili, (a.s.), ishin harruar krejtësisht. Gjithkush jetonte siç dëshironte. Nuk e ndjenin shqetësimin se një ditë do të japin llogari, frikën se një ditë do të pyeten se çfarë kanë bërë në jetën e kësaj bote. Çdo gjë ishte e drejta e të fortit. I dobëti nuk kishte asnjë të drejtë.

Derisa më në fund erdhi Islami, kandili i drejtësisë dhe të vërtetës, i cili ndriçoi të gjitha errësirat. Atëherë mushrikët politeistë përballë



të vërtetave shumë të mëdha që solli islami, u kapluan nga shqetësimi i sundimit dhe pushtetit të tyre. Bashkëshortja e Ebu Sufjanit, Hindi bërtiste e vikatte:

“Çfarë është kjo fe kështu? Një grua kaq e madhe sa unë të jetë e barabartë me një robinë të çfarëdoshme? A nuk do të mund t’i jap më urdhra e direktiva robërve të mi? Jo nuk mund të ndodhë kjo, jo! Ai është rob e unë pronarja e tij. Unë e urdhëroj atë të bëjë çfarë të dëshiroj unë. Kush mund ta marrë këtë të drejtë prej meje?!”

Mirëpo;

Kur Resulullahu (a.s.), i cili edhe në frymën e fundit këshilloi besimtarët; «Kujdes namazin! Kini shumë kujdes namazin! Kini kujdes ndaj të drejtave të atyre që keni nën urdhërin tuaj!», çliroi Mekën, përballë faljes dhe drejtësisë së pafundme të tij, Hindi pranoi islamin duke dëshmuar shehadetin.

Në fakt;

Që kur Resulullahu (a.s.) filloi të kumtonte Kuranin Famëlartë, mushrikët politeistë kishin filluar të frikësoheshin. Në lidhje me kiametin tmerret e të cilit shpaloseshin që në suret e para, mohuesit filluan të flisnin në lidhje me «Lajmin e madh» dhe mes tyre lindi diskutimi; «Po sikur, realisht të jetë i vërtetë?»

Kjo do të thotë që kiameti dhe ahireti janë shqetësimi i besimtarëve, jobesimtarëve e i të gjithë njerëzve. Janë misteret për të cilat gjithkush kërkon zgjidhje...

Misterin e vdekjes dhe zbukurimin e saj, enigmën e kiametit dhe zgjidhjen e saj e ofron vetëm takvaja e devocioni...

Me afrimin ndaj Allahut të Lartmadhëruar, nëpërmjet takvasë, shqetësimet që njeriu ndjen në zemër fillojnë të zvogëlohen...

Vendin e trazirave dhe vuajtjeve që burojnë nga mungesa e zgjidhjes, e zë qetësia që sjell dorëzimi.



Rruga e shpëtimit nga tmerri i vuajtjeve është të jetuarit me një shqetësim pozitiv, i cili e përmirëson njeriun dhe e mban atë të karikuar me vlerat e imanit...

## TË JETOSH ME SHQETËSIMIN E FRYMËS SË FUNDIT

Allahu i Lartmadhëruar kërkon me ngulm që ne të jemi të sigurt gjatë ndodhisë së kiametit dhe në botën tjetër të ahiretit. Në një ajet kuranor Ai na tregon dy rrugët e shpëtimit tonë, atë të devotshmërisë, frikë-nderimit dhe atë të dhënies së frymës së fundit si mysliman:

***O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!*** (Al Imran, 102)

Mirësia e kësaj jete na është dhënë vetëm për një herë. Dhënia e shpirtit nuk do të realizohet më shumë se një herë në këtë botë. Nuk ekziston më një mundësi e dytë.

Prandaj njeriu duhet të kujdeset shumë për këtë mundësi të vetme, nuk duhet ta çojë dëm me indiferencë e neglizhencë. Jeta, pasuria, fëmijët e mirësitë e tjera që i janë dhënë atij për t'u sprovuar, nuk duhet ta largojë atë nga shqetësimi i dhënies së frymës së fundit me besim e me islam. Në një ajet kuranor thuhet:

***“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.”*** (Munafikun, 9)

Sepse mirësitë e pasurisë dhe fëmijëve në jetën e kësaj bote janë joshëse dhe të dashura për njeriun.

Nëse njeriu i etur për përjetësi, mashtrohet nga jeta e kësaj bote e zhytet në të duke menduar se pasuria e tij do ta shoqërojë vazhdimisht atë, e çon dëm lëndën që i është dhuruar atij për të fituar ahiretin duke e shpenzuar për dëshirat e tekat e egos së tij.

Sërish indiferenti në vend që pjesën më të dashur të tij, pra fëmijën,



ta edukojë në rrugën e Allahut të Lartmadhëruar, e ta kthejë atë në një lëmoshë rrjedhëse, me idealin e përgatitjes për të ardhmen, e lë fëmijën të painformuar në lidhje me ahiretin, e kështu çon dëm ahiretin e vet por edhe atë të fëmijës.

Allahu i Lartmadhëruar kërkon prej nesh që mirësitë të cilat janë si thika me dy presa t'i përdorim siç duhet.

Sepse shumica e njerëzve i keqpërdorin mirësitë e Allahut të Lartmadhëruar, si ai që në vend që të presë bukën me thikën e tij, pret damarët e dorës së vet. Allahu i Lartmadhëruar në lidhje me pishmanllëkun që njeriu do të përjetojë në frymën e fundit nëse do t'i keqpërdor mirësitë e Tij, shprehet:

***“...O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!”*** (Munafikun, 10)

***“Por Allahu nuk ia shtyn afatin asnjë shpirti, që i vjen koha (e vdekjes); Allahu e di mirë gjithçka që bëni ju.”*** (Munafikun, 11)

Që në çastet e fundit mos të përjetohen këto situata të frikshme është e domosdoshme që fryma e fundit të jepet në punë të mira e të hajrit. Kështu që shqetësimi i frymës së fundit nuk vlen vetëm për mohuesit dhe të shkujdesurit, por edhe për besimtarët.

Të gjithë në ahiret do të ndjejnë keqardhje dhe pendim. Një ditë, Resulullahu, (a.s.), u shpreh:

***“-Nuk ka njeri që vdes e nuk ndien keqardhje e pishmanllëk.”***

Sahabët pyetën:

***“-Për çfarë o i Dërguari do të ndiejnë njerëzit pasi të vdesin keqardhje e pishmanllëk?”***

Ai (a.s.) u dha këtë përgjigje:



*“-Vepërmirët do të ndiejnë keqardhje e pishmanllëk për faktin që nuk kanë vepruar më shumë vepra të mira. Ndërsa ata që kanë bërë vepra të këqija do të bëhen pishman për faktin e mosbraktisjes së veprave të këqija.”*

(Tirmidhi, Zuhd, 59.)

Ndërsa në një hadith tjetër i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

*“Banorët e xhenetit nuk do të përjetojnë keqardhje e pishmanllëk për asnjë tjetër të kësaj dynjaje, përveçse për çastet që kanë kaluar pa për-kujtimin e Allahut të Lartmadhëruar.”* (Hejsemî, X, 73-74.)

Allahu i Lartmadhëruar rëndësinë e mbajtjes së kiametit në qendrën e vëmendjes na e thekson me ajetin që i flet në mënyrë direkte Resulullahut, (a.s.), e bashkë me të edhe të gjithë umetit të tij:

*“(O i Dërguari Im!) A ke dëgjuar për Ngjarjen Gjithëpërfshirëse (Kiametin)?”* (Gashije, 1)

Lajmi i madh padyshim që na mbërriti. Mirëpo Allahu i Lartmadhëruar na tërheq vëmendjen në formën:

*“Si ka mundësi që veproni e jetoni sikur të mos ju kishte ardhur fare lajmi?! Si mundet të vraponi krejtësisht pas gjërave të boshta e të ulta duke rënë rob të ambicieve?! Pse kapitalin tuaj kryesor, pra jetën tuaj e çoni në huti e indiferencë?!”*

Në ajetët në vazhdim na jepen dy përfundimet e mundshme të një-rëzve, dy llojet e fytyrave, njëra fytyrë është e atyre që kanë jetuar me shqetësimin e frymës së fundit dhe tjetra e atyre që kanë jetuar në mos-kokëçarje:

*“Atë Ditë do të poshtërohen fytyra njerëzish.”* (Gashije, 2)

*“Atë Ditë, fytyrat e disave do të jenë të gëzuara.”* (Gashije, 8)

Sërish Allahu i Lartmadhëruar na fton në një tjetër shqetësim;



## NË ÇFARË GJENDJEJE DO TË JEMI ATË DITË?

Në jetën e kësaj bote kujdesemi shumë për pamjen e jashtme, pastërtinë, bukurinë dhe rregullin.

Po në jetën tjetër si do të jetë pamja, forma, fytyra jonë e jashtme? A nuk duhet në fakt t'u kushtohet edhe më shumë kujdes këtyre të fundit?

Si do të jetë fytyra jonë në botën tjetër?

Një fytyrë me dhë e pluhur, me gjak e djersë, me turp e marre, e vyshkur dhe e zezë?

Apo një fytyrë e lumtur, e ndritur, me shkëlqim, që ndriçon me shenjat e sexhdeve, bilur e pastër dhe e nurtë?

Në çfarë gjendjet do të jetë trupi ynë?

Një trup i shkretë, gjymtyrët e të cilët do të dëshmojnë kundër tij, e që do të ringjallet me shenjat e shëmtuara të gjynaheve që janë bërë në mënyrë të hapur e të fshehur, që është shtypur nga peshat e rënda të mëkateve, në qafën e të cilit është varur tabela e padrejtësive dhe dhunimeve që ka bërë gjatë jetës së kësaj bote?

Apo një trup që shëndrit nga abdesti, i plotë me nurin e Kuranit, me shenjat e veprave të mira që do të shpërblehen, i pastër, i bukur, i mrekullueshëm dhe i mbushur me qetësi?

Nuk duhet lënë në harresë;

Ajo që do të përcaktojë fytyrën dhe formën tonë në botën tjetër do të jetë niveli cilësor i zemrës në jetën e kësaj bote.

Zemrat e nxira e të bëra katran në jetën e kësaj bote do të bëhen shkak për një ringjallje të shëmtuar, të fishkur, përçmuar e të neveritshme.

Ndërsa zemrat që janë purifikuar e pastruar nga papastërtitë në jetën e kësaj bote dhe kanë bërë vepra të mira, me lejen dhe bujarinë e Allahut



të Lartmadhëruar, do të bëhen shkak për një ringjallje të bukur, të nurtë e të lumtur.

Si përfundim, jeta e kësaj bote, përbën themelin e botës sonë materiale e shpirtërore të botës tjetër.

Do të jenë të sigurt nga shqetësimi e dëshpërimi i të ardhmes tro-nditëse vetëm ata që do të miqësohen me Allahun e Lartmadhëruar në jetën e kësaj bote:

***“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.”*** (Junus, 62)

Prandaj, qëllimi i vetëm i kësaj jete është përparimi në rrugën e miqësisë me Allahun e Lartmadhëruar. Përpjekja dhe ngulmimi në të. Dhe receta e kësaj është:

## MIRËNJOHJA, FALËNDERIMI DHE DHIKRI

Ajeti në krye të sures Fatiha, që është më e dashura e gjuhëve tona;

***“Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve!”*** na fton drejt meditimit dhe reflektimit të të gjitha botëve dhe na kujton mirënjohjen ndaj madhësisë hyjnore.

Njeriu nuk duhet të jetë mosmirënjohës ndaj Allahut të Lartmadhëruar që e ka krijuar dhe i ka dhuruar kaq të mira të pafundme, e që në këmbim të kapitalit të dhuruar e të harxhuar në rrugën e Tij, e fton atë drejt xhenetit të mrekullueshëm të krijuar enkas për të. E kundërta e mosmirënjohjes është mirënjohja e falënderimi.

Për të qenë i vazhdueshëm në gjendjen e mirënjohjes e falënderimit është kusht të rrihet larg indiferencës. Ndërsa shpëtimi nga indiferenca realizohet nga dhikri, përmendja e vazhdueshme e Allahut të Lartmadhëruar.

Dhikri...



Të kujtuarit e Allahut vazhdimisht...

Të kujtuarit e vdekjes...

Të kujtuarit e kiametit e ahiretit...

Të kujtuarit e islamit në çdo segment të jetës...

Një zemër që nuk e harron Allahun e Lartmadhëruar nuk del nga rruga e duhur. Askush nuk e fillon me bismilah një padrejtësi apo një veprim që thyen zemrën e dikujt. Për këtë arsye në krye të punëve që e largojnë individin nga Allahu i Lartmadhëruar duke e çuar njeriun në indiferentizëm e gjynah është harrimi i Allahut Fuqiplotë. Allahu (xh. sh.) në disa ajete kuranore na këshillon:

***“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju! Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).”***

(Hashr, 18-19)

Që mirënjohja, falënderimi dhe përmendja e Allahut (xh.sh.) të jenë cilësi të vazhdueshme te njeriu duhet domosdo që zemra të rafinohet, zbukurohet e të urtësohet me vështirimin e manifestimeve madhështore hyjnore në vitrinat dhe vulat e Tij kudo në krijim. Duhet medoemos të jetohej me vetëdijën e sundimit të Tij.

Ndërkohë që këto tre cilësi e afrojnë njeriun me Allahun (xh.sh.) këto tri vese e pengojnë atë të bëhet mik i Tij;

## MENDJEMADHËSIA, KOPRRACIA DHE MARRËZIA

Për t’u miqësuar me Allahun e Lartmadhëruar duhet të eliminohen këto tri vese...

### **Pengesa e parë, mendjamadhësia dhe uni.**

Mendjemadhësia, -Zoti na ruajt prej saj-, është një tentativë për t’iu bërë Zotit ortak. Një arrogancë fatale.





Madhështia është cilësi vetëm e Allahut të Lartmadhëruar. Doktrina e teuhidit nuk e toleron në asnjë formë e mënyrë ortakërinë. Për këtë arsye mendjemadhësia dhe uni; ashtu si iblisin, e hedhin njeriun në greminë. Iblisi u armiqësua me Allahun e Lartmadhëruar për shkak të mendjemadhësisë.

**Pengesa e dytë është koprracia.** Koprracia që ushtrohet nga njeriu është tentativa e shfaqur nga njeriu për t'u bërë pronari i një malli që s'është i tij. Mirëpo;

«Pronësia i përket Allahut». Pasuria nuk është e individit. I është lënë atij përkohësisht në përdorim. Pronari i vërtetë i çdo pasurie është vetëm Allahu i Lartmadhëruar. Njëri nga kushtet e vendosura të përdorimit të saj është edhe dhurimi i saj duke qëndruar larg koprracisë dhe abuzimit në shpenzim, pra përkujdesja për krijesat e Allahut të Lartmadhëruar. Koprraci që përvetëson mirësinë që i është lënë amanet duke u bërë qorr ndaj të dobtëve, nevojtarëve dhe të varfërve dhe shurdh ndaj krijesave të cilat kërkojnë mëshirë, kurrë nuk do të bëhet mik i Allahut të Lartmadhëruar.

Koprraci nuk është vetëm të mos i japësh paratë tjetrit, por edhe të mos i japësh tjetrit diturinë, kohën dhe shërbimin.

Koprraci është edhe ta strehosh vetën në strofullën e dembelizmit duke thënë; «Unë bëra kaq shumë, a nuk mjafton? Tani le të bëjnë diçka edhe të tjerët!»

**Pengesa e tretë** e njeriut për t'u bërë mik i Allahut të Lartmadhëruar është **marrëzia**. Nuk bëhet fjalë për një marrëzi që vjen si rezultat i një të mete mendore apo vonese zhvillimi mendor. Marrëzia në fjalë, edhe pse gjoja mendja është në kokë, është fatkeqësia e terrimit të saj nga indiferenca, habitja e zemrës nga nefti, të preferuarit e kësaj bote ndaj tjetrës. Është përdorimi i mendjes për të lulëzuar jetën e neftit e për ta shndërruar në gërmadhë jetën e brendshme shpirtërore.



Një ditë khalifi i mylimanëve Sulejman bin Abdulmelik e pyeti Ebu Hazimin i cili kishte patur fatin të takonte sahabët e Resulullahut (a.s.):

“Çfarë ka ndodhur me ne që nuk e pëlqejmë vdekjen?”

Përgjigjja e tij ishte shumë kuptimplotë:

“Jeni mashtruar nga dëshirat e egos, keni lulëzuar jetën e kësaj bote dhe keni shkatërruar jetën e botës tjetër. Për këtë arsye nuk ju pëlqen të kaloni nga një vend i lulezuar në një vend të shkatërruar e plot gërmadha.”

I marrë me plot kuptimin e fjalës është ai person që dëgjon për vdekjen e të tjerëve e i sheh të tjerët teksa vdesin; kalon pranë varreve të tyre, por nuk kupton britmat e tyre. Poeti i madh i islamit, Rumi teksa bën dallimin ndërmjet të zgjuarit dhe të marrit shprehet:

*“Të zgjuarit qajnë në fillim; e në fund buzëqeshin me gëzim. Të marrët në fillim shkrihen duke qeshur, e në fund i bien gurit me kokë duke qarë e duke bërë titur. O njeri! Bëhu largpamës e shih fundin e gjësë qysh në fillim, që në ditën e gjyqit të madh mos të digjesh nga zjarri i pendimit!”*

Siç u tha edhe më sipër; «Ai njeri tek i cili gjenden këto tri vese; pra mendjemadhësia, koprracia dhe marrëzia, nuk miqësohet kurrë me Allahun e Lartmadhëruar.». Mirëpo kur këto vese luftohen deri në shkaktërrimin e tyre, atëherë fillon rrugëtimi drejt gjallërimit dhe reflektimit të shpirtit. Për t'ia dalë në luftën e madhe me këto vese, duhet bërë një përpjekje për fitimin e këtyre tri virtyteve:

1. Brendësimi i Kuranit dhe Sunetit dhe përhapja e tyre në çdo segment të jetës.
2. Përfshirja në mirësitë e thellësive të natës.
3. Arritja në të vërtetën e kuvendimeve (sohbeve).

Duhet ta konceptojmë si sahabët e nderuar Kuranin Famëlartë që është udhëzuesi ynë në të dyja botët, një mirësi e dërguar nga Allahu i Lartmadhëruar për të ruajtur të mbrojtur robët e Tij nga tmerri i ahiretit. Në perceptimin e tyre ajetet kuranore ishin;



## SOFRA TË ZBRITURA NGA QIELLI

Gjenerata fatlume në epokën e së cilës u shpall Kurani Famëlartë e konsideronte si mirësinë më të madhe shpalljen e çdo ajeti. Në fillim ata i mësonin ajetet e shpallura e mandej reflektonin e meditnin në lidhje me thellësitë përmbajtësore të tyre, diskutonin së bashku, mësonin me përkushtim e devocion dhe ishin të përfshirë nga një entuziazëm i veçantë përpjekjeje dhe vendosmërie.

Hazreti Omeri (r.a.) ka thënë:

“Së bashku me një komshi prej ensarëve, jetonim në një zonë të lartë të Medinës, aty ku jetonin pasardhësit e Umejje bin Zejdit. Uleshim me radhë poshtë për të marrë dituri nga Resulullahu (a.s.). Një ditë zbrisja unë e një ditë ai. Kur zbrisja unë ia sillja të gjitha informacionet atij në lidhje me shpalljen apo me ndonjë gjë tjetër, të njëjtën gjë bënte edhe ai në ditën kur i takonte atij të zbriste...” (Buhari, Kitabu'l Ilm, 27.)

Pra Kurani dhe Suneti duhen asimiluar e brendësuar në mënyrën më të plotë. Në shtëpi, në rrugë, në timon, në shkollë, në vendin e punës, në vendin e tregtisë... Si është jeta jonë në çdo segment të saj? Sa është ajo afër jetës së Resulullahut (a.s.)? Është e domosdoshme të jemi në një gjendje të tillë vetëllogarie për shpëtimin tonë në ahiret...

Kushti i nevojshëm për të zbukuruar ditën tonë me Kuran dhe Sunet është;

## PËRNDRITJA E NATËS ME NURIN E SEXHDEVE

Allahu i Lartmadhëruar dëshiron ta takojë robin e Tij në paraagim. Ai (xh.sh.) e fton atë ta gjallërojë natën me pendim, sexhde, lexim të Kuranit dhe me dhikër e përmendjen e Tij. Ai (xh.sh.) i hap dyert e faljes; thërret drejt mëshirës dhe pendimit.

Si i përgjigjemi ne kësaj ftese hyjnore?

Për t'ju përgjigjur ftesës së Allahut të Lartmadhëruar për në xhenetin



e Tij, na duhet të kujdesemi për gjallërimin e natës. Na duhet ta organizojmë jetën tonë sipas parimeve të shpallura prej Tij ku përkufizohen robërit e dashur me cilësitë përkatëse;

**«Ata që i kërkojnë falje Zotit në paraagim»,**

**«Ata që ia dalin të shkëputen nga shtrati i tyre i ngrohtë»,**

**«Ata që kalojnë natën në kijam e në sexhde».**

Teksa ia plotësojmë trupit nevojën e domosdoshme për gjumë, nuk duhet të harrojmë e të neglizhojmë nevojën e shpirtit për adhurim. Një ndër mjetet më efikase për vetëdijësimin tonë për të vërtetat që cituam më lart është kuvendimi (sohbeti)...

## ATMOSFERA E NDJESHMËRISË SË KUVENDIMEVE

Çfarë është kuvendimi?

Kuvendimi është grumbullimi i besimtarëve krah për krah, e zemër për zemër, vetëm për hirë të Allahut të Lartmadhëruar, për të përfutur nga bota shpirtërore e njëri-tjetrit...

Mirëpo për të përfutur prej së vërteti nga kuvendimet duhet të kuptohet thelbi i tyre.

Nëse kuptohet thellësisht e vërteta e kuvendimeve atëherë ato shërbejnë si recetë për çdo problem, në të kundërt kuvendimet marrin trajtën e grumbullimeve të pavlera e të padobishme.

Që disa njerëz të jenë bashkë nuk mjafton që ata të ndajnë të njëjtin vend e kohë, por ata duhet të ndajnë edhe të njëjtën frekuencë shpirtërore, e të njëjtën ndjeshmëri.

Sadi Shirazi duke u mbështetur në historinë e “banorëve të shpellës” që kalon në suren Kehf shprehet:

“Një qen u bë besnik sepse ruajti të mirët, prandaj përmendet edhe në Kuran. Ndërsa bashkëshortet e dy të derguarve të Allahut të Lartma-



dhëruar, Nuhut e Lutit, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta, vetëm pse u shoqëruan me të këqijtë u bënë prej banorëve të xhehenemit.”

Si përfundim, për t’u mbrojtur nga tmerri i kiametit dhe dënimi i ahiretit, për të qënë i sigurt nga frika dhe pikëllimi i asaj dite të tmerrshme duhet të aplikohen recetat e mësipërme:

Duhet të jemi vazhdimisht në gjendje mirënjohjeje, falënderimi dhe dhikri...

Duhet ta ruajmë zemrën nga mendjemadhësia, koprracia dhe marrëzia.

Duhet ta ngulisim Kuranin dhe Sunetin në jetën tonë, ta gjallërojmë jetën shpirtërore dhe t’i shtojmë përpjekjet për të përfituar sa më shumë nga kuvendimet me vëllezërit e besimit.

**Zoti ynë na e mundësoftë kalimin e jetës me merakun e frymës së fundit dhe të kiametit e na ndihmoftë ta jetojmë jetën duke e zbuluar atë me vepra të mira!**

**Në ditën e kiametit e në botën tjetër, na përfshiftë edhe ne në grupin e fatlumëve për të cilët në Kuranin Famëlartë thuhet «Ata nuk do të kenë frikë e as nuk do të brengosen»!**

**Amin...**





# DUNJAJA DHE AHIRETI

Në syrin e miqve të Allahut





# DUNJAJA DHE AHIRETI

në syrin e miqve të Allahut

## NJË PIKË PËRBALLË OQEANIT

Kemi dy jetë.

Njëra është kalimtare e tjetra e përhershme:

Dunjaja dhe ahireti...

Dunjaja në krahasim me ahiretin është si pika në raport me oqeanin.

Resulullahu, (a.s.), ka thënë:

*“Dunjaja në raport me ahiretin mund të krahasohet me ujin që merr gishti që futet në det. Le ta shohë ai që bën këtë provë se sa ujë mund të marrë gishti nga deti.”* (Muslim, Xhenet, 55.)

Njeriu, prejse ahireti është përtej perdes së misterit dhe për arsye se kjo botë është ngjitëse dhe plot kënaqësi të përkohshme, mashtruese dhe argëtuese, mund të bie në fatkeqësinë dhe marrëzinë e të preferuarit të kësaj bote përkundrejt botës tjetër. Rumi duke shprehur dhëmbshurinë e tij ndaj asaj mendjeje që bën këtë përzgjedhje të palogjikshme ka thënë:



*“Sa keq që keqpërdorimi i mendjes ia ka hapur emrin e keq asaj. Dëshira e shfrenuar ndaj kësaj bote e privon njeriun nga të shpresuarit e ahiretit.”*

Ajo çfarë i privon mohuesit nga e përjetshmja; është mohimi i ahiretit. Sa kontardiktor është në fakt ky mohim. Allahu i Lartmadhëruar atyre që mohojnë ringjalljen u kujton krijimin fillestar:

***“Njeriu thotë: «Vallë, pasi të vdes, a do të ringjallem përsëri?» A nuk e mban mend njeriu se Ne e kemi krijuar atë, kur ende nuk ishte asgjë?!”*** (Merjem, 66-67)

Ai njeri që harron ahiretin; do të thotë që ka harruar vetveten, por edhe krijimin. Kjo harresë është një arrogancë armiqësore ndaj Krijuesit. Në një ajet kuranor thuhet:

***“A nuk sheh njeriu se si Ne e krijuam atë prej pikës së farës, e megjithatë ai bëhet kundërshtar i hapët?!”*** (Jasin, 77)

Ishte periudha e Mekës. Një periudhë kur mushrikët që nuk besonin në botën tjetër, ushtronin çdo lloj terrori ndaj myslimanëve. Myslimanëve filloi t’u shterrojë durimi dhe toleranca. Disa prej tyre thanë:

*“Ne po përballemi me të gjitha llojet e vuajtjeve. Kurse politeistët po bëjnë një jetë të qetë e të rehatshme.”*

Kjo ishte edhe arsyeja që u shpall ajeti kuranor:

***“Ti (o Muhamed) mos u mashtro nga bredhja e jobesimtarëve nëpër botë! Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është Xehenemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend!”*** (Ali Imran, 196-197)

Resulullahu (a.s.) edhe në ditën më të mirë të mbushur me triumf e sukses, por edhe në ditën më të keqe në të cilën po përjetonte vuajtje e trishtim është shprehur:

*“Jeta e vërtetë është jeta e ahiretit.”*

Jeta e kësaj bote është një pikë uji përballë ahiretit, një përfitim mi-



nimal, e një interes shumë afatshkurtër. Ata që e mohojnë Allahun e Lartmadhëruar në jetën e kësaj bote, gjynahqarët që nuk i pranojnë të dërguarit e Tij që u kujtojnë atyre Allahun e Lartmadhëruar dhe ahiretin, në botën tjetër do ta pohojnë faktin që kjo dynja është një «përfitim krejt i vockël» kështu:

## SA KOHA E MËNGJESIT!

Allahu i Lartmadhëruar na informon se gjynahqarët gjendjen e kësaj bote përballë ahiretit do ta përkufizojnë kështu:

***“Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t’u duket se kanë qëndruar (në Tokë) veç një mbrëmje apo një mëngjes.”*** (Naziat, 46)

Me të vërtetë njeriu indiferent duke zgjedhur dëshirat e ulta e kalimtare të kësaj bote, e çon dëm jetën e pafundme dhe të lartuar të ahiretit.

Në një ajet kuranor thuhet:

***“Këta janë ata që jetën e kësaj bote e kanë blerë me jetën e ardhshme. Atyre nuk do t’u lehtësohet dënimi dhe askush nuk do t’u vijë në ndihmë.”*** (Bekare, 86)

Ai që e kupton këtë të vërtetë nuk i jep asnjë grimë vlerë jetës së kësaj bote. Rumi shpreh:

***“Nëse njeriu do ta shihte ahiretin qoftë edhe një fije, do të shprehej: «Kjo jetë tokësore e jotja qoftë!»”***

Mashtrimi që i bën kjo botë njeriut është si mirazhi i oqeanit në mesin e shkretirës.

Nëse ai do ta shesë lumturinë e ahiretit për të fituar jetën e kësaj bote, nuk do t’i hyjë në dorë asgjë tjetër veç rërës së zharitur nga zjarri i pendimit dhe humbjes.

Ata që mashtrohen nga dashuritë ordinere, kalimtare dhe nga mirazhi i kënaqësive të rreme nuk do të kenë pjesë nga mirësitë e përhershme. Do të orvaten në vyshkjen e ambicieve dhe vuajtjeve të tyre.



Kursë lumturia dhe triumfi i jetës arrihet nëpërmjet shkatërrimit të vullgaritetit të nefsit (egos).

Për t'ia dalë kësaj duhet menduar;

Çfarë është jeta e kësaj bote?

## DISA FRYMË TË KUFIZUARA NË NUMËR

Allahu i Lartmadhëruar betohet në asrin.

Betohet në kohën që ikën fluturimthi.

Çdo gjë merret e jepet borxh kurse thesari i kohës jo.

I çuditshëm është fakti që çdo njeri e di se një ditë me padyshim do të vdesë.

Mirëpo shumë njerëz tregohen budallenj duke e neglizhuar këtë fakt.

Kurani i madhërishëm që na ofron mundësinë e të vrojtuarit të skenave të asaj **dite të vështirë** / (Tekst arabisht), na informon se gjynahqarët do ta shpjegojnë indiferencën e tyre në këtë formë:

Banorët e xhenetit do të pyesin banorët e xhehnemit:

**“Çfarë ju ka sjellë në Sekar?”** (Muddeththir, 42)

Ata do t'u përgjigjen:

**“-Nuk ishim nga ata që falnin namaz**

**-dhe as prej atyre që i ushqenin të varfrit.**

**-Ne lëshoheshim në biseda të kota me llafazanët**

**-dhe mohonim Ditën e Llogarisë,**

**derisa na erdhi vdekja.”** (Muddeththir, 43-47)

Sepse kur ja beh vdekja e njeriu niset për në botën tjetër asnjë monedhë nuk vlen për në portën e mbretërisë së ahiretit veç;



## THESARIT TË IMANIT

Qëllimi i imanit është e arritja e të vërtetës së dëshmisë (tekst arabisht) La ilahe il-lall-llah.

Në majat e besimit arrihet vetëm me dituri, adhurim, vepra të mira dhe moralin e bukur.

Imani është dielli i të vërtetës që ndriçon këtë botë, botën e varrit dhe botën tjetër të ahiretit.

Imani është një hartë drite (nuri) që shpjegon gjeografinë e jetës mbas vdekjes, e asaj bote me plot të panjohura.

Imani është dokumenti që konfirmon pranimin e robit në audiencën hyjnore. Është ftesa e hyrjes në lumturinë e përhershme.

Është diploma e nurtë e fshehtësisë së pavdekësisë e shkruar me lapsin e të vërtetës.

Sërish, imani është shfuqizimi dhe pranimi i pamjaftueshmërisë së çdo dashurie tjetër veç asaj të Allahut të Lartmadhëruar, i çdo diturie dhe njohjeje veç «marifetullahut (njohjes së Allahut xh.sh.)».

Sa bukur e shpreh poeti këtë të vërtetë:

*Imani është ai thesar që o Zot sa i madh  
Një zemër e ndryshkur, në gjoks një barrë!*

Indiferentët, që e pandehin këtë jetë një orëshe si të pafundme, e që e çojnë këtë botë të gënjeshtërt me të hutuarit e zhytur në të, nesër kur Israfil i t'i fryjë Surit, do të strehohen më kot në britmat e tyre për ndihmë.

Nje tjetër skenë e ahiretit është edhe kjo:

***“Atje, ata do të thërrasin: «O Zoti ynë, nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë.» (Atyre do t’u thuhet): «Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi? Andaj, shijoni (dënimin)! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!» (Fatir, 37)***



Për t'i shpëtuar këtij fundi të tmerrshëm Rumi shprehet:

*“Thirri mendjes e përpiqu ta shohësh fundin e gjërave, që në fillim mëto.  
Syrin që mund ta shohë të vërtetën e ahiretin, me indiferencë mos e qërro.”*

Ai që nuk e përcepton përkoshmërinë e kësaj jete, edhe nëse sheh së jashtmi, së brendshmi është i verbër. Ai që e përcepton përkoshmërinë, por nuk përpiqet të bëhet gati për ahiretin edhe nëse duket sikur jeton në aspektin biologjik, me zemër është i vdekur. Këta duke e çuar dëm jetën në indiferencë, egocentrizëm, kundërshtim e harlisje, i kanë shndërruar trupat e tyre të kësaj bote në varrezat e shpirtërave të tyre, ata kanë rënë në fatkeqësinë e pandehjes së mjerimit për lumturi e shpëtim.

Një ditë Nexhmeddin Kybra, që njihet si një personalitet që jetën e kësaj bote e kaloi me shqetësimin dhe merakun e botës tjetër, së bashku me ndjekësit e tij, mori pjesë në një xhenaze. Kur imami po i këndonte talkinën të vdekurit, ky mik i Allahut të Lartmadhëruar vuri buzën në gaz, një gjë kjo që nuk ishte vërejtur më parë të bëhej nga një burrë i devotshëm si ai. Njëri nga ndjekësit e tij mori guximin dhe e pyeti:

“I nderur, nuk më ka rastisur t’ju shoh më parë duke vënë buzën në gaz. Cila është urtësia e buzëqeshjes tënde në këtë xhenaze?”

Nexhmeddin Kybra me të njëjtën buzëqeshje i kthehet ndjekësit të tij:

“Biri im, sipas rregullit të islamit, i gjalli ia këndon talkinën të vdekurit. Mirëpo në rastin e kësaj xhenazeje ndodhi e kundërta. Ai që këndoi talkinën e kishte zemrën e vdekur, ndërsa ai që u varros e kishte zemrën krejt të gjallë. Të kënduarit e talkinës nga ana e një të vdekuri një të gjalli më bëri shumë çudi.”

Rruga e gjallërimit të zemrës është vdekja pa vdekur. E kështu të hiqet dorë nga dëshirat tekanjoze te nefsit. Omeri (r.a.) ka thënë:

*“Merreni vetën në llogari sa jeni pa u marrë në llogari.”* Zbukurohuni (me vepra të bukura) për paraqitjen e madhe (kur njeriu do të dalë para Allahut të Lartmadhëruar për të dhënë llogari). Padyshim për atë i cili



do ta marrë vetën në llogari sa është në jetën e kësaj bote, llogaria e botës tjetër do të jetë më e lehtë dhe kollajtë. (Tirmidhi, Kijamet, 25, 2459)

Për shpëtimin dhe qetësinë në botën tjetër, duhet t'u rezistojmë situatave që nuk janë të preferueshme për nefsën tonë, është thelbësore të shprehim pëlqimin tonë ndaj asaj që është caktuar për ne.

Hafiz Shirazi në lidhje me këtë temë shprehet:

*“Nëse në kopshtin e kësaj bote nuk duron dot as edhe një gjemb,  
kam frikë se do të dalësh nga ky kopsht pa këputur asnjë gem.”*

Sepse rezistenca shpirtërore e njeriut rritet në raport me kapërcimin nga ana e tij e pengesave gjatë jetës. Për këtë arsye Allahu i Lartmadhëruar i ka kaluar profetët në hallkën e sprovës e vuajtjeve të rënda. Njeriu sprovohet mbi bazën e dhuntive të dhuruara. Allahu i Lartmadhëruar do të kërkojë llogari për çdo mirësi të dhënë robit nga ana e Tij. Në një ajet kuranor thuhet:

***“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!”*** (Te-kathur, 8)

Rruga e shpëtimit është të shikuarit e kësaj bote siç realisht është, pra si shkollën e provimit për të cilën do të merremi në llogari.

Atëherë duhet të mendojmë;

## ÇFARË ËSHTË KJO BOTË?

Kjo botë nuk është vendi i argëtimit e i harlisjes.

Përkundrazi, kjo botë me çfarë ka brenda, i gjithë universi nga fillimi e deri në fund, nga grimca te planetet përbëjnë një poemë meditimi dhe reflektimi... Qielli, toka, malet, gurët, zogjtë, kopshtet janë shkolla madhështore meditimi...

Kur shihet universi me syrin e zemrës do të vërehet se çdo gjë, nga grimca më e vogël e deri te planetet e mëdha, janë zbukuruar me ma-



nifestimet e madhështisë dhe fuqisë hyjnore. Çdo gjë, për ata që kanë zemër, është një vitrinë hyjnore, është vullë e madhështisë së Allahut të Lartmadhëruar.

Universi i shqyrtuar përmes shpirtit është plot me qëllime të imta, e urtësi delikate. Universi sipas një vështrimi të përgjithshëm është një shkollë besimi me shumë provime. Në këtë botë që drejtohet dhe menaxhohet nga Allahu i Lartmadhëruar, njerëzit që tregojnë negativitet dhe mungesë rregulli, ngaqë harxhojnë dhuntitë e tyre jo në përputhje me kënaqësinë e Allahut të Lartmadhëruar, janë përgjegjës për faktin që kanë shuar mundësinë e fitimit të ahiretit dhe nuk janë përpjekur ta sigurojnë atë. Dërgimi i profetëve dhe tërhekja e njerëzimit drejt përsosmërisë me gjuhën, diturinë dhe moralin e tyre, është një mirësi hyjnore. Kurani famë-lartë me argumente logjike, ndjesore dhe morale na e shpjegon ahiretin, për eksistencën e të cilit bien dakort të gjitha fetë.

Kur njeriu sheh me sy të kujdesshëm veten por edhe atë çfarë e rrethon atë, menjëherë e kupton se përballë fuqisë dhe pushtetit hyjnorë të flasësh për pamundësinë e eksistencës së ahiretit është e turpshme dhe qesharake.

Në jetën e kësaj bote ka shumë mirësi, por secila prej tyre është një lëndë provimi. Do të merremi në llogari për çdo frymë, kafshatë, pikë e për çdo çast. Ku dhe si i kemi harxhuar ato. Sepse kjo botë;

## ËSHTË ARA E AHIRETIT

Kjo shprehje që është bërë e famshme si hadith, shpreh një të vërtetë shumë të rëndësishme:

*“Dynjaja është ara e ahiretit.”* (Axhlûnî, Keshfu'l-Hafâ, I, 412.)

Të gjitha të vërtetat që shprehin të qenët e kësaj bote të pavlerë, konsistojnë në dhënien e tërësishme të njeriut ndaj kësaj bote duke e harruar ahiretin. Rumi në lidhje me këtë temë shpreh:





*“Çfarë është dynjaja? Dynjaja është indiferenca e njeriut ndaj Allahut të Lartmadhëruar. E jo të poseduarit e kumashit, parësë, tregtisë, gruas, e fëmijëve.”*

Dynjaja duhet ta afrojë njeriun me Allahun e Lartmadhëruar, frymët duhet të jenë hapa që hidhen drejt lumturimit tonë në ahiret.

Njeri i përsosur është ai që në shiritin e jetës lë kujtime besimi, dashurie, dhurimi, morali e veprash të mira.

Rreziku dhe trishtimi më i madh është malli dhe pasuria në duart e injorancës dhe fatkeqit. Pasuria që nuk shoqërohet me moral dhe virtyt të lartë i hap derën fatkeqësive personale dhe shoqërore.

Rumiu në lidhje me këtë temë është shprehur:

*“Ai që do ta dinte se kjo botë është ara e mbjelljes për mahsherin (ringjalljen), do të mbillte shumë për të korrur në botën tjetër shumë.”*

Çdo njeri në këtë jetë është fermeri i botës tjetër. Ai do të korrë në botën tjetër çfarë ka mbjellë në këtë botë. Atij që do të dërgojë nga ara e kësaj bote vepra të mira do t'i buzëqesh fytyra në rrëmujën e ahiretit. Allahu i Lartmadhëruar në një ajet kuranor ka thënë:

***“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit...”*** (Teube, 111)

Pra sipas botkuptimit të duhur kjo botë nuk është vendi i qejfit, lojës e argëtimit, por vendi i sakrificës, përpjekjes dhe punëve të hajrit.

Në një ajet kuranor thuhet:

***“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t'u zbavitur! Ne i kemi krijuar ato me qëllim të plotë, por shumica e tyre nuk e dinë.”*** (Duhan, 38-39)

Do të vijë një ditë, e cila nuk ka të nesërme! Ajo ditë për secilin prej nesh është e panjohur! Fjalët që nuk jetohen dhe veprimet që bëhen me ego, janë si qerasje e zbrazur. Këto fjalë dhe zëra i merr era e jetës, zhduken



pa lënë asnjë gjurmë. Ndërsa gjendjet dhe fjalët e miqve të Allahut të Lartmadhëruar vazhdojnë të jetojnë e të zbukurojnë zemrat e besimtarëve.

Sa bukur e shpreh Rumi të vërtetën që malli dhe pasuria janë një amanet i lënë për të fituar botën tjetër:

*“Resulullahu (a.s.) për ata që mallin dhe pasurinë e tyre e kanë ndarë për Allahun e Lartmadhëruar ka thënë; «Sa pasuri e bukur, sa mall i begatë!». Uji brenda anijes e fundos anijen. Ndërsa uji jashtë saj e mban mbi supet atë. Kur e hodhi dashurinë për mallin dhe pasurinë nga zemra, Sulejmani (a.s.) i tha vetes fakir. Një shtambë me gojë të mbyllur gjezdis mbi detin e paanë, ashtu siç shëtit shpirti i mbushur me ajër e frymë. Ai që në shpirtin e tij ka ajër e frymë dashurie shëtit mbi dynjanë pa u fundosur në të duke vëzhguar manifestimet hyjnore. Kjo botë për rrugëtarin është një hiç, pasi ai është i vetëdijshëm se është e tëra e Zotit. Kështu që mbushë zemrën me diturinë ledunni, me ashkun hyjnor, e lidhja gojën e vulose atë.”*

Resulullahu (a.s.) na tregon për shkaqet dhe përfundimet e arritjes së zemrës në këto nivele:

Transmetohet nga Ibn Mesudi (r.a.):

Një ditë i Dërguari i Allahut, (a.s.) lexoi ajetin 22 të sures Zumer.

***“...ai që Allahu ia ka hapur kraharorin për të pranuar Islamin, duke qenë kështu në dritën e Zotit të vet...”***

Më pas shtoi:

*“Kur drita hyn në zemër ajo qetësohet dhe zgjerohet.”*

Sahabët e pyetën Resulullahun (a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! Cilat janë shenjat e kësaj?”

Resulullahu, (a.s.), iu përgjigj:

*“Largimi (me zemër) prej dynjasë dhe afrimi (me vepra të mira) ndaj ahiretit.”* (Taberî, Tefsir, VIII, 37)



Sa kuptimplotë është shembulli i mëposhtëm që lidhet me reflektimin e zemrës në veprat tona:

Nëse në rrënjët e një pemë ka ndonjë kalbësirë, ajo shfaqet edhe në gjethet dhe frutat e saj. E njëjta gjë funksionon edhe për njeriun. Nëse ai në zemrën e tij ka ndonjë sëmundje apo indiferencë, ajo shfaqet edhe në prirjet dhe veprat e tij. Rumi në vargjet e tij shprehet:

*“Nëse pema është e shtrembër edhe hija e saj është e shtrembër.”* Nëse nuk e marrim në dorë për ta drejtuar botën tonë të brendshme atëherë edhe bota jonë e jashtme do të shndërrohet në gërmadhë. Imam Shafiu ka thënë:

*“Nëse nuk e angazhon veten me të vërtetën, do të të angazhojë e pavërteta.”*

Prandaj duhet vazhdimisht të angazhohemi me punë të hajrit duke menduar për ahiretin. Tekefundit kushti i parë i lumturisë është robëria ndaj Allahut të Lartmadhëruar. Ata që rrinë larg Hakut dhe që vrapojnë pas iluzionit të lumturisë së përkohshme të kësaj dynjaje, për zemrat me besim e devocion janë humbje dhe mjerim. Një mashtrim i hidhur.

Të mirat e kësaj bote duhet t’i bëhen dritë morale, njerëzore dhe ahireti të zotit. Nuk ka mjeshtëri më të rëndësishme së ajo që e ndihmon njeriun t’i shndërrojë të mirat e kësaj bote në kapital ahireti.

I pasuri së brendshmi dhe së jashtmi, nuk duhet të jetë një llambë specifike vetëm për familjen e tij, por ai duhet të ndriçojë të gjithë. Ai duhet ta japë pasurinë në rrugën e Allahut të Lartmadhëruar, duhet të kujdeset për të varfërit e nevojtarët, duhet t’u gjendet pranë atyre që nuk kanë askënd, duhet t’u japë udhëzim e mëshirë atyre që kërkojnë udhëzim e mëshirë.

Sepse njeriu është si ai udhëtari që duke kaluar ditët i afrohet më shumë destinacionit. Destinacioni që do të arrihet është ahireti. Përgatitja më e vlefshme për destinacionin në fjalë është devocioni, dhe shoku



më i mirë është vepra e hajrit. Rumi në veprën e pavdekshme të tij, të mburrur me Kuranin dhe Sunetin e Resulullahut (a.s.), në Mesnevinë e tij shprehet:

*“Resulullahu (a.s.) ka thënë:*

*«Për (të fituar) ahiretin nuk ka asnjë shok më të mirë se adhurimi, mirësia dhe vepra e mirë. Nëse vepra që ti ke bërë është vepër e mirë atëherë ajo do të të bëhet miku yt i përhershëm. Nëse ajo është e keqe atëherë bëhet gjarpri yt i varrit që do të të kafshojë.»”*

Resulullahu (a.s.) ka thënë:

*“Të vdekurin e shoqërojnë tri gjëra: Familjarët, pasuria dhe vepra. Dy prej tyre kthehen dhe vetëm njëra mbetet me të. Familjarët dhe pasuria kthehen kurse vepra mbetet me të.”* (Buhârî, Rikâk, 42; Muslim, Zuhd, 5.)

Ndërsa Rumi në njëjtën të vërtetë e shpreh kështu:

*“Ty të duhet një mik që ashtu i gjallë do të hyjë në gropën e varrit me ty. Ai propozet me ty duke qenë gjallë, ndërkohë që ti do të jesh i vdekur. Nëse është i mirë do të të bëjë mirë. Nëse është i keq do të të shtyjë për nga e keqja. Ky mik është vepra, puna jote. Sa të kesh mundësi e forcë rregullo veprën, punën tënde!”*

Dynjaja është një shkollë provimi, ndërsa jeta e kësaj bote është një afat i dhënë për këtë provim.

Ndërsa në fundin e këtij provimi;

## DO TË DALIM NË AUDIENCË!

Allahu i Lartmadhëruar nëpërmjet ajeteve të ndryshme na informon për përkohësinë e kësaj bote, për ringjalljen pas vdekjes, e për daljen tonë në audiencën e Tij.

Kur njeriu jep frymën e fundit, lë çdo gjë të kësaj bote këtu dhe vrapon drejt audiencës hyjnore. Në një ajet kuranor thuhet:



***“Tashmë na vini veç e veç, ashtu siç ju krijuam herën e parë, duke lënë pas vetes ato që ju patëm dhuruar...”*** (En'am, 94)

Allahu i Lartmadhëruar do ta shkatërrojë këtë botë që e ka kriju për njeriun, ndërsa njeriun do ta ringjallë në botën e përhershme. Sa e trishtë është që njeriu ta hedhë veten në zjarr për gjërat kalimtare të kësaj dynjaje.

Njeriu duhet ta jetojë këtë botë me shqetësimin e ahiretit. Allahu i Lartmadhëruar, i Cili është i patëmeta, larg absurdit dhe të pakuptimtës, nuk e ka krijuar atë pa asnjë qëllim; dhe nuk do ta lër pa marrë në llogari atë që neglizhon këtë qëllim. Në një ajet kuranor thuhet:

***“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?”*** (Kijame, 36)

Njeriu që harron qëllimin e krijimit, duke iu shmangur detyrës së robërisë, e duke shtyrë jetën e tij në mbretërinë e Allahut të Lartmadhëruar në mënyrë egoiste dhe pas punëve boshe, në çastin e vdekjes do të pendohet, por pa asnjë dobi. Allahu i Lartmadhëruar në një ajet kuranor thotë:

***“Agonia e vdekjes do të sjellë të vërtetën (e jetës tjetër): «ja, kjo është ajo së cilës përpiqeshe t'i ikje!» Dhe do të fryhet në Sur - kjo është Dita e kërcënimit.”*** (Kaf, 19-20)

Ndërsa ata që do të jetojnë në përputhje me pëlqimin e Allahut të Lartmadhëruar e me qëllimin e tyre të krijimit, do të përballen me selame e sihariqe. Në një ajet kuranor thuhet:

***“Me të vërtetë, atyre që thonë: «Zoti ynë është Allahu», e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t'u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t'u thonë: «Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.»*** (Fussilet, 30)

Allahu nuk do që njeriu të ketë zemër të zbrazët e të pagdhundur. Ai dëshiron modelin e mikut. Ai dëshiron ta qerasë krijesën e Tij.

Në këtë botë, por edhe në botën tjetër, gjatë vdekjes, por edhe në ri-



ngjallje, dëshiron ta ndihmojë krijesën e Tij. Selami i Allahut ndaj robërve që do t'ia dalin ta meritojnë ndihmën e Allahut të Lartmadhëruar, që do të dalin para Tij me zemrën e përsosur, dhe të shpëtuar nga harbutëria e nefsit, do të jetë ky:

***“Hyni në të (Xhenet) me paqe e siguri. Kjo është Dita e amshimit!”***

(Kaf, 34)

Me shprehjen e Junus Emresë, për atë që nuk mashtrohet nga «bota e rreme», për atë që kapitalin e tij të jetës e përdor duke dhuruar, shërbuer, e bërë vepra të mira, për të fituar jetën e vërtetë të ahiretit, për ata besimtarë që me devocion mbërrijnë në audiencën hyjnore, Ahireti nuk është një fatkeqësi e rëndë, por një freski qetësimi dhe sigurie nga frika dhe trishtimi:

***“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.”*** (Junus, 62)

Për të arritur në këtë gradë miqësie duhet bërë përpjekje e vazhdueshme për edukimin e nefsit, për prehjen e zemrës, për zhvlerësimin e kësaj dynjaje dhe të çdo gjëje që ajo përmban, në syrin dhe zemrën e besimtarit, e kështu të arrihet gjendja e shikimit të rrezatimeve të forcës hyjnore dhe vulave të Fuqisë së Tij kudo.

Kjo do të thotë që për të perceptuar saktësisht dynjanë dhe Ahiretin duhet;

## **TË VËZHGOHET E VËRTETA DHE URTËSIA**

Urtësia e bën mendjen që të kuptojë pamjaftueshmërinë e saj. Misteret që nuk kuptohen me mendje, zgjidhen me urtësi, si në rastin e historisë me Musain dhe Hidrin. E rëndësishme është të mund të lexosh me urtësi. Fillimi i shpalljes së Kuranit me urdhërin (tekst arabisht) **“Lexo!”**, përmban një nivel shumë të lartë urtësie. Të mund të lexosh, është kusht që t’i zotërosh këto urtësi, tekefundit universi lexohet nëpërmjet urtësive.



Nëse nuk do të ishin lexuar urtësitë dhe s'do ishin hapur të fshehtat, edhe thesaret e diturive më të zakonshme do të ishin të pakuptimta. Nuk do të ndërtohej qytetërimi i virtyteve, e nuk do të shfaqeshin në skenën e historisë personalitetet monumentale si Junus Emre, Shah Nakshibendi, Rumi dhe Hydaji. Pra mos të ishin urtësitë, të fshehtat do të rrinin të mbyllura dhe njerëzit nuk do të zhvilloheshin shpirtërisht. Zhvillimi i njeriut realizohet në masën në të cilën kuptohen dhe përjetojnë sekretet. Sepse;

Kur zbresin fshehtësitë, mendja hesht; fillon të përshkohet rruga shpirtërore, fillon thellimi shpirtëror, dhe frymëzimet zbrazen në zemër e shpirt si shi i begatë.

Atëherë perceptimet fillojnë të zhvillohen e thellohen:

Njeriu është i paaftë. Vazhdimisht nevojtar i Zotit të tij. Është Allahu i Lartmadhëruar Ai që ia mëson njeriut sekretet e Tij.

Ndërsa mjeti janë profetët e Tij. Kurse kushti është takvaja- devocioni.

Pra;

## URTËSIA DHE DEVOCIONI

Në një ajet kuranor thuhet:

***“...kini frikë Allahun! Allahu ju mëson ju (çfarë nuk dini)...”*** (Bekare, 282)

Thellimi shpirtëror i besimtarit dhe të jetuarit e tij në devocion lidhet shumë me faktin se sa ai zhytet në detin e urtësisë. Aq sa urtësohet atëherë zhvillohet shpirtërisht dhe mëson misteret e Kuranit. Kështu ai fillon të lexojë...

Pra;

Kurani, universi, njeriu dhe çdo gjë që mund të lexohet, mund të kuptohet e lexohet vetëm me një zemër të devotshme dhe me urtësi. Sytë në këtë proces leximi janë vetëm mjet për te zemra.



Miqhtë e Allahut gjetën jetë në klimën e këtyre të vërtetave, e kështu e kompletuan qasjen e tyre ndaj fesë me dituri të jashtme, por edhe me dituri të brendshme. I përsosën sjelljet e tyre duke bërë një rrugëtim të brendshëm zemre. E merituan titullin e nderuar veresetul enbija (trashëgimtarë të profetëve).

Pra;

## TRASHËGIMTARË TË PROFETËVE

Ata kanë shpirtëra të pastër që u shërbejnë si pasqyrë njerëzve të tjerë.

Ata janë shembuj udhëzimi dhe morali profetik të shpërndarë në kohë. Ata flasin për realitetin e pandryshueshëm të njeriut në këtë botë dhe në tjetrën. Ata me mesazhet e tyre jetojnë edhe pas vdekjes. Ata e ndihmojnë njeriun në njohjen e vetes. U japin shpirtërave siguri dhe qëndrueshmëri.

Për besimtarët burimi kryesor i lumturisë e i qetësisë është dashuria e Allahut të Lartmadhëruar dhe e të Dërguarit të Tij. Kuvendimet e vepërmirëve ta japin mundësinë e shijimit të kësaj dashurie, prandaj ato duhen konsideruar si një pasuri paçmuar.

Kuvendimet e vepërmirëve dhe ato të dijetarëve janë si dy xhenete, brenda të cilëve ka sy e zemra të ndezura.

Sigurisht ata gëzojnë prirje e tyre shpirtërore, sipas manifestimeve të ndryshme hyjnore.

Sepse;

Dikush ndodhet në luginën e mahnitjes përballë madhështisë hyjnore. Dikush përumbet në heshtjen e thellë, pa zë, pa fjalë dhe pa gjuhë.

Nga të diturit dikush lihet përgjegjës për të shpalosur të vërtetat me gjuhën e gjendjes, si Bahaeddin Nakshibendi.





Të tjetër si Junus Emreja me shokë bëhen bylbylët e dashurisë hyjnore.

E disa të tjerë si Rumi me të ngjashmit e tij me gjuhën e zemrën e tyre bëhen;

## BURIM KUPTIMI

Rumi si dijetari tek i cili u shpërfaqen një numër i pafundëm i manifestimeve të atributit kelam (fjalës hyjnore) ka arritur pothuajse në pozitën e zëdhënësit të tyre. Dituritë, urtësitë, misteret që i dhuroi Allahu i Lartmadhëruar atij, i konkretizoi në shprehje me një autoritet të posaçëm interpretativ.

Kjo për arsye se njerëzit e periudhës në të cilën ai e jetoi jetën e kësaj bote, kishin një trazirë e si rezultat edhe nevojë për atë që bëri Rumi.

Në një kohë kur invazioni mongol po bënte kërdrinë, dogmat e prishura fetare e mykja morale po përhapeshin në mënyrë të frikshme, shpirti njerëzor ishte bërë si shtëpi që digjej, mbushë me duman e paqartësi. Shpirtërat kishin një nevojë të jashtëzakonshme për freski e prehje.

Pikërisht në këtë kohë shfaqet Rumi i cili hap dritaret e qartësisë e urtësisë dhe përhap klimën e sigurisë dhe qëndrueshmërisë për të gjithë nevojtarët.

Ai, duke iu referuar shprehjes së Aliut (r.a.): *“Paqtojini shpirtërat me fjalë dhe veprime të urta, sepse ashtu siç lodhen dhe dobësohen trupat, ashtu edhe shpirtërat lodhen dhe dobësohen.”*, e konsideronte si shërbim këtë angazhim.

Sheb-i arus-in, pra natën e dasmës, e bëri urë ndërmjet kësaj dynjaje dhe ahiretit. Ai na tërhoqi vëmendjen sesi duhet ta jetojmë këtë botë në mënyrë që nata në të cilën hidhet hapi drejt ahiretit, të shndërrohet në natën e dasmës, natën e gëzimit, natën e prehjes dhe të rifreskimit, pra që ajo të bëhet nata e arritjes tek Allahu (xh.sh.), i Cili është më i bukuri dhe më i patëmeta.



Kështu Rumi me veprat e tij iu bashkua karvanit të të pavdekshmëve.

## MIQTË E ALLAHUT (XH.SH.) NUK VDESIN

Sepse;

Ata vazhdojnë të jetojnë edhe pasi e braktisin këtë jetë kalimtare nëpërmjet sadekave rrjedhëse dhe veprave plot urti që kanë lënë pas. Miqtë e Allahut (xh.sh.) i kanë kthyer në parime të dynjasë dhe ahiretit, këshillat dhe fjalët që burojnë nga Kurani dhe Suneti.

Prandaj me rastin e ditëve të Sheb-i arusit kemi cituar këshilla dhe mesazhe të miqve të Allahut (xh.sh.) që janë kandil ndriçues për rrugën dhe dritë e shpirtit, me shpresën që do të mund të kthehen në çelësa për të hapur zemrat. Sa me kuptim janë këto fraza që përmbajnë kriteret më të rëndësishme të formësimit të dynjasë dhe ahiretit e në të njejtën kohë që përfshijnë edhe themelin e meditimit dhe reflektimit:

**“Dynjaja është tregu i besimtarëve. Nata dhe dita janë kapitali i besimtarëve. Veprat e mira janë malli që ata tregtojnë. Xheneti është fitimi i tyre, ndërsa xhehnemi është humbja.”** (Ebu Bekr r.a.)

Njeriu i dërguar në këtë dynja për fitimin e përjetësisë, do të marrë përfitimin sipas punës së kryer. Në një ajet Kuranor thuhet:

***“... kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë.”*** (Zelzele, 7-8)

Sipas këtyre ajeteve, xheneti dhe xhehnemi janë rezultat i veprave të njerëzve. Pasi ato të manifestohen, nuk do të ketë më kthim prapa, prandaj e vetmja zgjidhje është vlerësimi siç duhet, me vepra të mira, i kapitalit të ditës dhe të natës, në tregun e kësaj dynjaje.

**“I zgjuar është ai që ka devotshmëri, i pamend është ai që bën padrejtësi.”** (Ebu Bekr r.a.)



Rruga e vetme për të fituar xhenetin dhe kënaqësinë e Allahut është devotshmëria. Duke qenë kështu, largimi nga sinqeriteti dhe fundosja në padrejtësi nuk janë veprat e duhura të një personi të zgjuar. Më të këqinj të pamendëve veprojnë në formë të tillë. Çfarë fituan Nemrudi dhe Faraoni me padrejtësitë dhe tiranitë e tyre?! Vetëm humbjen e pafundme! Ndërsa të devotshmit do të hyjnë në xhenet nga cila portë që të dëshirojnë.

Historia, me faqet e saj të arta dhe ato të errëta me padrejtësi e tirani, është për njerëzimin monument i pamatë shembulli dhe udhëzimi. Dielli që kemi mbi kokë, i cili ka shkëlqyer për një kohë mbi sarajet e faraonëve, hamanëve, nemrudëve, adëve, semudëve, qoshqet dhe thesaret e tyre, pas një farë kohe ka lindur plot pompozitet mbi rrënojat e tyre.

**“Zoti im! Bëj që jeta ime më e dobishme të jetë pjesa e fundit e saj, vepra më e mirë të jetë e fundmja, dita ime më e mirë të jetë dita e arritjes te Ti!”** (Ebu Bekr r.a.)

E gjithë meseleja është arritja e një fundi të mirë. Fundi më i dhimbshëm është ai i një jete të mbushur nga fillimi në fund me vepra të mira, në të cilën në pasazhin e fundit të saj, njeriu shkëputet nga rruga e tij dhe priret nga xhehnemi. Prandaj Allahu i Lartmadhëruar urdhëron robërit e Tij:

## DERI NË FRYMËN E FUNDIT

**“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”** (Hixhr, 99)

Ashtu si nuk konsiderohet i kryer një namaz katër rekatësh që mbyllet pa etehijatun (qëndrimin) e fundit, ashtu edhe veprat e mira nuk do të konsiderohen të realizuara nëse nuk e reflektojnë mirësinë deri në fund. Prandaj çdo veprim i yni është i pranuar në raport me përfundimin e tij të hajrit.

Allahu i Lartmadhëruar, në lidhje me imanin dhe Islamin deri në frymën e fundit, na urdhëron;



**“... vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”** (Al’Imran, 102)

Në mënyrë të veçantë në fundin e kohës ka një rëndësi më të madhe ruajtja e imanit. Resulullahu, (a.s.), ka thënë:

*“Vraponi drejt punëve të mira. Shumë shpejt do ta mbulojnë realitetin, si nata e errët, fitnet, përçarjet. Atëherë njeriu do të zgjohet besimtar e do ta presë natën si jobesimtar; do të flejë besimtar e do të zgjohet jobesimtar. Do ta shesë fenë e tij për çfarëdo vogëlsie të kësaj dynjaje.”* (Muslim, Iman, 186; Tirmidhi, Fiten, 30, Zuhd, 3; Ibn Maxhe, Ikame, 78.)

**“Kur një rob mburret për shkak të një mirësie të kësaj bote, Allahu i Lartmadhëruar e përbuzë atë derisa t’i largohet krejt ajo mirësi.”**

(Ebu Bekr r.a.)

Çdo gjë është një amanet dhe perceptimi i saktë dhe vetëdija për të është domosdoshmëri. Pronari i amanetit, do ta marrë një ditë atë. Nëse robi e harron këtë fakt dhe mburret me mirësitë e dhuruara, i humbet të gjitha vlerat. Sepse kjo gjendje është indiferencë dhe marrëzi që tërheq hakmarrjen dhe dënimin e Allahut.

**“Injoranti ma i madh prej njerëzve është ai që shet ahiretin e tij për dynjanë e dikujt tjetër. Pra ai që priret drejt pëlqimit të njerëzve në vend që të kërkojë pëlqimin e Allahut.”** (Omeri r.a.)

Interesi dhe përfitimi material e mbyt perceptimin njerëzor. Madje edhe dijetarët i shtyn në honin e injorancës.

Shembulli më tipik i kësaj që thamë, është iblisi. Edhe pse ai ishte prijësi i melekëve, për shkak të mendjemadhësisë u bë udhëtar i xheh-nemit.

**“Jepju pak dynjasë, që të jetosh i lirë!”** (Omeri r.a.)

Indiferentët e kuptojnë lirinë si shfrenim ndaj dynjasë, si sjellje sipas qejfit dhe rehatisë dhe si konsumim pa menduar fundin.

Kurse Zoti i dynjasë, këta lloj njerëzish, i burgosë në një robëri të



përjetshme; ndërsa atyre që nuk mashtrohen nga mirazhet e dynjasë dhe jetojnë sipas direktivave hyjnore, Zoti u jep lirinë e përjetshme.

Ai që çlirohet nga dynjaja, nuk bëhet pre e obsesioneve dhe varësisë ndaj tekave të kësaj bote, pra jeton i lirë.

**“Mendimi i kësaj dynjaje është errësirë në zemër; mendimi i ahiretit është dritë në zemër.”** (Osmani r.a.)

Manifestimi i çdo mendimi lidhet me natyrën e qendrës së individit. Zemra (qendra) e atyre që kanë bërë qëllim dynjanë, që është vendi i errësirës për shkak të të keqijave dhe arrogancës, errësohet dhe bën edhe të zotin e saj të zvarritet në errësirë. Kurse ahireti duke qenë jeta e vërtetë simbolizon nurin e dritën. Zemra e atyre që marrin në qendrën e tyre ahiretin mbushet me nur e dritë. Shikimi i tyre kalon edhe në të përtëjmën e largët. Ata arrijnë të shikojnë edhe përtej pengesave.

Aliu (r.a.) ka thënë:

**“Miq të Allahut të Lartmadhëruar janë atë që kur të tjerët shohin dukshmërinë e dynjasë ata shohin fytyrën e brendshme të saj.”**

Zemrat e tyre bëhen rëntgen. Sigurisht kjo nuk është një gjë e lehtë për t'u arritur.

Sepse;

*“Të ngjitesh në lartësinë e virtyteve është e vështirë, kurse të biesh në nivelin e turpit është e lehtë.”* (Aliu r.a.)

Prandaj në lidhje me këtë temë parimi të cilin duhet të kemi parasysh është:

**“Allahu i Lartmadhëruar ia zbukuron jetën e kësaj bote atij që jeton fenë e Tij.”** (Aliu r.a.)

Në lidhje me realizimin praktik të kësaj Aliu (r.a.) sërish shpreh:

*“Nga mirësitë e kësaj bote ty të mjafton Islami,*



*Nga angazhimet e ndryshme ty të mjafton adhurimi me bindje,  
Nga shembujt mësimdhënës ty të mjafton vdekja.”* (Ibn Haxher, Munebbihât, fq. 5.)

Ai që ka përmbledhur në veten e tij këto gjashtë cilësi, ka bërë çdo gjë në lidhje me fitimin e xhenetit dhe shpëtimin nga xhehnemi:

*“Bësimin në Allahun Fuqiplotë dhe bindjen e adhurimin ndaj Tij.  
Njohjen e shejtanit dhe kundërshtimin e tij.  
Njohjen e ahiretit dhe vrapimin pas tij.  
Njohjen e dynjasë dhe divorcin prej saj.  
Njohjen e të vërtetës dhe bindjen ndaj saj.  
Njohjen e të pavërtetës dhe qëndrimin larg prej saj.”* (Ibn Haxher, Munebbihât,

fq. 25-26.)

Aliu (r.a.) gjithashtu ka thënë:

## KINI KUJDES!

Kini kujdes!

*“Unë nuk kam parë diçka tjetër më të çuditshme se xheneti për fitimin e të cilit njerëzit flenë e nuk zgjohen në paraagim për të adhuruar Allahun e Lartmadhëruar, e që gjithashtu nuk sakrifikojnë gjumin për t’u ngutur në rrugën e Allahut të Lartmadhëruar.*

*Gjithashtu mua më habit shumë xhehnemi prej të cilit pandehin njerëzit se po i largohen, ndërkohë që ata nuk heqin dorë nga gjumi i indiferencës!”* (Bakillânî, I’xhâzu’l-Kur’ân, fq. 144.)

*“Asnjë gjë e dobishme pas të cilës pason xhehnemi, nuk është e dobishme. Asnjë shqetësim pas të cilit vjen xheneti nuk është shqetësim e mërzi. Të gjitha kënaqësitë (e ndaluara) përballë xhenetit janë ta parëndësishme. E të gjitha fatkeqësitë e kësaj botë përballë xhehnemit mund të konsiderohen gëzime.”* (Sherif er-Radij, Nehxhu’l-belâğa, no: 387.)

Njëri nga parimet që duhet t’ia vëmë shumë veshin është edhe ky:



***“Përgatituni mirë në lidhje me vendin ku preferoni të shkoni në ditën e kiametit.”*** (Omer bin Abdulaziz r.a.)

Sepse;

***“Vdekja nuk është fatkeqësi. Fatkeqësi është të mos dish se çfarë të pret pas saj.”*** (Imâm Rabbânî k.s.)

Me të vërtetë njeriu indiferent kridhet në dhjetra dituri duke zgjidhur mistere të ndryshme, por nuk mund ta zgjidhë dot nyjën e injorancës së vet në lidhje me pas vdekjen që do t'i kushtojë fatkeqësinë më të madhe. Prejse nuk mund ta zgjidhë dot atë, gjatë historisë personalitetet e shquar dhe ata më të diturit e kanë këshilluar njerëzimin në lidhje me jetën e kësaj bote, vdekjen dhe botën tjetër.

Në veprën e famshme të Jusuf Has Haxhibit, Kutadgu Bilig jepen këto këshilla të rëndësishme:

*“O vdekatar, pse mashtron veten, ti këtu je mysafir vetëm për dy ditë.*

*Ti e di që jeta është për të vdekur; vdekja është bërë gati e po pret çastin për të ardhur. Për një argëtim dy ditësh mos e hidh vetën me zori në zjarr.”*

Sepse;

## DYNJAJA ËSHTË MOSMIRËNJOHËSE!

“Ki kujdes! Dynjaja është mosmirënjohëse, lumturia e saj është e paqëndrueshme. Atë çfarë ta jep, shumë shpejt ta merr sërish. E gjithashtu malli i kësaj bote e urren shumë fenë e të vërtetës; kur të jepet dynjaja fillon e neglizhohet besimi.”

“Ai që merr një rrugë për udhëtim, nuk ndërton shtëpinë në rrugë; ai që emigron nuk i lë gjërat në shtëpi. Ti je një mysafir, kjo botë është vendi që të pret ty si të tillë, në vendin ku do të qëndrosh si mysafir mos kërko shumë rehati.”



*“O ti njeri i ditur, mos u bëj rob i trupit tënd! Nëse trupi të merr rob ty, të kërkon si haraç fenë tënde.”*

*“Lëre këtë botë të përkohshme, kërko ahiretin e përhershëm; nëse ti nuk e lë dynjanë, të lë ajo ty. Kjo dynja është e mërzitshme, prandaj mërzitu me të; sa më shumë të mërzitesh me të, aq më shumë ajo të nënshtrohet ty.”*

Sa bukur e konkretizon Muhjiddin Ibn Arabi njeriun që apasionohet pas kësaj bote e nuk heq dorë dot prej saj:

## **TË PISH UJË DETI**

*“Për ata që priren pas jetës materiale, kjo jetë ngjan me ujin e detit dhe me pirjen e tij, sa më shumë që pinë prej tij aq më shumë u shtohet etja, e sa më shumë që kanë etje aq më shumë pinë prej tij.”*

E pse duhet t'i jepen shpirtërat kësaj bote të vorbullt e me kanxha, e cila u jep njerëzve fatkeqësi nga më të ndryshmet, e njëmijë e një vuajtje e halle? Pse duhet të lidhen pas saj ndërkohë që nuk kanë asnjë dobi prej saj? Pse duhet të kenë guxim mendjet të bien në të njëjtat gabime, gjynahe dhe padrejtësi duke i pasur para syve si shembujt më konkret popujt dhe individët që u shkatërruan para nesh?

Njeriu duhet të mësojë t'i shërbejë lulës së trëndafilut në këtë botë të vjeshtë.

Përndryshe në pranverën e ahiretit nuk do të lejohet të hyjë në trëndafilishten e xhenetit.

Sa bukur e shpreh këtë Sadi Shirazi:

*“Mos e prish lulen e trëndafilut në vjeshtë, që të mos privohesh nga bukuria e saj në stinën e pranverës.”*

Në lidhje me dynjanë dhe ahiretin ka shumë këshilla që na vinë nga poeti i madh Rumi (k.s.).

Në lidhje me përpjekjen për shndërrimin e dynjasë në një natë gëzimi martese ai shprehet:





*“O i gjo­rë që për një kafshatë buke e hedh tutje thesarin e imanit, e që shet një thesar të çmuar për një kokërr elbi!”*

*Nemrudi nuk ia dha shpirtin Ibrahimit (a.s.) e përfundoi t’ia dorëzonte atë një mushkonje.”*

Njeriu aq ambicioz e shumë i kujdesshëm në tregtinë e kësaj dynja­je, është aq i pakujdesshëm, shkapërdarës e keqshpenzues në tregtinë e ahiretit.

I tillë që;

Për një interes minimal, mund të sakrifikojë pafundësinë. E nëse bie pre e ambicies, për një kokërr elbi, jep thesare të tëra, e për një kafshatë shet thesarin e imanit të tij. Për të kënaqur e zbutur ambiciet e tij derdh gjakun e sa e sa njerëzve. Ndoshta për dy-tre ditë duket sikur i ka buzeqeshur fati i suksesit, por më pas nuk është i mjaftueshëm as për të mundur një mushkonjë, e kështu shkatërrohet e rrotullohet për në greminën e humbjes...

“Edhe sikur të kenë të mirat e të gjithë botës, miu dhe gjarpri sërish dhë hanë, tenja brenda drurit thotë me vete «e kush ka një ëmbëlsirë kaq të mrekullueshme si unë!».”

Njeriu e bën jetën në varësi të moralit dhe cilësive që ka përvetësuar. Nëse dikush ka zgjedhur për vete natyrën e miut dhe të gjarpërit, është e kotë e e pavlerë t’ia servirni atij bukuritë e gjërat e këndshme.

Sepse gjendja në të cilën ai ndodhet nuk ia lejon atij vetëdijësimin për bukuritë dhe veprat e këndshme që ju do t’i servirni. Prejse nuk i vëren ato ai do të vazhdojë sërish të jetojë me të njëjtat gabime e gjynahe.

Madje do t’i mbrojë ato. Do të debatojë e shamatohet me të gjithë në marrëzi e sipër. Sepse ai mjerimin e pandeh lumturi. Mundësitë që zotëron i duken si prona e tij.

Kur në fakt;



*“Sa exheli (caktimi i beftë i Allahut) është pa t’i marrë të gjitha gjërat që të janë dhënë, duhen dhënë të gjitha ato që të urdhërohen për t’u dhënë.”*

Pra të vepruarit me vetëdijën e amanetit është një kusht i domosdoshëm.

Rruga e kësaj është dhurimi i shumtë e i shpeshtë, dhe bërja mirë vazhdimisht... Dhe në çdo frymë, t’ia dorëzojmë Allahut të Latmadhëruar atë çfarë zotërojmë. E kështu të përgatitemi për ditën e bajramit të pafundësisë.

Sepse;

*“Dita e tmerrshme kiametit, që është një kurban bajrami, për besimtarët është një festë bajrami, kurse për kafshët një ditë vdekjeje.”*

Dhe një shprehje e thuktë e Rumiut (k.s.) që nuk ka nevojë për shumë fjalë e shpjegime thotë:

*“Mos kërko pavdekësinë nga kjo dynja. Ajo nuk e ka as për vete atë që të ta japë ty.”*

**Ja Rabbi;**

**Na mbro ne prej mashtrimit të kësaj dynjaje, nga shkëmbimi i pasurisë së ahiretit me metelikët e parëndësishëm të kësaj dynjaje dhe nga harresa e vdekjes e kiametit!**

**Na e bëj të mundur ta përdorim si material për të shprehur robërinë tonë ndaj Teje me vetëdijën e amanetit, dynjanë që e ke përgatitur për ne, e jetën që na e ke bërë kapitalin tonë më të rëndësishëm! Na e mundëso të përfjetojmë kënaqësinë e mirësive Tuja të ahiretit, Xhenetin dhe Xhemalin (Hirin) Tënd!**

**Amin!..**



## BESIMTARI DHE DYNJAJA -1-



## BEŠIMTARI DHE DYNJAJA -1-

### QËLLIMI I ARDHJES NË KËTË BOTË: PËRPJEKJA

Allahu i Lartmadhëruar e ka krijuar njeriun që ta njohë Qenien e Tij dhe që ai ta adhurojë Atë, pra t'ia shpreh në formën më të përsosur robërinë Atij.

Njeriu për këtë provim u dërgua në këtë botë të mundimshme e plot vuajtje, e cila kërkon durim dhe përpjekje të vazhdueshme.

Allahu i Lartmadhëruar ia premtoi atij xhenetin ku nuk ka asnjë vuajtje e mundim, nëse nga ky provim do të dalë me sukses.

Ndërsa për ata që nuk kanë dëshirë të kenë sukses në provimin në fjalë, na ka informuar se i pret një vend i tmerrshëm në ahiret, xhehe-nemi.

Për atë njeri që i beson kësaj të vërtete, kjo dynja me çfarë ajo ka brenda saj, nuk është gjë tjetër veç një dekori shkolle e provimi. **Jeta e kësaj bote është vendi i provimit deri në frymën e fundit, deri në pikën e fundit të djersës ku do të punohet e do të bëhet përpjekje deri në shterrimin e forcave tona.**



Për të korrur paqen dhe lumturinë në ahiret, është e domosdoshme të derdhet djersë në këtë dynja e të përballohen vuajtjet e saj. E gjithashtu, duke u kujdesur për të drejtat e Allahut ndaj nesh, është kusht që të kujdesemi për të drejtat e të tjerëve, të mos lëndojmë kënd, të kemi një qasje mëshire dhe dhembshurie në veprat tona ndaj çdo krijese tjetër...

Ndërsa për fatkeqët të cilët nuk besojnë në të vërtetën e ahiretit, kjo dynja që është mjet, bëhet qëllim. Vdekja u kthehet në një fund të pakuptimtë; ndërsa jeta, në çdo çast të saj, u duket si një trashëgimi të cilën e kanë marrë të gatshme për ta përdorur e shpenzuar pa kriter e pa llogari. Çdo rast dhe mundësi, pa parë nëse është hallall apo haram, e pastër apo e ndotur, e drejtë apo e padrejtë, e konsiderojnë si një pasuri prej së cilës duhet përfituar, e cila mund të uzurpohet, mund të konsumohet, mund të përvetësohet... Në këtë këndvështrim, dynjaja kthehet në një vend të ndotur nga mijëra padrejtësi, nga mungesa e dhembshurisë, nga zullumi, gjaku dhe lotët.

Vlerat si drejtësia dhe e vërteta, durimi dhe mëshira, dhembshuria dhe njerzillëku, vetëm në zemrën e atyre që i besojnë ahiretit siç duhet dhe të cilëve u dridhen zemrat nga frika e llogaridhënies, marrin vërtetë kuptim.

Sepse ata e dinë që;

## **DO TË MERREN NË LLOGARI PËR ÇDO MIRESI...**

Allahu i Lartmadhëruar i ka obliguar krijesat të kryejnë detyra konform veçantive specifike që u ka dhënë.

Melekët i ka krijuar të pastër nga egoja, vullneti dhe aftësia për kundërshtim, me qëllim që të zbatojnë në çast urdhrat hyjnorë.

Ndërsa njeriun e ka krijuar me cilësi tjera të veçanta. Pasi i dha mendje, zgjuarsia, dëshirë, ambicie, zemërim, ego e plot cilësi të tjera pozitive



dhe negative, e solli në këtë dynja dhe e bëri zëdhënësin e Tij në tokë, duke lënë krijesat e tjera nën urdhrat dhe shërbimin e tij.

Ai e informoi njeriun përmes pejgamberëve dhe librave, sesi Ai donte që njeriu ta jetonte këtë dynja, e kështu e ushqeui atë edhe shpirtërisht. I dha njeriut gjithashtu vullnetin, e kështu filloi provimi:

**I dha dëshira dhe pasione;** dhe ndoqi reagimin e njeriut në përdorimin e tyre, nëse do t'i drejtonte nga gjërat e ulta të kësaj dynjaje apo nga ahireti...

**I dha mirësinë e mendjes;** dhe pa nëse atë do ta përdorë si mjet meditimi dhe reflektimi dhe si një mekanizëm matës që gjatë zgjedhjes së preferencave vendos t'i japë prioritet ahiretit, apo si një mjet në funksion të përfitimit të interesave të kësaj bote.

**I dha zemërim dhe entuziazëm;** dhe vëzhgoi nëse këto cilësi për të do të jenë forca lëvizëse për të vërtetën, drejtësinë, mbrojtjen e nderit dhe madhësisë së Islamit dhe atdheut, për mbrojtjen e popullit dhe të dobtëve, apo do t'i përdorë si lëndë ndezëse për konflikte dhe përçarje, si fitil mendjemadhësie dhe vetëmadhësie...

**I dha energji, gjallëri, rini, i dha kohë e mundësi...** dhe pa nëse do të përpiqet t'i përdorë ato apo do të dembeloset, do të qëndrojë i pa-interesuar, do të përfshihet mbas gjërave të kota duke i çuar dëm ato. E nëse do t'i përdorë, ku e si do t'i përdorë ato...

**I dha pasuri, i dha mirësi, i dha mall...** dhe pa si do ta shfrytëzojë këtë të drejtë që i ka dhënë... A do ta ndajë atë me të tjerët apo do ta ndajë veç për vete? A do ta harxhojë sipas shariatit të nderuar e sunetit të Resulullahut, (a.s.), apo do të abuzojë me të duke e shpërdoruar? A do t'i kërkojë nevojtarët, a do të kujdeset për ta, a do të ndihet përgjegjës për ta apo do t'i privojë ata nga pasuria e tij? Me koprracinë e tij, ashtu siç fsheh qeni kockën, do ta grumbullojë dhe fshehë pasurinë e tij duke e çuar dëm jetën dhe mundësitë që ajo i ofroi apo çdo mundësi do ta konsiderojë si një farë që hidhet në bahçen e xhenetit, e duke bërë vepra të mira do ta mbjellë arën e kësaj bote me devotshmëri?



A do të falënderojë me mirënjohje për mirësitë e dhuruara apo do të bie në batakun e egos e mosmirënjohjes?..

Si përfundim;

**Çdo mirësi në këtë botë provimi do të përbëjë një temë për t'u marrë në llogari, secila prej tyre është dhuruar si një lëndë provimi. Në një ajet kuranor thuhet:**

***“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!”*** (Te-kathur, 8)

Ky ajet përfshin të gjitha mirësitë e dhuruara për të cilat do të jepët llogari, shpirtërore e materiale.

Nuk duhet harruar se;

Puna, fitimi, harxhimi i asaj çfarë është fituar nga njeriu, pra të gjitha mirësitë që i janë lënë në përdorim, përfshihen në robërinë e tij ndaj Allahut të Lartmadhëruar. Përgjegjësia e njeriut nuk soset vetëm me kryerjen e adhurimeve si falja e namazit apo agjërimi i muajit të Ramazanit. Njeriu është përgjegjës për çdo kafshatë që kalon nga fyti, për çdo fjalë që i del nga goja, për çdo detyrim shpirtëror apo material që lidhet me veten dhe me të tjerët.

Përkujdesja me ndjeshmëri ndaj këtyre përgjegjësive dhe zbatimi me rigorozitet i detyrimeve ndaj Zotit (xh.sh.) dhe krijesave të Tij quhet takva (devotshmëri), moral i bukur, politesë islame.

Pejgamberët, sahabët e nderuar dhe miqtë e Allahut të Lartmadhëruar e jetuan jetën e kësaj bote me këtë dinjitet e politesë dhe treguan një kujdes të veçantë ndaj fitimit të pastër e ndaj kafshatës hallall.

Ata edhe iu dorëzuan Allahut të Lartmadhëruar edhe punuan dhe u përpoqën për fitimin e riskut të tyre hallall.

Të gjithë pejgamberët si Hz. Dauti (a.s.), e sa e sa miq të Allahut (xh.sh.) kishin si tipar dallues:





## PËRPJEKJEN PËR FITIMIN HALLALL

Njeriu në jetën e kësaj bote për të mbajtur veten dhe familjen e tij është nevojtar i fitimit material. Është detyra e çdonjërit të punojë e të fitojë që të mos i bëhet barrë e të mos ia shtrijë dorën askujt.

Resulullahu, (a.s.), i cili shprehej *“Asnjë njeri nuk ka ngrënë diçka më të mirë se ajo çfarë ka fituar vetë.”* (Buhârî, Bujû‘, 15; el-Enbijâ, 37), i edukoi sahabët me fitimin e rriskut në rrugë hallall, e me pavarësinë ndaj njerëzve.

Një ditë erdhi një medinas i varfër te Resulullahu (a.s.) dhe i kërkoi atij diçka për të ngrënë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e pyeti:

*“A ke ndonjë gjë në shtëpi?”*

Burri u përgjigj:

“Po, kam. Në shtëpinë time ndodhet një pëlhurë. Me njëren pjesë të saj mbulohemi e pjesën tjetër e përdorim për ta shtruar në tokë. Gjithashtu në shtëpi kemi edhe një enë me ujë.”

Resulullahu, (a.s.), e urdhëroi atë:

*“M’i sill gjërat që paske në shtëpi!”*

Burri solli pëlhurën dhe enën e ujit. Resulullahu (a.s.) i mori në dorë dhe u tha atyre që kishte afër:

*“Kush ka dëshirë t’i blejë këto objekte?”*

Njëri nga sahabët u shpreh se mund t’i merrte për një dërhëm. Resulullahu, (a.s.), pyeti disa herë:

*“A jep kush më shumë?”*

Më pas ia shiti objektet e burrit në fjalë një sahabi për dy dërhëm. Ia dha të varfërit dy dërhëmët dhe i tha:



*“Njërin nga dërhemët çoja familjes kurse me dërhemin tjetër shko e blij një sëpatë, pastaj eja tek unë!”*

Kur burri erdhi me sëpatën në dorë Resulullahu, (a.s.), e mori sëpatën i vuri një bisht u kthye nga burri dhe i tha:

*“Tani shko, prit me këtë sëpatë drunj dhe shiti! Puno pesëmbëdhjetë ditë, e mandej eja sërish tek unë!”*

Burri i varfër erdhi te Resulullahu, (a.s.), pas pesëmbëdhjetë ditësh. Ai kishte fituar 10 dërhem dhe me ato para i kishte blerë vetes dhe familjes veshmbathje dhe ushqim.

Resulullahu, (a.s.), u gëzua shumë nga ky lajm dhe u shpreh:

*“Kjo për ty është më e mirë se sa të lypësh, gjë e cila do të dukej si njollë në fytyrë tënde në ahiret...”* (Ebû Dâvûd, Zekât, 26/1641; Ibn Mâxhe, Tixhârât, 25.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), nuk dëshiron që besimtari të jetë dembel, i painteresuar për gjërat, i ámullt e letargjik. Për Resulullahun, (a.s.), për dikë që ka mundësi fizike, puna, qoftë ajo edhe e rëndomtë si ajo e prerjës së drurëve, është më e mirë se lypja.

Sahabët të pajisur me këtë vetëdije, punuan e derdhën djersë jo vetëm për të siguruar të ardhurat e tyre të përditshme, por edhe për të dhënë sadaka e lëmoshë. Kur u shpallën ajetet e dhurimit edhe sahabët që nuk kishin asgjë pos shpirtit, dolën e prenë dru, i shitën e i dhuruan në rrugë të Allahut, për të qenë edhe ata pjesë e ajeteve të shpallura.

Shumë profetë kanë jetuar me mundin e duarve të veta. Ademi, (a.s.), ka siguruar nevojat e mjaftueshme për të jetuar me bujqësi, Idrizi, (a.s.), me rrobaqepësi, Isai, (a.s.), me zdrukthëtarë, Davudi, (a.s.), është mjeshtri i parë i prodhimit të parzmoreve, në historinë e njerëzimit. Ndërsa Resulullahu, (a.s.), është marrë me tregti dhe ka bërë edhe punën e çobanit në rininë e tij të hershme. Gjatë historisë islame vërejmë se edhe dijetarët e dijeve të jashtme apo të brendshme, krahas angazhimeve të tyre me veprimtari të ndryshme fetare, për të siguruar nevojat e tyre të përditshme, janë marrë me tregti apo me zejtarë.



Në një hadith thuhet kështu:

*“Allahu i Lartmadhëruar dëshiron ta shohë robin e Tij të lodhur nga vrapimi pas fitimit hallall.”* (Sujûti, el-Xhâmiu’s-Sagîr, I, 65.)

Një shembull spikatës i kësaj përkujdesjeje është **Shah Nakshibendi**. Në mexhliset e tij, ai përmendte shpesh dhe kërkonte nga ndjekësit e tij zbatimin konkret të hadithit të mëposhtëm:

*“Adhurimi ndahet në dhjetë pjesë, nëntë prej tyre janë kërkimi i rriskut hallall, kurse pjesa që mbetet janë veprat e tjera.”* (Dejlemî, Musnedu’l- Firdevs, III, 107/4062.) (Buhârî, Enîsu’t-tâlibîn, fq. 63, 68.)

Haxhe e siguronte ushqimin e tij prej bujqësisë. Ai tregonte një kujdes shumë të veçantë për farat, arën dhe kafshët që përdorëshin për të lëvruar tokën.

Shumë dijetarë merrnin pjesë në kuvendimet e tij për të shijuar mirësinë dhe bereqetin e ushqimit të tij hallall. (Buhârî, Enîsu’t-tâlibîn, fq. 64; Ebu’l-Muhsin Muhammed Bâkir, Makâmât, fq. 37, 112, 138; Reshahât, fq. 159, 184.)

Shah Nakshibendi i jepte kaq rëndësi punës dhe fitimeve që siguronte njeriu prej duarve të veta sa që ata që ishin dembelë dhe të padisponueshëm për punë nuk i pranonte për nxënës të tij. (Ebu’l-Kâsim, er-Risâletu’l Bahâijje, vr. 121 a-b.)

Parimi i edukimit dhe udhëzimit të tij ishte puna dhe përkushtimi ndaj saj për të siguruar jetën e kësaj bote pa ju bërë barrë askujt, por me kushtin që gjatë punës të mos harrohet Allahu i Lartmadhëruar.

Ajo çfarë duhet të kuptojë mire besimtari në përpjekjen për fitimin e rriskut hallall është rëndësia e të mbështeturit në Allahun në lidhje me këtë pikë, pra duhet të kuptohet;

## DORËZIMI

Besimi se garanti i rriskut është Allahu i Lartmadhëruar, të mosrënit në tundim e të mos kapluarit nga frika në kohë të vështira, pra të qëndruarit krenar dhe i fortë është pasojë e dorëzimit tek Allahu i



Lartmadhëruar. Ky besim është streha e garancisë ku strehohet besimtari përballë zvarritjes drejt haramit që kërkon t'i bëjë shejtani atij duke e frikësuar me varfëri.

Në një ajet kuranor thuhet:

***“Thuaj: «Do të na godasë vetëm ajo që na ka caktuar Allahu; Ai është Mbrotësi ynë dhe vetëm tek Allahu le të mbështeten besimtarët!»”***

(Teube, 51)

Një ndër manifestimet më të jashtëzakonshme të cilësisë së Allahut të Lartmadhëruar err-Rrezzak realizohet në dimër. Bien sasi të larta bore, çdo zonë sipas pozitës gjeografike që ka, mbulohet me borë. Ka zona që mbulohen gjysëm metër me borë e ka zona që mbulohen një metër me tylin e bardhë të borës. Një numër i pafundëm gjallesash që jetojnë aty strehohen në gjoksin e tokës. Nën përkujdesjen e Furnizuesit të Lartmadhëruar toka me dheun e bekuar të saj, bëhet djepi ku vazhdojnë ekzistencën e tyre një pafundësi gjallesash. Më i Mëshirshmi i të mëshirshmëve edhe aty ua siguron rriskun krijesave të Veta. Kur vjen pranvera e shkrihen borërat, në vend që të shohim skelete ngordhësirash, vërejmë krijesa të gjalla të shpërndara në natyrën e gjelbëruar me bukurinë pranverore.

Në një hadith thuhet:

*“Nëse ju do t'i dorëzoheshit siç duhet Allahut të Lartmadhëruar, ashtu siç Ai ushqen zogjtë do t'ju ushqente edhe ju. Zogjtë dalin në mëngjes me stomakun bosh e kthehen në muzgun e mbrëmjes me stomakun plot.”*

(Tirmidhi, Zuhd, 33; Ibn Mâxhe, Zuhd, 14.)

Mirëpo besimi te dorëzimi nuk duhet ta shtyjë njeriun drejt dembelizmit. Sepse dembelët me gjendjen e tyre të mefshtësisë janë të gjorët që nuk i besojnë Allahut të Lartmadhëruar, por u besojnë atyre që ndihen përgjegjës për t'i mbajtur me të holla ata.

Në kohën e kalifatit të tij, Omeri (r.a.), atyre që zhyteshin në përtaci, nuk punonin e silleshin gjithë ditën kot duke u shprehur; “Ne jemi i jemi dorëzuar Allahut të Lartmadhëruar!”, u hoqi vërejtjen duke u shprehur:



“Ju nuk i jeni dorëzuar Allahut të Lartmadhëruar me bindje, por ju i besoni pasurisë së të tjerëve.

**Të bindurit siç duhet Allahut të Lartmadhëruar janë ata që e hedhin farën në tokë e mandej shpresojnë prej Allahut të Lartmadhëruar.”**

(Ibn Rexheb el-Hanbeli, Xhâmiu'l Ulûm ve'l-Hikem, Ammân 1990, fq. 650)

Shah Nakshibendi në lidhje me këtë temë është shprehur:

“Ai që i dorëzohet Allahut të Lartmadhëruar, nuk duhet të dëgjojë nefsin e tij, e duke punuar duhet ta fsheh dorëzimin.” (Ebu'l-Muhsin Muhammed Bâkir, Makâmât, fq. 70.)

Së bashku me dorëzimin, pra së bashku me cilësinë e të mosbesuarit të askush veç Allahut të Lartmadhëruar, duhet edhe cilësia tjetër e mirë;

Të mos ia shtrish dorën askujt tjetër veç Allahut të Lartmadhëruar:

## VETËMJAFTUESHMËRIA NDAJ KRIJESAVE

Istigna (vetëmjaftueshmëria) është mjaftueshmëria e robit me atë çfarë ka duke mos u ndjerë nevojtar për asgjë.

Të qenët në një gjendje vetëmjaftueshmërie ndaj Allahut të Lartmadhëruar, të qenët i llastuar me pasurinë, fëmijët e të mirat e dhururara prej Tij është një tipar i shëmtuar i jobesimtarëve. Ata e pandehin veten së bashku me pasurinë e të mirat e tyre si të përjetshëm, kujtojnë se do të jetojnë gjithmonë. Mirëpo jeta e kësaj bote është një pasuri e përkohshme.

Në një ajet kuranor thuhet:

**“O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun, kurse Allahu s'ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavd.”** (Fatir, 15)

Besimtari që është i vetëdijshëm për nevojën që ka për Allahun e Lartmadhëruar, që kërkon vetëm prej Tij dhe që i dorëzohet veç Atij, nuk ia shtrin dorën askujt. Në këtë këndvështrim istigna-ja (vetëmjaftueshmëria ndaj krijesave të tjera) është një cilësi e lavdëruar dhe e pëlqyeshme.



Të kërkosh prej të tjerëve, të përdorësh metoda për ta prekur tjetrin që t'i marrësh diçka është e trupshme dhe cënon nderin. Ai që beson se rrisku vjen nga Krijuesi i Plotfuqishëm nuk i var shpresat te krijesat e gjora.

Resulullahu (a.s.) ka marrë betimin e disa prej sahabëve që ata të mos kërkonin asgjë prej kujt. Ai e ndaloi lypjen dhe gjithashtu dëshiroi që njerëzit të mos hynin kurrë në një gjendje pritshmërie prej të tjerëve.

Kjo ngjarje është shumë domethënëse në lidhje me temën që po trajtojmë:

**Ebu Saidi** (r.a.) ishte një sahab i varfër që herë pas here detyrohej të lidhte gurë në stomakun e tij. E ëma i tha:

“Çohu! Shko te i Dërguari i Allahut e kërko diçka prej tij! Filan person ka shkuar te ai e Resulullahu (a.s.) e ka ndihmuar. Edhe filani ka shkuar te ai e është ndihmuar. Hajde shko edhe ti se mbase të ndihmon edhe ty!”

Ebu Saidi iu përgjigj kështu nënës së tij:

“-Të shohim nënë, po bëjmë një përpjekje për të gjetur diçka, nëse nuk gjejmë gjë po shkojmë te Resulullahu (a.s.).!”

Mirëpo të gjitha përpjekjet i shkuan bosh, ai nuk arriti të siguronte asgjë. Ai vendsoi të shkonte te Resulullahu (a.s.) pasi nuk kishte tjetër zgjidhje. Kur shkoi te Resulullahu (a.s.) e gjeti atë duke dhënë hutbe. U ul për ta dëgjuar. Gjatë hutbes Resulullahu (a.s.) u shpreh:

*“Njerëzve që tregohen të vetëmjaftueshëm dhe ruajnë nderin e tyre, Allahu i Lartmadhëruar u jep aftësinë që gjatë gjithë jetës së tyre të jenë të pavarur, pra të vetëmjaftueshëm ndaj kësaj dynjaje...”*

Pasi Ebu Saidi (r.a.) që kishte ardhur me shumë turp te Resulullahu (a.s.), dëgjoji këto fjalë, nuk mori guximin për t'i kërkuar gjë. Kështu u kthye në shtëpi pa gjë në dorë. Gjendjen e tij të mëpasme na e shpjegon vetë kështu:



“Edhe pse u ktheva në shtëpi duarbosh, pasi më erdhi turp t’i kërkoja gjë Resulullahut (a.s.), Allahu i Lartmadhëruar na furnizoi me rriskun e Tij, e më pas punët tona na shkuan aq mbarë, sa u bëmë më të pasurit e ensarëve. (Shih. Ahmed, III, 44.)

Duhet që ta theksojmë mirë faktin që vetëmjaftueshmëri nuk do të thotë që në një shoqëri secili të shohë punën e hallin e vet e të mos ndihmojë askush kënd. Ajo është thjeshtë një këshillë e dhënë që njeriu të mos i bëhet barrë kujt, por përkundrazi të heqë barrat dhe ngarkesat e të tjerëve.

Në një shoqëri do të ketë të varfër, nevojtarë, të gjymtuar, të sëmurë, të paafër, nëna dhe baballarë të moshuar për të cilët jemi përgjegjës edhe nëse kanë forcë për të punuar, prindër me fëmijë të sëmurë, njerëz që punojnë shumë e përpiqen ditë e natë, por që nuk arrijnë të përballojnë nevojat për të sëmurët e tyre apo fëmijët që po rrisin, të papunë edhe megjithatë këqojnë përditë punë, të falimentuar, njerëz që bien në burg... e sa e sa njerëz në gjendje të mjeruar!

Është detyrë e atyre që kanë mundësitë ekonomike e shpirtërore që të përpiqen t’i gjejnë të varfërit e të vetmuarit- edhe nëse ata fshihen nga turpi dhe besimi- e t’ia plotësojnë nevojat duke i qetësuar e freskuar me mbështetje.

Allahu në Kuran thotë:

**“Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët.”** (Dharrijat, 19)

Ndërsa në suren Mu’minun teksa Allahu rendit cilësitë e besimtarëve që do të fitojnë kënaqësinë e xhenetit nuk përmend vetëm “ata që japin zekatin” por shprehet:

**“të cilët japin zekatin (duke u angazhuar seriozisht për të).”** (Muminun, 4)

Allahu i Lartmadhëruar është Dhuruesi e Dhënësi më bujar, Ai është më Bujari i bujarëve. Mëshira e Tij ndaj të varfërve, nevojtarëve dhe ze-



mërthyerve është e pafundme. Mirësia dhe begatia e Tij ndaj robërve të Vet janë shumë të gjëra. Allahu i Lartmadhëruar kërkon prej besimtarëve (mu'minëve) që i ka krijuar si zëdhënësit e Tij në tokë e si dëshmuesit e Qenies së Tij, të pajisen me cilësitë e Tij të bukura; pra Ai dëshiron që edhe besimtarët (mu'minët) të jenë të mëshirshëm, bujarë, të ndërgjegjshëm, të ndjeshëm dhe delikatë.

Ai nuk na ngarkon vetëm me detyrën e të dhënit atyre që na kërkojnë, por na urdhëron që t'i kërkojmë e t'i gjejmë heronjtë e nderit që nuk lypin edhe pse kanë nevojë, e gjithashtu prej nesh pret një zemër të pjekur deri në atë masë sa të arrijmë t'i dallojmë të tillët nga fytyrat e tyre.

Në një ajet kuranor thuhet:

***“(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato.”*** (Bekare, 273)

Njëra nga çështjet që thekson ajeti i mësipërm është:

Ata që i kushtohen diturisë dhe shërbimeve vullnetare e për këtë arsye nuk punojnë dot, kryejnë një detyrë të domosdoshme (farzi kifaje) për komunitetin. Siç interesohej Resulullahu (a.s.) për edukimin, adhurimin dhe furnizimin me ushqim të sahabëve të suffes, duhet të përkujdesen edhe ata që kanë mundësitë e mjaftueshme ekonomike për nxënësit e diturive, urtësive e arteve të ndryshme, në mënyrë që ata të mos detyrohen që gjatë nxënies së diturive të punojnë e të kalojnë në stërmundim.

Një ngjarje e ndodhur në kohën e epokës së lumturisë e tregon qarte qasjen e Resulullahut (a.s.) ndaj kësaj teme:

Enes bin Maliku (r.a.) tregon:

“Në kohën e Resulullahut (a.s.) jetonin dy vëllezër. Njëri prej tyre vinte te Resulullahu (a.s.) për të marrë dituri, kurse tjetri punonte në





profesionin e tij. Një ditë vëllai që punonte vjen pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe i ankohet për të vëllanë.

Resulullahu (a.s.) iu përgjigj në lidhje me ankesën në fjalë kështu:

*“Ndoshta ti në sajë të vëllait tënd (që i është përkushtuar diturisë) gjen punë dhe furnizohesh me të mirat e kësaj bote.”* (Tirmidhi, Zuhd, 33/2345)

Allahu i Lartmadhëruar në ndarjen e riskut e ka lënë të varfrin në amanetin e të pasurit. Ai (xh.sh.) kërkon nga i pasuri që ta njohë nga fytyra nevojtarin, ta gjejë, ta shohë e të përkujdeset për të. Kurse tek i varfëri Allahu i Lartmadhëruar kërkon të shohë durimin, nderin dhe vetëmjaftueshmërinë. Kështu që i pasuri jo që nuk bie në batakun e mendjemadhësisë dhe famës, por vihet në kërkimin e të varfërve që ia pranojnë ndihmën, ndërsa të varfërit ndihen të përkrahur pa u poshtëruar e keqtrajtuar. Kështu ndërtohet një qytetërim dashurie me shpirtëra të lidhur ndër vete.

Pas hixhretit Resulullahu (a.s.) shpalli vëllazërinë e muhaxhirëve me ensarët në mënyrë që këto të fundit t'i dilnin për zot muhaxhirëve. Ata u bënë përgjegjës për çdo gjë të njëri-tjetrit. Madje ata u bënë për një kohë edhe trashëgimtarë të pasurisë së njëri-tjetrit. Ensarët duke treguar një shembull vëllazërie të pa hasur më parë në historinë e njerëzimit i ofruan muhaxhirëve edhe shtëpitë e tyre më kopshte të bukura. Ndërsa muhaxhirët nuk u treguan lakmitarë e ta pangopur, por i pranuan këto mirësi për t'i punuar e përfituar bashkërisht.

Në këtë frymë Resulullahu (a.s.) bëri vëllezër Abdullarrahan bin Aufin, nga muhaxhirët, me Sa'd bin Reb'inë nga ensarët. Pas kësaj Sa'di i tha vëllait të tij, Abdurrahmanit:

“- Vëllai im, unë jam më i pasuri i Medinës. Dua të ta dhuroj gjysmën e pasurisë simë...”

Abdurrahmani u tregua i përmbajtur duke u shprehur:

“Mallin dhe pasurinë tëndë ta gëzofsh me shëndet!”



Ai kërkoi prej atyre që gjendeshin pranë tij t'i tregonin pazarin ku zhvillohej tregtia e qytetit. U angazhua me tregti dhe u vu në kërkimin e rriskut hallall.

Maturia, vetëmjaftueshmëria dhe dorëzimi i dhanë kaq bereqet e mirësi sa ai më vonë do të shprehej:

“Nuk e harroj kurrë, edhe nëse lëvizja ndonjë gurë nga vendi, shpre-soja se do të gjeja ndonjë flori nën të.” (shih. Buhârî, Bujû, I; Ibn Kethîr, el-Bidâje, III, 228.)

Në fitimin e rriskut hallall duhet pasur parasysh edhe disa pika të tjera. Në mënyrë të veçantë:

## **MOSRËNIEN NË VORBULLËN E LAKMISË SË DYNJASË**

Njeriu nuk duhet ta harxhojë kapitalin e tij të jetës vetëm duke kërkuar të mirat e kësaj bote, por ai duhet të bëjë kujdes edhe ndaj detyrave të tjera të adhurimit e të robërisë ndaj Allahut të Lartmadhëruar.

Ambicia në drejtim të pasurisë së kësaj bote është një vuajtje e vazhdueshme që e bren njeriun dhe e privon atë nga rezultatet pozitive, qetësia dhe lumturia. Kjo përbën edhe sëmundjen më të vështirë të egos.

Kjo thënie në lidhje me krijesat e tjera veç njeriut, të cilat nuk bien në batakun e kësaj sëmundjeje, vlen të përmendet si urtësi:

“Qysh se është krijuar kjo botë, asnjë zog nuk u përpoq të bëjë një fole më shumë së fqinji i vet, asnjë dhelpër nuk u shqetësua se ka vetëm një strofull ku të strehohet, asnjë ketër nuk ngordhi nga sikleti se nuk ka grumbulluar arra për të kaluar më shumë se një dimër, asnjë qen nuk qëndroi zgjuar nga meraku se nuk ka ruajtur asnjë kockë për pleqërinë e tij.”

Sa marrëzi është të harrosh jetën e pasosur duke u stresuar dhe duke punuar me një zell të tepruar e plot ambicie për jetën e kësaj bote që do të soset për çdokënd, pa asnjë përjashtim, heret apo vonë, nga alarmet e



exhelit, e që fundi i së cilës është me vështirësi pleqërie e sëmundjeje, pra në vend që ta ndërtosh pafundësinë ta lësh mes zjarresh atë!

Nuk përputhet kurrë me islamin shprehja “Të punosh është adhurim...” kur ajo keqkuptohet në formën që mund edhe të mos kryejë detyrimet e tjera fetare një njeri që kërkon rriskun e punon ditë e natë.

Duhet të bëhet mësim fundi i hidhur i Salebesë, i cili duke qënë pëllumb (zog) i mesxhidit të Resulullahut (a.s.), vrapoi pas pasurisë së kësaj bote, e u shkëput fillimisht nga namazet, më pas nga zekati e mandej nga zemra e Resulullahut (a.s.).

Pronarët janë përgjegjës për kujdesjen ndaj kohës së adhurimit të punëtorëve.

Për Allahun e Lartmadhëruar nuk është justifikim i pranuar që të punosh në një vend ku nuk të lihet mundësia e faljes dhe agjërimit apo ku kundërshtohet Zoti haptazi dhe ta shprehësh këtë si një gjendje detyrimi.

Këtu duhet të hyjë në lojë tevekkuli (mbeshtetja tek Allahu dhe besnikëria ndaj Tij) dhe të kërkohet mundësia e fitimit të rriskut pa i hyrë në hak të drejtës së Allahut ndaj nesh. Nëse robi do t'i mbështetet Allahut të Lartmadhëruar, me sinqeritet, devocion e durim gjatë kërkimit të rriskut dhe furnizimit, atëheer Allahu do ta furnizojë me begatitë e Tij andej nga ai nuk e pret, siç thuhet edhe në ajetin kuranor:

(teksti arabisht)

***“Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t'i japë risk prej nga nuk e pret. Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai. Allahu e përmbush me siguri vendimin e Tij dhe për çdo gjë Ai ka caktuar masë.”*** (Talak, 2-3)

Të mos shkosh në ato vende ku shkelen urdhërat e Allahut në mënyrë të hapur, as si klient e as si punëtor, është një obligim që lidhet me mosdashjen diçka apo dikë për hir të Allahut të Lartmadhëruar.



Urdhëri i Resulullahut (a.s.) për të derdhur ujërat që ishin mbushur në rrenoja të një populli që ishte shkatërruar shekuj më parë është një shembull sinjifikativ që shpjegon mirë dëmet që shkaktojnë këto vende në botën tonë shpirtnore.

Si përfundim;

Jeta e kësaj bote është një rrugëtim dhe është e domosdoshme që ajo të bëhet në përputhje të plotë me adresën ku ne kemi dëshirë të shkojmë në botën tjetër.

**O Zot i Plotfuqishëm! Na bëj nga ata që përpiqen në rrugën Tënde... Mos lejo dashurinë e dynjasë të hyjë në zemrën tonë, kafshatën haram apo të dyshimtë të hyjë në organizmin tonë, e zjarrin të na përcëllojë lëkurën tonë...**

***“Allahu im! Duke na mundësuar riskun hallall na mbro nga harami! Me mirësinë Tënde mos na bëj të kemi nevojë për dikë tjetër veç Teje!”***

(Tirmidhi, Deavât, 110/3563.)

**Amin!..**



BESIMTARI DHE DYNJAJA -2-



## BEŠIMTARI DHE DYNJAJA -2-

### VEPRAT SIPAS QËLLIMEVE...

Njeriu jetën e kësaj bote, e cila është pasuria më e rëndësishme që i është dhënë, duhet ta jetojë në dobinë e kësaj dhe botës tjetër, me përpjekje të vazhdueshme shpirtërore dhe jo ta çojë dëm me gjëra të kota e me argëtime, duke u zhytur në dembelizëm dhe në përgjumje.

Çdo vepër që bëhet me nijetin e mirë fiton statusin e adhurimit. Detyra jonë e robërisë ndaj Allahut të Lartmadhëruar realizohet jo vetëm me faljen e namazit, kryerjes se haxhit, e umres dhe plot adhurimeve të përcaktuar nga feja jonë, por edhe me veprimtari të dobishme në shërbim të njerëzve dhe me aktivitete të ndryshme sociale.

Kështu, përpjekja për furnizimin e familjes me të mira materiale, pra kur përpjekja bëhet me nijetin e mirë për kafshatën hallall, është adhurim. Kafshata e bukës me të cilën ushqehet fëmija është sadaka (lëmoshë). Kur veprohet në përputhje me principet «Shërbimi ndaj njerëzve, është shërbim ndaj Zotit.», «Më i miri në mesin e njerëzve është më i dobishmi në mesin e tyre.», atëherë shërbimet me karakter publik bëhen shkak për fitimin e shumë sevapeve.



Siç ka thënë edhe Resulullahu (a.s.), veprat fitojnë vlerë në raport me nijetin për të cilin bëhen. Çdo përpjekje dhe punë që synon pëlqimin e Allahut të Lartmadhëruar ka energjinë dhe cilësinë e ibadetit. Kurse punët që bëhen me tjetër nijet dhe qasje do të kenë atë që synohet.

Angazhimi me nijetin e vetëm për të fituar pasuri dhe për ta grumbulluar atë e bën njeriun përgjegjës para Allahut (xh.sh.), ndërsa kur angazhimi bëhet me nijetin e fitimit të kafshatës hallall dhe fuqizimit në adhurim, shërbim dhe dhurim, atëherë ai bëhet shkak për fitimin e kënaqësisë së Allahut të Lartmadhëruar.

Prandaj qëllimi ynë në veprimtaritë e jashtme të kësaj bote si tregti, industri, bujqësi e të ngjashmet me to, duhet të jetë i përtej kësaj bote, duhet të lidhet me ahiretin;

## QËLLIMI DUHET TË LIDHET ME AHIRETIN

Qëllimi gjatë angazhimit me punë të ndryshme që na sjellin përfitime nuk duhet të jetë dëshira e egos dhe ambicia e fitimit të kësaj bote, por dëshira që duke fituar të mira materiale në rrugë hallall të kemi më shumë mundësi t'u shërbejmë njerëzve, t'u dhurojmë atyre e të ndërtojmë vakëfe për njerëzit në nevojë. Qëllimi i përpjekjeve për të fituar më shumë së është e mjaftueshme dhe e nevojshme, nëse nuk lidhet me dëshirën për të konsoliduar kapitalin tonë të ahiretit, atëherë koha që ndahet për këto përpjekje dhe mundësitë e dhuruara që harxhohen për tekat e nefsit bëhen shkak për fitimin e gjynaheve. Dhënia e llogarisë në lidhje me ta vështirësohet shumë.

Nuk duhet harruar se Allahu i Lartmadhëruar riskun ia jep krijesave të Tij në forma dhe sasi të ndryshme. Dikujt i jep shumë e dikujt i jep pak. Ata të cilëve u janë dhënë shumë të mira materiale janë në një provim shumë të vështirë. Të varfërit janë në përgjegjësinë e tyre. Kështu që ai të cilit i është dhënë shumë dhe atë mirësi e harxhon për tekat e nefsit (egos) konsiderohet grabitësi i hakut (të drejtës) së tjetrit.





Detyra (farz kifaje) e ndërtimit dhe përjetësimit të institucioneve që do t'i shërbejnë Islamit e Kuranit bie mbi gjithë umetin, pra mbi gjithsecilin sipas mundësisë materiale që zotëron. Ai që nuk e kryen këtë detyrë sipas mundësisë që posedon është përgjegjës.

Krahas urdhërave dhe këshillave për të punuar dhe për t'u përpjekur për fitimin e riskut hallall, feja jonë tërheq vëmendjen edhe për të mos bërë tamah në lidhje me pasurinë e kësaj bote, por që edhe të mos pushtohet qenia njerëzore nga ambicia për të zotëruar pasuri pa fund. Dashuria e zemrës për këtë botë dhe për atë çfarë ajo ka brenda saj bëhet shkak për largimin e njeriut nga ahireti.

Kjo botë asht një gjë e pavlerë dhe e ulët për Allahun e Lartmadhëruar. Vlera e vetme e saj buron nga fakti i fitimit të ahiretit nëpërmjet saj, pra i të qenët të saj mjet dhe truall i ahiretit. Një besimtar nuk duhet të bie kurrë në iluzionin e Karunit i cili u pushtua nga mendimi egoist «Unë e kam fituar vetë këtë», por duhet ta shfrytëzojë pasurinë për të manifestuar virtytin e bujarisë dhe mirësisë në shërbim të ahiretit.

Nuk duhet harruar se kjo dynja është kalimtare... Çdo gjë e kësaj dynjaje;

## ËSHTË E PËRKOHSHME

Një herë e një kohë një mbret ndërton një saraj. Pasi ndërtohet saraji fton një evlija për ta shëtitur në të. Më pas e pyet mikun e Allahut:

“-Zotëri si t'u duk saraji?”

Miku i Allahut iu përgjigj:

“-Madhështia e sarajit t'i merr sytë. Çdo gjë është e përsosur, por ka një mangësi shumë të madhe.”

Mbreti i çuditur e pyet:

“-Çfarë i mungon sarajit tim të ri?”



Përgjigjja e tij lidhet me të vërtetën absolute të kësaj dynjaje:

“-Sarajit i mungon përjetësia!”

Një ditë Behlul Dana nuk i rezistoi dot tundimit të tij për të shkruar në muret e sarajit që kishte ndërtuar Harun Rashidi disa vargje për ta këshilluar atë:

“O Harun! E lartësive baltën dhe e përçmove fenë duke mos i shërbyer asaj; i lartësive gurët mirëpo përçmove Kuranin dhe Sunetin, nuk u dhe atyre vlerën që u takon.

Nëse këtë saraj e ke bërë me paratë tuaja i ke shpenzuar pa kriter ato. Allahu i Lartmadhëruar nuk i do shpërduruesit.

Nëse paratë i ke marrë nga thesari i shtetit, atëherë kjo do të thotë se i ke bërë një padrejtësi shumë të madhe të gjithë umetit. Allahu i Lartmadhëruar nuk i do ata që bëjnë padrejtësi.”

Në temën e fitimit pika që duhet të kihet më shumë kujdes është legjitimiteti (lejueshmëria)...

## **HALLALLI (E LEJUARA)**

Kur Resulullahu (a.s.) shkoi në Medinë një ndër punët e para që bëri ishte të përcaktonte një vend ku do të zhvillohej tregtia dhe inspektimi i saj.

Ai i këshilloi vazhdimish ata që kishin dëshirë të merren me tregti që të jenë të saktë në peshim, të mos mashtrojnë e të mos betohen për të shitur mallin në mënyrë të padrejtë, të mos nxjerrin sipër mallit jocilësor atë që është më cilësor.

Kurani i madhërishëm në suren Mutaffifin flet për fundin e tmerrshëm të atyre që bëjnë padrejtësi në peshim duke i hëngër hakun të tjerëve.

Resulullahu, (a.s.), në hutben e lamtumirës, vuri theksin në rëndësinë e respektimit të të drejtave të njerëzve;



«Kamata është nën këmbët e mia!», u shpreh ai (a.s.) duke tërhequr vëmendjen ndaj pasurisë së kësaj bote.

Ata që i vunë veshin e zemrën këtyre këshillave të ndritura manifestuan moralin islam jo vetëm në faltore, por edhe në pazar e në rrugë. Ja njëri prej tyre;

## IMAM AZAMI

Prijësi i medh'hebit tonë juridik, Ebu Hanife merrej me tregti dhe në saje të suksesit të tij ishte bërë i pasur. Kur filloi të angazhohej seriozisht me dituri punët ia delegoi një përfaqësuesi, ndërsa ai ndiqte se sa përshtatej tregtia që ai bënte me normat e sheriatit. Në këtë pikë ishte aq rigoroz sa një herë kur ai dërgoi ortakun e tij, Hafs bin Abdurrahmânin, të shësë kumash i tha;

“O Hafs! Malli ka këto të meta. Prandaj këtë tregojua klientëve dhe shite lirë atë.”

Hafsi e shiti mallin në çmimin që përcakttoi Imami, por harroi t'ia tregonte të metat e mallit klientit. Kur Imami e mësoi këtë fakt e pyeti Hafsin nëse e njihte klientin apo jo. Kur Hafsi iu përgjigj negativisht pyetjes së bërë, Imami të gjithë shumën e fituar nga malli i shitur, rreth 30 mijë derhem, i ndau si lëmoshë dhe në të njëjtën kohë i dha fund ortakërisë me Hafsin. (Shehâbetin Ahmed bin Haxher el-Hejtemi, Imâm Âzam'in Menkibeleri, për. Abdulvehhab ÖZTÜRK, Ankara 1978, fq. 82.)

Një ditë, Sufjan Sevri, i cili shprehej “Një person është fetar aq sa kafshata e tij hallall”, u pyet:

“-Zotëri! A mund të na shpjegoni rëndësinë e faljes së namazit në rreshtin e parë?”

Përgjigjja e dhënë vinte theksin në një çështje shumë të rëndësishme:

“Vëllai im! Ti shiko mirë e kujdesu se ku e fiton bukën! Nëse ushqimi



që han është hallall, fale namazin në cilin rresht të kesh dëshirë, nuk ka asnjë problem.

Sigurisht falja e namazit në rreshtin e parë ka më shumë dobi, por ajo që ka më rëndësi është falja e namazit me kafshatën hallall në stomak.”

Duhet të dihen mirë urdhrat dhe ndalesat e fesë sonë në lidhje me temat e fitimit, tregtisë dhe punës, për ato çështje që nuk ja dalim t’i mësojmë duhet të pyesim ata që janë kompetent në fushën e fikhut. Padituria nuk është justifikim për asgjë.

Në temën e fitimit hallall është kusht i domosdoshëm rigoroziteti.

Në mënyrë të veçantë atëherë kur kujdesi ndaj haramit e hallallit ka rënë, kur janë shtuar nevojat dhe janë shtuar ngatërresat, pra në;

## FUNDIN E KOHËS

Në ditët tona ka më shumë nevojë të jemi të kujdesshëm ndaj hallallit dhe të largohemi ndaj haramit dhe dyshimit.

Duhet të ndjekim me shumë kujdes gjykimet juridike të dijetarëve në lidhje me format më të reja të bërjes së tregtisë si bursa e të ngjashmet me të.

Gjynahet me karakter ekonomik si kumari që konsiderohet vepër e ndyrë e shejtanit, kamata për të cilën thuhet se është si t’i shpallësh luftë Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ryshfeti që do ta dërgojë në xhebnem edhe dhënësin edhe marrësin, në këto kohë të fundme kautike, emra dhe trende të ndryshme po i presin rrugën besimtarëve.

Dikush duke u nxitur nga shejtani që u qaset njerëzve prej anëve të ndryshme, paratë e pista të fituara në rrugë jo të lejuara, përpiqet t’i pastrojë duke bërë gjoja bamirësi, e kështu beson se do të justifikohet para Allahut të Lartmadhëruar. Kjo gjë është mashtrim i thellë.

Nuk duhet lënë në harresë fakti që edhe nëse paratë e fituara në rrugë haram harxhohen të gjitha për bamirësi nuk do t’i sjellin dobi shpirtërore



të zotit në botën tjetër dhe se llogaria ka për t'u dhënë në mënyrë specifike në lidhje me të drejtat njerëzore. Sipas një hadithi të nderuar në lidhje me një njeri që vjen në haxh me paratë e fituara haram dhe thotë «Lebbejk!», atij një zë nga qielli do t'i thotë:

*«Nuk ka për ty as lebbejk e as saddejk! (Ti nuk pranohesh në audiencën hyjnore). Sepse fitimi yt është haram, ushqimi yt është haram, mjeti më të cilin ke ardhur këtu është haram. Kthehu si gjynahqarë nga haxhi pa asnjë sevap! Mërzitu për faktin që nuk do të pritesh ashtu siç pate dëshirë.»*

(Hejsemi, III, 209-210.)

Kur e shumta e një gjëje është haram edhe e pakta e saj është e tillë. Nuk ka rëndësi sasia por cilësia e gjësë. Për besimtarin ashtu siç është obligim të rrijë larg qoftë edhe një pike të alkoolit është gjithashtu obligim të qëndrojë larg qoftë edhe pluhurit të kamatës. Në ditët tona, fatkeqësisht njeriu mësohet me kamatën nëpërmjet kartave të kreditit dhe fjalët që dëgjohen kudo e që marrin trajtën e fetvave bëhen shkak që myslimanët të ndoten e të bien në batakun e kamatës.

Në kohët tona vërehet përzierja e haramit në punë të ndryshme të cilat janë hallall sipas sheriatit (në pamjen e jashtme) por ngaqë nuk respektohen rregullat e islamit prej tyre përftohen fitime harami. Sepse përtej haramit e hallallit puna duhet vlerësuar edhe për detajet dhe stilin e realizimit, pra ajo duhet të peshohet edhe në pikëpamje shpirtërore (batini).

## JO VETËM SË JASHTMI (ZAHIRI)

Thelbi i aktiviteteve tregtare industriale është hallall; mirëpo kur paraqitja e tyre bëhet pa kujdes duke shkaktuar lakmimin e nevojtarëve atëhere fitimi prej tyre bëhet problematik dhe me të meta.

Në ditët tona ambicia për të fituar fryhet dhe merr trajta të papërmbytshme. Çdo gjë, pa u verifikuar legjitimiteti në pikëpamje të sheriatit, bëhet mjet i kësaj ambicie.



Shfaqen për shitje në rrugë produktet më të shijshme ushqimore pa u marrë në konsideratë shikimet e përvuajtura të të varfërve. Edhe nëse shitësi i tregton produktet nga hallalli i tij, e blerësi i blen me paratë e tij hallall, kur mbi produktet në fjalë ka shikime lakmitare jetimësh dhe nevojtarësh atëherë edhe produktet por edhe fitimi prej tyre dëmtohen dhe dëmtojnë shpirtëroren e besimtarit.

Çfarë na ka mbetur ne nga ai qytetërim i jashtëzakonshëm i cili e konsideronte hakun e syrit si hakun e robit?

Mallrat reklamohen me shumë ekzagjerim dhe ndiqen të gjitha rruget dhe metodat për të bindur klientët për t'i blerë. Nëse ato mallra që reklamohen me aq ekzagjerim nuk janë cilësorë aq sa ç'paraqiten, pra nëse klienti mashtrohet për shitjen e tyre, atëherë kemi të bëjmë me një gjynah për të cilin do të jepet llogari.

Sa mund të jenë të pastra fitimet që përftohen nga shitjet që bëhen me reklama të ekzagjeruara që nxisin luksin, marrjen e një rrobe të re ndërkohë që ajo e mëparshme nuk është vjetruar ende, e që motivojnë epërsinë ndaj tjetrit nëpërmjet aparencës?

A nuk janë bashkëfajtorë me ato që vishen me rroba që tregojnë të gjitha linjat e trupit, ata që prodhojnë rroba për të mbuluarat, por që sipas fesë nuk janë të lejuara e që nxisin këtë lloj veshjeje për të fituar sa më shumë?

Ka prej atyre indiferentëve që duke u bazuar në rregullat e jashtme të fikhut i paraqesin si të lejuara këto stile veshjeje, mirëpo nëse merren opinionet nga njerëzit e përgjegjshëm e të vetëdijshëm në pikëpamjen shpirtërore ata nuk do të ishin dakort dhe do t'i ndalonin këto qasje.

Kujdesi i treguar ndaj kësaj çështjeje do ta mbronte botën shpirtërore të besimtarit. Miqtë e Allahut të Lartmadhëruar kanë theksuar shumë faktin se dy faktor ndikojnë më shumë se të tjerët në botën e brendshme të njeriut:



## DY NDIKUESIT MË POTENTË

1. Risku
2. Shoku...

Miqtë e Allahut kanë përfituar nga bashkëbisedimet dhe qëndrimet me të mirët dhe besnikët dhe nga të qëndruarit larg nga indiferentët, por kanë bërë shumë kujdes edhe ndaj kafshatës që fushin në bark. Produktet ushqimore që futen në organizëm ndikojnë direkt në gjallërimin e zemrës në masën e pastërtisë së tyre të hallallit. Ushqimi haram apo i papastër në aspektin islam e ngurtëson zemrën dhe e shqetëson atë.

Miqtë e Allahut jo vetëm kishin kujdes ndaj asaj çfarë hanin, por ata kujdeseshin edhe për drunjtë e zjarrit me të cilin bëhej ushqimi.

Shah Nakshibendi këshillonte vazhdimisht ndjekësit e tij që të ishin të kujdesshëm dhe vigjilent ndaj çdo kafshate të ushqimit. Kur ai ulej në sofër me ndjekësit e tij e vërente se ndonjëri prej tyre hante qoftë edhe një kafshatë në indiferencë ia tërhiqte vëmendjen me shumë dashuri dhe dhembshuri. Ai nuk pajtohej kurrë me faktin që një ndjekës i tij mund të ushqej në mënyrë indiferente. Kur ushqimi përgatitej pa dëshirë e me energji të keqe zemërimi ai nuk e vinte atë në buzë dhe këshillonte edhe ndjekësit e tij të bënin të njëjtën gjë. Përballë një ushqimi të tillë ai shprehej:

“Ky ushqim ka errësirë, nuk është e përshtatshme që ne të hamë prej tij.”

Një ditë kishin shkuar në një vend që quhej Gadivit. Njëri nga ndjekësit e tij i solli një ushqim përpara mjeshtrit. Mjeshtri u shpreh:

“Ne nuk mund ta hamë këtë ushqim. Ushqimi është përgatitur me nerva dhe pa qejf. Personi që ka situr miellin, që ka zënë brumin dhe që e ka pjekur atë ka qenë i zemëruar dhe në gjendje indiference.”

Edhe kur futej ndonjë kullonjëse në tenxhere me zemërim e me padëshirë, Shah Nakshibendi nuk e hante atë ushqim. Ai vazhdimisht shprehej:



***“Nuk ka asnjë dobi nga puna që bëhet me zemërim, indiferencë, pa dëshirë dhe me zori. Në atë punë përzihen nefs i dhe shejtani.***

***Veprat e mira dhe sjelljet e hijshme janë të mundshme vetëm me kafshatën hallall. Kafshata hallall nuk duhet ngrënë në mënyrë indiferente, por në mënyrë vigjilente dhe të vëmendshme. Përpjekja që çdo vakt i ushqimit të hahet me zemrën zgjuar dhe me vetëdije të plotë bëhet zakon për besimtarin e kështu ai gjatë namazeve do ta përjetojë kënaqësinë e adhurimit me zemrën plot zgjim e vetëdije.”*** (Buhâri, Enîsu’t-tâlibin, fq. 6465; Reshahât, fq. 513)

Njëherë i tërhoqi vërejtjen një ndjekësit të tij teksa ai po merrte ujin për ta ngrohur në oxhak dhe ndërkohë po fliste gjëra të kota e të panevojshme:

“Akoma nuk ke mësuar as kaq pak?

Gjatë përgatitjes së ushqimit dhe ngrohjes së ujit duhet të aktivizohet zemra e të mbrohet gjuha nga fjalët e kota. Kështu atij që merr abdest me ujin në fjalë apo që ha nga ushqimi i përgatitur me vëmendje i bëhet qetësi dhe urtësi.

Ndërsa atij që merr abdest me ujin e ngrohur pa vëmendje dhe ha ushqimin e gatuar në mënyrë indiferente i bëhet padrejtësi dhe gaflet.” (Reshahât, fq. 513)

Një dijetar i shquar nga Buhara e pyeti Shah Nakshibendin:

“Si arrihet qetësia e zemrës në namaz?”

***“Duhet që ushqimi i ngrënë të jetë hallall dhe ngrënësi të jetë i vëmendshëm gjatë ushqyerjes. Por nëse mbahet vëmendja zgjuar edhe gjatë marrjes së abdestit dhe tekbitit fillestar atëherë arrihet qetësia e zemrës në namaz.”*** (Buhâri, Enîsu’t-tâlibin, fq. 84.)

Ky kujdes dhe ndjeshmëri kaq e lartë ndaj kësaj teme lidhet me kujdesin që kishte Resulullahu, (a.s.), i cili nuk pranoi të hante mishin e dashit të prerë pa lejen e sahabës që ishte i zoti i mallit.





Të njëjtën ndjeshmëri dhe kujdes ndaj temës në fjalë kishte edhe Ebu Bekri (r.a.) i cili kur hëngri ushqimin që i kishte sjellë shërbyesi i tij si qerasje, pasi e mori vesh që e kishte fituar në rrugë haram, futi gishtat në fyt për ta nxjerrë.

Të njëjtin kujdes tregoi edhe Hizri, kur iu servir ushqimi nga Abdulhalik Guxhdyvani. Ai u shpreh “Ushqimi qenka hallall, por i gatuar me zemërim!” Të njëjtën sjellje kanë manifestuar edhe miqtë e tjerë të Allahut të Lartmadhëruar.

Si rezultat i kujdesit që shfaqën ndaj kafshatës së bukës, personalitetet e mëdha të islamit përjetuan frikë-respektin, qetësinë e brendshme, gjallërimin shpirtëror në nivelet më të larta. Gjithashtu mëshira, dhembshuria dhe politesa u bënë cilësitë e pandashme të botës së tyre shpirtërore. Ata u trishtuan me trishtimin e të tjerëve, ata përjetuan të gjitha vujatjet e vëllezërve të tyre myslimanë.

## NË KULMET E SAKRIFICËS

Mëshira është një tipar dallues i besimtarit. Një njeri i mëshirshëm është sakrifikues, bujar, dhurues dhe vepërmirë. Ai i braktis koprracinë e nefsit, ambicien, vulgaritetin, e shpëton nga egoizmi, kështu fiton empatinë, pra preferon tjetrin para vetes, ai ia heq vetes për t'ia dhënë tjetrit. Me veprat e mira që ai bën afrohet me Allahun e Lartmadhëruar, duke u bërë miku i më të Mëshirshmit. Në lidhje me këtë temë një shembull konkret është Abdullah bin Muvaffak.

Njëri prej dijetarëve më në zë të tabiinëve, Abdullah bin Mubarek shkoi në haxh. Pasi i kreu detyrat e haxhit, u ndal në Mesxhidul Haram për të vazhduar me adhurimet e tij. Gjatë meditimt në një gjendje transhendence vërejti dy melekë që zbritën nga qielli. Njëri prej tyre po i thoshte tjetrit;

“-Këtë vit e bënë haxhin 600 mijë vetë. Mirëpo të gjithëve iu pranua haxhi për shkak të veprës së mirë që bëri Ali bin Muvaffak, këpucari nga



Shami, i cili edhe pse e bëri nijet këtë vit të vinte në haxh nuk mundi të vinte.

Abdullah bin Mubarek doli nga gjendja shpirtërore e meditimimit ku ishte zhytur i çuditur. Ai dëshironte të njihej me personin që kishte fituar knaqësinë e Allahut të Lartmadhëruar dhe ishte kurioz të zbulonte veprën e tij e cila ishte bërë shkak për pranimin e haxhit të të gjithë haxhilerëve të atij viti.

Ai iu bashkua një kervani që po shkonte për në Sham. Duke pyetur e gjeti Ali bin Muvaffakun. Ai e pyeti atë se pse nuk e kishte bërë haxhin këtë vit edhe pse e kishte bërë nijet dhe çfarë vepre të mirë kishte bërë që e kishte penguar të bënte haxhin.

Ali bin Muvaffak u çudit shumë kur pa Abdullah bin Mubarekun, një dijetar kaq të madh që kishte ardhur ta vizitonte atë. Ai pësoi një shok emocional fillimisht, por pasi erdhi në vete iu përgjigj:

“-Ka 30 vjet që digjem nga dëshira për të bërë haxhin. I mbloodha 300 dërhëm me shumë vështirësi sepse me zanatin tim të këpucarit nuk sigurohen të ardhurat kollaj. Më në fund mora vendimin që këtë vit të shkoja në haxh;

Mirëpo një ditë gruaja ime shtatzënë më tha:

«-Nga komshia jonë po vjen erë mishi, a mund të shkosh t'i kërkoj një copë mishi për mua?». Shkova tek komshiu dhe ia shpjegova hallin tim. Komshiu filloi të qajë dhe më tha:

«Ka shtatë ditë që fëmijët e mi janë pa ngrënë... S'kam asnjë kacidhe. Mbeta pa zgjidhje, prandaj mora një kafshë të ngordhur në rrugë. Preva një copë prej saj dhe e vura mishin në zjarr sa për të gënjyer fëmijët. Nëse nuk gjej ndonjë gjë më të mirë për t'u dhënë për të ngrënë do të jem i detyruar t'i ushqej me këtë mish ngordhësire. Nëse dëshiron të marrësh nga ky mish ta jap, por nëse për fëmijët e mi që janë në pikën kritike afër vdekjes është hallall, për ju ky mish është haram.»



M'u copëtua zemra nga çfarë dëgjova. Mora dërhëmet që i kisha grumbulluar me aq vështirësi për gjatë 30 viteve dhe ja dhashë komshiut tim që ishte në gjendje aq të keqe dhe i bëra dua Allahut të Lartmadhëruar: «O Zoti im këtë lëmoshë që po jap ma prano si një haxh të bërë!»

Ja pra cilësitë që aktivizojnë mëshirën e Allahut të Lartmadhëruar:

Sakrifica, empatia dhe dhurimi edhe kur nuk ke mjaftueshëm për vete...

Një rob që kursen të ardhurat e tij të shumë viteve për të bërë haxhin, duke bërë një jetë të thjeshtë, të përmbajtur dhe me dorëzim të plotë të Allahu i Lartmadhëruar e duke punuar e duke derdhur djerse në kërkim të riskut hallall... Përballë varfërisë ekstreme të vëllait të tij mysliman ai nuk mendon adhurimin e tij, por nevojën e vëllait...

Sakrifica e tij u pranua dhe u vlerësua aq shumë prej Allahut Fuqiplotë sa edhe pse ai nuk mundi të shkojë fare në haxh, prej tij iu pranua haxhi të gjithë haxhilerëve të atij viti.

Një mesazh i jashtëzakonshëm ky për ne...

Përreth nesh, por edhe kudo në botën islame ka aq të uritur, të pa-fuqishëm, myslimanë që po u bëhet aq shumë padrejtësi dhe shumë të mbetur vetëm.

Nëse ne me të vërtetë kërkojmë pëlqimin, kënaqësinë, mëshirën dhe afrimin me Allahun e Lartmadhëruar atëherë duhet seriozisht të pyesim:

Sa shpirti dhe zemra jonë njësohet me shqetësimin dhe trishtimin e myslimanëve në nevojë?

Të mirat materiale që na i ka dhuruar Allahu i Lartmadhëruar i harxhojmë veç për vete apo edhe për nevojtarët, të vetmuarit dhe të pa-shpresët?

Apo edhe ne si Karuni e si Salebeja mendojmë me arrogancë «Janë vetëm të mijat këto sepse i kam fituar vetë!»?



A jemi të përfshirë edhe ne në fatkeqësitë e umetit? Mos po shman-gemi prej përgjegjesisë sonë duke u marrë me gjërat tona apo jemi duke u përpekjur për t'i gjetur nevojtarët për t'i qetësuar e freskuar me ndihmën tonë modeste?

A po ja heqim vetes për t'ia dhënë atyre?

Sa po përfshihemi në sevapin e isarit, sipas të cilit besimtari i pjekur dhuron edhe kur vete ka nevojë për ndihmë?

### **SA JEMI AFËR ALLAHUT TË LARTMADHËRUAR?**

Çdo festë bajrami është një mirësi e Allahut të Lartmadhëruar ndaj nesh sepse ne në klimën e haxhit dhe kurbanit mbushemi me energji e besim, marrim veten në llogari në lidhje me vetëdijën e vëllazërisë dhe përpiqemi të jetojmë në përputhje me përgjigjet pozitive që na vijnë thellë nga brendësia jonë.

Falë Zotit në ditët tona adhurimi i kurbanit është një manifestim i përpekjes për të dhuruar sa më shumë...

Një shkak për të shkuar në çdo cep të gjeografisë islame, me pro-duktet ushqimore për të uriturit, dhe me ndihmat e ndryshme për ne-vojtarët...

Një mundësi shumë e mirë për të paraqitur para Allahut të Lartma-dhëruar sinqeritetin, sakrificën, empatinë tonë...

Të lumturosh të uriturit, të vetmuarit dhe fatkeqët në aspektin ma-terial dhe shpirtëror në ditët e bukura të Bajramit është mënyra më e përsosur e kryerjes së ibadetit të kurbanit që nënkupton «Afrimin edhe më shumë me Allahun e Lartmadhëruar».

**Allahu i Lartmadhëruar na bëftë nga robërit e Tij më të afërt që shërbejnë e sakrifikojnë në rrugën e Tij dhe që mundësitë që Ai u ka dhënë i vënë në shërbimin e të tjerëve duke i dhuruar vëllezërve të tyre në besim çdo gjë, madje edhe atë për të cilën kanë vetë nevojë...**



**Na ruajtë nga gjynahet, të këqijat, haramet dhe punët e pista, të dukshme e të padukshme. Na i ndriçoftë dhe gjallëroftë zemrat me riskun e pastër e hallall!**

**Amin!..**





NATA E DASMËS





# NATA E DASMËS

## SEKRETI I QENIES: DASHURIA

Në themelin e qenies gjendet dashuria. Allahu i Lartmadhëruar e ka pajisur universin në çdo detaj me dashuri. Kjo dashuri është shpërndarë në çdo gjë, në çdo qenie, duke u bërë shtylla e jetës.

Po të mos ishte dashuria asnjë qenie nuk do të përkujdesej për paskardhësit e saj. Vetëm në saje të dashurisë një mace ushqen me gji të vegjlit e saj edhe nëse vetë është pa ngrënë, i pastron ato, i strehon në një vend të sigurt dhe i ruan nga rreziku që mund t'u kanoset.

Edhe krijimet si gjarpri apo akrepi në të cilat manifestohen cilësitë e frikshme të Zotit, nuk janë të privuara nga dashuria. Një gjarpër e rrit të voglin e saj duke e parë e ruajtur vazhdimisht. Ndërsa akrepi e rrit të voglin e vet duke e mbajtur në shpinë.

Kur gjërat shihen me vëmendjen e duhur, do të vërehet se nga grimca e deri te planetet, nga bota bimore e deri te bota e trupave të ngurtë, pra çdo gjë ka dashuri dhe çdo gjë bën sakrificën e vet në emër të saj.

Elektronet që sillen rreth bërthamës, neutronet dhe protonet...



Planetet që sillen si dërvishët fluturues rreth dieje e yjeve...

Pemët me dashurinë e tyre reflektojnë cilësitë e bukura të Allahut të Lartmadhëruar, duke çelur lulet, duke na dhënë frutat... Pemët rrinë gjatë gjithë jetës në gjendje kijami, në dimër në mënyrë modeste bëjnë dua, e në verë bëhen bujare, shërbejnë pa kërkuar shpërblim...

Lumenjtë që vërshojnë drejt oqeanit e aty ku kalojnë sjellin pranverën... Zogjtë emigrues që kapërcejnë kontinente për të shkuar në vendet që nuk i kanë parë kurrë më parë... Dielli i cili është përgjegjës për ushqimin e krijesave, ngrohjen dhe shkëlqimin e tyre... Zemra që punon pa pushuar asnjë çast për të mbajtur organizmin në jetë...

Të gjitha këto janë manifestimet e dashurisë hyjnore në tharmin e çdo qenieje. T'i konsiderosh këto mrekulli thjeshtë si ligje natyre apo instinkte do të thotë të mbyllësh sytë apo të verbohesh përballë kësaj dashurie që është pika e përbashkët e të gjithë krijimit.

Ndërsa njeriun, të cilin Allahu i Lartmadhëruar e krijoi në formën më të përsosur, e nderoi duke e bërë zëdhënësin e Tij në tokë dhe e krijoi për të dëshmuar Qenien e Tij, i dha dashuri më shumë duke edhe e sporvuar me të:

## PROVIMI I DASHURISË

Në qenien e njeriut ku shquhet cilësia e të qenët qenie sociale, është i pranishëm nefsi si qendra e dëshirave dhe kërkesave, shpirti si kujtimi i frymës së Allahut dhe mallit për qielloren apo të përtejmen si dhe zemra që është qendra e dashurive.

Në një ajet kuranor thuhet:

***“Burrrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu.”*** (Âl ‘Imran, 14)



Krijimi me prirjen për t'i dashur disa gjëra të kësaj bote e për t'u lidhur me to, përbën për njeriun edhe provimin e tij më të madh.

Allahu i Lartmadhëruar e ka krijuar qenien sepse ka dashur të dihet e të njihet Qënia e Tij. Aftësinë më të lartë për ta njohur Atë ia ka dhuruar njeriut. Thënë ndryshe, shkaku i krijimit të njeriut është pikërisht «muhabbetullahu», pra dashuria hyjnore.

Kemi të bëjmë me një shpenzim të qenies, me pasoja të tmerrshme atëherë kur njeriu që është udhëtar drejt mejdanit të mahsherit (ditës së grumbullimit të madh) prej besatimit të Kalu Bela-së, ndalet në stacionin e dynjasë e ia falë shpirtin dashurive kalimtare të saj!

Sa bukur e konkretizon Rumi gjendjen e indiferencës njerëzore me fjalë poeti:

*“Nuk më shkakton habi qengji kur vrapon për t'i ikur ujkut. Tekefundit ujku është gjuejtësi i tij.*

*Çudi të jashtëzakonshme më shkakton qengji që bie në dashuri me ujkun, armikun e përbetuar të tij!..”*

Ta çosh dëm dashurinë në vende të papërshtatshme është njësoj si të shkojë dëm nëpër moçale e pirgje plehrash, uji i pastër i burimit.

Të gjitha dashuritë kalimtare që nuk përfundojnë te Allahu Fuqiplotë, që nuk të shpiejnë të Ai (xh.sh.), e që të dërgojnë në adresa të gabuara e në rrugë pa krye, janë vetëm burim lodhjeje dhe sikleti për shpirtin e njeriut.

Duhet të përceptohet mirë fakti që dashuritë kalimtare janë mjete për të arritur dashurinë e përhershme, pra janë shkallë në rrugën e arritjes së saj, e kështu duhen nxjerrë një e nga një nga zemra. E gjithë dashuria dhe i tërë interesimi duhet të drejtohen në adresën e duhur.

Zemra nga një xham i zakonshëm, nëpërmjet procesit të pastrimit e purifikimit fillon të kristalizohet. Vetëm kështu bëhet një elmas i meritueshëm për reflektimin hyjnor; ajo bëhet një diamant i çmueshëm



duke ruajtur thelbin e saj të pastër e duke e përpunuar atë me detajet e devocionit. Vezullimi i arritjes në destinacionin e duhur shkëlqen vetëm në zemrat që kanë mbërritur nivelin e diamantit në fjalë.

## NJË ZEMËR E PASTËR...

Në kuran zemra e purifikur emërtohet si kalbi selim; zemër e pastër, zemër që ka gjetur qetësinë, zemër e pastruar. Në ajetin që vijon theksohet se e vetmja rrugë shpëtimi është pikërisht një nivel i tillë zemre:

***“...në Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!”*** (Shuara, 88-89)

Për t'u arritur ky nivel është domosdoshmëri të braktiset e keqja që i është inspiruar nefsit (egos) për t'i dhënë kuptim sproves dhe të aktivizohen aftësitë shpirtërore. Ky proces emërtohet si takva (devotshmëri).

Lënda e parë e devotshmërisë është dashuria. Është aftësia dhe përpjekja për ta përdorur dashurinë në shërbimin e Atij që e meriton.

Të qëndruarit e njeriut larg dashurive të përkohshme apo të kthyerit shpinën krejt atyre; si për shembull refuzimi i martesës, agjërimi i vazhdueshëm e pandërprerje, të mospunuarit fare për sigurimin e të ardhurave për të jetuar, janë qasje që nuk i ka lejuar modeli ynë më i lartë i dashurisë, Resulullahu (a.s.). Besimtari nuk duhet të zgjedhë rrugën më të shkurtë, por rrugën më të saktë, atë që ka ndjekur gjatë jetës Resulullahu (a.s.).

## T'I SHNDËRROSH DASHURITË NË SHKALLË PËR TE DASHURIA HYJNORE

Ta lejojmë zemrën të priret drejt të vdekshmëve konsiderohet shpërdorim i saj. Rruga për t'i përdorur me vend këto prirje është braktisja e shpërdorimit të saj; të drejtuarit e tyre në dashurinë e vërtetë, të shndërruarit e tyre në shkallë drejt muhabbetullahut (dashurisë hyjnore).

Të gjitha dashuritë kanë dy anë. Ndaj të dyja anëve duhet treguar



një kujdes i madh, i njëjlojtë me atë që tregojmë natyrshëm ndaj anëve të mprehta të thikës.

Njeriu ndjen dashuri ndaj anëtarëve të familjes, në mënyrë të veçantë ndaj fëmijëve të tij. Mirëpo kjo dashuri ka dy anë.

Shumë fatkeqë, për t'ia bërë qejfin anëtarëve të familjes shkatërrojnë ahiretin e tyre. Për t'i krijuar kushte më të mira jetese familjes zhyten në kamatë, fitime haram e punë të tjera të ndaluara. Duke mos dashur t'ia prishin rehatinë, nuk arrijnë të bëjnë edukimin e tyre. -Le të mos heqin keq ata-, mendojnë ata, e kështu i shkaktojnë vuajtje të pafundme në botën tjetër vetes, por edhe anëtarëve të familjes.

Kjo është një dashuri e cila kultivohet në drejtim të familjes por në kahun negativ të saj.

Nëse personi dashurinë që ushqen për familjen do ta mbartte në horizontet e ahiretit duke vepruar me mendimin; «Dua të jem së bashku me familjen time jo vetëm në këtë jetë, por edhe në tjetrën. Nuk dua të jemi vetëm në varr apo në mahsher e të dënohemi duke u shkatërruar...», të motivohet për të punuar e për t'i ushqyer me kafshatën hallall pjesëtarët e familjes dhe kujdeset për moralin dhe formimin e tyre, pra nëse jeton sipas Kuranit dhe Sunetit të Resulullahut (a.s.), atëherë dashuria ndaj tyre nga një dashuri kalimtare bëhet një kënaqësi e përjetshme.

Në fakt familja ekziston për ta sjellë njeriun në këtë nivel pjekurie shpirtërore. Islami me strukturën e familjes e shndërron atë në një shkallë lartimi drejt dashurisë hyjnore duke e larguar njeriun nga jeta egoiste drejt një jete shpirtërore.

Ky është ndryshimi ndërmjet marrëdhënies së jashtëligjshme dhe kurores. Njëra e përçmon nefsin drejt xhehnemit e tjetra e larton atë drejt xhenetit.

Edhe **materialiteti** i tillë është:

Për shembull paraja është një gjë që e do shumë nefsi (egoja) për të



siguruar të gjitha nevojat materiale. Nëse ajo dëshirohet vetëm për këtë e shpie njeriun në shkatërrim. Sa të varfër ka që duke mos pasur mundësi të shkelin normat bëjnë një jetë të kujdesshme e po t'i kenë të ardhurat e mjaftueshme do ta ndryshojnë stilin e jetesës duke e lënë veten të bien në gjynahe. Të njëjtën gjë bëri edhe Karuni.

Ndërsa kur kërkohen të mirat materiale me nijetin dhe dëshirën e sinqertë; Për hir të Allahut të Lartmadhëruar do të zbus hallet e nevojtarëve, do t'i udhëzoj ata të cilëve u bëhet padrejtësi, një prirje e tillë bëhet shkak për fitimin e dashurisë hyjnore.

Ai që vrapon mbas fitimit dhe nuk lejon hyrjen e materiales në zemër, duke e perceptuar atë vetëm si mjet për të fituar kënaqësinë e Allahut të Lartmadhëruar e duke menduar «Unë jam përgjegjës për të varfërit, të vetmuarit e të braktisurit. Do të fitoj në rrugë hallall e do ta shtoj shërbimin ndaj njerëzve në nevojë!» përngjasohet dhe njësohet me gjendjet e sahabëve të nderuar të Resulullahut (a.s.) si Ebu Bekri, Osmani e Abdurrahman bin Avfi (r. anhum).

Ajo çfarë duhet të mbahet parasysh është pastërtia e nijetit dhe jo të përdoret nijeti si pretekst i nefsit.

Edhe **dëshira për post e pozita të larta shtetërore** është e tillë, me dy anë:

Ai person që kërkon post dhe makam për arsye që nxisin dënimin e Allahut të Lartmadhëruar, si mendjemadhësia e vetëpëlqimi; do të fundoset si faraonët dhe hamanët në shtjellat e të përkohshmes.

Kurse personat që me meritë, e prej të cilëve populli është i sigurt, kanë dëshirë e dashuri të ngarkohen me detyra të rëndësishme me qëllimin për t'u bërë kalifët e Zotit në tokë, të instalojnë drejtësinë e t'i japin hakun gjithsecilit, të ndihmojnë të varfërit, me principin “Shërbimi ndaj hallkut (popullit) është shërbim ndaj Hakut (Zotit)”, një dëshirë kalimtare e shndërrojnë në një gjë të pavdekshme.



Në lidhje me këtë temë kanë rëndësi edhe natyrat e prirjet e njerëzve. Personalitetet si Ibrahim bin Et'hem, e kanë arritur muhabbetullahun (dashurinë hyjnore) duke braktisur postet, sarajet e pozitat. Kurse nga profetët e Allahut të Lartmadhëruar, Hz. Sulejmani (a.s.), i bërë dua të Gjithpushtetshmit për një pushtet që nuk do të arrihet nga asnjë krijesë tjetër. Hz. Yusufi (a.s.) kërkoi postin e ministrit apo mbikëqyrësit të ekonomisë. Kurse Omer bin Abdulazizi, Sulltan Fatih Mehmet Hani, refuzuan të dorëhiqen, edhe pse personalisht nuk e donin më atë, nga posti i tyre vetëm e vetëm që të ishin të dobishëm për umetin e tyre.

Ata janë ruajtur nga mendjemadhësia, vetëpëlqimi, padrejtësia dhe shthurjet që shkakton pozita, madje arritën të bëheshin modele thjeshtësie, drejtësie e devotshmërie për bashkëkohësit e tyre.

Shembujt e këtyllë mund t'i shtonim, sigurisht. Por, thelbi i çështjes është mbajtja e zemrës nën kontroll, të moslejosh në zemër asnjë dashuri tjetër veç dashurisë ndaj Allahut të Lartmadhëruar dhe shndërrimi i disa prirjeve të natyrshme të saj në shkallë për te marifetullahu (dashuria hyjnore). Kjo është puna më e vështirë e zemrës. Ta përdorë dashurinë për Atë që e meriton;

## ARTI MË SUBLIM I ZEMRËS

Ashtu siç përcaktohet edhe në hadithet e Resulullahut, (a.s.), qendra më themelore dhe më e rëndësishme materiale dhe shpirtërore e qenies së njeriut është zemra.

Në Kuranin famëlartë shpjegohet qartë se në zemrat e atyre fatkeqëve që priren vetëm nga e përkohshmja duke u zhytur në gjynahe, ka sëmundje dhe shtrembërim, këto zemra hapen krejt ndaj vesveseve të shejtanit dhe nga zbukurimet e jashtme, duke u mbushur me mohim e gjynahe; pastaj ato duke humbur natyrshmërinë e tyre ndryshken, vulosen dhe kyçen; duke insistuar në indiferencë ato ngurtësohen e bëhen më të ashpra se gurët, e si përfundim zemrat në fjalë budallepshen duke u bërë intolerante,



inJORante, tirane, mendjemadhe, frikacake, të njëanshme, hipokrite, syfaqësore dhe intrigante, tallëse me të vërtetën, dëshuese dhe të verbëra.

Pa u pastruar nga këto vese të ulta është e pamundur të arrish Hakun (Zotin). Ato që e shpiejnë zemrën drejt këtyre greminave janë veset dhe huqet e tij. Janë dëshirat dhe dashuritë kalimtare dhe të ulëta.

Ndërsa zemrën e pastër me të cilën Allahu i Lartmadhëruar është i kënaqur prej saj e përshkruan; një zemër që dridhet kur përmendet Allahu i Lartmadhëruar, që ka frikë, e devotshme, e ndjeshme, e butë, e ruajtur, një zemër që priret veç nga Haku, e lidhur, rezistente, e paepur, që gjen prehje në përmendjen e Allahut të Lartmadhëruar e e mbushur me qetësi e lumturi.

Zemrave të tilla Allahu i Lartmadhëruar u ka dhënë dashuri për besimin dhe i ka zbukuruar me të vërtetat e imanit. E gjithashtu u ka dhënë atyre urrejtje për mohimin, gjynahin dhe rebelimin.

Njeriu që arrin këto nivele të larta pjekurie, përshpirtërohet dhe me mall kërkon të takohet me Zotin e tij. Tashmë vdekja është porta e domosdoshme e këtij takimi. Miqtë e Allahut të Lartmadhëruar që kanë arritur në nivele të tilla e kanë perceptuar vdekjen si çastin e takimit me Të duke e emërtuar atë si natën e dasmës. Rumi u shpreh këtë si;

## NATA E DASMËS

Rumi në medresetë e selçukëve kishte arritur nivelin e Gazaliut të dytë. Ai ishte një dijetar i qetë, një muderriz që bënte jetë të thjeshtë e modeste. Në brendësinë e tij fshihej një oqean i tërë. Detyra e aktivizimit të oqeanit të tij apo vërshimit të oqeanit të tij i ishte dhënë Shemsi Tebrizit.

Në rrugën që Rumi e përmbledh; «*Isha i papjekur, u poqa, u dogja!*...», ai hyri nëpërmjet miqësisë, dashurisë dhe bashkëbisedimeve me Shemsi Tebrizin.





Shemsi Tebrizi e ndezi shpirtin oqeanik të Rumiut me shkrepsen e dashurisë. Oqeanin e fshehur të urtësisë që ndodhej brenda Rumiut e zgjoi me flakën e dashurisë duke e bërë të dukshëm për të gjithë.

Më miqësinë e tij, e bëri Rumiun të shtegtojë nga e vdekshmja drejt pavdekshmërisë.

Ia shpjegoi me ndarjen dhe dhimbjen që ajo shkaktoi te Rumiun.

Kështu Rumiun;

Duke u djegur nga malli i ndarjes nga miku i vetëm që njihte gjuhën e tij të shpirtit, Shemsi Tebrizi, ai arriti në gradën e dëgjimit të dhikrit që bënte edhe një çekiç gjatë punës.

Nivelin e arritur prej tij, Rumiun e përshkruan;

*“Isha i vdekur, u ngjalla... Isha një pikë loti e u bëra buzëqeshje... U zhyta në oqeanin e dashurisë e të ashkut; e në fund mbërrita, gjeta pavdekësinë...”*

Ndërsa me miqësinë që ai kishte me Hysameddin Çelebiun nëpërmjet Mesnevisë hodhi në fjalë dashurinë dhe urtësinë. U ngjiz një vepër e rrallë që është udhërrëfyes për të gjithë shpirtërat e dashuruar.

Rumiun që arriti majat e këtij arti të zemrës, me veprat e tij na mësoi shumë të vërteta.

## KËSHILLAT E RUMIUT NË LIDHJE ME DASHURINË

### Atyre që kanë rënë në kurthin e dëshirave trupore:

*“Mos u përpjek të ushqesh e të zhvillosh trupin. Sepse ai tekefundit do t’i bëhet kurban tokës. Ti përpiku të kultivosh shpirtin! Ai do të nderohet e do të naltohet për te më i Madhi.”*

*“Kultivoje shpirtin me ushqime shpirtërore. Pajise atë me mendim të thellë, shikim të mprehtë e me begati shpirtërore; që të arrije atje ku është nisur i fortë e i shëndetshëm.”*



### **Atyre që janë përfshirë nga dashuria për pasuri e mall:**

*“Çfarë ndodh me njeriun që bëhet rob i arit e i dynjasë? E çfarë vlere ka ajo gjë që nuk harxhohet në rrugë të Zotit? Të poshtërohesh e të bëhesh rob i dynjasë duke u përdredhur si një gjarpër para portës së saj çfarë tjetër mund të jetë përveçse mjerimit që e dërgon njeriun duarbosh drejt qiejve?”*

*“Mos u jep shumë mbas pasurisë dhe pozitës; që kur të vijë koha mos ta kesh të vështirë shkëputjen prej saj. Jepe pa u menduar, shko e fito sevap! Dhuroja vetën Atij që të mban, Ai është i Pari, e Ai është i Fundit. Nëse dëshiron ta gjesht Atë, hiqe peshën e nefsit që ta fundos varkën e shpirtit, që të arrish ku dëshiron.”*

### **Atyre që janë përfshirë nga dashuria për post e pozitë:**

*“Kur magjistarët, që u torturuan dhe u dënuan me vdekje nga Faraoni, pranuan Zotin e Musait u shprehën:*

*O Faraon! Allahu na begatoi me një mbretëri të atillë, saqë mbretëria jote përballë saj është një hiç. Mbretëria që na u dhurua nuk është kalimtare, por e përhershme. Edhe ne si Habibi Nexhxhar shprehemi me plot gojë; «Ah sikur ta dinte populli ynë!»”*

*“O Faraon! Tërhiq nga Misiri, në atdheun e shpirtit ka me qindra Misire!”*

Por duhet ditur mirë se dashuria që i thuri vargje dhe i bëri himn Rumi, nuk është asnjë gjë tjetër veç dashurisë që fton Islami, Kurani Famëllartë dhe Resulullahu, (a.s.). Ashtu siç ankohet ai vetë në hyrje të Mesnevisë, jo çdokush që dëgjon tingujt e zemrës së tij kupton shqetësimin dhe qëllimin e vargjeve të tij; disa prej tyre siç i vjen edhe më këndshëm nefsit të tyre, e perceptojnë atë thjeshtë si një filozof humanist, një poet që shkruan për dashurinë njerëzore e një mendimtar. Rumi është shprehur para shumë shekujsh në lidhje me përpjekjet për deformimit të figurës së tij:

*“Sa të kem frymë e shpirt unë jam shërbëtor i Kuranit.  
Unë jam pluhur i rrugës së Muhamed Mustafait.*



*Nëse dikush nga fjalët e mia përfton çfarë do ai.  
Atëherë unë lëndohem prej tij, e ndjej neveri.”*

Këto vargje janë në të njëjtën kohë edhe përkthyeset e të vërtetës së madhe:

Kushti i muhabbetullahut, dashurisë hyjnore është:

## DASHURIA NDAJ RESULULLAHUT (A.S.)

Rruga më e saktë dhe më e shkurtë që të shpie në dashurinë hyjnore kalon nga dashuria e më të dashurit të Allahut të Lartmadhëruar. Ndërsa manifestimi i kësaj dashurie është bindja ndaj Resulullahut (a.s.).

Është kusht i domosdoshëm lidhja me çdo aspekt të tij dhe bindja absolute ndaj tij duke u mbështetur në principin **“I dashuruari do çdo gjë të asaj qenie që dashuron.”**, apo sipas urtësisë së hadithit **«Njeriu është me atë që do.»**. Lidhja dhe bindja e plotë ndaj Resulullahut, (a.s.), është shtylla kurrizore e dashurisë hyjnore. Niveli i dashurisë matet me sakrificat dhe përpjekjet që bëhen në emër të kësaj dashurie.

Dashuria që ndjehet për Resulullahun, (a.s.), reflektohet si qetësi në adhurime, politesë në marrëdhëniet ndërnjerëzore, rafinim në moral, dhëmbshuri në shpirt, shpirt ndër fjalë dhe thellësi në shikim. Burimi më i ngrohtë për fitimin e këtyre cilësive kaq të bukura është i Dërguari i Allahut (a.s.).

Me të vërtetë shpirtërat mund ta mësojnë dashurinë në kuptimin e plotë të fjalës nga atmosfera e tij shpirtërore, vetëm atëherë kur të arrijnë të sillen e të digjen si fluturat rreth Nurit të Qenies së tij. Për ta matur nivelin tonë të dashurisë ndaj Resulullahut, (a.s.), Rumi, (k.s.), jep disa manifestime të kësaj dashurie në univers:

*“Sa e sa flutura u hodhën në zjarr në emër të dashurisë. Tundën krahët mes flakësh, u dogjën e u përcëlluan dhe me gjuhën e gjendjes na thanë: «Bëhuni edhe ju si ne!»”*



*“Qiriu edhe digjet edhe qan. Ia ka dhënë veten vuajtjes e djegies. Mirëpo teksa qan e përletet shpërndan rreth tij dritë.”*

*Qiriu na thotë; «Çfarë dobie do të kesh nga fitimi i kësaj bote, nga ari e sermi? Nëse dëshiron të fitosh shpirtëroren, prej së cilës do të kesh dobi të pafundme, digju e shkrijë si unë!»*

Sahabët e nderuar, në dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij sakrifikuan aq shumë sa edhe fluturat që hyjnë në zjarr, ia patën zilinë. U shkrinë si qirinjtë e shndritën si yjet. Ja njëri prej tyre:

### SEUBANI (R.A.)

Seubani u kap rob në zonat e Jemenit dhe u soll në Medinën e shndritshme. Në saje të Resulullahut, (a.s.), fitoi lirinë. Ai iu bashkua sahabëve të suffes duke mos pranuar të kthehej në vendlindje, edhe pse iu dha leja për ta bërë një gjë të tillë. Ai ia dedikoi jetën shërbimit ndaj Resulullahut, (a.s.), kuvendimeve të tij, mësimit përmendsh të haditheve, praktikimit dhe transmetimit të tyre. Ai nuk kishte asnjë pasuri të kësaj bote, as një pemë të mbjellur madje. Atë nuk e tërhoqi asnjë dashuri tjetër në jetën e kësaj bote. Kredhja në dashurinë hyjnore ia zeroi të gjitha dëshirat e tjera.

Një ditë Seubani teksa po dëgjonte Resulullahun, (a.s.), gjatë kuvendimit të tij, po e shikonte atë me një shikim të thellë dhe të përhumbur. Kishte një gjendje shumë të tensionuar. Gjendja e tij i ra në sy Resulullahut (a.s.), i cili me mëshirë e pyeti:

*“O Seuban! Çfarë të mundon?”*

Seubani i mikluar nga vëmendja që po i kushtonte Resulullahu, (a.s.), me zemrën e mbushur me dashuri iu shpreh:

*“T’u bëfshin kurban nëna, babai dhe jeta ime, o Resulullah! Malli që kam për ty më djeg e më përcëllon aq shumë, sa kur jam larg bukurisë së nurit tënd, qoftë edhe për disa çaste, më kaplon vuajtja dhe mjerimi i ndarjes... Nëse vuajtja nga të qenët jo bashkë me ty në këtë dynja*



dhemb kaq shumë po dhembja e të qenët larg teje në ahiret sa shumë do të ndihet?!

Në botën tjetër ju do të jeni së bashku me profetët e tjerë.

Kurse çështja ime nuk dihet si do të shkojë në botën tjetër, nuk e di me kë do të përfundoj të jem! E nëse nuk do të mund të hyj në xhenet do të privohem tërësisht nga mundësia e të shikuarit ty. Këto mendime ma trazojnë shpirtin, o Resulullah!”

Fjalëve plot dhembje të Seubanit, që shpesh dëgjoheshin edhe nga sahabët e tjerë, por edhe kervanit të shpirtërave që do të digjen nga malli për të, deri në kiamet, Resulullahu, (a.s.), u dha sihariqin ngushëllues:

*“Njeriu është me atë që do.”* (Buhârî, Edeb, 96; Muslim, Birr, 165.)

Resulullahu, (a.s.), që ndezi këtë kandil dashurie në shpirtin e sahabëve, por edhe në shpirtin e të gjithë miqve të Hakut deri në kiamet, është manifestimi më kulminant i dashurisë hyjnore. Ai në çastet e fundit të kësaj jete u shpreh *«drejt Refikit Ala»* (Mikut më të Lartë), e kështu ai ndezi dritën e natës së dasmës për të gjithë miqtë e Hakut.

Edhe Shah Nakshibendi është prej atyre miqve të Allahut që dashuritë e tjera i bëri shkallë për të dashuria hyjnore, madje ai u bë një nga mjeshttrat më të shquar të këtij arti. Dashuria e tij është shërbimi;

## DHËMBSHURIA DHE DASHURIA PËR KRIJESAT

Shah Nakshibendi u lartua në rrugën shpirtërore me sugjerimin e mjeshtrit të tij, Emir Kulal:

*“Përpiku të fitosh zemrën e njerëzve; shërbeju të paafëte! Mbroji të dobët dhe zemërthyerit! Ata janë të tillë që nuk presin gjë nga askush. Shumica e tyre jeton në prehje, modesti e butësi. Të tillët geji dhe shërbeju!”*

Një mik tjetër i Hakut këtë të vërtetë e shpreh në mënyrë të përmbledhur duke u shprehur:



“Bëhu hije në diell, bëhu kaftan në ftohtë, bëhu bukë në uri!”

Shah Nakshibendi, në vitet e para të rrugëtimit të tij, për të arritur gradën e hiçit që është gjendja e kundërt e mendjemadhësisë dhe egoizmit, u shërbeu të sëmurëve dhe të vuajturve, kafshëve të plagosura, madje ai për shtatë vite pastroi rrugët ku kalonin njerëzit me dëshirën maksimale për të shërbyer.

Pengesa më e madhe në rrugën e dashurisë është nefsi (egoja) uni. Nuk arrihet të dashuria e vërtetë pa hequr dorë prej egos, pa u shkrirë tërësisht në qenien që dashurohet. Jeta e miqve të Hakut është rrugëtimi nga fena fil’lah (shuarja në dashurinë e Allahut) në beka bil’lah (përfjetësimin në dashurinë e Allahut).

Shah Nakshibendi që ishte edhe shembulli më i zgjedhur i hiçit, një ditë teksa po i mbante një ligjeratë ndjekësve të tij, u tregoi këtë ngjarje:

*“Sipas transmetimeve një ditë Shejh Ebu’l-Abbas Kassâbin e pyetën:*

*«-Gjatë ceremonisë së xhenazes tuaj cilin ajet na sugjeroni të këndojmë?»*

*Dijetari i nderuar u shpreh:*

*«Leximi i ajeteve u takon të mëdhenjve, ndërsa për ne lexoni këto vargje: Çfarë ka në këtë botë më të bukur se sa arritja e mikut tënd te më i Dashuri!»*

Pasi Shah Nakshibendi u tregoi këtë ndodhi me modesti e përkorësi nxënësve të tij u tha:

*«Vargjet e mësipërme i meritojnë të mëdhenjtë. Në ceremoninë e xhenazes time është e mjaftueshme të thoni: Erdhëm në praninë Tënde si lypsarë të falimentuar! Pashë hatrin e Dashurisë Tënde na e bëj risk një grimcë të Bukurisë Tënde!»*

Shah Nakshibendi që u përgatit për frymën e fundit me vetëdijën e robërisë ndaj Hakut e me dashurinë ndaj krijesave të Tij duke u bërë



monument i modestisë dhe hiçit, në lidhje me frymën e fundit është shprehur:

*“Shoqërohuni me atë me të cilin keni dëshirë të shoqëroheni në frymën e fundit.”*

Pra ashtu siç dëshirojmë ta përfjetojmë momentin e frymës së fundit duhet ta kalojmë edhe të gjithë jetën.

Që fryma e fundit të mund jetë momenti i arritjes së takimit me Zotin duhet që gjithë jetën ta kalojmë me dëshirën dhe mallin e takimit me Të.

Ajo çfarë do të na duhet në frymën e fundit është dëshmia e shehadetit, përmendja e Zotit me zemrën e mbushur me iman e besim.

Prandaj është domosdoshmëri kalimi i një jetë të tërë me dhikër dhe larg harresës së Zotit të Lartmadhëruar, me vetëdijën se gjendemi vazhdimisht nën vëzhgimin e kamerave hyjnore.

Ashikët e Hakut që kaluan një jetë të tërë me këtë vetëdije të lartë, dashuruan edhe mjeshtrat e tyre që u bënë shkak për ta të arrinin në këto grada kaq të larta.

Ata shkruajtën vargje dashurie, malli e mirënjohjeje për Resulullahun, (a.s.), dhe për udhëzuesit e tyre shpirtëror që i drejtuan për kah dashuria hyjnore.

## TINGUJT E TRISHTË TË DASHURISË

Jaman Dede me një të kaluar në religionin e krishterë arriti ta përfjetojë kënaqësinë e Hakikatit Muhammedije thellë në shpirt, duke u bërë një ashik i zjarrtë i Resulullahut, (a.s.), në saje të Mesnevisë. Një ditë atë e pyetën nxënësit e tij:

“-Pse na flisni kaq shpesh për Rumiun dhe Mesnevinë e tij?”

Përgjigjja e tij me shumë mirënjohje ishte:



“Evladët e mi, Rumi u më kapi për dore mua e më çoi te porta e Resulullahut, (a.s.), duke u bërë shkak për udhëzimin tim. Fakti që unë flas shpesh për të lidhet me këtë të vërtetë. Por unë mendoj se edhe pse e përmend shpesh, sërish është pak.”

Në lidhje me dashurinë hyjnore dhe me udhëzuesin e saj, Resulullahun (a.s.) kanë shkruar edhe njerëz të tjerë vargje të bukura e të zjarrrta.

Prej gjokseve të tyre që u dogjën e u thanë nga malli për ta parë Resulullahun (a.s.) në ëndërr, për ndërmjetësimin e tij në mahsher, për të pirë një gllënjë nga keutheri i tij, për t'u përfshirë në grupin e atyre fatlumëve që do të jenë së bashku me Resulullahun (a.s.) në xhenet, buruan tingujt më të bukur të ashkut...

Por vargjet e tyre është e pamundur të kuptohen vetëm duke i lexuar sepse ato kanë buruar nga malli që shkakton dëshira e zjarrrtë për takimin e madh.

Kuptimi i tyre i vërtetë rroket vetëm duke u zhytur në oqeanin e madh të dashurisë hyjnore ku ata gjetën përjetësinë.

Ashtu siç shprehet edhe Rumi:

*“Nëse kërkon të më kuptosh mua tërësisht, atëherë bëhu si unë!”*

Sa bukur e shpreh Ibrahim bin Ed'hem faktin se ai që nuk e përjeton kënaqësinë e madhe të dashurisë hyjnore nuk mund ta kuptojë kurrë atë:

“Sikur dalldia apo ekstaza që përjetojmë ne në dashurinë hyjnore të ishte diçka konkrete, mbretërit, për ta pasur dhe për ta shijuar atë, do të ishin gati të flijonin të gjitha pasuritë, madje edhe mbretërinë e tyre.”

**Allahu i Lartmadhëruar na dhuroftë edhe neve nga gjendjet e atyre ashikëve të Tij që e pastruan zemrën prej dashurive kalimtare dhe i bënë dashuritë e tilla shkallë për kah muhabbetullahu, dashuria hyjnore!**





**Na bëftë edhe ne prej atyre robërve që momentin e fundit të jetës e përjetojnë si një moment lumturie e takimi me Zotin e tyre dhe që në frymën e fundit dëgjojnë thirrjen e Allahut të Lartmadhëruar: *O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!* (Fexhr, 27-30)**

**Amin!..**





E vërteta dhe shpëtimi në dynja dhe ahiret arrihen

VETËM DUKE E DASHUR ATË



# VETËM DUKE E DASHUR ATË

Arrihen e vërteta dhe shpëtimi  
Në dynja dhe ahiret

## SHEMBULLI MË I VEÇANTË...

I Dërguari i Allahut, (a.s.)...

Mëshirë për botët...

Shkak për mëshirimin, shpëtimin dhe faljen në të dyja botët...

Vepra më e lartë dhe më madhështore artistike ku manifestohet në kulmin e vet emri i Allahut Teala, el- Xhemal (I Bukuri)...

Kriteri më i mrekullueshëm i veprave për njerëzimin dhe udhërrëfyesi më i zgjedhur...

Ishte fati i sahabëve ta shikonin atë dhe të ishin të pranishëm në kuvendimet e bereqetshme të tij. Kurse për ne u caktua të vinim 1400 vjet pas Resulullahut, (a.s.), në këtë jetë. Për ata që nuk patën mundësi të jetonin në të njëjtën kohë dhe vend me të, u bë ngushëllim e vërteta:

Në hadithin e mësipërm thuhet:



*“Njeriu është bashkë me atë që do.”* (Buhari, Edeb, 96.)

Sahabët që ishin edhe me trup edhe me zemër me Resulullahun, (a.s.), në jetën e kësaj bote, trishtoheshin nga mendimi se mund të ndaheshin nga ai në botën tjetër, vraponin me shqetësim drejt tij dhe duke derdhur lot kërkonin ta shuanin zjarrin e trishtimit që vlonte në gjokset e tyre.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), duke ia treguar kushtin e të qenët me të në botën tjetër, i ngushëllonte ata, por njëkohësisht u tregonte rrugën që ata duhet të ndiqnin:

#### «NJERIU ËSHTË ME ATË QË DO.»

Resulullahu, (a.s.), vendosi ta dërgonte Muadh bin Xhebelin vali në zonën e Jemenit. Duke e përcjellur atë i tha:

*“- O Muadh! Ndoshta pas këtij viti nuk do të më shohësh më, me shumë mundësi do ta vizitosh këtë mesxhidin tim dhe varrin tim!”*

Pasi dëgjoi këto fjalë, Muadhi u përlot. I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

*“- Mos qaj o Muadh!..”* dhe pastaj e ktheu kokën nga Medina e ndritur dhe u shpreh:

*“- Njerëzit që janë më afër meje, janë ata që kanë më shumë frikë-respekt për Allahun.”* (Ibn Hanbel, V, 235; Hejsemi, IX, 22.)

Kjo do të thotë:

Më të afërtit e Resulullahut (a.s.) janë ata që kanë frikë-respekt ndaj Allahut Teala, edhe nëse ata vijnë 1400 vjet më pas apo 2000 vjet më pas.

Prandaj jemi të detyruar ta peshojmë veten:

#### **Sa kemi dashuri?**

Sa e duam të Dërguarin e Allahut, (a.s.)? A dëshirojmë që në ditën e Kiametit, në atë shpërthim të madh, të jemi në krahët e dhembshurisë së tij, të jemi bashkë me të?



Duhet ta marrim në llogari veten tonë...

Jeta jonë familjare sa ngjason me jetën familjare të Resulullahut, (a.s.)? A jetohej Suneti i tij në familjet tona?

Struktura e shtëpisë sonë a ngjason me kriteret qiellore të strukturës familjare të Resulullahut, (a.s.)?

Po sofrë jonë? Sa është e hapur ajo ndaj mysafirëve dhe krijesave të tjera të Allahut, (xh.sh.)?

Stili jonë i të bërit tregti, a ngjan me stilin e tij? Tregtia që ne bëjmë, a është në përputhje me parimet e tij që janë plot jetë për të dyja botët? Sa përfitojmë ne prej saj dhe sa përfitojnë të tjerët?

Cilësia më e rëndësishme e dashurisë për Resulullahun, (a.s.), që do të sigurojë begatinë dhe mirësinë në dynja dhe në ahiret, është të qenët e saj mbizotëruese në çdo etapë të jetës.

Resulullahu (a.s.), pasi realizoi marrëveshjen e Medinës, gjëja e parë që bëri ishte vizita në treg. I hodhi një sy grurit dhe frutave që shiteshin në pazar. Vuri re që poshtë ishin të lagurat dhe sipër të thatat. Menjëherë u shpreh me kritikë:

*“Nuk janë prej nesh ata që mashtrojnë myslimanët.”* (Muslim, Iman, 164.)

Po vëllazëria jonë e fesë në çfarë gjendjeje është?

Sa lumturohemi në me gëzimin e shoqërisë, me lumturinë e vëllzërve tanë?

Sa mërzitemi me trishtimin e shoqërisë? Sa bëhemi ortakë në hallet e të vuajturve, të vetmuarve, e hallexhinjve?

Sa përpiqemi ne dhe sa realisht sakrifikojmë nga vetja jonë?

Çfarë marrëdhëniesh sociale kishte Profeti ynë, (a.s.)?

Çfarë marrëdhëniesh ndërtonte Profeti (a.s.) me të varfrit, të vetmuarit, hallexhinjtë? Po ne si i ndërtojmë këto marrëdhënie? Ne e dimë



që kur në familjen tij i vinte diçka, Resulullahu, (a.s.), nuk gjente qetësi pa e ndarë me të tjerët.

Sa jemi ne bashkë me Resulullahun, (a.s.), në të gjitha këto gjendje, në çdo segment të jetës, në parimet e tij të adhurimit, të jetës familjare apo shoqërorë, në mënyrë që të fitojmë të drejtën për të qenë së bashku me të në kiamet?..

Sepse kushti për të qenë së bashku me të:

### **DASHURIA E VËRTETË...**

Të duash, të posedosh një ndjenjë dashurie, është një mirësi e Allahut, një caktim i Tij... Ekziston një ndjenjë dashurie në të gjitha krijesat, në një formë apo në një tjetër. Me ndjenjën e dashurisë vazhdon ekzistencën lloji, me ndjenjën e dashurisë krijesat ofrojnë bukurinë e tyre.

Nëna ka dashuri për të voglin e saj. I vogli ka dashuri për nënën e tij. Ka dashuri mes bashkëshortëve, vëllezërve, motrave, miqve. Ka dashuri për atdheun, komunitetin dhe shoqërinë. Kur e shkëpusim qengjin nga kopeja, ai sërish rikthehet në tufë...

Pra, ka dashuri të përhapur në të gjithë universin.

Por njeriu, si krijesa më e nderuar, duhet të dijë që;

Qendra e vetme e dashurisë është Allahu i Madhëruar.

Dashuria është manifestim i njërit prej emrave më të bukur të Allahut (xh.sh.), el-Vedûd. Miqësia dhe dashuria janë attribute të Allahut të Madhëruar. Origjina e vetme e dashurisë është Allahu i Madhëruar.

Është e trishtueshme që dashurinë, që është një amanet hyjnor, e keqpërdorim duke ua dhënë të pameritueshmëve, e flijojmë për ambiciet, epshet, dhe për adresat e gabuara fizike, egoiste, kalimtare dhe të ulta.

Me fjalë të tjera, të drejtuarit e dashurisë në vendet e gabuara, është shpërdorimi më i shëmtuar. Është njësoj sikur ujin e burimit ta derdhim në moçal.





Dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij është Sidretü'l-Müntehâja<sup>1</sup> e dashurisë.

Të mund ta kthesh në miraxh dashurinë... Ata që nuk mund ta shndërronjë në miraxh këtë mirësi të Allahut Teala, janë në një humbje shumë të madhe. Ata do t'i tresin fuqitë e tyre në një në një rrugë pa krye.

Egot e papërpunuara që nuk i janë përgjigjur Sunetit të lartësuar të zotërisë së universit, Hazreti Muhamedit (a.s.), dhe nuk janë angazhuar me edukimin shpirtëror, bien në gabimin e harxhimit të dashurisë në destinacionet e gabuara. Një ego e tillë i ngjan një maceje tepër të dhënë pas gjuajtjes së presë së saj, miut. Kjo mace, të cilës i janë servirur ushqimet më të shijshme, teksa po ushqehet me të gjitha të mirat, sheh një mi dhe largohet nga gjithçka për të shkuar pas tij, pas kësaj krijese të ndyrë.

Allahu i Lartmadhëruar i Cili na urdhëron të lexojmë urtësitë dhe sekretet e universit, e fton robin e Tij drejt burimit të dashurisë, adresës së vërtetë të saj.

Ndërsa etaloni i vërtetë i dashurisë ndaj Allahut Teala është bindja ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Dashuria ndaj Allahut matet;

## ME BINDJEN NDAJ MË TË DASHURIT TË TIJ

Në një ajet kuranor urdhërohet:

*“Thuaju (o Muhamed):*

***«Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë».*** (Al-Imrân, 31)

Allahu i Madhëruar na jep një etalon.

1. Pema ku iu shfaqen sekretet hyjnore Hazreti Muhamedit (a.s.) në natën e Miraxhit (Sqarim nga përkthyesi).



Parametri që mat dashurinë tonë ndaj Allahut, lidhet me faktin se sa i bindemi dhe e ndjekim të Dërguarin e Allahut.

Pra dashuria ndaj Allahut është e ndërlidhur me ndjekjen e Profetit, (a.s.).

Aq sa jemi brenda Sunetit të Resulullahut, (a.s.), aq sa përpiqemi të jemi në jetën e Resulullahut, (a.s.), në urtësinë dhe këshillën e tij, aq është e pranishme edhe dashuria e Zotit të Lartmadhëruar tek ne.

Ky është një kriter që duhet ta kemi në qendër të vëmendjes ...

Aq sa kemi bindje ndaj të Dërguarit të Allahut, aq kemi dashuri për Allahun e Madhëruar. Aq sa kemi etje për Sunetin, pra për zbatimin e tij në jetën tonë, aq kemi edhe dëshirë të vërtetë për të arritur tek Allahu i Madhëruar.

Në një jetë që kalohet me përpjekje serioze dhe të sinqerta për të ndjekur Resulullahun, (a.s.), çdo gjë që ne shohim, dëgjojmë, lexojmë, na kujton Allahun e Madhëruar. Kënaqësia e vërtetë e dashurisë shijohet duke u lidhur me Allahun, (xh.sh.), dhe të Dërguarin e Tij, (a.s.). Ndërsa kënaqësitë e tjera jashtë këtyre që përmendëm janë shkak për humbjen e plotë të njeriut.

Një dashuri e gjerë për Allahun e Madhëruar e çon njeriun tek i Dërguari i Tij. E çon atë në bindjen ndaj tij.

Sepse;

### **VIZA JONË DREJT PËRJETËSISË ËSHTË TEK AI (A.S.)...**

Për kalimin nga një shtet në një tjetër, në kushtet e kësaj dynjaje, kërkohen pasaporta dhe viza.

Për të kaluar në botën e përjetshme duhet të marrim nga Resulullahu, (a.s.), vizën e lumturisë, paqes, sigurisë, pra xhenetit, faljes, ndërmjetësimit të tij. Allahu i Madhëruar, na drejtohet edhe ne teksa i drejtohet të gjithë umetit të Profetit Muhamed (a.s.):



***“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju...”***

(Bekara, 143)

Allahu i Madhëruar shprehet;

**“Le të jetë Profeti dëshmitari juaj.”** Arritja tek Allahu Teala është e mundur vetëm me dëshmimin, përkujdesjen dhe udhëzimin e Profetit (a.s.).

Mësuesi i të gjitha diturive fetare të tilla si akâid, ibadet, muamelat, ukûbat, tefsir, hadith është Resulullahu, (a.s.). Shembull i gjallë i Kuranit që përfshin të gjitha dituritë në fjalë është sërish Profeti ynë. Të gjitha veprat islame janë shkruar për të shpjeguar një libër dhe për të sqaruar Resulullahun, (a.s.), i cili e bëri atë libër moralin e tij.

Ai që e jeton Sunetin, rrit mundësinë e marrjes më shumë pjesë urtësie e mirësie nga Kurani. Kushdo që përpiket të marrë një pjesë nga struktura shpirtërore e të Dërguarit të Allahut, atëherë ai bëhet më i meritueshëm që në qenien e tij të manifestohen në mënyrën më të përsosur emrat e Allahut të Madhëruar.

Dashuria dhe bindja ndaj Allahut të Madhëruar dhe ndaj të Dërguarit të Tij, janë të ndërthurura ...

Në një ajet Kuranor thuhet:

***“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut.”*** (Nisâ, 80)

Duke iu bindur të Dërguarit, ju i bindeni Allahut.

Pra, nuk ka dualitet në bindjen ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, kjo është një bindje e vetme, e cila përbën bazën e dashurisë.

Shpëtimi dhe lumturia e robit të Allahut, në këtë botë, në varr dhe në botën tjetër, është e mundur vetëm duke ndjekur gjurmët e të Dërguarit të Allahut. Pra, e gjithë çështja lidhet me;



## MUNDËSINË E MARRJES PJESË NGA STRUKTURAT SHPIRTËRORE TË TIJ

Katër detyrat kryesore të Resulullahut, (a.s.), gjatë jetës së kësaj bote ishin:

1. Komunikimi i urdhrave të Allahut,
2. Pastrimi i egove,
3. Mësimi i Librit, Kuranit,
4. Mësimi i urtësisë.

Ne duhet të bëhemi nxënës dhe ndjekës të Profetit si sahabët e sufës, në mënyrë që struktura jonë shpirtërore dhe fizike të jetë e shëndetshme, për të përfutur sa më shumë nga Resulullahu, (a.s.).

Në një ajet Kuranor urdhërohet:

***“Vërtet, kushdo që pastrohet së brendshmi, do të shpëtojë”*** (Shems, 9)

***“Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen.”*** (Bekare, 222)

***“...petkat e tua pastroji.”*** (Muddeththir, 4)

Pra, pastërtia jonë materiale dhe shpirtërore është një domosdoshmëri.

Në fillimin e pastrimit shpirtëror, vjen rafinimi i botës së brendshme, filtrimi i saj, pastrimi i saj nga gjithçka që e largon atë nga Allahu, dhe mbrujtja me çdo cilësi që e afron atë me Allahun.

Që kjo të realizohet në mënyrën e duhur është thelbësore të kuptojmë Kuranin dhe urtësitë. Është domosdoshmëri të përvetësohen dimensionet e thella të Kuranit.

Allahu i Madhëruar shprehet si më poshtë për ata që nuk zhyten në thellësitë e Kuranit:

***“Vallë, a nuk përsiatin ata për Kuranin apo i kanë zemrat të kyçura?!”*** (Muhamed, 24)



Çështja është të mund të bëhemi një Kuran i gjallë.

Atëherë;

Urtësitë e fshehta të universit fillojnë të bëhen gjithnjë e më të dukshme.

Manifestohet pastërtia dhe transparenca shpirtërore.

Sigurisht, pastërtia materiale është thelbi, themeli i saj.

Për këtë arsye është thënë;

*“Pastërtia vjen nga besimi!”*

Për Allahun e Lartmadhëruar robërit besnikë dhe vepërmirë janë ata që kanë pastruar botën e tyre të jashtme dhe të brendshme.

Allahu i Madhëruar dëshiron që të gjithë robërit e Tij të bëhen të tillë, prandaj urdhëron:

***“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)!”*** (Teube, 119)

Besimtari duhet të përpiqet të jetë së bashku me besnikët, dhe duhet të shfaqë me të gjitha gjendjet e tij mirësi, politesë, delikatesë dhe me fytyrën e qeshur të Islamit, duhet t'i buzëqeshë të gjitha krijesave.

Sepse;

Jeta jonë e varrit do të formësohet sipas jetës sonë të kësaj bote.

Forma jonë e ringjalljes në ahiret dhe gjendja e fytyrës dhe trupit tonë do të jenë të lidhura krejtësisht me jetën tonë shpirtërore të kësaj bote.

Kiameti është një skenë e madhe terrori, një shpërthim i tmerrshëm.

Por ai shpërthim dhe tmerr nuk do t'i dëmtojë besimtarët e vendosur.

Në një ajet Kuranor thuhet:



***“Me të vërtetë, atyre që thonë: «Zoti ynë është Allahu», e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë:***

***«Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.»»*** (Fussilet, 30)

Kështu që rruga për shpëtimin në botën tjetër, do të fitohet në këtë botë.

Sepse;

## NË VARR NUK DO TË FITOHET ASGJË

Në Ahiret nuk do të fitohet asgjë gjithashtu! Vendi i fitimit është vetëm kjo dynja...

Sa përpiqemi ne për ta jetuar fenë e Allahut dhe Sunetin e Profetit tone, në mënyrë që në ditën e Gjykimit, Profeti (a.s.) të dëshmojë pro nesh?!

Ai Profet, (a.s.), që është plot dhembshuri ndaj nesh...

Në një ajet kuranor thuhet:

***“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.”***

(Teube, 128)

Ne duhet të jemi të gëzuar dhe të lumtur në çdo moment të jetës sonë, për mirësinë e të qenët umet i Resulullahut, (a.s.), i cili është i dhembshur dhe plot mëshirë ndaj nesh, zemërbutë ndaj nesh. Nuk duhet të mbytemi në vorbullën e frikës dhe shqetësimit.

Ne duhet të mendojmë;

A ka dhuratë më të madhe sesa të jesh umet i zotërisë sonë, Resulullahut, (a.s.)?



Resulullahu, (a.s.), nuk është vetëm shkak mëshire për ne, në botën tjetër. Bindja me dashuri ndaj tij e shpëton njeriun nga të gjitha shqetësimet edhe të kësaj jete.

**Shprehjet e Mjekut të zemrave, plot shërim për gjoksin, ilaç për zemrën, dhe plot urtësi, njohuri të thellë dhe sekret, si dhe veprimet dhe këshillat e tij, janë ujë jete edhe për trupin edhe për shpirtin tonë.**

**Frymët e tij me aromë xheneti dhe frymëzimet çliruese, nëse ndiqen, janë ilaçi i vetëm që do të na sigurojë qetësinë, paqen dhe sigurinë e vërtetë.**

Sepse fryma e tij e mirësisë dhe e shërimit e shndërroi periudhën e injorancës në epokën e artë të lumturisë; Jethribin e zjarhtë e ktheu në Medinën e ndritshme, toka dhe pluhuri i së cilës u bënë shërim; njeriun e kohës së injorancës, që kishte trupin e ndotur dhe shpirtin e njollosur, e shndërroi në sahab të nderuar i cili ndërtoi një civilizim plot vlera si kurrë më parë në historinë e njerëzimit.

Shërimi i tij është edhe i brendshëm, edhe i jashtëm...

Si trupor ashtu edhe shpirtëror...

Për këtë arsye, të gjithë pejgamberët që nga Profeti Adem, (a.s.), e deri tek Hazreti Isai, (a.s.), i gjithë njerëzimi, zgjidhjen e problemeve dhe shërimit të zemrave e kanë kërkuar nëpërmjet dashurisë ndaj Profetit tonë.

Dijetari Es'ad Erbilî, në emër të umetit të Profetit Muhamed, (a.s.), i është drejtuar Resulullahut (a.s.):

**Prej teje kërkojmë shërim ...**

*“O Mbreti i pejgamberëve, na ndihmo në ditën e Mahsherit!  
Sepse gjynahu dhe rebelizmi, këto dy sëmundje pa shërim,  
Veç tek ti gjejnë trajtim.”*

Në hadithe të ndryshme, flitet për shumë raste kur sahabët e nderuar kanë gjetur shërim nga Resulullahut, (a.s.).



Njëri nga dhjetë të përgëzuarit me xhenet, Sad bin Ebi Vekkasi, (r.a.), në vitin e haxhit të lamtumirës, në Mekë, u kaplua nga një sëmundje shumë e rëndë.

Resulullahu, (a.s.), erdhi ta vizitonte atë. Pasi foli diçka në lidhje me testamentin, Sad bin Ebi Vekkasi, (r.a.), e pyeti Resulullahun, (a.s.):

«-O i Dërguari i Allahut! O do të ikin shokët e mi e unë do të mbes këtu (A do të vdes këtu?)»

Resulullahu, (a.s.), iu përgjigj:

*«-Jo, ti nuk do të qëndrosh këtu.*

*Me ndihmën e Allahut të Lartmadhëruar do të bësh vepra të mira e do të lartësohesh. Shpresoj nga Allahu i Lartmadhëruar që të jetosh edhe shumë vite dhe disa nga njerëzit (besimtarët) do të kenë dobi prej teje, kurse disa të tjerë (jobesimtarët) do të kenë dëm prej teje.»* (Buhârî, Xhenâiz, 36.)

Më pas Resulullahu, (a.s.), u lut:

*“O Zot, jepi shërim Sadit.”* (Muslim, Vasâjâ, 8.)

Sad bin Ebi Vekkasi (r.a.) edhe pse kishte humbur shpresën për të jetuar dhe po bëhej gati të linte testamentin, pas lutjes plot shërim të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), jetoi edhe 45 vjet. Ai i shërbeu shumë islamit dhe mori pjesë në shumë ngadhënjime.

Një sahab tjetër fatlum që përfitoi nga mrekullia profetike e shërimit ishte edhe Aliu, (r.a.).

Ishin kohët e vështira të Hajberit.

Myslimanët po hasnin vështirësi të mëdha, sulmet e tyre po zmbrapseshin dhe kur ata u lodhën deri në rraskapitje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), u tha:

*“Nesër do t’ia jap flamurin atij prej duarve të të cilit Allahu do të sjellë fitoren e Hajberit.*





*Ai e do Allahun e Lartmadhëruar dhe të Dërguarin e Tij, por edhe Allahu Fuqiplotë dhe i Dërguari i Tij e duan atë!”*

Sahabët që kishin marrë pjesë në këtë betejë e që nuk po mbaronte, e kaluan gjithë natën duke diskutuar se kujt do t’ia jepte Resulullahu, (a.s.), flamurin e triumfit.

Në të gdhirë, të gjithë sahabët vrapuan për te Resulullahu, (a.s.), me dëshirën e marrjes së flamurit nga dora e tij e nurtë.

Omeri, (r.a.), në lidhje me këtë moment është shprehur:

“Nuk e kam dëshiruar kurrë prijësinë (komandën) e ushtrisë më shumë se atë ditë. Përpiqesha të bëhesha më i dukshëm atë ditë në mënyrë që Resulullahu, (a.s.), të më thërriste dhe të ma jepte mua flamurin e prijësisë së ushtrisë.”

Resulullahu, (a.s.), thirri Aliun, (r.a.), për t’ia dhënë flamurin e nderit. Aliut, (r.a.), po i dhimbnin sytë atë ditë, prandaj kishte ardhur i shoqëruar nga të tjerët. Sytë e tij ishin dëmtuar aq shumë sa nuk shihte dot as vendin ku vendoste këmbët.

Kur Resulullahu, (a.s.), vërejti gjendjen e rëndë të Aliut (r.a.), u këndoi disa ajete syve të tij dhe më pas i fryu.

Luani i Allahut, Aliu, (r.a.), me lejën e Allahu u shërua.

Më pas Resulullahu, (a.s.), ia veshi parzmoren dhe ia dha atij flamurin:

“O Ali! Ec përpara! Derisa Allahu të ta lehtësojë e mundësojë triumfin mos shih as majtas e as djathtas!” (Buhârî, Ashâbu’n-Nebî, 9; Muslim, Fedâilu’s-Sahâbe, 32-34; Hejsemi, VI, 151.)

Resulullahu, (a.s.), me duatë e tij shëruese, dhe me Sunetin e tij jetëdhënës, u ka shërbyer me dhëmbshuri e mëshirë jo vetëm sahabëve, por edhe të gjithë besimtarëve, deri në ditën e Kiametit.

Me fjalë të tjera, për ne, Resulullahu, (a.s.), është një mburojë shpirtërore edhe për këtë botë, por edhe për botën tjetër, ai është një;



## SHKAK SIGURIE

Resulullahu, (a.s.), na informon vetë në lidhje me dhembshurinë dhe mëshirën që ia ka për umetin e tij:

*“Bëni kujdes! Unë jam për ju një burim sigurie. Kur të ndërroj jetë, do të lutem në varr për ju deri në fryrjen e parë të surit:*

*«O Zot, umeti im, umeti im!..»”* (Ali el-Muttaki, Kenzu'l-Ummâl, XIV, 414.)

Në një hadith tjetër Resulullahu, (a.s.), shprehet:

*“Jeta imë për ju është e dobishme! Ju flisni me mua dhe unë ju informoj për vendimet hyjnore.*

*Edhe vdekja ime për ju është e dobishme.*

*Veprat tuaja më paraqiten mua.*

*Kur unë të shoh ndonjë vepër të mirë, do të falënderoj Allahun e Lartmadhëruar, e kur të shoh ndonjë vepër të keqe do t'i kërkoj Allahut falje në emrin tuaj.”* (Hejsemi, IX, 24.)

Ai është afër nesh...

Po ne sa jemi afër tij?

Aq sa jeta jonë do t'i ngjasojë jetës së tij, familja jonë vatrës familjare të tij, aq edhe Resulullahu (a.s.) do të na mbrojë me krahët e dhembshurisë në këtë botë e në botën tjetër, nga e keqja e nefsit tonë dhe nga të këqijtë që duan të na hedhin në kurthin e tyre.

Dashuria kërkon bindje...

Dashuria të imponon bindje, pra bindje ndaj çdo gjëje të asaj genie që dashurohet me të vërtetë...

Dashuria gjithashtu të imponon ruajtjen, pra frikën se mos ofendohet ajo genie që dashuron, e kështu njeriu hyn në rrugën e devotshmërisë. Ai që me të vërtetë do Allahun e Lartmadhëruar dhe Resulullahun, (a.s.), e që dëshiron në botën tjetër të jetë komshi me më të Dashurin e Allahut,



(a.s.), e ta shohë Bukurinë e Allahut (xh.sh.), kërkon natyrshëm të ketë vlerë të veçantë tek më të dashurit e tij...

Si përfundim;

**Kandari i dashurisë është sakrifica.**

**Forca e besimit rritet me sakrificat e bëra.**

Dashuria jonë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij është e fortë aq sa ajo mund të vëjë në lëvizje jetën, pasurinë dhe të gjitha mundësitë tona, në rrugën e Allahut të Lartmadhëruar, pra aq sa mund të sakrifikojmë për të.

Allahu (xh.sh.) si kriter praktik për këtë, në Librin e Tij, na jep shembujt e muhaxhirëve dhe ensarëve. (Teube, 100)

Dhëntë Allahu Fuqiptotë që të marrim pjesë nga dëshira e flaktë e sahabëve të nderuar dhe miqve të Allahut në ndjekjen e Sunetit të Resulullahut, (a.s.), që është edhe domosdoshmëria e arritjes te «muhabbetullahu» (dashuria hyjnore).

Na bëftë prej atyre fatlumëve që duke u lidhur fort mbas Sunetit të Resulullahut (a.s.), arrijnë sigurinë, shpëtimin, shërimin dhe ndërmjetësimin e tyre në ahiret.

**Amin!..**





Në Klimën e Ramazanit të nderuar

TRI MIRËSI... TRE RREZIQE...



## Në Klimën e Ramazanit të nderuar TRE MIRËSI... TRI RREZIQE...

### ÇDO GJË ËSHTË NJË MUNDËSI

Në këtë dynja në të cilën kemi ardhur për provimin e robërisë, çdo gjë është një mjet dhe mundësi për të fituar kënaqësinë e Allahut, (xh.sh.).

Allahu i Lartmadhëruar, i Cili kërkon që ne ta kujtojmë Atë më shpesh me emrat Rrahmân dhe Rrahim, ka shpalosur Bujarinë e Tij ndaj nesh përmes mundësive të pafundme me të cilat mund të fitojmë miqësinë dhe kënaqësinë e Tij.

Për sa kohë këto mjete shfrytëzohen sipas dëshirës së Allahut (xh.sh.), janë mundësi të mëdha për besimtarin. Janë bekime të jashtëzakonshme për të cilat ne nuk paguajmë asnjë çmim.

Por nëse nuk e kuptojmë vlerën e tyre dhe shprehim mosinteresim, ata kthehen në një rrezik të madh për ne. Këto mirësi të mëdha, duke qenë mundësi për të fituar mëshirën e Allahut (xh.sh.), për ata që tregohen mosmirënjohës bëhen shkak humbjeje- Zoti na ruajt.



Hadithi i nderuar i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), që lidhet me temën që po trajtojmë, është një hadith në lidhje me të cilën duhet të reflektojmë jo vetëm gjatë ditëve të muajit të shenjtë të Ramazanit që po kalojmë, por në çdo ditë të jetës sonë.

Profeti i mëshirës, Resulullahu i nderuar, edhe pse gjatë gjithë jetës së tij qëndroi larg mallkimit ndaj umetit të tij, mallkimit të Xhebrailit në lidhje me ata që tregohen indiferentë duke mos vlerësuar mundësitë hyjnore, i është përgjigjur me;

«Amin!»

Ja pra;

### TRE “AMIN-ËT” DHE SEKRETET E TYRE!

Transmetohet nga Kâ'b bin Uxhre, (r.a.):

I Dërguari i Allahut na kërkoi të afroheshim afër mimberit, ne menjëherë u grumbulluam aty. Resulullahu (a.s.), ngjiti një shkallë dhe tha;

«*Amin!*»

Pastaj ngjiti edhe një tjetër shkallë dhe përsëri tha;

«*Amin!*»

Më pas ngjiti edhe shkallën tjetër dhe sërish përsëriti;

«*Amin!*»

Kur zbriti nga mimberi, ne e pyetëm në lidhje me sekretin e ngjarjes:

“ - O i Dërguari i Allahut! Sot ne kemi dëgjuar diçka të re nga ju, të cilën nuk e kemi dëgjuar kurrë më parë.”

Pas kësaj i Dashuri i Allahut, (a.s.), u shpreh:

“ - *Kur isha në mimber, erdhi Xhebraili (a.s.).*

*Sa isha në shkallën e parë, ai tha:*





**«- Qofshin larg mëshirës ata që e arrijnë muajin e shenjtë të Ramazanit, por nuk u falen**

**gjynahet!»**

*Unë thashë:*

«Amin!»

*Kur hodha hapin e dytë ai tha:*

**«- Qofshin larg mëshirës, ata të cilët nuk dërgojnë salat dhe selam kur përmendet emri yt!»**

*Unë thashë:*

«Amin!»

*Pastaj kur ngjita shkallën tjetër, ai tha:*

**«- Qofshin larg mëshirës, ata të cilët nuk fitojnë xhenetin ndërkohë që kanë arritur pleqërinë e dy prindërve të tyre, apo njërit prej tyre!»**

*Unë thashë:*

«Amin!» (Hakim, Müstedrek, IV, 170.)

Në këtë hadith të nderuar kemi rikujtim të tre mirësive të mëdha të zbritura nga Allahu (xh.sh.) përmes Xhebrailit (a.s.), për umetin e Resulullahut (a.s.).

Ky rikujtim nuk bëhet në prani të disa personave, por të një xhemati të tërë. Kujtimi në lidhje me këto tre mirësi të mëdha nuk është bërë vetëm për sahabët që ishin të pranishëm aty, por janë për të gjithë ne;

## TRE KËSHILLA TË RËNDËSISHME

E para;

Këshilla për shfrytëzimin në mënyrën më të mirë të Ramazanit të nderuar, i cili është plot mundësi faljeje dhe nga fillimi deri në fund është plot me mëshirë dhe mirësi...



E dyta;

Këshilla për ta perceptuar siç duhet rëndësinë e Resulullahut, (a.s.).  
Të qenët i vetëdijshëm për këtë rëndësi të pamatë.

E treta;

Këshilla në lidhje me mundësinë e hyrjes në xhenet duke fituar kënaqësinë e prindërve të cilët janë shkak i ardhjes sonë në këtë dynja dhe edukimit tonë në mënyrën më të bukur.

Këto tri këshilla, janë në shërbim të vetëdijësimit për këto tre mirësi dhe na orientojnë që të mos humbasim këto mundësi hyjnore që na janë dhënë.

Falënderimi i qoftë Allahut të Madhëruar që për çdo vit të kalendarit tonë të jetës na mundëson përjetimin e një tjetër Ramazani të bekuar!

Allahu na bëftë nga ata që këtë stinë të bereqetshme e kalojnë plot përsipirtshmëri dhe me zemrën plot dashuri dhe kënaqësi adhurimore.

Amin!

Sepse ky është një muaj ku vërshon mëshira hyjnore... Sepse ky muaj është;

## **NJË GUVË MËSHIRË**

Ramazani i nderuar...

Mbreti i njëmbëdhjetë muajve...

Ky muaj është ai ku mëshira hyjnore rrjedh si oqean. Kur muaji i Ramazanit shihet me një sy të pakujdesshëm, ai nuk ndryshon nga muajt e tjerë.

Por;

Fillimi i Ramazanit të shenjtë është mëshirë, mesi i tij është kohë faljeje dhe fundi është mundësi shpëtimi nga xhehnemi...



Ky muaj është sezoni i trajtimit të mangësive të robërisë sonë ndaj Allahut (xh.sh.), është një spital i specializuar për sëmundjet shpirtërore, një qendër shpirtërore rehabilitimi...

Ky muaj është shkolla e zbukurimit të gjendjes dhe veprave tona të singerta dhe të mira dhe gjithashtu është shkolla ku mësojmë si të fitojmë kënaqësinë e Allahut (xh.sh.)...

Një shkollë devotshmërie...

Tekefundit;

Allahu i Madhëruar dëshiron t'i pastrojë robërit e tij nga indifereca dhe gjynahet. Ramazanin e nderuar e ka bërë mundësi për këtë pastrim.

Në mënyrë që robi të jetë në gjendje të përfitojë sa më shumë nga ky muaj i begatë dhe që ai të mund ta shfrytëzojë në mënyrën më të drejtë atë, duhet të pastrohet nëpërmjet adhurimeve të ndryshme.

Pra;

Duhet të pastrohet me namazet farze, duhet të pastrohen me namazet e teravive dhe me namazet e natës. Duhet të pastrohen duke agjëruar me të gjitha organet e tij. Duhet të pastrohet krejtësisht me iftalet që jep për të varfrit, me dhurimet, me zekatin dhe sadaka-i fitrin.

Në këtë mënyrë, shpirtrat, në përpjekjen për t'u pastruar, do të meritojnë përjetimin e madhësisë së Natës së Kadrit në dhjetë ditëshin e fundit. Si rezultat, robi do të dalë nga muaji i madhërisëm i Ramazanit krejt i pastër, pasi ka shfrytëzuar bujarinë e pamatë të Allahut, (xh.sh.), gjatë këtij muaji.

Mirëpo sa keq për ata që do të përjetojnë zhgënjimin e dhembshëm dhe për të cilët Xhebraili në duanë e tij shprehet se do të jenë larg mëshirës hyjnore; Ata që rrijnë larg bujarisë së Allahut në muajin e bekuar të Ramazanit, duke mos arritur pastrimin shpirtëror, që bëjnë sikur nuk i shohin këto bujari, që i shpërfillojnë sofrat e pafundme që zbresin nga qiejt dhe refuzojnë mirësitë e veçanta hyjnore.



Atëherë;

Për të mos rënë në një zhgënjim të tillë duhet ta perceptojmë si pasuri muajin e madhërishëm të Ramazanit dhe t'i kryejmë me sinqeritet adhurimet duke përfituar sa më shumë prej tij dhe me aq sa kemi durim dhe kapacitet, duhet të mbruhemi me ato adhurime.

Veprat në këtë stinë bekimesh do të jenë ushqimi më i vlefshëm për jetën tonë të përtejme.

Me këtë vetëdije duhet të vrapojmë drejt kryerjes së këtij urdhri hyjnor:

## **BJER NË SEXHDE DHE AFROHU!**

Si çdo stinë tjetër edhe stina e bereqetshme e muajit të shenjtë të Ramazanit është një mundësi e shkëlqyer për afrimin me Allahun e Lartmadhëruar nëpërmjet sexhdeve. Allahu i Lartmadhëruar urdhëron sexhden si çastin më kryesor të namazit. Sepse sexhdja është vendi ku shpërfaqet në mënyrën më të plotë përulja dhe dorëzimi ynë ndaj Tij. Është momenti kur njeriu është më afër Allahut të Lartmadhëruar. Është një gjendje në të cilën kibleja e trupit është Qabja e Madhnueshme dhe kibleja e zemrës është Allahu i Lartmadhëruar. Prandaj namazi;

Siç urdhërohet edhe në ajetin «*Bjer në sexhde dhe afrohu!*» (Alak, 19), është një shkak shumë efikas për afrimin me Allahun e Lartmadhëruar.

Sigurisht bëhet fjalë për namazin që falet në një harmoni të plotë midis trupit dhe shpirtit. Namazi që i bën besimtarët të zhvillohen në planin shpirtëror...

Më pas edhe adhurimet e tjera fitojnë cilësinë e afrimit me Allahun e Lartmadhëruar. Veçanërisht:

## **AGJËRIMI I VËRTETË**

Çdo gjë vlerësohet nga cilësitë që zotëron. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për namazin, por edhe për agjërimin. Nëse gjatë agjërit



plotësohen kushtet cilësore që kërkohen atëherë arrihet qëllimi për të cilin ai është bërë obligim. Një agjërimit cilësor, pra përpjekja për t'i dhënë hakun agjërimit është një domosdoshmëri.

Për t'u pranuar agjërimit nga ana e Allahut të Lartmadhëruar, duhet që në këtë adhurim të përfshihen edhe gjuha, syri, veshi si dhe organet e tjera.

Gjatë agjërimit duhet të kemi kujdes jo vetëm të mos fusim gjë në gojë nga ushqimet e pijet e ndryshme, por edhe të mos nxjerrim ndonjë fjalë të papërshtatshme nga goja. Resulullahu, (a.s.), në një hadith shpreh:

*“Mos fol asgjë që të detyron të kërkosh ndjesë!”* (Ibn Mâxhe, Zuhd, 15.)

Gjuha jonë duhet të jetë gjuhë e butë mëshire. Ajo nuk duhet të ngulë gjëmba në zemrat e njerëzve. Iftari nuk duhet të bëhet me mishin e gjallë të njerëzve për shkak të thashethemeve që mund të bëhen gjatë agjërimit. (Huxhurât, 12)

Pra;

Adhurimet që bëhen në stinën e fitimit të sevapeve, pra në muajin e shenjtë të Ramazanit, nuk duhet të kryhen për inerci të zakoneve apo për t'iu përshtatur traditave tona, por duhet të kryhen me vetëdijën e lartë dhe të sinqertë të robërisë ndaj Allahut të Lartmadhëruar. Në të kundërt adhurimeve u ikën mirësia dhe boshatisen nga pjesa e tyre shpirtërore, agjërimit kthehen në një stil diete, kurse namazet e teravive duke u falur shpejt, kthehen në shërbim të tretjes së ushqimit.

Duhet ditur se;

Një namaz i falur me frikë-respekt, zekati dhe lëmosha e dhënë me zemër të pastër, agjërimit që mbahet me dashuri, një zemër që qëndron mes frikës e shpresës, janë shenjat që tregojnë se besimi ka arritur në gradën e shijimit.

Nga agjërimit që do të mbahet duke iu përmbajtur këtyre principeve do të përfitojmë shumë. Ja për shembull;



## PËRFITIMET QË DO TË KEMI NGA MIRËSIA E AGJËRIMIT

Agjëruesi fillimisht vetëdijësohet për vlerën e mirësive të Allahut të Lartmadhëruar. Me një uri gjysëmditëshe ai percepton dobësinë e tij. Kupton se sa është nevojtar i mirësive të Allahut të Lartmadhëruar.

Sepse njeriu ashtu siç nuk ia di vlerën shendetit sa është mirë, nuk ia di vlerën as mirësive të Allahut të Lartmadhëruar sa nuk është privuar prej tyre. Parë nga ky aspekt agjërimi është një adhurim shumë i rëndësishëm. Sepse ai duke e privuar njeriun prej të mirave materiale për një kohë të kufizuar, aq sa ai mund të durojë, bëhet shkak për vetëdijësimin e tij për të mirat e pafundme që na dhuron Allahu në përditshmëri.

Kështu agjëruesi ndjen së brendshmi gjendjen e të varfërve, të vetmuarve dhe hallexhinjve.

Jusufi, (a.s.), teksa kryente detyrën e përgjegjësit të thesarit të shtetit e u ndante të varfërve ndihma ushqimore, i kalonte ditët e tij me agjërim dhe uri, në mënyrë që të njësohej me gjendjen e të varfërve.

Siç shprehet edhe populli ynë i dashur “Nuk ia di i ngopuri të uriturit”, njeriu sado të dijë, të dëgjojë, e të shohë, kur nuk i jeton vetë gjendjet e të varfërve, nuk arrin t’i kuptojë plotësisht kurrë ata.

Ja pra agjërimi kultivon te njeriu këtë lloj perceptimi.

Agjërimi është një adhurim që na informon për vlerën e mirësive të dhuruara, që zgjon te njeriu ndjenjat e falënderimit, që kultivon vetëdijën e kuptimit të të varfërve dhe hallexhinjve, që shkatërron prirjet dëshiruese të nefsit (egos) dhe që e shpëton njeriun nga robërimi ndaj materies duke e ngjitur atë në pjekurinë e virtytit të durimit.

Agjërimi është përfaqësuesi më i spikatur i nevojtarëve që thërrasin në heshtje e pa fjalë; “Kini mëshirë për ne!”. Është një energji e thellë shpirtërore që lartëson ndjenjat tona të mëshirës e dhembshurisë mbi nivelin e dashurive kalimtare.



Agjërimi është një disiplinë shpirtërore që merr nën kontroll përbindshin tonë të egos duke i lënë kështu mundësi gjallërimi ndjenjave të dhëmbshurisë dhe mëshirës.

Agjërimi na përsos moralin tonë duke na mësuar cilësitë e domosdoshme që i duhen njeriut në përballjen e tij me jetën si «durimin, vetëmjaftueshmërinë, vullnetin, këmbënguljen dhe largimin nga tekat e egos.».

Pejgamberët janë përgatitur shpirtërisht me agjërim ndaj detyrës së profecisë. Kur kanë arritur në kulmin e përsosjes, janë larguar pak nga bota njerëzore, dhe kur tek ata janë shfaqur cilësitë e pastra shpirtërore dhe engjëlllore atëherë zemrat dhe mendjet e tyre janë furnizuar nga burimet e shpalljes hyjnore.

Me të vërtetë;

Hazreti Musai, (a.s.), profeti i nderuar i malit Sina, agjëroi dyzet ditë e dyzet net deri sa u shpall Teurati.

Hazret Isai, (a.s.), profeti i shenjtë i malit Sair, agjëroi dyzet ditë dhe dyzet net derisa iu shpall fjala e parë e Ungjilit.

Nëna jonë, Aishja, (r.a.), shprehet:

“Familja e të Dërguarit të Allahut, nga dita kur arriti në Medinë e deri kur ka ndërruar jetë Profeti, nuk e ka ngopur stomakun me bukë gruri për tre ditë radhazi asnjëherë.” (Muslim, Zühd, 20.)

Profeti ynë herë pas here mbante agjërimin “Savm-i Visal”. Ky lloj agjërimi, që mbahet pa ngrënë iftar disa ditë, ishte i rezervuar specifikisht vetëm për të Dërguarin e Allahut.

Padyshim, rëndësia që i jepet agjërimit dhe ndjeshmëria që tregohet në zbatimin e tij praktik, lidhet me rezultatet e mëdha të agjërimit.

Agjërimi, i cili është një adhurim sevapin e të cilit do ta japë vetë Allahu i Madhëruar, ka shumë përfitime shpirtërore dhe materiale. Në mënyrë të veçantë koha e iftarit është momenti kur kënaqësia materiale dhe shpirtërore arrijnë kulmin.



Sepse iftari është një kohë në të cilën Allahu (xh.sh.) u jep qetësi shpirtërore atyre që agjërojnë. Kjo është arsyeja pse tryezat e iftarit kanë ëmbëlsi dhe kënaqësi më të madhe se ushqimet që serviren në të. Në mënyrë të veçantë sofrat që zbukurohen nga familjarët dhe miqtë, të afërmit dhe të varfërit, janë si një festë qiellore e vendosur në tokë. Zemrat në ato sofra mbushen me dashuri, qetësi dhe bukuri shpirtërore të papërshkrueshme dhe të pashijuara kurrë më parë.

Në anën tjetër;

Një agjëruës, krahas kënaqësisë që përjeton në lidhje me sa shprehëm më sipër, përjeton edhe edukimin e vullnetit të tij me hallallin, larg haramit.

Në muajin e shenjtë të Ramazanit ne tregohemi te kujdesshëm dhe madje rrijmë larg edhe nga të lejuarat. Buka dhe uji që në kohë të tjera janë hallall, nga syfyri e deri në iftar bëhen haram.

Kjo;

Është një disiplinë që edukon dhe forcon vullnetin e besimtarit. Kjo disiplinë e lartëson njeriun në nivelin e durimit, duke e frenuar atë që të zgjasë dorën drejt ushqimit dhe ujit, sado që ai të jetë i etur dhe i uritur.

Kështu, duke edukuar vullnetin nëpërmjet agjërit, njeriu edukohet edhe për të shmangur gjërat e dyshimta.

Abdullah bin Omer (r.a.) ka thënë:

“Nëse nga përkulja në namaz ju merrni trajtën e një harku shigjete,

Dhe nëse nga agjërimi holloheni dhe bëheni si gozhda,

Për pa braktisur haramin dhe të dyshimtën, Allahu (xh.sh.) nuk e pranon adhurimin tuaj.”

Sepse;





## GJËRAT E DYSHIMTA HELMOJNË BOTËN SHPIRTËRORE

Përballë çdo gjëje të qartë, njeriu mban një qëndrim pozitiv ose negativ. Mirëpo përballë gjërave të dyshimta, hyjnë në lojë një mijë arsye, justifikime, dobësi, dhe shumë bien në batakun e mashtrimit. Pamundësia për ta përcaktuar gjënë qartë nëse është haram apo hallall, ka bërë shumë prej atyre që janë mbajtur për të pjekur dhe të formuar, të bien në vorbullën e mashtrimeve të shejtanit.

Sepse njeriu ndikohet thellësisht:

### **Fillimisht;**

Nga personi që dashuron. Nëse ai dashuron një njeri me nivel të lartë shpirtëror, do të lartohet edhe ai shpirtërisht, e nëse ai dashuron një person indiferent, edhe atij do t'i turbullohet bota e brendshme deri në indiferencë.

### **Së dyti;**

Nga ushqimi. Nëse ai është hallall, njeriu përjeton një rritje të jashtëzakonshme shpirtërore, e nëse është i dyshimtë, njeriut i ashpërsohet zemra.

Për këtë arsye, Islami na ndalon veçanërisht nga e dyshimta.

Parë nga ky aspekt;

Muaji i shenjtë i Ramazanit është në fakt një shkollë ku ne mësojmë si të qëndrojmë larg gjërave të dyshimta. Në jetën e njeriut, së bashku me hallallin dhe haramin, ekziston edhe zona e dyshimtë e cila duhet shmangur. Në lidhje me këtë, Resulullahu (a.s.) shprehet:

*“Hallalli është i qartë, harami është i qartë. Midis këtyre të dyjave, ka gjëra të dyshimta për të cilat njerëzit nuk janë të sigurtë nëse janë hallall apo haram.*

*Ata që shmangin çështjet e dyshimta, mbrojnë fenë dhe nderin e tyre. Ndërsa ata që nuk ruhen nga çështjet e dyshimta, gradualisht zhyten në haram.*



*Ashtu si bariu që kullot kopenë përreth tokës së dikujt tjetër dhe rrezikon që kopeja e tij të hyjë në këtë tokë.*

*Kini kujdes! Çdo mbret ka një tokë ku nuk lejohet të hyjë askush. Mos harroni se toka e ndaluar për ne nga Allahu, janë gjërat të cilat Ai na ka bërë haram.*

*Ta dini mirë që në trupin e njeriut ka një copë të vogël mishi, nëse kjo pjesë e mishit është e mirë, i gjithë trupi është në gjendje të mirë shëndetësore. Nëse ajo prishet, i gjithë trupi prishet dhe shkatërrohet. Kjo copë mishi është zemra.”* (Buhari, Iman, 39, Bujû, 2; Muslim, Musakat, 107-108.)

Shmangia e të gjitha llojeve të të dyshimtave është një nga kushtet më të rëndësishme në jetën e robit në mënyrë që zemra të mos prishet. Sepse një vullnet që shmang të dyshimtat, do të jetë në gjendje të jetojë një jetë xheneti brenda kufijve të haramit dhe hallallit. Ai tani preferon të përjetshmen dhe nuk lejon që kjo botë kalimtare dhe materiale t’ia çojë jetën dëm. Tekefundit, dëshira e Allahut të Madhëruar është që robi të arrijë këtë pjekuri. Për këtë arsye, Allahu Teala pasi na mëson orientimin nga mirësitë e përjetshme përmes largimit nga ngrënia dhe pirja gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit, na urdhëron të japim zekatin, lëmshën dhe sadakatë, për të kultivuar tek ne mendimin se pasuria është e Allahut.

Parë nga ky aspekt;

## **ZEKATI ËSHTË PREFERIMI I TË PËRJETSHMES**

Për shkak të rëndësisë së tij, zekati u bë obligim direkt pas agjërimit. Një urtësi tjetër e jashtëzakonshme që të bie në sy, është kjo:

Allahu i Madhëruar, pasi hapi tek njerëzit përmes agjërimit damarët e ndjeshmërisë dhe dhembshurisë, urdhëroi zekatin.

Derisa robërit;

Të japin bujarisht në rrugën e Allahut. Të mund të përzgjedhin të përjetshmen duke hequr dorë lehtësisht nga kalimtarja. Të arrijnë të bëhen empatik. Të realizojnë urdhrin e shprehur në ajetin:



***“... Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu! ...”***

(Kasas, 77)

Allahu i Lartmadhëruar kërkon veçanërisht nga njeriu që, ai ta shikojë krijimin nëpërmjet syrit mëshirues të Krijuesit. Allahu e urdhëron besimtarin që t'u dhurojë vëllezërve të tij që janë në një gjendje ekonomike më të dobët se ai, të jetë zemërgjerë, të jetë empatik dhe të vendosë të tjerët para vetes.

Prandaj;

Ne duhet të dimë që ta jetojmë Ramazanin me këto cilësi.

Duhet të mendojmë që:

Disa nga vëllezërit tanë me të cilët patëm përjetuar Ramazanin e kaluar, nuk jetojnë më. Atyre u ra fleta e fundit e kalendarit të jetës, iu mbush faqja e fundit e fletores së veprave dhe u ndanë nga ne.

Ne nuk mund ta dimë;

Ky Ramazan mund të jetë mundësia e fundit edhe për ne.

Në fakt, Allahu i Madhëruar na urdhëron që t'i kryejmë ibadetet sikur të ishin adhurimet e fundit të jetës sonë, me vetëdijen dhe perceptimin e mundësisë së fundit para vdekjes. Çdo natë ta perceptojmë si natë Kadri, çdo kalimtar ta perceptojmë si Hidrin, çdo agjërime dhe çdo namaz ta kryejmë sikur të ishte agjërimi dhe namazi i fundit të jetës sonë.

Ai që do na e mbajë gjallë në mendjen dhe zemrën tonë këtë perceptim, është padyshim i Dërguari i Allahut, (a.s.).

## **I DËRGUARI I ALLAHUT QË...**

Është një mirësi e pamatë që Allahu i Madhëruar ia dhuroi njerëzimit... Shprehja më e lartë e bujarisë së Tij ndaj nesh...

Mrekullia më e madhe dhe më e bukur e artit ...



Një dhuratë e mrekullueshme nga Allahu i Lartmadhëruar për secilin...

Një kriter vepre për çdo njeri pavarësisht nivelit... Shembulli i vetëm, shembulli më i bukur...

Me çdo gjendje të tij, është një shkak udhëzimi drejt Darus- Selamit, xhenetit...

Shenja më e rëndësishme e perceptimit të vlerës së jashtëzakonshme të kësaj mrekullie, është të dërguarit e selamit me nderim e respekt ndaj tij, kudo që kujtohen, përmenden, dëgjohen, shkruhen, lexohen recitohen emrat e bukur të tij.

Atij i dërgojnë salate siç e meriton, Allahu i Madhëruar dhe të gjithë melekët e Tij.

Atë e përshëndet Allahu Teala dhe këtë përshëndetje me selam ia kujton të gjithë besimtarëve në namaz në qëndrimin e tehiyatit. Ndërkohë që gjatë namazit, dhënia selam një personi tjetër e prish namazin, dhënia selam Profetit

“Selam ty, o Pejgamber!”, e përsos namazin.

Ajo çfarë na bie si detyrë neve si umet i Profetit Muhamed (a.s.) është bindja ndaj tij dhe organizimi i jetës sonë sipas Sunetit të tij, me dashurinë për të në zemrat tona.

Për shkak se gjithçka begatohet me të, shpirtrat shenjtërohen me të, madje edhe personat më shterpë lulëzojnë me të. Vështrimi i tij i lartëson shpirtrat...

Edhe njerëzit me zemër më të ngurtë, me fjalën e tij u bënë njerëz me shpirt të ndjeshëm, të edukuar, u bënë sahabë dhe arritën kulmin në virtyt. U përjetuan shumë manifestime të mrekullueshme kur;

## PREKU DORA E TIJ...

Beshir bin Akrabe el-Xhuheni shpjegon:



Në ditën e Uhudit takova Resulullahun (a.s.).

Unë e pyeta:

“- Në çfarë gjendjeje është babia im?”

Ai m'u përgjigj:

“- *Ai ra shehid, Allahu e mëshiroftë!*”

Fillova të qaja. Ai më mori, më përkëdheli kokën dhe më hipi në kafshën e tij.

Pastaj më tha:

“- *A nuk je i kënaqur nëse të bëhem unë baba dhe Aishja nënë?!*”

(Hejsemi, VIII, 161.)

Unë u shpreha:

“- T'u bëfshin kurban nëna dhe babai im, o i Dërguari i Zotit, natyrisht që jam i kënaqur!”

Megjithëse flokët më janë thinjur tani, pjesa e flokëve ku më përkëdheli i Dërguari i Allahut, (a.s.), është akoma e zezë. ” (Buhâri, et-Târîhu'l-Kebîr, II,78; Ali el-Muttakî, XIII, 298/36862.)

Ja pra një burim i tillë jete dhe mirësie ishte ai!

Ai ishte një mirësi kaq e madhe saqë;

Allahu i Madhëruar, i Cili e prezantoi atë tek njerëzit si një bekim dhe mëshirë, tërhoqi vëmendjen përmes mallkimit të Xhebrailit ndaj atyre që nuk i çojnë salat dhe selam Profetit, (a.s.), kur përmendet emir i tij dhe e bëri Profetin e dashur të pohonte:

“Amin!”

Për të mos qenë objekt i këtij mallkimi dhe në mënyrë që pohimi “Amin” i Profetit, (a.s.), të mos bjerë mbi ne, duhet që zemrën dhe gjuhën tonë ta njomim vazhdimisht me salatet dhe selamet për të. E sidomos kudo ku përmendet emri i tij i bekuar.



Në mënyrë të veçantë, duke shprehur gatishmëri dhe bindje, me shpirt dhe zemër, në çdo çështje që ai na ka urdhëruar. Sidomos në temën e të drejtave të prindërve.

Sepse njëra prej tri këshillave të tij lidhet me;

### **TË DREJTAT E PRINDËRVE...**

Nënat dhe baballarët tanë janë shkaqet prej të cilëve ne erdhëm në jetë, janë personat tanë më të dashur.

Në periudhën tonë më të dobët dhe kur kishim më shumë nevojë, janë kujdesur për ne me mëshirë; ata janë njerëzit më të mrekullueshëm që kanë sakrifikuar për ne gjumin, ushqimin, kohën dhe rehatinë... Janë ata të cilëve ne nuk mund t'ua shlyejmë kurrë detyrimin dhe janë zemrat më të afërta ndaj nesh.

Është detyra jonë parësore të jemi fëmijë të denjë për ta. Ata meritojnë një falënderim të përvetshëm. Kur ata të plaken, ne duhet t'i shikojmë si sytë e ballit, të përkujdesemi për ta, t'i meritojmë duatë dhe lutjet e tyre; këto janë detyrimet tona të mirënjohjes ndaj tyre.

Allahu i Lartmadhëruar, urdhrin për t'u shërbyer prindërve e ka përmendur menjëherë pas urdhrin të robërisë ndaj Tij. Në mënyrë të veçantë, kur prindërit plaken, fëmijët nuk duhet të shfaqin pakënaqësinë ose bezdisjen më të vogël. Në lidhje me këtë Allahu Teala urdhëron:

**“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti.”** (Isra, 23)

sepse;

### **KJO ËSHTË MIRËSI!**

Nëna e besimtarëve, Hazreti Aishja, (r.a.), rrëfen:



Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

*“Më kishte zënë gjumi dhe e pashë veten në xhenet. Dëgjova zërin e dikujt. Po lexonte Kuran.*

*«-Kush është ky?», - pyeta.*

*«-Ky është Hare bin Nu'man», - më thanë.”*

I Dërguari i Allahut, i cili e shpjegoi këtë, iu shpreh nënës sonë, hazreti Aishes (r.a.):

*“Ja pra kjo është mirësia e vërtetë, kjo është mirësia e vërtetë!”*

Hârise ishte njëri prej sahabëve që sillej më mire se të tjerët me nënën e tij. (Ahmed, VI, 151-152; Hakim, IV, 167.)

Mirësia ndaj nënës është një direktivë të cilin Profeti, (a.s.), e theksoi veçanërisht.

Po kështu, edhe edukata e përkujdesjes ndaj babait është:

## DIREKTIVË E PROFETIT (A.S.)

Hazreti Aishja, (r.a.), transmeton:

“Një person erdhi te i Dërguari i Allahut, (a.s.). Me të ishte edhe një burrë i moshuar. I Dërguari i Allahut, (a.s.), e pyeti:

*«- O filan! Kush është burri që ka ardhur me ty?»*

Ai u përgjigj:

*«- Ky është babai im.»*

I Dërguari i Allahut, (a.s.) ia tërhoqi vëmendjen atij:

*«- Mos ec para tij, mos u ul para tij, mos e thirr atë në emër dhe mos u bëj shkak që ai të shahet dhe të fyhet prej teje.»”* (Hejsemi, VIII, 137.)

Nëse një person fyen babain e dikujt tjetër, edhe tjetri do ta fyej babain e tij, kështu si rezultat fëmija i bën keq babait të vet.



Kujdesi dhe ndjeshmëria në lidhje me prindin duhet të kuptohet shumë mirë. Në lidhje me këtë temë ka shumë direktiva hyjnore.

Ja pra;

## DIREKTIVA E MIRËNJOHJES SIPAS AJETEVE:

***“Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës dhe thuaj: «O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!»”*** (Isra, 24)

Si për çdo çështje, edukata e Profetit (a.s.) ishte shumë e veçantë edhe në këtë çështje.

“Një ditë, ndërsa Profeti, (a.s.), ishte i ulur, erdhi bashkëshorti i nënës së tij të qumështit. Resulullahu, (s.a.s), për ta respektuar atë, një pjesë të veshjes së tij e shtroi në tokë dhe e ftoi atë të ulej mbi rrobën e vet.

Pas pak, erdhi edhe nëna e tij e qumështit. Resulullahu (s.a.s), shtroi anën tjetër të veshjes për nënën e tij dhe e ftoi të ulej.

Pak më vonë erdhi vëllai i qumështit.

I Dërguari i Allahut, (a.s.) u ngrit në këmbë edhe për të dhe e uli para vetes.” (Ebu Davud, Edeb, 119-120 /5145.)

## ME PAK FJALË

Sa lumturi nëse do të mund ta jetonim muajin e shenjtë të Ramazanit me këto cilësi të bukura!

Nëse e jetojmë muajin e shenjtë të Ramazanit dhe më pas gjithë jetën rreth bukurive, mirësive dhe parimeve profetike të lartpërmendura, tre mallkimet dhe tërheqjet e vëmendjes që cekëm në hadithin në fillimin e temës sonë, kthehen në tre dua dhe sihariqe.

Duke u nisur nga e kundërta e asaj që u shpreh në hadith, mund të shpresojmë;





## TRE DUA DHE SIHARIQE

Shpresohet që dua ja e Xhebrailit në lidhje me ata që do ta vlerësojnë, ashtu siç i ka hije, me vepra të bukura, adhurime dhe agjërime, muajin e shenjtë të Ramazanit, do të marrë trajtën:

**«- U mëshiroftë ai person i cili arrin muajin e shenjtë të Ramazanit dhe të cilit i falen gjynahet!».**

Resulullahu, (a.s.), do të thotë:

«-*Amin!*»

Po kështu, në lidhje me ata që do ta jetojnë jetën të lidhur me dashurinë ndaj nurit të Resulullahut, (s.a.s), dhe do t'i dërgojnë atij vazhdimisht salate dhe selame, Xhebraili (a.s.) do t'i thotë Profetit (a.s.):

**«- U mëshiroftë ai që të dërgon selame dhe salate ty kur përmendet emri yt në prani të tij!»**

Resulullahu (s.a.s), do t'i përgjigjet:

«-*Amin!*»

Shpresohet gjithashtu që Xhebraili (a.s.), në lidhje me fëmijët mirënjohës ndaj prindërve dhe që sillen ndaj tyre simbas parimeve të shpallura nga Allahu (xh.sh.) dhe simbas haditheve të Resulullahut (s.a.s), të thotë:

**«- U mëshiroftë ai që arrin pleqërinë e prindërve të tij, apo të njërit prej tyre, dhe fiton xhenetin!»**

Resulullahu, (s.a.s), do të thotë:

«-*Amin!*»

Lum për ata që marrin dua të tilla të hajrit për të cilat Resulullahu, (s.a.s), ka thënë “Amin!” dhe meritojnë sihariqet e përjetshme!

Lum për ata që ia dinë vlerën këtyre mirësive të jashtëzakonshme hyjnore, dhe që përfitojnë prej tyre në mënyrën më të bukur duke kërkuar të fitojnë kënaqësinë e Allahut të Madhëruar...



**O Zot!**

**Për mirësitë e jashtëzakonshme që na ke dhuruar të falënderojmë dhe të lartësojmë pafund!..**

**Na jep përpjekjen për ta çuar në vend falënderimin ndaj Teje, në masën e dobësisë sonë...**

**Na e mundëso që ta jetojmë këtë muaj të shenjtë të Ramazanit në të cilin ndodhemi, me qetësi, gëzim, përshpirtshmëri, me ndezjen e mallin për Ty!**

**Na mbro ne nga indiferenca ndaj mirësive hyjnore!**

**Na ruaj zemrën tonë nga indiferentët që janë larguar nga mëshira Jote!**

**Na bëj të jetojmë një jetë me adhurime, vepra të mira, dhurime, singeritet, dua të hajrit dhe sihariqe përjetësie dhe na bëj bashkë me vepërmirët! Bëj që ky stil jetese të na çojë në Bajramin e përjetësisë!**

**Amin!..**



## TË QENIT UMET I TIJ

Me përgjegjësi dhe vlera...





# TË QENËT UMET I TIJ

Me përgjegjësi dhe vlera...

## MUSTAFAI I TETËMBËDHJETË MIJË BOTËVE ...

Allahu i Madhëruar e krijoi njeriun dhe e dërgoi atë në këtë botë për provimin e robërisë; për t'i treguar njerëzimit udhëzimin për këtë provim, dërgoi fjalën e Tij, në formën e librave të shenjtë, dhe peygamberët që do ta shpallnin dhe do ta jetonin atë, e gjithashtu do të bëheshin kriter vepre për njerëzimin.

Sipas një transmetimi, që nga njeriu i pare Hazreti Ademi, (a.s.), e deri tek Profeti Isa, (a.s.), kanë ardhur më shumë se 124 mijë profetë; ata e kanë ftuar njeriun në bindjen ndaj Allahut (xh.sh.), në njohjen dhe pëlqimin e Tij, në robërinë ndaj Tij, në miqësinë me Të dhe në fund në shpëtimin dhe xhenetin e pasosur të Tij.

Të gjithë këta profetë erdhën vetëm për popullin apo komunitetin e tyre. Ndërsa Zotëria i Universit, Prijësi i të gjithë profetëve, Zotëria ynë, (a.s.), u dërgua si profet për të gjithë njerëzimin, detyrë kjo që iu dha vetëm atij nga të gjithë peygamberët e tjerë. I Dërguari i Allahut është kulminacioni i artit hyjnor manifestuar në qenien njerëzore. Çdo besimtar



që i qaset atij me dashuri, mund t'i gjejë zgjidhjet e të gjitha problemeve të jetës së vet tek ai.

Ai është i vetmi etalon praktik i veprave për miliarda njerëz.

Në një ajet kuranor thuhet:

***“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.”*** (Enbija, 107)

Përgjithësisht, jetëgjatësia e shpalljeve të profetëve të mëparshëm kufizohet me jetën e tyre; ndërsa Profeti ynë, (a.s.), duke qenë në gradën e lartë të vulës së shpalljes, pra si peygamberi i fundit, u dërgua si i tillë deri në ditën e gjykimit.

Përsëri në një ajet kuranor thuhet:

***“Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë.”*** (Sebe, 28)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka ndjerë një përgjegjësi të madhe në raport me gradën e tij të lartë. Ai ka shfaqur përpjekjet maksimale për të mbushur me mëshirën për të cilën ai ishte dërguar, fillimisht të afërmit dhe bashkëqytetarët e tij, pastaj të gjithë banorët e zonave që ai mund të arrinte, pastaj të gjithë njerëzimin e Epokës së Lumturisë, pastaj umetin që do të vijë deri në ahiret, tërë krijesat, të gjitha qeniet.

Ai shkoi në Taif, duke përballuar edhe goditjet me gurë nga banorët e zonës. Ai nuk i mallkoi ata që e goditën me gurë, por u lut për udhëzimin dhe mëshirimin e tyre. Ai nuk ra në pesimizëm nga refuzimi që iu bë nga e tërë zona ku shkoi, por u gëzua me udhëzimin e një robi që takoi në rrugë.

Edhe umeti i Profetit të mëshirës, ka përgjegjësi që burojnë prej të qenët umet i tij.

Është i mbështetur në ajete kuranore fakti që në ditën e kiametit do të



merren në llogari pejgamberët dhe shoqëritë në të cilat ata janë dërguar; (Araf, 6); Çdo profet do të dëshmojë për umetin e tij (në favor të atyre që i janë përgjigjur ftesës së tij dhe në disfavorin e atyre që nuk i janë përgjigjur pozitivisht kësaj ftese). Ndërsa Pejgamberi ynë, (a.s.), do të dëshmojë ndaj të gjithë pejgamberëve dhe umeti i tij do të dëshmojë ndaj të gjithë umeteve. (Nisa, 41; Buhari, Tefsir, 2/13, Enbija, 3; Tirmidhiu, Tafsir, 2/2965.)

Në një ajet kuranor thuhet:

***“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju...”***

(Bekare, 143; Shih. Buhari, Xhenaiz, 86; Muslim, Xhenaiz, 60.)

Umeti i Muhamedit, (a.s.), duke i treguar botës fytyrën e qeshur të Islamit, duke shpërndarë drejtësi, mëshirë, vlera shembullore, është në pozitën e përfaqësimit të fesë së Allahut të Madhëruar në tokë.

Sigurisht, kjo vlerë nuk arrihet duke ardhur në jetën e kësaj bote në periudhën e shpalljes së Profetit, (a.s.), ose pas saj. Niveli i pjekurisë që i duhet njeriut për të qenë dëshmitar i Allahut dhe kriteri i vërtetë vlerësues para Allahut, (xh.sh), është devotshmëria.

Sepse devotshmëria;

**ËSHTË CILËSIA MË E DASHUR PËR ALLAHUN E LARTMADHËRUAR...**

Në një ajet kuranor thuhet:

***“... Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij...”*** (Huxhurat, 13)

Devotshmëria është instalimi i udhëzimeve të larta të Kuranit dhe Sunetit, që janë shkaqe për lumturinë tonë të të dyja botëve, në jetën familjare, në jetën tregtare, në jetën sociale dhe në çdo fazë të jetës.

Me fjalë të tjera, devotshmëria;

Është kryerja e urdhrave fetare me dashuri të zjarhtë dhe emocion.



Pra, të qenët i përpiktë ndaj urdhrave dhe ndalesave të Allahut, të qenët i vetëdijshëm se vëzhgohemi nga kamerat hyjnore në çdo çast, e kështu të shmangim gjynahet në mënyrë të prerë.

Ai që do të na e mësojë devotshmërinë, udhëzuesi ynë më sublim, i Dërguari i Allahut, (a.s.), shprehet:

*“Unë jam ai që e njuh më së miri Allahun në mesin tuaj dhe ai që i frikësohet më shumë ndër të gjithë ju.”* (Buhârî, Edeb, 72; Muslim, Fedâil, 127.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), me moralin e tij që Kurani e përkufizon si të përsosur, me personalitetin për të cilin janë shprehur pozitivisht edhe armiqtë e tij, është shembulli më veçantë, udhëzuesi më i përsosur, etaloni më i bukur për çdo individ të umetit të tij, të çdo profesioni apo pozicioni.

Pra mënyra e vetme për t’u bërë një umet i hajrit, që do të dëshmojë në të dyja botët para Allahut të Lartmadhëruar, është të dashuruarit e Resulullahut, (a.s.), më shumë se veten, dhe atë dashuri të përpiqemi ta shndërrojmë në mundësi për përvetësimin e gjendjeve të tij, të moralit të tij, të strukturës së tij shpirtërore, duke qenë gjithnjë të shoqëruar së bashku me të.

Tekefundit, Resulullahu, (a.s.), atyre që patën fatin të ishin bashkë me të në jetën e kësaj bote, por që frikësoheshin se në jetën tjetër nuk do kishin më mundësi të ishin pranë tij, u dha ilaçin, parimin jetësor:

## **NJERIU ËSHTË BASHKË ME ATË QË DO...**

Enes bin Malik, (r.a.), rrëfen:

Një ditë te Resulullahu, (a.s.), erdhi një person dhe e pyeti:

“-O i Dërguari Allahut! Kur do të ndodhë kiameti?”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e pyeti:

“-E çfarë ke përgatitur ti për kiametin?”





Burri u shpreh:

“Dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij...”

Pas kësaj Resulullahu, (a.s.), i tha:

*“Atëherë ti do të jesh me ata që do.”*

Enesi, (r.a.), në vazhdimin e këtij transmetimi ka thënë:

“Përveç hyrjes sonë në islam, asnjë gjë tjetër nuk na ka gëzuar më shumë se hadithi i Resulullahut (a.s.): «Me të vërtetë ti do të jesh bashkë me të dashurit e tuaj.». Unë e dua Allahun e Lartmadhëruar, të Dërguarin e Tij, Ebu Bekrin, (r.a.), dhe Omerin, (r.a.), -edhe pse nuk mund t'i arrij veprat e tyre- shpresoj të jem së bashku me ta.” (Muslim, Birr, 163.)

Ja pra, sahabët e nderuar u gëzuan pamasë kur mësuan rrugën e të qenët së bashku me Resulullahun, (a.s.), në të dyja botët, pra kur mësuan ndjekjen e tij me dashuri. Sepse Resulullahu, (a.s.), i edukoi sahabët e tij me ligjërimi dhe me moralin e tij të lartë prej ku buronin rrezet e nurit, i rriti dhe i përsosi ata siç rrit e përsos dielli bimët.

Ai me përgjegjësinë e të qenët mëshirë për të gjitha botët, i shikoi krijesat me syrin e dhembshurisë së Krijuesit, e në mënyrë të veçantë ndaj umetit të tij kultivoi një dashuri të rrallë, ai u dridh gjithë jetën nga mëshira dhe dhembshuria duke menduar fundin e umetit të tij, për lumturinë e përjetshme të umetit ai kaloi një jetë të tërë me dua fjale dhe vepre.

Ndërsa te sahabët dashuria ishte një energji që i nxiste ata të ndiqnin në çdo gjë atë që donin më fort, një kënaqësi dhe emocion që i nxiste vazhdimisht nga e mira.

Ja disa shembuj nga morali i tij kuranor, moral i cili i bëri sahabët, që ishin të etur për urtësinë e tij, të shkëlqenin si yje:

Nëna jonë, Aishja (r.a.) ka thënë:

“Resulullahu nuk konsideronte asnjë vepër më të shëmtuar se gënjeshtrën. Nëse dëgjonte që ndonjë sahab i tij kishte gënjyer, qoftë ajo



gënjeshtrë edhe krejt e vogël, i rrinte larg atij duke mos pasur dëshirë të komunikonte me të, derisa ai të pëndohej.” (Ibn Sa’d, I, 378.)

Nga kjo kuptohet se dashuria e Resulullahut, (a.s.), për sahabët e tij ishte një dashuri e shenjtë dhe parimore. Një dashuri që transformonte për mirë, që zbukuronte, që nuk mbyllte sytë para gabimeve, që përmi-rësonte e që lartësonte.

Dashuria është një emocion brenda së cilës ka edhe garë. Ai që do dikë ka dëshirë që të jetë i vetmi në sytë dhe në zemrën e asaj qenie që dashuron. Ai përpiqet të jetë personi më sakrifikues, më i trishtuari e më besniku në mënyrë që të meritojë dashurinë dhe komplimentet nga qenia që dashuron. I Dashuri i Allahut të Madhëruar këtë tipar të natyrshëm të njeriut e ka orientuar drejt mirësisë, prandaj i ka nxitur sahabët të garonin në mirësi.

Të garuarit në punë të hajrit, për besimtarin i cili është dëshmitari i Zotit në tokë, është një shkak që e shtyn atë për ta shfrytëzuar kohën që është kapitali më i rëndësishëm që nuk duhet çuar dëm.

Resulullahu, (a.s.), për të nxitur fillimisht sahabët e mandej të gjithë umetin e tij deri në ditën e kiametit, drejt kësaj gare mirësie, shpesh i bënte pyetje të ndryshme motivuese të pranishmëve në kuvendimet e tij, ai vinte në pah kështu tiparet e atyre që do të meritojnë xhenetin, duke motivuar edhe të tjerët drejt këtyre veprave. Ja një shembull i kësaj çfarë thamë më sipër:

## A KA USHQYER SOT KUSH NDONJË TË VARFËR?

Abdurrahman bin Ebu Bekri, (r.a.), rrëfen:

Një ditë, pas faljes së namazit të sabahut, Resulullahu (a.s.) u kthye nga xhemati dhe pyeti sahabët:

“-A është kush nga ju sot agjërueshëm?”

Omeri, (r.a.), u shpreh:



“-O i Dërguari i Allahut! Mbrëmë nuk e mendova ta agjëroj ditën e sotme, prandaj nuk jam agjërueshëm.”

Më pas Ebu Bekri, (r.a.), mori fjalën dhe u shpreh:

“Mbrëmë e bëra nijet ta agjëroj ditën e sotme, prandaj sot gdhiva agjërueshëm.”

Ndërkohë Resulullahu, (a.s.), vazhdoi me pyetjet:

*“A ka vizituar kush prej jush sot ndonjë të sëmurë?”*

Kësaj here Omeri, (r.a.), pyeti me habi:

“O i Dërguari i Allahut! Sapo falëm namazin e sabahut së bashku dhe akoma nuk kemi lëvizur fare nga vendi, si mund të kishim vizituar ndonjë të sëmurë?”

Ndërsa Ebu Bekri, (r.a.), u shpreh:

“-Dëgjova se Abdurrahman bin Aufi ishte sëmurë. Kur dola për në mesxhid kalova aty dhe i bëra një vizitë të shpejtë.”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), bëri edhe një pyetje tjetër të fundit:

*“A ka ushqyer kush sot ndonjë të uritur?”*

Omeri, (r.a.), sërish tha:

“O i Dërguari i Allahut! Sapo falëm namazin tani, nuk kemi lëvizur fare prej këtu akoma!”

Ndërsa Ebu Bekri, (r.a.), dha këtë përgjigje:

“-Kur hyra sot në mesxhid pashë njërin që po ankohej për copën e bukës. Ndërkohë djali im, Abdurrahmâni kishte një copë bukë elbi në dorë. Ia mora menjëherë atë nga dora dhe ia dhashë nevojtarit.”

I mbushur me kënaqësi prej veprave të Ebu Bekrit, (r.a.), Resulullahu, (a.s.), u shpreh:

*“-Të përgëzoj me xhenet, o Ebu Bekr!”*



Omeri, (r.a.), i prekur dhe i pikëlluar u shpreh:

“-Ah xhenet!”

Më pas Resulullahu, (a.s.), për ta gëzuar edhe Omerin, (r.a.), shtoi edhe këto fjalë:

*“-Allahu e mëshiroftë Omerin, Allahu e mëshiroftë Omerin! Kur ai dëshiron të bëjë një vepër të mirë, e bën atë menjëherë pas Ebu Bekrit.”*

(Hejsemî, III, 163-164. shih. Ebû Dâvûd, Zekât, 36/1670; Hâkim, I, 571/1501.)

Besimtari duhet vazhdimisht të jetë në nijetin e mirë për të bërë ndonjë vepër të dobishme, për të shërbyer dhe për të bërë ndonjë mirësi. Dhe për konkretizimin e këtyre nijeteve duhet të jetë në gjendje lutjeje, përpjekjeje dhe përkushtimi. Udhëzimi për këtë është në Kuranin Famëllartë:

## KUR TË MBAROSH NJË PUNË, HIDHU NË TJETRËN...

Allahu i Lartmadhëruar urdhëron:

***“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (në punën tjetër) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!”*** (Inshirah, 7-8)

Sahabët e nderuar që e kishin fituar këtë vetëdije, pasi ndërroi jetë Resulullahu, (a.s.), nuk ranë në gjendje neglizhence për asnjë moment, u përhapën në çdo cep të botës me diturinë, urtësinë, ftesën dhe përpjekjen e tyre; pishtarët e zemrave që kishin ndezur në Medinën e shndritshme, i dërguan në Samarkand, Kinë, Iran, Anadoll, afër Stambollit, në Afrikë, e deri në brigjet e Oqeanit Atlantik.

Ata kurrë nuk treguan as lodhje dhe as nuk ranë në pesimizëm, në këto udhëtime kaq të mundimshme.

Sepse ata;

Shkuan me energjinë që kishin marrë nga i Dërguari i Allahut, (a.s.). Ai ishte burimi i energjive të tyre të pashtershme.



Dëshirat e tyre të vetme ishte;

Të fitonin pëlqimin e Allahut dhe të mund të ishin afër me të Dërguarin e Allahut në botën tjetër.

Tiparet e tyre ishin:

Ata u njësuan me gjendjet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), morali i përsosur dhe personaliteti i mrekullueshëm i të cilit mund të përmblihdhet në formën el-Emin (i besueshëm) dhe es-Sadik (besëplotë). Kështu ata këshilluan për mirë dhe ftuan në rrugën e Resulullahut, (a.s.). Ata qenë të suksesshëm në këtë rrugë. Njerëzit grupe- grupe, popuj të tërë, u ndriçuan nga drita e Islamit.

Sepse sahabët dhe ndjekësit e tyre mësuuan nga Resulullahu, (a.s.), nderimin e njeriut;

## RESPEKTI NDAJ NJERIUT

Jalah bin Murre, (r.a.), rrëfen:

“Kam marrë pjesë në shumë ekspedita pranë Resulullahut, (a.s.). Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), haste ndonjë të vdekur, urdhëronte menjëherë që ai të varrosej, pa pyetur nëse ishte besimtar apo jobesimtar.” (Hakim, I, 526/1374.)

Çdo person mbart sekretin e Allahut të Lartmadhëruar. Vendimi në lidhje me njeriun do të jepet sipas gjendjes së frymës së tij të fundit. Për këtë arsye, është e nevojshme që çdo njeriu t'i jepet kohë dhe t'i bëhet respekti deri në fund. Tekefundit, dritaret e zemrës janë të hapura karshi Allahut, (xh.sh.). Si do të jepet fryma e fundit është e panjohur për këdo, përveçse për Profetët dhe për ata njerëz që Profetët kanë përgëzuar me xhenet.

Që ftesa për në Islam të jetë e suksesshme, është kusht të respektohet njeriu. Sepse njeriu, kur dikush i afrohet me respekt, percepton thelbin e tij shpirtëror dhe vetëdijësohet për aftësitë shpirtërore që ndodhen në veten e tij.



Të parët tanë kanë shpalosur drejtësinë e tyre për shekuj me radhë në zonën e Ballkanit dhe të Europës dhe janë treguar të dhembshur dhe të mëshirshëm më banorët e krishterë të këtyre zonave. Kanë sjellë në këto zona familje që dëshmuar të vërtetën e Zotit dhe shpalosën fytyrën e qeshur të Islamit, nga Anadulli; në sajë të tyre, shumë prej banorëve të zonës që kishin ndërgjegje të pastër dhe të përafërt me Islamin, u nderuan me të vërtetën islame, kryesisht populli i Bosnjes dhe ai i Shqipërisë.

Dhembshuria, mëshira dhe dashuria ndaj umetit, që kishte Resulullahu, (a.s.), u reflektua edhe tek sahabët dhe tek pasuesit e tyre që ndërtuan një brez të lavdishëm.

Dhembshurinë e Resulullahut, (a.s.), ndaj umetit të tij, të cilën e përgëzon dhe e inkurajon edhe Kurani, Enes bin Malik, (r.a.), e shpjegon kështu:

“Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), nuk shihte për tre ditë radhazi njërin prej vëllezërve myslimanë, pyeste për të. Nëse ai ishte larg, Resulullahu, (a.s.), lutej për të; nëse ai ishte në shtëpi, Profeti shkonte për ta vizituar; nëse ishte sëmurë personi, Resulullahu, (a.s.), shkonte t’i uronte «shërim të shpejtë».” (Hejsemi, II, 295.)

Ashtu siç ai ishte në gjendje duaje për umetin e tij, ashtu edhe kërkonte prej të tjerëve që të bënin gjithnjë dua për umetin e tij. Një nga miqtë e Allahut Teala, Maruf Kerhi, (k.s.), ka thënë:

“Ai që thotë dhjetë herë në ditë:

Tekst arabisht

«O Allah, përmirësoje gjendjen e umetit të Profetit Muhamed (a.s.)!

O Allah largoja vështirësitë e umetit të Profetit Muhamed (a.s.)!

O Allah mëshiroje umetin e Profetit Muhamed (a.s.)!»

Do të renditet në listën e miqve të Allahut Teala.” (Ebu Nuajm, Hilje, VIII,



Duaja (lutja) është nijet, qëllim.

Robi i dobët i lutet Allahut Teala, i Cili është më Madhështori dhe që përtej Qenies së Tij nuk ka asnjë forcë tjetër, që mund të realizojë qëllimet robit.

Teksa përjetojmë kënaqësinë e shqiptimit të këtyre lutjeve, për përmirësimin e gjendjes së umetit, shpëtimin e umetit nga vështirësitë dhe telashtet dhe për mëshirimin e tij nga Allahu Fuqiplotë, duhet të vëmë në dispozicion duart, mundësitë, pasuritë dhe jetën tonë. Të gjitha përpjekjet me vetëdijen e umetit;

## ME FRYMËN E VËLLAZËRISË...

Zotëriu i botëve që çdo cilësi të mirë e tregonte me stilin e tij të jetesës, interesimin dhe vëmendjen që duhet t'i kushtojë vëllai vëllait të tij mysliman, e tregoi me sakrificën dhe mëshirën shembullore duke u shprehur:

*“Unë jam afër çdo besimtari në këtë botë, por edhe në tjetrën, më shumë se çdo njeri tjetër. Nëse dëshironi (në lidhje me këtë temë) lexoni këtë ajet: «I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëri-tjetrin...» (Ahzab, 6) Nëse një besimtar lë pas vdekjes pasuri dhe mall le ta marrin atë trashëgimtarët e tij. Nëse ai lë ndonjë borxh apo nevojtar lë të vijë tek unë sepse do të jem unë ai që do ta mbroj e ndihmoj atë.”* (Buhârî, Tefsîr, 33/1, Kefâlet, 5, Ferâiz, 4, 15, 25; Muslim, Ferâiz, 14)

Po ne, të Dërguarin e Allahut, (a.s.), i cili është më afër nesh se vetë ne, dhe më i vlefshëm se vetëvetja jonë, a arrijmë ta duam më shumë se jetën tonë? Nëse themi «po e duam» atëherë veprat tona janë në drejtimin e duhur të vërtetimit të asaj çfarë pretendojmë?

Resulullahu, (a.s.), e vërtetonte fjalën e tij me vepra. Gjatë ekspeditave kujdesej për rreshtat e fundit të ushtrisë, i ndihmonte të lodhurit duke i kapur nga krahët, kështu u bëhej mbështetje morale gjithsecilit.



Ia shpërndante menjëherë plaçkën e luftës fukarenjve, në të shumtën e rasteve, ai nuk linte asgjë në shtëpinë e tij veç ujit të pishëm. Një shembull tjetër që tregon se sa shumë e donte umetin e tij në raport me veten është edhe ky:

Meshruku, (r.a.), transmeton:

Vizitova nënën tonë, Aishen (r.a.), e cila urdhëroi të me servirin diçka për të ngrënë. Ndërkohë ajo u shpreh:

“Më vjen të qaj sa herë ngopem me ushqim, nuk mund t’i mbaj dot lotët.”

Kur unë e pyeta:

“-Përse?”

Ajo m’u përgjigj:

“-Më kujtohet çasti kur ndërroi jetë i Dërguari i Allahut, (a.s.). Be-tohem në Allahun e Lartmadhëruar se ai nuk e ngopi barkun e tij me mish dhe bukë dy herë në një ditë.” (Tirmidhî, Zuhd, 38/2356; Muslim, Zuhd, 1.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili shpalosi virtyte kaq të larta me jetën dhe personalitetin e tij, mori shumë masa në drejtim të shtimit të dashurisë ndërmjet vëllezërve myslimanë.

Ai këshilloi përhapjen e selamit. Nxiti shkëmbimin e dhuratave, ndihmën reciproke dhe dhënien borxh atyre që janë në vështirësi.

Ai e konsideroi buzëqeshjen lëmoshë. Ai ishte vazhdimisht i buzë-qeshur. Sahabët e tij ishin në një garë të vazhdueshme për t’i ngjarë sa më shumë buzëqeshjes së fytyrës së tij të begatë.

Ummu’d Derda, (r.a.), na shpjegon:

“Ebu Derda pas çdo gjëje që fliste buzëqeshte. Një ditë i thashë:

«-Kam frikë se njerëzit (duke mos e kuptuar dot arsyen tënde të buzëqeshjes) do të të etiketojnë si të çmendur!»





Ai ktheu një përgjigje që shpjegonte arsyen e buzëqeshjes së tij:

«-I Dërguari i Allahut, (a.s.), buzëqeshte sa herë fliste diçka.» (Ahmed, V, 198, 199.)

Për sahabët e Resulullahut, (a.s.), nuk kishte fare rëndësi se çfarë thonin e mendonin njerëzit, sepse dëshira e vetme e tyre ishte të merrnin sa më shumë pjesë nga bota e brendshme e më të Dashurit të Allahut, (a.s.).

Ebu Kursafe, (r.a.), është shprehur:

Kur unë së bashku me nënën dhe tezen time shkuam për t'i dhënë në besën (bejatin) Resulullahut, (a.s.), nëna dhe teza ime, në kthim, u shprehën në lidhje me çfarë kishin ndjerë:

“-Biri ynë, ne nuk kemi parë një njeri tjetër si Resulullahu, (a.s.). Nuk njohim dikë tjetër me fytyrë më të bukur, me rroba më të pastra dhe më fjalëmbël se ai. Ai sikur shpërndante dritë nga goja e tij e nderuar.” (Hejsemî, VIII, 279-280.)

Edhe nga goja e ndjekësve të tij, pra nga goja e sahabëve të nderuar dhe miqve të Hakut, dolën fjalë të ëmbla e të shquara, perla plot urtësi.

Fjalët e tyre, si një ujëvarë që rrjedh këndshëm, u bënë shkak që njerëzit të përjetonin freskinë dhe kënaqësinë shpirtërore të besimit.

Besimtarët që brendësuan moralin e lartë të islamit, si lulet e freskëta e të sapoçilura, përkëdhelën dhe ndezën shpirtërat e njerëzve me bukurinë, pastërtinë dhe aromën e tyre.

Sahabët e nderuar;

Nga dashuria e veçantë që ata kishin për të Dërguarin e Allahut, (a.s.), në temën e zbatimit në jetë të urtësive dhe këshillave të tij, ishin plot entuziazëm dhe pothuajse në garë me njëri-tjetrin.

Ata thonin pa menduar lodhjen, rrezikshmërinë dhe vdekjen;



«Dëgjuam dhe u bindëm!»

Ishin ditët e para mbas Uhudit... Resulullahu, (a.s.), sapo ishte kthyer në Medinë. Mirëpo rreziku i armikut akoma nuk kishte kaluar. I Dërguari i Allahut (a.s.), për të treguar madhështinë e besimtarëve dhe për të frikësuar armiqtë, pyeti besimtarët edhe për t'i nxitur ata:

*“-Kush dëshiron të ndjekë armiqtë?”*

Të dëshirojë një gjë i Dërguari i Allahut, (a.s.) e mos të dëshironin sahabët e tij?! A mund të kishin ata një vullnet tjetër veç vullnetit të Resulullahut, (a.s.)?! Menjëherë ata vrapuan për të zbatuar urdhërin e Resulullahut, (a.s.). Në këtë ekspeditë të organizuar për ndjekjen e armikut pothuajse të gjithë ata që morën pjesë ishin të plagosur.

Ndërkohë, Abdullah bin Sehli, (r.a.), i cili kishte marrë plagë të rënda në Uhud, u kthye në Mekë së bashku me vëllain e tij Rafi (r.a.). Ata dëgjuan thirrjen e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe thanë:

## SI MUND TA HUMBASIM NE KËTË MUNDËSI?!

“ - Vallahi, ne nuk kemi një mjet transporti dhe plagët i kemi të rënda. Por si mund të mungojmë në një ekspeditë ku merr pjesë vetë i Dërguari i Allahut, (a.s.)?! ”

Ai që kishte plagët më të lehta, e ndihmoi dhe e mbajti në shpinë tjetrin. Në këtë mënyrë, ata nuk u ndanë për asnjë moment nga Resulullahu, (a.s.). (Ibn Hisham, III, 53.)

I tillë ishte vizioni i dashurisë së sahabëve ndaj Resulullahut, (a.s.), dhe qëndrimi bashkë me të...

Nuk mjaftonte një lidhje e zakonshme për të shprehur dashurinë ndaj Resulullahut, (a.s.), kërkohej sakrificë; ajo nuk përbëhej vetëm nga emocioni, por kërkonte edhe veprim.

Duke vepruar në bazë të këtij fakti, sahabët e nderuar:



Ata, si «fatlumët që i ishin përgjigjur ftesës» së Profetit Muhamed, (a.s.), ndjenin mbi shpatullat e tyre përgjegjësinë e pjesës tjetër që ende «nuk i ishte përgjigjur kësaj ftese». Ata vazhdimisht tregonin dhembshuri ndaj tyre siç tregohet dhembshuri ndaj një të sëmuri apo një të privuari. Sepse falënderimi ndaj mirësisë së udhëzimit, është përçimi i këtij udhëzimi tek të privuarit...

## FALËNDERIMI PËR UDHËZIMIN

Ata e dinin se në falënderimin e mirësisë së udhëzimit përfshihej edhe përçimi i mirësisë së udhëzimit edhe tek ata njerëz që kishin ngelur në errësirë, jashtë nurit të udhëzimit. Ata kurrë nuk u lodhën gjatë shërbimit për ta çuar në vend me entuziazëm këtë përgjegjësi.

Sepse ata i eleminuan të gjitha pikëpyetjet nga energjia që morën nga bota shpirtërore e të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Ata u bënë udhëtarë të pafundësisë, duke e konsideruar të vetmen strehë dhe mbështetje, atmosferën shpirtërore të Profetit, (a.s.).

Ata nuk kishin asnjë lloj shqetësimi që lidhej me jetën e kësaj bote.

Ata u përpoqën të bartnin personalitetin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), kudo që shkuan. Për këtë arsye, qëllimi i vetëm i jetës së tyre ishte: të mësonin, të lexonin, të ndjenin, të përthithnin Kur'anin, që ishte morali i Profetit (a.s.); duke e përcjellë atë me fjalët, sjelljen, gjendjet dhe moralin e tyre.

Edhe ideali ynë duhet të jetë ai i gjeneratës së sahabëve që ishin sakrifkues, të zellshëm, të ndjeshëm, të këndshëm dhe të fortë. Etaloni ynë duhet të jenë sahabët që u bënë pasqyrë e pastër e përcjelljes së rrezatimeve të moralit të nurtë të Resulullahut, (a.s.).

Tipari ynë dallues, siç ishte edhe i tyri, duhet të jetë principi i Resulullahut, (a.s.): «*Njeriu është me atë që do!*»

Ne duhet të bëjmë llogarinë e vetes në lidhje me faktin sesa jemi përfshirë brenda këtij parimi...



Ne duhet të pyesim:

Sa pjesë kemi përftuar nga bota shpirtërore e të Dërguarit të Allahut, (a.s.)?

Sa copëza kemi merituar nga jeta e ndritur, nga gjendja shpirtërore dhe personaliteti i asaj Qenieje të nurtë?

## SA E MERITOJMË?

**Pjesa shpirtërore gjatë adhurimit** tonë, në çfarë niveli është?

Pra a na shpiejnë adhurimet tona në kënaqësitë dhe në thellësitë e ndjenjës? Në ç'masë mund të arrijmë qetësinë dhe prehjen shpirtërore?

Në cilin nivel është **hijeshia e veprave tona**?

Sa janë zemrat tona tempuj mëshire dhe rahmeti?

Sa mund të shpërndajmë nga ai tempull mëshirë për të tjerët. Vep-  
rat tona mbyllen me “Zoti qoftë i kënaqur me ty!”; apo me «Nuk ta bëj  
hallall!»?

Në ç'masë është **mirësjellja në moralin tonë**?

A është mirësjellja që ne u tregojmë të tjerëve në të njëjtin nivel me  
delikatesën që presim prej tyre?

A arritëm të shpëtojmë nga kotësia, armiqtësia dhe arroganca? A  
kemi modesti të sinqertë?

Çfarë thellësie ka **butësia në zemrat tona**?

Sa mund të afrojmë të gjitha krijesat në gjirin tonë? Sa e bëjmë zemrën  
tonë tempull strehimi për nevojtarët dhe të vetmuarit?

Sa gjithëpërfshirëse është mëshira jonë, sa aktive është ajo?

Sa shndrit **bukuria e nurit në fytyrën tonë**?

Sa janë të pranishme në ne shenjat e besimtarëve që janë afër Re-  
sulullahut, (a.s.), siç përshkruhen në ajetin kuranor;



**“...Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes...”** (Fe’h, 29) ?

Në çfarë mase dhe cilësie është **rrjedhshmëria jonë e gjuhës**?

A shpërndan ajo qetësi dhe prehje shpirtërore?

Sa i japin freski bashkëbiseduesit fjalët tona?

Në çfarë mase janë kultivuar **ndjenjat tona**?

A jemi vetëdijësuar në lidhje me faktin së të gjitha krijesat na janë besuar neve? Në çfarë niveli është ndjeshmëria jonë ndaj ajeteve të Allahut të Lartmadhëruar, ndaj përgjegjësisë sonë, përballë vdekjes që na afrohet dita-ditës, e kiametit? A na dridhen zemrat? A na përloten sytë?

Ku është orientuar **thellësia e shikimeve tona**?

Sa mund t’i vëzhgojë zemra jonë manifestimet e madhështisë hyjnore, gëlimet e fuqisë hyjnore dhe zbukurimet hyjnore? Sa e zbatojmë direktivën hyjnore **«Lexo!»** (Alak, 1).

Sa jemi ruajtur nga dituria e jashtme dhe e padobishme, informacionit të thatë dhe të pavlerë? Sa kemi përthithur të fshehtat dhe urtësitë?

E si përfundim;

Sa jemi begatuar nga oqeani i pamatë i moralit të lartë të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili përmendet me nderim në ajetin **“se ti je me virtyte madhore.”** (Kalem, 4)? Sa ka tek ne prej cilësive më të bukura të botës shpirtërore plot mëshirë të prijësit të profetëve, Resulullahut, (a.s.)?

Lum për umetin e Muhamedit (a.s.) që këtyre pyetjeve do t’u përgjigjet pozitivisht e do ta mbyllë jetën e kësaj bote me dritën e imanit (besimit)!

Lum për ata që ikën si dëshmorë nga kjo botë e si trashëgimtarë të denjë të Resulullahut, (a.s.), e u nderuan me xhenet!

**Allahu na bëftë edhe ne të ecim në rrugën e nurtë të të Dashurit të Tij dhe na dhuroftë gjendjet e sahabëve dhe miqve të Tij që u njësuan me moralin e lartë të Kuranit të Madhëruar!**



**Allahu na përsostë me dashurinë e Muhamedit, (a.s.); na i bashkoftë zemrat tona, në jetën e kësaj bote, me zemrën e Resulullahut, (a.s.), dhe gjithashtu na bëftë nga ata fatlumë që do të jenë së bashku me Resulullahun, (a.s.), në jetën e pasosur!**

**Amin!..**



Të qenët bashkë me profetin

## NË TË DY BOTËT







## Të qenët bashkë me profetin NË TË DYJA BOTËT

### DASHURIA...

Në themelin e krijimit dhe universit qendron dashuria...

Allahu i Lartmadhëruar që dëshiroi të njëhej, çdo gjë e krijoi për njeriun, ndërsa njeriun e krijoi për adhurimin e Tij, për njohjen e Tij dhe për miqësinë me Të.

E gjithë qënia është një shkollë dhe një dekor për realizimin e këtij provimi.

Shpërblimi i këtij provimi është xheneti dhe shijimi i bukurisë së Allahut të Lartmadhëruar... Ndërsa ndëshkimi është privim nga mirësitë hyjnore dhe dënim i dhembshëm...

Librat e këtij provimi janë shpalljet e shenjta, kurse mësuesit janë të dërguarit e Allahut, (a.s.).

Udhëzuesi më i fundit dhe më i përsosur në njohjen e Allahut, në adhurimin e Tij dhe në miqësinë me Të është Kurani Famëlartë; ndërsa mësuesi më i shquar, shembulli më i lartë dhe manifestimi më i plotë si udhëzues është zotëria i botëve, Muhamed Mustafaja, (a.s.).



Personalitetin që kërkon Allahu i Lartmadhëruar prej nesh dhe moralin e përsosur që do të na bëjë miq të Tij, na i shpjegoi dhe vazhdon të na i shpjegojë Kurani Famëlartë, ndërsa Resulullahu, (a.s.), na i tregoi dhe vazhdon të na i tregojë nëpërmjet jetës së tij.

Sado të jemi mirënjohës për këto mirësi të jashtëzakonshme është pak. Falënderimi për këto mirësi fillimisht bëhet duke përfutur prej tyre. Falënderimi për këto mirësi duhet të fillojë me vetëdijësimin në lidhje me to, me pranimin e tyre, dhe me përqaftimin me dashuri e entuziazëm me Kuranin dhe Sunetin e Resulullahut (a.s.). Në fakt ai që është më afër Allahut të Lartmadhëruar e kupton më mirë fjalën e Tij, Kuranin e madhërishtëm, dhe ai që është afër dhe i shkrirë me gjendjet e Resulullahut (a.s.) e kupton më mirë Sunetin e tij.

Në lidhje me këtë temë mëshira hyjnore dhe dhembshuria profetike nuk na ka lënë pa shembull dhe pa udhëzues. Se sa mirësi të jashtëzakonshme janë Kurani Famëlartë dhe Resulullahu, (a.s.), dhe se si duhet shlyer borxhi i këtyre mirësive na e kanë treguar sahabët e nderuar dhe ndjekësit më korrekt të tyre, miqtë e Hakut.

Resulullahu, (a.s.), e jetoi jetën e kësaj bote me shqetësimin e përçimit të mëshirës së tij, për të cilën ishte dërguar, qoftë edhe te një person më tepër. Ai ia dedikoi jetën e tij prej profeti, pra rreth 23 vjet të shpalljes, shpëtimit shpirtëror të njerëzve dhe në hutben e lamtumirës rreth 120 mijë të pranishmëve iu drejtua tri herë me fjalët:

“A e përmbusha misionin tim që m’u besua?”, duke mbajtur për dëshmitarë Allahun e Lartmadhëruar dhe duke e kryer me suksesin më të plotë këtë mision kaq të shenjtë. Me shpalljen dhe vetëdijën e shërbimit që u dha sahabëve, me dashurinë dhe përpjekjen për të lartuar fjalën e Allahut të Lartmadhëruar, ai u bë shkak për shpëtimin e njerëzve në të dyja botët.

Ai, (a.s.), nuk u mjaftua vetëm me shpëtimin e Mekës, Medinës dhe gadishullit arabik, por që mëshira e Allahu të Lartmadhëruar të përfshijë



të gjithë, u dërgoi letra ftese të gjithë burrave të shteteve që për kohen kishin pushtet të plotë politik dhe dërgoi sahabët e tij me misionin e shërbimit të përçimit të islamit deri edhe në Kinë.

Sepse ai;

## ËSHTË MËSHIRË PËR TË GJITHA BOTËT

Vetë i Dashuri i Allahut, (a.s.), ka thënë:

*“Për një besimtar, të qenët shkak që mëshira të arrijë edhe te një person më shumë, e që dikush të gjejë udhëzimin, është më e rëndësishme se çdo gjë tjetër mbi të cilën lind dielli.”* (Xhâmiu’s-sagîr, No: 7219.)

Sahabët që morën në dorëzim këtë flamur, e mbartën kandilin e nurtë të udhëzimit të islamit nga Oqeani Atlantik e deri në Kinë. Njëri prej tyre ka një vlerë shumë të veçantë për ne:

Ebu Ejub el Ensari (r.a.)...

Ky sahab i nderuar që kishte mikpritur në shtëpinë e tij të Dërguarin e Allahut, (a.s.), me vetëdijën e përhapjes së islamit që kishte përfutur prej tij, me dëshirën e flaktë për të qënë bashkë me Resulullahun, (a.s.), në botën e pasosur, mori pjesë në ekspeditën e Stambollit duke qenë tetëdhjet e ca vjeç. Gjatë rrugës u sëmur. Kur iu afrua vdekja i tha mikut të tij ushtar:

“Nëse më mbarohen ditët e kësaj jete e vdes, më merrni me vete e më varrosni në kufirin e tokave bizantine deri ku ju mund të shkelni. Kur ju të përballeni me ushtrinë armike e të mos mundeni më të përparoni më tej, pikërisht aty më varrosni!” (Shih. Ahmed, V, 419, 416)

Ai sahab nga qyteti i bekuar i Medinës, qindra kilometra larg vendlindjes, në zonën që ka marrë emrin e bekuar të tij, vizitohet nga qindra turistë nga mbarë bota, e kështu edhe në kohët e sotme ai është burim udhëzimi, entuziazmi dhe predikimi.



Zemrat e sahabëve kanë rrahur vazhdimisht për Resulullahun, (a.s.), dhe fitimin e kënaqësisë së tij, sytë e tyre kanë kërkuar pëlqimin e tij, ata ishin të gatshëm të sakrifikojnë çdo gjë për dëshirën më të vogël të tij. Ata e konsideruan detyrë sakrificën dhe privimin dhe vraponin të kënaqur pas saj. I vetmi pretendim i tyre për gjithë çfarë sakrifikuan ishte;

## **TË JENË SË BASHKU NË TË DYJA BOTËT**

Ata ishin të etur për të qenë së bashku me Resulullahun (a.s.). Përpiqeshin ta përsosnin raportin me të. Sepse e kishin perceptuar mirë faktin se për të qenë mik me Allahun e Lartmadhëruar duhet të jesh afër dhe bashkë me të Dërguarin e Tij.

Ata me të vërtetë kishin një dëshirë të zjarrtë të ishin pranë Resulullahut, (a.s.). Kishin dëshirë të ishin prapa ose në të djathtë të tij kur falnin namazin. Sipas një transmetimi të Enesit (r.a.):

“Resulullahu, (a.s.), kërkonte prej muhaxhirëve dhe ensarëve ta falnin namazin pranë tij (pas tij) në mënyrë që ata të mund të mësonin në mënyrë të përkryer (rregullat e namazit).” (Ibn Mâxhe, Salât, 44.)

Në luftëra dhe në ekspedita silleshin rreth Resulullahut, (a.s.), me dashurinë më të flaktë. Ata ishin aq besnikë ndaj tij dhe të lidhur me të, sa nëse Resulullahu (a.s.) bënte me shenjë nga deti ata niseshin drejt tij pa dyshimin më të vogël. Ata nxorën shpatat dhe luftuan edhe kundër të afërmeve të tyre që nuk pranuan Islamin. Zgjedhën afërsinë e Resulullahut, (a.s.), përballë afërsisë së gjakut që kishin me prindërit e vëllezërit e tyre.

Dhanë besën se do ta ruanin Resulullahun, (a.s.), deri në vetëflijim. I dhanë fjalën Allahut të Lartmadhëruar për këtë dhe i qëndruan besnikë asaj deri në frymën e fundit. Për të ruajtur jetën e të Dërguarit të Allahut të Lartmadhëruar harruan jetën e tyre e të fëmijëve të tyre.



## JA NJË SHEMBULL NGA BETEJA E UHUDIT

Në ditën e Uhudit qyteti i Medinës u trondit nga një lajm i tmerrshëm:

**“Muhamedi (a.s.) u vra!”**

Në qytetin e Medinës ku ndodheshin gratë, fëmijët dhe të moshuarit që nuk kishin marrë dot pjesë në luftë, u dëgjuan britmat e vikatjet e dëshpërimit që u ngjitën deri në Arsh. Secili doli në rrugën prej nga ku mund të vinte ndonjë luftëtar për të marrë një lajm të saktë. Atë ditë zonja Sumejre mori lajmin e pesë dëshmorëve nga familja e saj. Kur asaj i thanë:

“-Dy djemtë, babai, burri dhe vëllai juaj kanë rënë dëshmorë.”

Ajo nuk u prek prej këtij lajmi të rëndë, por e shqetësuar thellë në zemër pyeste për Resulullahun, (a.s.):

“-A i ka ndodhur gjë atij? A i ka ndodhur gjë atij?”

Sahabët i thanë:

“-Falënderimet i takojnë Allahut të Lartmadhëruar, i Dërguai i Allahut, (a.s.), është mirë. Ai, ashtu siç dëshiron ti, është në jetë.”

Atëherë zonja e nderuar Sumejra, (r.a.), u shpreh:

“-Nuk më zë vendi pa e parë të Dërguarin e Allahut me sytë e mi. Ju lutem ma mundësoni ta shikoj, tani!”

Kur e dërguan te Resulullahu (a.s.), ajo menjëherë shkoi pranë tij, kapi një cep të rrobës së tij dhe u shpreh:

**“T’u bëfshin kurban nëna dhe babai im, o Resulullah! Kur ti je gjallë dhe mirë, nuk më shqetëson asgjë tjetër!”** (Vakidi, I, 292; Hejsemî, VI, 115.)

Çfarë dashurie madhështore! Çfarë etjeje për të qenë shpirtërisht bashkë me Resulullahun, (a.s.)! Çfarë besimi i mrekullueshëm në lartësinë dhe nderin e të rënit dëshmorë!..



Çfarë shkriu e thellë në gjendjen e Resulullahut, (a.s.), ...

Dëshira e flaktë e sahabëve për të qenë së bashku me Profetin tonë dhe për të përfituar nga kuvendimet e tij, arriti deri në atë shkallë sa u shpall ajeti, i cili urdhëronte që mbasi të zgjidhnin çështjet e tyre, njerëzit të mos rrinin aq gjatë sa ta bezdisnin Profetin, (a.s.). Punët e kësaj bote sahabët i ndanin me njëri-tjetrin në mënyrë që të kishin mundësi të faleshin me Resulullahun, (a.s.), e të merrnin pjesë në kuvendimet e e mrekullueshme të tij. Nënati i inkurajonin fëmijët e tyre të merrnin pjesë në kuvendimet e Resulullahut, (a.s.).

Sahabët e nderuar e kishin kuptuar shumë mirë që i Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte shembulli më i përsosur. Çdo gjendje të Resulullahut e mësonin për vete, ua mësonin të tjerëve, dhe e zbatonin praktikisht në jetën e tyre. Abdullah Ibn Abasi, Abdullah Ibn Omeri dhe sahabët e ngjashëm më ta, përfituan nga lidhjet farefisnore me Profetin tonë; Ata u përpoqën të mësonin sesi ai (a.s.) gjallëronte natët e si i jetonte ditët. Ata u përpoqën që ditët dhe netët e tyre t'ia përngjasonin atyre të Resulullahut (a.s.).

Sahabët e sufes si Ebu Derda, Ebu Hurejre, Enes bin Malik, Bilal Habeshi, Abdullah Ibn Omer, e shumë të tjerë, si shkak i dashurisë së tyre të lartë për Profetin tonë, në çdo rast përpiqeshin të ishin pranë Resulullahut (a.s.). Madje i ishin dedikuar ndjekjes së tij në mënyrë të pashmangshme, siç hija ndjek të zotin e saj.

Pasi ndërroi jetë Resulullahu, (a.s.), ata jetuan si pasqyra fatlume që reflektonin kudo atë Diell. Gjurma e dashurisë që Resulullahu, (a.s.), la në zemrat e tyre, ishte aq e mrekullueshme sa sahabët edhe kur nuk e dinin urtësinë e një veprimi të caktuar të Resulullahut, (a.s.), e kryenin atë vetëm e vetëm për t'u njësuar me të.

Dashuritë që ata kishin në zemër, i nxisnin ata që të vepronin kështu... Dashuria ndaj Allahut (xh.sh.) dhe dashuria ndaj Profetit (a.s.).

Këto dy dashuri ishin ndërthurur brenda njera tjetrës si në ajetin kuranor:



***“Thuaju (o Muhamed): «Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë!»”*** (Al-Imran, 31)

Në veçanti, dashuria dhe bindja e Abdullah bin Omerit, (r.a.), ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ishte shumë e flaktë.

Abdullahu, (r.a.), pas ndërrimit jetë të Dërguarit të Zotit, për shkak të dashurisë ndaj tij, mësonte vendet ku Resulullahu, (a.s.), kishte falur namazet dhe falej aty. Ecte në rrugët që kishte ecur Resulullahu, (a.s.), ulej nën pemët që ishte ulur ai dhe i ujiste ato me kujdes që të mos thaheshin. Me një singëritet të veçantë ndiqte shtigjet që kishte përshkuar Resulullahu, (a.s.), dhe e kthente kafshën e tij, pikërisht aty ku e kishte kthyer Profeti, (a.s.). Kur nuk kishte asnjë punë, ai dilte në rrugë vetëm e vetëm për t’u dhënë selam vëllezërve të tij mysliman. (Ibn Sad, IV, 156; Ibn Haxher, el-Isabe, II, 349; Ibn Esir, Usdu’l-gabe, III, 341.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), kur ishte i hipur në kafshën e tij gjatë udhëtimit, adhuronte Allahun e Lartmadhëruar (falte namaz nafle dhe për rukutë dhe sexhdet) levizte kokën duke lënë të kuptohej që po falej. (Ashtu si mund të ndjekë një njeri shenjat në borë) Ibn Omeri, (r.a.), që gjatë gjithë jetës e imitoi Resulullahun, (a.s.), gjatë udhëtimeve të tij falej siç ishte falur ai, (a.s.). (Buhâri, Taksîru’s-Salât, 7, 8, 11, 12; Vitri, 5, 6; Muslim, Musâfirîn, 39.)

Abdullah bin Omer, (r.a.), i cili kishte vërejtur se Resulullahu, (a.s.), shkonte çdo të shtunë në këmbë ose me kafshën e tij të transportit në xhaminë Kuba, e aplikoi të njëjtën gjë deri në fundin e jetës. (Muslim, Haxh, 521)

Kur atë e pyesnin:

“-Pse e bën një gjë të tillë?”

Ai kthente të njëjtën përgjigje:

“-E kam parë Resulullahun, (a.s.), duke bërë të njëjtën gjë.” (Buhâri,

Vudû’ 30; Haxh, 16, 38, 149; Muslim, Haxh, 25, 245, 521; Elfâz, 21; Tirmidhî, Haxh, 39/864; Ebû Dâvûd, Hâtem, 5/4227, 4228; Nesâî, Haxh, 174; Ibn Mâxhe, Haxh, 43; Muvattâ, Haxh, 31.)



Këta ishin disa shembuj që tregojnë etjen për të qenë bashkë me Resulullahun edhe së jashtmi. Ndërsa ata që tentojnë të bëjnë veprime të tilla pa ditur kuptimin dhe urtësinë shpirtërore të veprimeve në fjalë, pra duke mos qenë të njësuar shpirtërisht me Resulullahun, (a.s.), janë thjeshtë imitues të thatë.

Kurse sahabët e nderuar njësimin e jashtëm me Resulullahun në vend dhe në kohë e shoqëruan me njësimin shpirtëror me të (a.s.).

### NJËSIMI SHPIRTËROR...

Etaloni i tyre shpirtëror ishte dashuria e çdo gjëje që ai (a.s.) donte dhe urrejtja e çdo gjëje që ai (a.s.) urrente.

Sepse ata mësuan prej Resulullahut, (a.s.):

*“Vepra më e mirë prej të gjitha veprave është të duash për hir të Allahut të Lartmadhëruar dhe të urresh për hir të Allahut të Lartmadhëruar.”* (Ebû

Dâvûd, Sunnet, 3.)

**Të duash atë që e meriton dhe të urresh atë që e meriton një gjë të tillë.**

Në fakt kjo qasje nuk ishte thjeshtë një virtyt, por një domosdoshmëri besimi.

Në një ajet kuranor përmendet si një kusht besimi njësimi shpirtëror me Resulullahun, (a.s.):

(teksti arabisht)

*“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht.”* (Nisa, 65)

Ata e kishin perceptuar mirë se duhet t’ia dorëzonin vullnetin e tyre vullnetit të Resulullahut, (a.s.), pa asnjë shqetësim e kundërshtim dhe këtë të vërtetë u përpoqën ta konkretizonin në jetën e tyre të përditshme.





Njësimi i zemrës me zemrën e Resulullahut (a.s.) dhe kultivimi i dashurisë me referencë më të Dashurin e Allahut, (a.s.), është pjesë integrale e imanit. Resulullahu, (a.s.), e ka theksuar e forcuar këtë lidhje dashurie me disa hadithe të bekuara:

Për shembull, një ditë teksa Resulullahu, (a.s.), kishte kapur për dore Hasanin, (r.a.), dhe Hysejnin, (r.a.), u shpreh:

*“Kush me do fort mua, dy nipat e mi dhe prindërit e këtyre dyve, në ditën e kiametit do të jetë së bashku me mua.”* (Tirmidhî, Menâkib, 20/3733.)

Ky dorëzim përbën edhe shkrirjen e mendjes dhe mendimit në brendësitë e Kuranit dhe Sunetit; pra është edhe njësim mendor.

Zemrat, intelektet, ndjenjat dhe mendimet duhet të kenë vetëm një qëllim: Kënaqësinë e Allahut të Lartmadhëruar dhe të të Dashurit të Tij, (a.s.)...

Kjo ngjarje që u jetua pas luftës së Bedrit është shumë domethënëse:

Në luftën e Bedrit, myslimanët medinas kishin zënë rob xhaxhain e Resulullahut, (a.s.), Abbasin. Dëshironin ta vrisnin atë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), u shpreh:

*“Mbrëmë nuk vura fare gjumë në sy prej xhaxhait tim Abbas, kisha frikë mos ta vrasin ensarët.”*

Omeri, (r.a.), tha:

“-A të shkoj e të flas unë me ta, o Resulullah?”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), iu përgjigj:

“-Po, mund të shkosh!”

Omeri, (r.a.), shkoi te ensarët dhe u tha:

“-A nuk mund ta lironi robin tuaj, Abbasin?”

“-Jo, vallahi atë nuk do ta lirojmë!” - thanë ata.



Kur Omeri, (r.a.), u tha:

“Edhe nëse me këtë veprim do të jetë i kënaqur Resulullahu, (a.s.)?”

(Atëherë situata ndërroi, çështja mori tjetër kahje) dhe ata u shprehën:

“-Nëse me këtë veprim do të jetë i kënaqur Resulullahu, (a.s.), atëherë ne më kënaqësinë më të madhe ia japim lirinë Abbasit, mund ta marrësh!”

Omeri, (r.a.), e mori atë nga mesi i robërve të tjerë të luftës dhe i tha:

**“- O Abas, bëhu mysliman! Vallahi, hyrja jote në Islam më gëzon më shumë sesa hyrja e babai tim, Hatab.**

**Sepse unë e di se i Dërguari i Allahut, (a.s.), dëshiron shumë që ti të bëhesh mysliman, kjo do ta bënte atë shumë të lumtur.”** (Ibn Kethir, el-bidaje, III, 333.)

Pëlqimi i tij... Gëzimi i tij... Kënaqësia e tij...

E gjithë çështja e sahabëve ...

Çfarëdo që i Dërguari i Allahut, (a.s.), i pyeste, sahabët e nderuar shpreheshin:

“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë!”

Ata i mirëprisnin direktivat hyjnore dhe profetike, çelësat e lumurisë së përvetshme, me dëshirë të flaktë dhe entuziazëm, si të ishin sofa të mëdha që zbrisnin nga qielli.

Ata pyesnin të Dërguarin e Allahut, (a.s.), për çdo vështirësi që hasnin.

Ata përfituan nga dituria dhe urtësia e tij. Dituria për ta ishte një pasuri e dobishme për dynjanë dhe ahiretin, që rriste vetëdijen e frikë-respektit për Allahun (xh.sh.) dhe që mprehte perceptimin e tyre.

Një dituri të thatë, të padobishme, pa vepra, pra një dituri që nuk të çonte te «marifetullahu», ata nuk e konsideronin si të vlefshme për t'u mbajtur në kujtesë.



Ata patën nderin të shoqëroheshin me Profetin tonë në jetën e kësaj bote. Të gjitha përpjekjet e tyre ishin të lidhura me dëshirën e bartjes së këtij shoqërimi edhe në botën tjetër;

## **NË SHOQËRINË E RESULULLAHUT (A.S.) NË BOTËN E PËRJETSHME...**

Sahabët e nderuar, që panë fytyrën e bekuar të Qenies së Nurtë në këtë botë, dhe si fatlumët që morën pjesë në kuvendimet e tij, e kishin perceptuar lumturinë e të qenët umet i tij, në mënyrë të tillë që edhe duke qenë ende në shoqërinë e Profetit, (a.s.), frikësoheshin nga ndarja prej tij në ahiret.

Shumë prej tyre, me një mall përvëlues, për të kërkuar ilaçin e këtij shqetësimi, shkuan te Resulullahu, (a.s.), dhe ia shpalosën këtë problem.

Theubani, (r.a.), ishte njëri prej tyre. Ai e donte shumë të Dërguarin e Allahut, (a.s.), dhe nuk mund ta duronte dot qëndrimin larg tij. Një ditë, ai shkoi pranë Profetit, (a.s.). Ai ishte dobësuar dhe në fytyrën e tij të zverdhur lexohej një shqetësim.

I Dërguari i Allahut, (s.a.s), e pyeti atë:

*“- O Theuban, çfarë ke që je zverdhur kështu?”*

Theubani u shpjegua:

*“- O I Dërguari i Allahut, unë nuk kam as sëmundje, as dhembje. Mirëpo kur nuk të shoh më merr malli shumë për ty dhe derisa arrij të të takoj ty përjetoj një vetmi të thellë. Ti je më i dashur për mua se vetja, familja dhe fëmijët e mi. Kur jam në shtëpi dhe më kujtohesh ti nuk mund të duroj dot pa të parë fytyrën, prandaj vrapoj menjëherë për te ti. Kur ky mall është kaq i vështirë për t’u duruar në këtë botë, po në botën tjetër si do të jetë vallë?! Kur mendoj ahiretin më kaplon frika se mos vallë atje nuk do të mund të të shoh fare. Sepse unë e di që në botën tjetër ti do të jesh në grada të larta bashkë me profetët e tjerë. Kurse unë nëse hyj në*



xhenet do të jem diku poshtë e larg mundësisë së të qenët pranë teje. Por nëse nuk do të jem nga fatlumët e xhenetit, atëherë mundësia për të të parë më, do të jetë krejt e pamundur.”

Pas kësaj Allahu i Lartmadhëruar shpalli këtë ajet:

***“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!”***

(Nisa, 69) (Shih. Vâhidî, fq. 168-170.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tregoi Theubanit, (r.a.), dhe të gjithë atyre besimtarëve që friksohen se në ahiret do të jenë larg Resulullahut, (a.s.), se e vetmja zgjidhje është shoqërimi me të (a.s.) në çdo aspekt:

*“Njeriu është me atë që do.”*

Në hadithin e mësipërm Resulullahu, (a.s.), sqaron mirë faktin se rruga për të qenë bashkë me Resulullahun, (a.s.), në ahiret kalon nga të qenët bashkë me të, (a.s.), nëpërmjet dashurisë, që në këtë botë. Në pamje të parë nga hadithi i mësipërm mund të kuptohet se dashuria si ndjenjë është e mjaftueshme për të qenë afër Resulullahut, (a.s.).

Mirëpo i Dërguari i Allahut, (a.s.), për ata që kanë dëshirë të jenë pranë tij në kopshtet e xhenetit ka këshilluar: veprat e mira dhe moralin e lartë. Për shembull në një hadith Resulullahu, (a.s.), është shprehur:

*“Ai që do të jetë më afër meje në ditën e kiametit është ai që do të më dërgojë mua më shumë salate dhe selame.”* (Tirmidhî, Vitir, 21.)

Pra nuk bëhet fjalë për një dashuri të thatë, por për një dashuri të thellë që e nxit gjuhën drejt salavatëve, që e lidh zemrën me botën shpirtërore të Resulullahut dhe çdo veprim me moralin e islamit, etaloni i së cilës është çdo veprim i të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Pra hadithi i mësipërm duhet të kuptohet në formën:

*“Njeriu është bashkë me atë që do, për dashurinë e të cilit jeton dhe me dashurinë e të cilët formësohet dhe bëhet i qëndrueshëm.”*



Nëse një person e do Resulullahun, (a.s.), atëherë ai pajiset me personalitetin që pëlqen Resulullahu, (a.s.), bën ato vepra që dëshiron ai (a.s.), ka dëshirë të jetë bashkë me Resulullahun, (a.s.), me zemër, mendje, vepra, formë dhe karakter. Nëse ai do të përpiket seriozisht të njësohet me të, do të jetë së bashku me Resulullahun, (a.s.), në botën tjetër, aq sa do të jetë i suksesshëm në këtë njësim.

Mirëpo kur njeriu ia jep zemrën dynjasë dhe stolive të rreme të saj, e ndodhet në një gjendje emocionale dhe vepron për ta kënaqur të mallkuarin e Allahut, iblisin, duke bërë një jetë në kundërshtim me Allahun, (xh.sh.), dhe Resulullahun, (a.s.), duke u dhënë pas kënaqësive të ulta e dashurive të rreme, atëherë vendi i tij në jetën e pasosur do të jetë i njëjtë me ata që ai ka preferuar të shoqërohet e me dashurinë e të cilëve ka pranuar të formësohet.

“Njeriu do të jetë bashkë me atë që do dhe me dashurinë e të cilit është mbrujtur.”

Për këtë arsye i Dërguari i Allahut, (a.s.), që dridhej për të ardhmen e gjithkujt, i drejtohej çdonjërit me dashuri dhe kultivonte te secili idenë e bërjes së gjërave me dashuri:

Për shembull Enes bin Malikut, (r.a.), që e rriti si fëmijën e tij, një ditë i tha:

## I VOGLI IM!

*“I vogli im nëse mund të gdhihesh dhe ngrysesh pa pasur asnjë hile në zemrën tënde (asnjë ftohje ndaj vëllezërve besimtarë, pra nëse mund t'i falësh), bëje atë!”*

Pastaj vazhdoi:

*“I vogli im, kjo (që të thashë më lart) është nga Suneti im. Kush e gja-llëron Sunetin tim me të vërtetë ai më ka dashur mua. E kush më do mua, do të jetë së bashku me mua në xhenet.”* (Tirmidhi, Ilim, 16/2678.)



Resulullahu (a.s.) me këtë hadith na përcjell edhe neve një mesazh:

Përpiquuni sa më shumë të arrini prehjen shpirtërore dhe shpëtimin e zemrës!

Sigurisht kjo nuk është e kollajtë, është një punë e vështirë arti i zemrës!

Me këtë nivel të lartë shpirtëror nuk është e lehtë të kalohet qoftë edhe një ditë. Mirëpo ata që do të mund t'ia dalin me sukses kësaj, e që do ta gjallërojnë Sunetin e tij duke u njësuar me të me zemër e me veprime, do të shpërblehen me shoqërinë e Resulullahut, (a.s.), në xhenet.

Enesi, (r.a.), iu dha në shërbim Profetit (a.s.) nga e ëma kur ai ishte 10 vjeç. Ai i shërbeu Resulullahut, (a.s.), për 10 vjet. Personaliteti i lartë i Resulullahut, (a.s.), për të cilin përcaktorët i bukur, i mrekullueshëm, i veçantë, janë të paaftë për ta përshkruar, dashuria dhe morali i Resulullahut (a.s.), ndikuan aq shume Enesin, (r.a.), sa pas shumë vitesh ai do të shprehej:

“ - Nuk kam hasur aromë më të mirë se ajo e Resulullahut, (a.s.), as në myshk e as në parfumet më të rralla. Nuk kam prekur asgjë më të butë se lëkurën e Resulullahut, (a.s.), as atllasi e as mëndafshi nuk i afrohen asaj.”

Thabiti, nxënësi i tij, e pyeti Enesin (r.a.):

“ - O mjeshtër, ti jeton sikur e sheh Resulullahun, (a.s.), dhe dëgjon tingullin e zërit të tij të bekuar, apo jo?”

Enesi, (r.a.), dha këtë përgjigje:

“ - Po! Vallahi, në ditën e kiametit shpresoj që të takohem me të.

Kur të arrij tek ai do t'i them:

«- O Resulullah, erdhi shërbëtori yt i vogël!»

I kam shërbyer Resulullahut, (a.s.), në Medinë për 10 vjet. Në atë kohë isha një fëmijë i vogël dhe jo çdo gjë që bëja ishte në përputhje me dëshirën e Resulullahut, (a.s.).



Megjithëkëtë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), asnjëherë për asnjë veprim timin nuk më ka thënë as «Uf!», nuk më ka thënë as «Pse e bërë këtë, pse nuk e bërë këtë?!» (Ahmed, III, 222.)

Po. Ata kishin arritur nivele kaq të larta shoqërimi dhe dashurie me Resulullahun, (a.s.), saqë jetën e kësaj bote e jetonin më kënaqësinë dhe prehjen e të qenët me të në xhenet.

Sërish Enesi, (r.a.), thotë:

“Pas kalimit të Resulullahut, (a.s.), në botën tjetër, nuk kam parë asnjë ëndërr ku ai nuk ishte i pranishëm...” (Ibn Sad, VII, 20.)

Për të gjithë ata që dëshiruan që në jetën e vërtetë, në ahiret, në xhenet, të jenë bashkë me të, Resulullahu, (a.s.), i tregoi të njëjtën rrugë, dhe veçanërisht ai u tërhoqi vëmendjen aty ku ata kishin nevojë.

**Aishja**, (r.a.), tregon:

“I Dërguari i Allahut, (a.s.) më urdhëroi:

« (O Aishe!) Nëse ty të lumturon të qenët me mua (në xhenet), (nëse dëshiron të takohesh me mua në xhenet) duhet të të mjaftojë ty nga kjo botë, aq sa ushqimi që ka një rrugëtarë. Ki kujdes dhe mos prano si miq kuvendimi të pasurit (që i janë dhënë kësaj bote). Mos e konsidero të vjetër një rrobë që nuk ka arnë.»” (Tirmidhi, Libas, 38/1780.)

Resulullahu, (a.s.), nënën tonë Aishen, (r.a.), e donte shumë, mirëpo asaj ia kujtoi se për të qenë në botën tjetër me të, duhet të bëntë një zgjedhje mes bukurive të rreme të kësaj dynjaje dhe mirësive të vërteta të ahiretit.

Pra një kusht për të qenë me Profetin Muhamed, (a.s.), është edhe orientimi i dashurisë në adresat e duhura...

## ADRESA E VËRTETË E DASHURISË

Kujdesi që lidhjen tonë në nivelin e trupit dhe të nevojave bazike me këtë dynja, të mos e kalojmë në nivel shpirtëror, duke e shndërruar në dashuri dhe dobësi...



I Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka këshilluar kështu sahabin që donte fort, Abdullah ibn Omerin, (r.a.):

Abdullahu, (r.a.), shembulli i veçantë i dashurisë dhe ndjekjes së Resulullahut (a.s.) shpjegon:

“Një ditë, Resulullahu, (a.s.), më kapi nga shpatulla dhe më tha:

*«Bëhu si i vetmuar dhe si udhëtar në këtë botë. Konsideroje veten nga banorët e varrit!»* (Buhari, Rikak, 3.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i udhëzonte njerezit në këtë shkollë provimi, sipas nevojave që ata kishin. Ebu Dher el- Gifari, (r.a.), nuk kishte probleme në lidhje me anën materiale të kësaj bote. Të fshehtën e të qenët bashku me të, Resulullahu, (a.s.), ia dha me një këshillë tjetër:

*“O Ebu Dher! Ha më pak dhe fol më pak që të jesh në xhenet me mua!”*

(Ali el-Muttaki, Kenz, III, 770/ 8704.)

Në ahiret, ku njeriu do të jetë me atë që do, për të qenë me Resulullahun, (a.s.), duhet që në këtë botë të shuhen dashuritë kalimtare...

Ja pra, e tillë është dobësia ndaj ngrënies dhe pirjes...

E tillë është dëshira për të folur dhe për t'u dhënë pas gjërave të kota...

Këto duken si të parëndësishme, por realisht janë gropa dhe pengesa tepër të rrezikshme.

Resulullahu, (a.s.), në mesin e veprimeve që do ta bëjnë besimtarin komshi me të në ahiret, ka theksuar:

## PËRKUJDESJA NDAJ JETIMIT

Sipas transmetimit të Sehl bin Sa'd es-Said-it (r.a.), Pejgamberi, (a.s.), ka ngritur dy gishtat, treguesin dhe të mesmin, dhe ka thënë:

*“Ai person që përkujdeset për jetimin, do të jetë me mua si këto dy.”*

(Buhari, Edeb, 24; Talak, 14.)





I Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili kishte shumë dhembshuri dhe dobësi ndaj besimtarëve, na tregon se rruga për të qenë bashkë me të në xhenet, është sakrifica, mëshira, dhembshuria në jetën e kësaj bote, si dhe përgjegjësia për jetimët, jo thjeshtë si ndenjë, por si angazhim.

Nëse personi njësohet me gjendjet e atij që do, në botën tjetër do të jetë bashkë me atë që do. Në sofrën e Abdullah ibn Omerit, (r.a.), i cili e kishte bërë parim njësimin me gjendjet e Resulullahut, (a.s.), nuk hahej asnjëherë pa pasur në tryezë një jetim, pra transmetohet se në çdo sofrë që ai shtronte ishte i pranishëm të paktën një jetim. (Buhari, el-Edebu'l mufred, nr.136; Ebu Nuajm, Hilje, I, 299.)

Nga Hasan Basriu, (r.a.), transmetohet:

Ibn Omeri, (r.a.), gjithmonë në sofrën e tij ushqente një jetim. Një ditë Ibn Omeri, (r.a.), u përgatit për të ngrënë, kërkoi jetimin në fjalë, por nuk e gjeti. Jetimi erdhi pasi ai e mbaroi ushqimin. Ibn Omeri, (r.a.), kërkoi ushqim edhe për jetimin, por nuk kishte mbetur aspak. Ai i solli jetimit brumë të pjekur dhe mjaltë dhe i tha:

“Urdhëro, haji këto, vallahi ti nuk u mashtrove (as unë nuk kam ngrënë diçka më të mirë sesa kjo që po ha ti.)”

Hasan Basriu ka thënë:

“Vallahi, as ibn Omeri nuk u mashtrua (sepse duke vepruar kështu, ai fitoi sevap shumë të madh).” (Buhari, el-Edebu'l mufred, nr.134; Ebu Nuajm, Hilje, I, 299.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), vazhdimisht tregonte sakrificat që duheshin bërë për të qenë bashkë me të në botën tjetër. Ai tregonte detyrat që janë të vështira dhe që nefsit i vijnë të rënda, por që janë shumë të rëndësishme. Ja njëra prej tyre:

## EDUKIMI I FËMIJËVE

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

*“Kushdo që rrit dy vajza deri në moshën e pjekurisë dhe i edukon ato,*



*në ditën e kiametit ai do të jetë krah për krah me mua”, dhe bashkoi dy gishtat. (Muslim, Birr, 149. Shih. Tirmidhi, Birr, 13.)*

Sa e rëndësishme është për të ardhmen e një shoqërie, rritja dhe edukimi siç duhet i vazhate, me nder, bukuri, mirësi, dhe krenari, të cilat në kohën e injorancës nuk gëzonin asnjë të drejtë dhe asnjë vlerë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), jep sihariqin e afërsisë në xhenet me prindërit që do ta realizojnë me sukses këtë detyrë.

Në ditët tona dëgjojmë vazhdimisht për të këqijat që po i bëjnë prindërit fëmijëve të tyre në foshnjëri dhe na ngjallin brenda nesh shqetësimin dhe pyetjen: «Ku po shkon shoqëria jonë?!»

Çdo periudhë pa Profetin (a.s.), është injorancë...

Një zemër që nuk rrah për të, është tirane...

Çdo ndërgjegje që nuk e aprovon atë, është e verbër dhe e errët...

Ne jemi nevojtare gjithmonë për parimet e tij që janë ujë jete për ne...

Në këto kohë ku po jetojmë, çdo ditë e më tepër kemi nevojë...

I Dërguari i Allahut, (a.s.), jep sihariqin e të qenët bashkë me të në xhenet, edhe për nënën e cila sakrifikon çdo gjë për fëmijën e vet. Në hadithin në fjalë thuhet:

*“Unë dhe gruaja e nxirë nga shqetësimi, do të jemi si këta të dy afër njeri-tjetrit. (Jezid bin Zureji e transmeton këtë hadith duke hedhur shikimin mbi dy gishtat që kishte bashkuar, treguesin me të mesmin.) Ajo grua që ka mbetur e ve nga bashkëshorti i saj me pozitë dhe post të rëndësishëm, dhe që (përveç pasurisë) ka prejardhjen dhe bukurinë e duhur. Pavarësisht se ka të gjitha këto cilësi, nuk martohet, dhe derisa i rriten jetimët apo derisa të vdes, ia dedikon veten atyre.”*

Gruaja e ve që citohet në hadith, së cilës i është nxirë fytyra nga shqetësimi, është ajo grua që për të rritur fëmijët nuk zbukurohet dhe nuk jeton në rehati dhe prej shqetësimeve që përjeton i thahet lëkura.

(Ebu Davud, Edeb, 120-121/5149.)



Rritja e fëmijëve siç i rriti Resulullahu, (a.s.), siç ai pëlqeu, dëshiroi, këshilloi, sugjeroi dhe gjykoi për të përshtatshëm, do të na bëjë të jemi fqinj me Resulullahun (a.s.) në botën tjetër. Lodhja për t'ia dalë kësaj, ndarja e kohës për këtë, sakrifica, heqja dorë nga disa gjëra që dëshiron nefs (egoja), dhënia prioritet fëmijës ndaj nefsit, do të bëhen shkak për të fituar kënaqësinë e Allahut të Lartmadhëruar dhe të Dërguarit të Tij.

Sahabët e nderuar nuk ishin bashkë me Resulullahun, (a.s.), vetëm në dimensionin e vendit dhe kohës, por ata u shkrinë në qenien e Resulullahut, (a.s.), me zemër, mendje, moral dhe vepra. E kështu ata merituan të jenë së bashku me Resulullahun, (a.s.), në xhenet, inshallah.

Qëllimi ynë, gjithashtu, duhet të jetë të merituarit e fqinjësisë së Resulullahut, (a.s.), njësimi dhe afërsisë me të në ahiret, duke bërë përpjekje maksimale që edhe pse kemi distancë fizike me të, të mund të jemi sa më afër me zemër e me dimensionin tonë të brendshëm.

Synimi ynë duhet të jetë, të ruajmë dashurinë tonë nga adresat e gabuara, vullnetin tonë t'ia falim vullnetit të tij, t'ia përshtasim zemrën, mendjen, moralin, adhurimin dhe veprat tona Resulullahut, (a.s.), dhe mbi të gjitha të përpiqemi me të gjitha forcat të bëhemi një kuran i gjallë siç ishte Resulullahu (a.s.). Shqetësimi ynë i vetëm duhet të jetë të mund të bëhemi pasqyra të denja që reflektojnë bukuritë e Kuranit, Islamit dhe Resulullahut (a.s.).

**O Zot! Na i bëj të dashura për zemrën tonë shkaqet që na afrojnë me Qenien Tënde dhe na sigurojnë të qenët tonë bashkë me Resulullahun (a.s.) dhe na e bëj të mundur t'i përjetojmë ato!**

**Na bëj nga robërit fatlumë që do ta meritojnë fqinjësinë me Resulullahun, (a.s.), në botën tjetër...**

**Amin!..**





TË JESH NGA FAMILJA E NDERUAR E RESULULLAHUT

me prejardhje e me zemër



# TË JESH PJESE E FAMILJES SË NDERUAR TË RESULULLAHUT

Me prejardhje ose me zemër

## FAMILJA E NJERËZIMIT

Allahu i Lartmadhëruar fillimisht krijoi Ademin, (a.s.), e më pas prej tij krijoi Havanë, mandej prej llojit të tyre krijoi tërë njerëzimin. Parë nga ky këndvështrim i gjithë njerëzimi është një familje.

Allahu i Lartmadhëruar njeriun që vjen në këtë botë i dobët, pa forcë dhe nevojtarë për mëshirë, ia besoi dhembshurisë së prindërve, Ai (xh.sh.) dëshiroi që njeriu të rritet dhe të edukohet në një familje që ka themelet në dashuri e mëshirë.

Allahu i Lartmadhëruar, që ka instaluar përgjegjësi e detyra të ndryshme ndërmjet bashkëshortëve dhe prindërve të fëmijëve, në lidhje me follenë familjare që është edhe bërthama e shoqërisë, ka dashur që të jetë një shkollë mëshire e qetësie ku njeriu përgatitet për të hyrë në xhenetin e Allahut të Lartmadhëruar.

Prindërit instinktivisht mendojnë për shëndetin, paqen, qetësinë



dhe të ardhmen e fëmijëve të tyre, për sigurimin e të cilave janë gati të bëjnë çdo lloj sakrifice. Zoti dëshiron që këto prirje të natyrshme që gjenden te prindërit të fitojnë dimensionin e ahiretit, prandaj urdhëron prindërit që të përpiqen e të përkujdesen edhe për të ardhmen e ahiretit të fëmijëve të tyre.

Në një ajet kuranor thuhet:

## URDHËRO FAMILJEN TËNDE

***“Urdhëroje familjen tënde, që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë!..”*** (Ta Ha, 132)

Shembulli më i bukur, modeli më i përsosur për ne, i Dërguari i Allahut, (a.s.), kërkon prej nesh të marrim shembull jetën e tij familjare si dhe familjen e lumtur dhe të paqtë që ai edukoi me shumë dashuri.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), në folenë e tij familjare, në zemrat e fëmijëve dhe të bashkëshorteve të tij, kultivoi një lidhje të brendshme dhe një dashuri të pafundme. Asnjë burrë nuk mund ta dojë gruan e tij aq sa Resulullahu, (a.s.), donte gratë e veta. Asnjë grua nuk mund ta dojë burrin e saj aq sa e donin gratë Resulullahun, (a.s.). Asnjë evlad nuk mund ta dojë babain e vet aq sa nëna jonë Fatimja, (r.a.), e donte babain e saj. Asnjë baba nuk mund të dojë fëmijët e vet aq sa i donte Resulullahu, (a.s.), fëmijët e tij.

Ja pra, kjo është familja më e lumtur në botë. Aq sa pjesë do të mund të marrim apo të përfitojmë ne nga bota shpirtërore e kësaj familjeje të lumtur, aq do të kemi sukses në formimin e familjes sonë të dashur...

E vetmja referencë se si duhet të jetë një kryetar i suksesshëm familjeje, e një baba i përsosur është i Dërguari i Allahut, (a.s.).

Referencat e vetme se si duhet të jetë një zonjë janë Hatixhja (r.a.), Fatimja (r.a.), Aishja (r.a.), dhe nënat e tjera të umetit.

Fëmijët e atyre që mbrohen me parimet e tyre marrin nga bota shpirt-





ërrore e Hasanit, (r.a.), dhe Hysejnit, (r.a.). Fëmijët tonë janë një shkak falënderimi dhe pjesa jonë që vazhdon rrugëtimin. Janë trashëgimtarët tonë të së mirës, janë sadaka rrjedhëse për ne dhe trashëgimtarët e të drejtës dhe të vërtetës.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), për t'i edukuar pjesëtarët e familjes së vet me këto vlera është treguar shumë i kujdesshëm dhe i vëmendshëm. Në Kuranin Famëlartë përmenden urdhërat hyjnorë, fetarë dhe moral, drejtuar bashkëshorteve të Resulullahut, (a.s.), dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes së tij.

Kur u shpallën ajetet e sures Ahzab:

***“O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera.***

***Nëse i frikësoheni Allahut, mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër epshore, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme!***

***Qëndroni në shtëpitë tuaja e mos i zbuloni stolitë tuaja, ashtu siç zbuloheshin në kohën e padijes! Falni namazin, jepni zeqatin dhe bindjuni Allahut e të Dërguarit të Tij!***

***O Familje e Profetit!***

***Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t’ju pastrojë plotësisht.”*** (Ahzab, 32-33)

Pejgamberi, (a.s.), për rreth 6 muaj, kur dilte për të falur namazin e sabahut, shkonte pranë derës së Fatimes, (r.a.), duke menduar se mund të jetë lodhur gjatë punëve të ditës dhe e nxiste atë dhe krejt familjen e vet duke u shprehur:

***“Çohuni për të falur namazin o familja ime! «Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t’ju pastrojë plotësisht.»*** (Tirmidhî, Tefsîr, 33/3206.)

Resulullahu, (a.s.), ftonte anëtarët e familjes së tij për një jetë plot devocion adhurimi të farzeve dhe nafileve, kërkonte me ngulm prej tyre



që të mos prireshin mbas kësaj bote dhe që të kishin shumë kujdes hallallin dhe haramin.

## PARIMET E LARTA

Ashtu siç dihet, pranimi i zekatit ishte haram për familjen e Profetit (a.s.). Një ditë Resulullahu, (a.s.), pa hazreti Hasanin, (r.a.), i cili ishte në moshë shumë të vogël, tek merrte një hurmë nga thesari i shtetit dhe po e fuste në gojë. Menjëherë ia nxori hurmën nga goja dhe i tha:

*“A nuk e di që familja e Muhamedit nuk e ha zekatin?”* (Buhari, Zekat, 57; Ahmed, I, 200.)

Urtësia e kësaj ndjeshmërie lidhet me dinjitetin dhe moralin e lartë të Resulullahut, (a.s.), që do të shërbente si mburojë ndaj mundësisë së gabimit të kujtdo nga rrethi i tij farefisnor dhe do të pengonte prirjen e natyrshme të çdokujt për dhënien e zekatit familjes së Profetit, (a.s.).

Sa bukur e tregon kjo ngjarje nivelin e disiplinimit të Hazreti Hasanit, (r.a.), si rezultat i edukimit profetik që u realizua plot detaje të tilla delikate:

Një ditë Hasani, (r.a.), bëri tavaf Qaben, më pas shkoi tek makami i Ibrahimit, (a.s.), dhe fali dy rekat namaz. Pastaj mbeshteti faqen e tij tek makami dhe filloi të qante. Ai përsëriti disa here shprehjet:

*“O Zot, erdhi në portën Tënde robi Yt i vogël dhe i dobët; O Allahu im, erdhi në portën Tënde hyzmeqari Yt i gjorë; O Zot në portën Tënde erdhi lypsari Yt, erdhi i vetmuari Yt!”*

Më pas u largua.

Brugës hasi disa njerëz që ushqeheshin me copa të thata buke. U dha selam atyre. Ata e ftuan për të ngrënë së bashku me ta. Hasani u ul me të varfrit dhe u shpreh:

*“- Sikur ta dija që kjo bukë nuk është sadaka, do ta haja bashkë me ju.”*



Pastaj i ftoi:

“- Çohuni të shkojmë në shtëpinë tonë!”

Të varfrit morën rrugën bashkë me të. Hasani, (r.a.), i ushqeu, i veshi me rroba të reja dhe u dha para me vete. (Ebshihi, el-Mustatraf, Bejrut 1986, I, 31.)

Resulullahu, (a.s.), familjen e tij e kishte mbajtur në këtë mënyrë me parimet e moralit të përsosur. Ai (a.s.) i paralajmëronte evladët e tij që mos ta tepronin as në temat e mubahut (për të cilat nuk ka ndonjë ndalesë në Islam) dhe që mos ta lejonin zemrën që t'i falej dynjasë.

Shërbyesi i Resulullahut, (a.s.), Theubani (r.a.), shpjegon:

Kur Resulullahu, (a.s.), nisej për rrugë takohej me të gjithë anëtarët e familjes së tij, në fund linte Fatimen, (r.a.). Ndërsa kur kthehej, Fatimja (r.a.) ishte e para me të cilën ai takohej.

Resulullahu, (a.s.), ishte kthyer nga një udhëtim. Fatimja (r.a.) kishte varur një perde mbi derën e saj dhe gjithashtu u kishte varur nga një bylyzyk sermi Hasanit dhe Hysejnit. Kur Profeti Muhamed, (a.s.), i pa këto, edhe pse kishte shkuar deri aty, nuk hyri fare brenda shtëpisë së Fatimes, (r.a.).

Fatimja, (r.a.), e kuptoi se arsyeja pse Resulullahu, (a.s.), nuk kishte hyrë në shtëpinë e saj, ishin gjërat që ai kishte parë. Menjëherë hoqi perden e zbukuruar dhe bylyzykët nga duart e fëmijëve. (Ebu Davud, Teraxhul, 21/ 4213.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), me përpikërinë dhe kujdesin e treguar ndaj familjes së tij, po zbatonte praktikisht këshillat që u jepte sahabëve:

Zejd bin Eslem, (r.a.), shpjegon:

Kur u shpall ajeti:

**“O ju, që besoni!**

**Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit**



**janë njerëzit dhe gurët...”** (Tahrim, 6), sahabët pyetën:

“ - O Resulullah! Ne mund ta ruajmë veten tonë, po familjen dhe njerëzit përreth nesh si mund t'i ruajmë?!”

Resulullahu, (a.s.), u dha këtë përgjigje:

“ - Urdhëroni ata që të bëhen robër të bindur dhe adhures të Allahut, (xh.sh.). Nëse ju i pengoni dhe i largoni nga rebelimi ndaj Allahut, (xh.sh.), kjo do të thotë që ju po i mbronin ata.” (Alusi, XXVIII, 156.)

Zotëria i universit, Resulullahu, (a.s.), familjen e tij që e mbriu me këto vlera e parime të vërtetshme dhe të veçanta, ia besoi umetit të tij. Ai na la detyrë që deri në kiamet ta duam familjen e tij, ta marrim shembull dhe ta nderojmë atë duke respektuar çdo anëtar të saj. Të duash familjen e Resulullahut (a.s.);

## MIRËNJOHJA NDAJ RESULLAHUT (A.S.)

Në një hadith të Resulullahut, (a.s.), thuhet:

*“Edukojini fëmijët në tri gjëra: Në dashurinë për Resulullahun, në dashurinë për familjen e Resulullahut dhe leximin e Kuranit...”* (Munâvî, I, 226.)

Ndërsa në një hadith tjetër thuhet:

*“Duajeni Allahun e Lartmadhëruar për faktin se ju furnizon me mirësitë e Tij. Më duani mua prej se doni Allahun e Lartmadhëruar. Dhe duajeni familjen time prej se më doni mua!”* (Tirmidhî, Menâkib, 31/3789.)

Një ditë Resulullahu, (a.s.), kapi për duarsh nipërit e tij të dashur, Hasanin dhe Husejnin (r.anhuma) dhe u shpreh:

*“Ai që më do mua, këta dy dhe prindërit e këtyre dyve do të jetë së bashku me mua në ahiret.”* (Tirmidhî, Menâkib, 20/3733.)

Sahabët e nderuar, që ndoqën me dashuri këtë urdhër, kultivuan një dashuri dhe një respekt të jashtëzakonshëm për të afërmit e Resulullahut, (a.s.). Tekembramja ai që do dikë do edhe miqtë, shërbyesit, ushqimet,



rrobat e tij, pra do çdo gjë që i kujton atë. Sa më shumë rritet dashuria aq më shumë shpërndahet ajo përreth qenies që dashurohet.

Sahabët e nderuar, që e donin më shumë se veten e tyre, Resulullahun, (a.s.), kur ndonjëri prej të afërmeve të tij, hipte në kalë vraponin për t'ia mbajtur yzengjitë. (Hejsemi, IX, 348.) Ata ngaqë e dinin se në ditën e kiametit do të këputen të gjitha lidhjet farefisnore përveç lidhjeve me Resulullahun, (a.s.), dëshironin nga thellësia e zemrës të martoheshin me ndonjë të afërm të Resulullahut, (a.s.), që të kishin edhe lidhje gjaku me të. (Hejsemi, IX, 173.)

Në këtë botë sprove, vuajtjet më të mëdha i përjetojnë profetët dhe miqtë e Hakut. Edhe familja e dashur e Resulullahut, (a.s.), nuk u shpëtoi vuajtjeve dhe fatkeqësive të adhuruesve të kësaj bote. Aliu, (r.a.), u bë kalif në kohë përçarjesh dhe intrigash për të bashkuar dhe njësuar umetin. Ai u vra pabesisht nga një harixhi. Husejni, (r.a.), së bashku me familjen e nderuar të tij u ekzekutua në mënyrë makabër në një natë ashureje nga një grup xhahilësh vrastarë. Kështu u zhvillua masakra më e tmerrshme që ka ndodhur në historinë e njerëzimit. Hasani, (r.a.), u helmua edhe pse hoqi dorë nga prijësia që të mos derdhej gjaku i vëllezërve myslimanëve.

Disa lakmitarë, me ambicien e ruajtjes së postit, në shekujt e parë, kanë pasur frikë vazhdimisht nga familja e Profetit, (a.s.). Ata i sollën vuajtje të shumta dhe shqetësime pafund anëtarëve të Ehli Bejtit. Ndërsa miqtë e Allahut, ndoqën rrugën e dashurisë së sahabëve, pra rrugën e besnikërisë dhe lartësimit të Ehli Bejtit, Hazreti Aliut, Hazreti Fatimes dhe fëmijëve të tyre. Shembulli i mëposhtëm është një rast kuptimplotë:

Bishri Hafi ka treguar:

“Një natë pashë në ëndërr Resulullahun, (a.s.). Ai më pyeti:

«-O Bishri! A e di pse Allahu (xh.sh.) ta rriti vlerën ty?»

«- Jo, o Resulullah!», iu përgjigja.

Ai (a.s.) më tha:

«- Praktikimi i Sunetit tim, shërbimi ndaj vepërmirëve, këshilla dhe



*vasa që u ke dhënë vëllezërve të fesë, dashuria ndaj sahabëve dhe familjes time, të kanë lartësuar ty në gradën e salihëve (vepërmirëve).»*

Personalitete të veçantë të letërsisë islame si Fuzuli, i kanë kënduar vazhdimisht dashurisë ndaj Ehli Bejtit.

Osmanët i kanë dhënë shumë rëndësi pasardhësve të nderuar të Profetit, (a.s.), për të çuar në vend të drejtat e tyre, ata kishin ndërtuar një institucion që quhej **“nakibu’l-eshrاف”**.

Ehli Bejti, ashtu siç na tregon zbatueshmërinë e Islamit në jetën familjare në mënyrën më të bukur, na mëson gjithashtu se si duhet të jetë një familje myslimane. Familjet që janë ndërtuar me këtë nivel cilësie, kanë edukuar me mënyrën më të bukur pjesëtarët e tyre, dhe këto personalitete të edukuar kaq mirë, duke manifestuar personalitetin dhe buzëqeshjen e Islamit, kanë ndërtuar qytetërime dhe kanë ngritur shekuj lumturie dhe paqeje për të gjithë njerëzimin.

Këtë vit dita e Ashures, që është dita e dhjetë e muajit Muharrem, në të cilën ndodhi tragjedia e Qerbelasë, nga ku duhet të marrim shumë mësim, i bie me 17 dhjetor, datë kjo që përkon me Sheb-i Arusin apo ditën kur Rumi, (k.s.), ndërroi jetë.

Dita e ashures na kujton Ehli Bejtin ose afërsinë me Resulullahun, (a.s.), nëpërmjet gjakut, kurse Sheb-i Arusi na kujton afërsinë me Resulullahun, (a.s.), nëpërmjet rrugës shpirtërore, pra na kujton miqtë e Allahut, (xh.sh.).

Këtë parim afërsie nëpërmjet rrugës shpirtërore, që arrin gati të jetë i njëjtë me lidhjen e gjakut, na e ka dhënë vetë Resulullahu, (s.a.s):

Një sahab e pyeti Resulullahun, (a.s.):

“- O Resulullah, kush janë anëtarët e familjes së nderuar të Muhamedit?”

Profeti, (a.s.), iu përgjigj:



“- Familja e nderuar e Muhamedit janë të gjithë ata që i frikësohen Allahut, (xh.sh.), të gjithë të devotshmit.” (Taberani, Bejhaki.)

Resulullahu, (a.s.), në lidhje me këtë të vërtetë, ka thënë për Selman Faresiun që e kishte shumë për zemër:

**«Selmani është prej meje!»**

Ashtu siç dihet nga të gjithë, Selman Farisiu, (r.a.), ishte një i huaj që kishte emigruar nga zonat e Persisë. Mirëpo në saje të edukimit dhe përpjekjes së vazhdueshme të tij u bë një personalitet aq shembullor dhe i dashur për të gjithë sa muhaxhirët, por edhe ensarët shpreheshin në lidhje me të:

*“Selmani është prej nesh.”*

Meqë ata nuk po merreshin vesh në lidhje me përkatësinë e tij, atëherë reagoi Resulullahu, (a.s.), duke u shprehur:

*“Selmani është prej nesh, prej Ehli Bejtit (familjes) tonë!”* (Ahmed, II, 446-447.)

Duke u mbështetur në këtë transmetim, Hakim Tirmidhiu është shprehur:

“Ka dy lloje trashëgimtarësh të Resulullahut, (a.s.). Lloji i parë përbëhet nga ata që kanë lidhje gjaku me të, kurse në llojin e dytë përfshihen ata që kanë lidhje shpirtërore me të.”

Prandaj themi që të gjithë miqtë e Hakut janë trashëgimtarët shpirtërorë të Resulullahut, (a.s.).

Ta jetosh jetën me devocion dhe t’ia dalësh ashtu si Selman Farisiu, ta dashurosh Resulullahun, (a.s.), të jesh besnik dhe t’i shërbesh atij me shpirt, do të thotë të arrish lumturinë e të qenët trashëgimtar i denjë i Resulullahut, (a.s.).

Rumiu, (k.s.), që u shpreh në lidhje me Resulullahun, (a.s.): *“Unë jam pluhuri i këmbës së Ahmed-i Muhtarit (a.s.).”*, u rrit në një familje ku manifestohej qartazi personaliteti i islamit dhe në të cilën ishte mbrujtur



mirë dituria dhe urtësia. Mësimet e para shpirtërore i mori nga Mbreti i Dijetarëve, babai i tij.

Ai edukoi veten dhe fëmijët e tij si mbretër urtësie shpirtërore dhe si shembuj morali e delikatese.

Rumi, i cili rrugëtimin e tij shpirtëror e përmbledh me frazën; *“Isha i papjekur, u poqa, u dogja!”*, shkruajti shumë vepra në lidhje me «Thelbin, të fshehtën, urtësinë dhe komentimin e të vërtetave kuranore.» U dha zgjidhje problemeve dhe halleve të sa e sa njerëzve. Akoma në ditët tona veprat e tij janë ndër veprat më të lexuarat edhe në botën perëndimore, fryma e tij dashurore akoma bëhet shkak që njerëzit të gjejnë rrugën e vërtetë.

Në lidhje me kuptimet dhe fuqitë e fjalëve të miqve të Allahut të Lartmadhëruar, Rumi, (k.s.), shprehet:

*“Tingujt dhe fjalët që dalin nga zemra e miqve të Hakut janë gjallëruese si suri i Israfil.”*

Për të përfituar nga fjalët plot kuptim e urtësi të Rumiut, (k.s.), që u këndoi me gjuhë cicërimash sekreteve hyjnore po paraqesim:

## KAPITALI I VËRTETË JANË DY SY QË PËRLOTËN

*“Në pazarin e kësaj bote kalimtare kapitali kryesor është ari. Ndërsa kapitali i domosdoshëm për botën tjetër është dashuria. Janë dy sy që përlojnë (nga dashuria). Ai që shkon në pazar pa lekë në dorë e çon kohën (jetën) dëm. Do të kthehet duarbosh nga pazari.”*

Allahu i Lartmadhëruar i ka krijuar dy botët, për njeriun; ndërsa njeriun e ka krijuar për marifetullahun (njohjen e thellë të Zotit) dhe muhabbetullahun (dashurinë e thellë të Zotit). Në pazarin e mahsherit të vetmet monedha që do të pranohen do të jenë dashuria ndaj Allahut të Lartmadhëruar si dhe dhe çdo përpjekje apo djersë e lot që janë derdhur në këtë rrugë.





Loti tregon ndjeshmërinë dhe gjallërinë e zemrës. Rumi, (k.s.), na e shpjegon me shembullin e mëposhtëm rëndësinë e derdhjes së lotëve prej dashurisë e frikës për Allahun e Lartmadhëruar:

*“Aty ku ka ujë të rrjedhshëm ka edhe gjelbërim. Aty ku derdhet loti vjen mëshira dhe rahmeti i Zotit. Derdh lotë nga sytë duke nxjerr tinguj si çikriku i ujit që të të gjelbërohet kopshti i zemrës. Nëse kërkon (gjallërimin e zemrës) për lotjen e syrit atëherë ki dhembshuri për ata (që nga vuajtjet e ndryshme) nuk u thahen sytë nga lotët. Nëse dëshiron të mëshirohesh e të dhembshurohesh duhet të kesh mëshirë e dhembshuri për të dobtët e të vobektët.”*

Pengesat më të madhe në rrugën e dashurisë për Allahun e Lartmadhëruar janë egoja dhe dëshirat e ulta si dhe mendja e papërpunuar që është bërë mjet i të keqes dhe është marrë rob nga egoja.

Rumi, (k.s.), na tregon një skenë rrënjëqethëse duke iu referuar historisë së Nuhut, (a.s.), me djalin e tij Kenan që nuk hipi në anijen e ndërtuar nga i ati i tij profet:

*“Ah sikur Kenani të mos kishte mësuar të notonte, të ishte përfshirë në mirënjohjen e Nuhut, të vendoste të hynte në varkë. Ah sikur të ishte i paditur si fëmijët, ashtu siç fëmijët struken në fustanët e nënave të tyre të ishte strukur edhe Kenani në mirësinë dhe bujarinë e Nuhut, (a.s.). Sikur të mos ishte pajisur me dituri të transmetuara që nuk lidhen me shpirtin e të mos ishte bërë mendjemadh e egoist! Ah sikur të merrte dituri të shpallur nga ndonjë mik i Allahut të Lartmadhëruar!”*

## INTELEKTI I VËRTETË DHE DITURIA E VËRTETË

Rumi, (k.s.), jep mesazhe shumë të rëndësishme për kohën tonë, në të cilën mbivlerësohen dituritë që lidhen me këtë botë e nënvlerësohen dituritë e ahiretit. Sa bukur e shpreh ai faktin që dituria e privuar nga kërkimi i Allahut, (xh.sh.), e cila sillet vetëm në lëvizshmëri dhe vërtetave dhe mbetet vetëm e jashtme e me një krah, është më e keqe se injoranca



e plotë; *«Ah sikur të mbetej thjeshtë një injorant në vend që të bëhej një dijetar i thatë dhe i njëanshëm!»*

Sërish Rumi, (k.s.), në lidhje me rrugën e arritjes së diturisë së vërtetë dhe urtësisë shprehet:

*“Ne, diturinë e vërtetë, e gjejmë vetëm duke braktisur diturinë e rremë. Ne arrijmë paqen dhe prehjen e vërtetë duke mos u pajtuar me dëshirat e trupit dhe ndjenjat e epshit.”*

Rumi, (k.s.), ka thënë:

*“O udhëtar i të vërtetës! Përdore intelektin dhe inteligjencën për të blerë mahnitjen! Sepse mahnitja shtanget përballë bukurisë, fuqisë dhe artit të Hakut!”*

*Bëje intelektin kurban përballë Hazreti Mustafasë dhe thua me plot zemër; «Mua më mjafton Allahu!»*

Intelekti është një mjet që i është dhuruar njeriut dhe si çdo mjet tjetër ai mund të përdoret për mirë ose për keq. Përdorimi i intelektit për mirë lidhet me shfrytëzimin e tij brenda kornizës së shpalljes. Ky është edhe kuptimi i bërjes kurban të intelektit pranë Resulullahut, (a.s.).

Në të kundërt, intelekti do të bëhet mjet i të keqes dhe në rrugën e të vërtetës dhe dashurisë do t'i bëhet njeriut vargua. Rumi, (k.s.), për një intelekt të tillë shprehet me hidhërim:

*“Kur intelekti bëhet vargua në rrugën e dashurisë dhe të vërtetës atëherë ai nuk është më intelekt, por gjarpër, akrep.”*

Që intelektin të mbledh sërish veten, i duhet të meditojë në mënyrë të shëndetshme dhe ka nevojë gjithashtu për urtësi dhe shembuj të mirë. Rumi, (k.s.), na rikujton me shembuj sinjifikativ, faktin që nuk duhet të mashtrohemi mbas kësaj bote:

## MOS TË TË GËNJEJË PASQYRA!

*“O udhëtar, shih mirë pamjen në pasqyrë! Mendo shëmtimin e të bu-*



*kurës në pleqëri dhe rrënimin e ndërtesës ndër vite dhe mos të të gënjejë pasqyra!..”*

*“O ti që mahnitesh e shtangesh nga bukuria e pranverës! Shih edhe zverdhimën dhe të ftohtin e vjeshtës!”*

*“Dashuria që ushqen për të vdekshmit nuk mund të jetë e pavdekshme! Ti dashurohu më të vërtetën që nuk vdes, që është gjithmonë gjallë, e që i jep shpirtit shpirt!”*

*“Biri im, deri kur do të vazhdosh të jesh robi i arit dhe i sermit? Nëse detin e mirësive e të furnizimeve do ta derdhnim në një shtambë sa mund të marrë ajo? Vetëm kismetin e një dite apo vetëm ujin e një dite...”*

*Shtambat e ambiciozëve, sytë e atyre që e duan shumë dynjanë, nuk mbushen kurrë. Edhe sedefi po të mos jetë i kënaqur me çfarë ka, nuk mbushet së brendshmi me inxhi.*

*Ai që në saje të dashurisë shpëton nga nefsi dhe gris rrobën e unit, pastrohet tërësisht nga ambicia, turpi dhe e keqja.”*

*Që shpirti t’u vëjë veshin këtyre këshillave e të shtrohet në rrugën e duhur është e nevojshme që të braktisen dëshirat e ulëta të nefsit. Për t’ia dalë kësaj fillimisht duhet të njihet nefsi. Rumi, (k.s.), në lidhje me këtë temë është shprehur:*

***“Është e lehtë të thyesh një idhull, madje shumë e lehtë; mirëpo ta pëndelesh të kollajtë thyerjen e idhullit ego është injorancë, injorancë.***

***Egoja është kaq hileqare sa me një dredhi të vetme të saj fundos në detin e rebelimit qindra faraonë dhe ndjekës të tyre.”***

*Rumi, (k.s.), duke i folur njeriut për tmerrin e nefsit emmare e fton atë të mos jetë indiferent ndaj nefsit të tij.*

*Umetit i është dhënë direktiva në këtë drejtim nëpërmjet duasë që ka bërë Resulullahu, (a.s.), e që duhet ta bëjë çdo besimtar:*

*“O Zoti im! Mos më lër në dorën e nefsit tim as sa hap e mbyll sytë!”*



(Xhâmiu's-Sagîr, v. I, fq. 58.)

Resulullahu (a.s.) u bëri me dije sahabëve se lufta më e madhe është lufta me nefsën, kur të gjithë së bashku po ktheheshin nga lufta e Tebukut, e cila për nga vështirësitë është quajtur “Lufta e sakrificave”, Resulullahu, (a.s.), u shpreh; *«Po kthehemi nga lufta e vogël për në luftën e madhe.»*

(Xhâmiu's-sagîr, II, 73.)

Rumiu, (k.s.), nga njëra anë na këshillon e paralajmëron për të keqen e nefsit dhe nga ana tjetër na kultivon shpresën duke na ftuar në pjekurinë që fitohet nga përpjekja për pastrimin e nefsit dhe purifikimin e zemrës:

***“Asnjë bukë nuk kthehet më në kokrra gruri si në kohën e të korrave. Asnjë kokërr e pjekur rrushi nuk kthehet në gjendjen e tij të mëparshme. Asnjë frut që piqet në krye të herës nuk kthehet më në gjendjen e tij të papjekur. O udhëtar! Piqu mirë edhe ti në këtë rrugë e ruaje veten nga prishja e degradimi.”***

Allahu i Lartmadhëruar na ka informuar se nuk t’ia mungojë shpërblimin atyre që bëjnë mirë, që kryejnë detyrimet e të qenët rob i Zotit, në mënyrën më të mirë, me vetëdijën e ihsanit, pra duke u ndjerë të vëzhguar nga Allahu i Lartmadhëruar edhe pse ata nuk e shohin dot Atë. Duke mos qënë kurrë të sigurt nga e keqja e nefsit, të gjitha përpjekjet që do të bëhen me sinqeritet në rrugën e tasavvufit, shpresohet të mos shkojnë dëm.

Mirëpo kushti i domosdoshëm i kësaj shprese është istikameti (qëndrueshmëria dhe këmbëngulja). Të mos presësh lidhjet me dëshirat e nefsit do të thotë të mbetësh i dyzuar mes imanit dhe kufrit. Rumiu, (r.a.), shprehet:

**«PËRTËRIJE IMANIN TËND!»**

***“O ti që dëshiron të bësh gjynahe e që përtërin fshehurazi dëshirat e egos! Ti duhet të përtërish imanin! Përtërije atë jo thjeshtë me fjalë, por me zemër! Nuk përtërihet imani duke përtërirë dëshirat e nefsit e të egos, sepse bindja ndaj nefsit e epshit e mbyll, e kyç derën e Hakut.”***



Pendimi dhe istigfari nuk janë vetëm kërkimi i faljes me gojë. Teubeja për t'u pranuar duhet të plotësohen këto kushte:

1. Pendimi ose pishmanllëku për gjynahun duhet të bëhet i plotë dhe i prerë.

2. Duhet përpjekje dhe këmbëngulje në mosbërjen qoftë edhe një herë të vetme të gjynahut dhe duhet t'ia dilet kësaj.

3. Duhet të kryhen vepra të mira pas pendimit.

Jahja bin Muadh, (rahmetullahi alejh), ka thënë:

“T’i kërkosh Allahut falje për një gjynah pa e braktisur atë, konsiderohet pendim gënjeshtari.”

Rumi, (k.s.), në lidhje me këtë të vërtetë ka thënë:

*“Në fillim shkëpute fëmijën zemër nga qumështi i djallit, pastaj bëje shok atë me melekët e Allahut (xh.sh.).”*

Dhe kjo është e mundur në saje të pajisjes me cilësi të larta. Cilësitë e tilla Rumi u përmbledh duke u shprehur:

**“Bëhu si dielli në dhembshuri dhe mëshirë!”**

Ashtu siç bëhet dielli sepse, me madhështinë e tij, që t’u japë dritë, ngrohje dhe ushqim të gjitha krijesave të tokës; ashtu edhe zemra e besimtarit, në dhembshuri dhe dashuri, duhet të jetë gjithëpërfshirëse, e gjerë dhe e thellë. Ne duhet ta shohim krijimin me syrin e Krijuesit, duhet ta jetojmë mbretërinë e bujarisë pa shteruar kurrë mëshirën dhe dhembshurinë.

Duke u frymëzuar nga dielli që ndriçon edhe vendet më të errëta, Saadi Shirazi është shprehur:

“Miqte e Allahut, (xh.sh.), preferojnë të blejnë në dyqane ku nuk shkon askush.” Pra ata kërkojnë të varfrit, nevojtarët, të vetmuarit, për t’u bërë një mirësi atyre.

A mund të mendohet një diell që nuk ndriçon dhe nuk ngroh? Kë-



shu mëshira dhe dhembshuria duhet të bëhen pjesë e pandashme e besimtarit.

Resulullahu, (s.a.s), në krahët e mëshirës së të cilit ka hyrë e gjithë ekzistenca, ka këshilluar sahabët që të jenë gjithëpërfshirës në mëshirë.

**“Bëhu natë në fshehjen e të metave të të tjerëve!”**

Si një mbulesë që i hidhet kësaj bote përsipër, nata mbulon shumë të fshehta dhe sekrete. Në fenë tonë, ashtu siç është haram të analizosh të metat dhe gabimet e tjetrit, është kusht që të mos përhapet gabimi i vëllait mysliman, sepse në këtë mënyrë përhapet edhe e keqja në shoqëri.

Thelbësore në tasavvuf është mosmarrja kategorikisht me të metat e të tjerëve dhe marrja me nefsin personal në aspektin e mbajtjes nën kontroll të tij.

Mirëpo udhëzuesit që kanë pastruar nefsin, përpiqen të pastrojnë edhe nefsin e të tjerëve. Dhe këtë nuk e bëjnë përmes demaskimit të tij tek të tjerët, por duke punuar me vetë personin.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), kur shihte ndonjë gabim tek sahabët, me edukimin e të cilëve merrej çdo ditë, shprehej duke ia lënë fajin shikimit të tij:

*«Çfarë po më ndodh mua që po i shoh disa në këtë gjendje?!»*

**“Bëhu si uji i rrjedhshëm në bujari dhe zemërgjerësi!”**

Një lum që arrin toka të çara nga thatësira, me gurgullimë, vërshima dhe gjallëri, është një shembull shumë i bukur që lidhet me besimtarin bujar, i cili kërkon zemrat e nevojtarëve, i gjen ato dhe i ringjall duke u dhuruar çdo gjë atyre, pa u menduar dy herë.

**“Behu si i vdekuri në zemërim dhe nervozizëm!”**

Forca e zemërimit është një aftësi që i është dhënë njeriut për ta përdorur në emër të të vërtetës, ndaj atyre që e meritojnë, për të instaluar drejtësinë kundër padrejtësisë. Rumi, (k.s.), këshillon që të mos përdoret



zemërimi në emër të egos personale.

Heroi i Ehli Bejtit, luani i Allahut, (xh.sh), Aliu, (r.a.), teksa po luftonte për lartësimin e fjalës së Allahut Teala me një idhujtar, e shtriu atë në tokë dhe po e vriste, idhujtari e pështyu në fytyrën e tij të ndritshme. Aliu, (r.a.), ia fali jetën kundërshtarit duke u shprehur: «Në momentin që ai më pështyu, ndjeva egon të më zgjohej, dhe u frikësova se mos po e vras i nxitur nga egoja ime dhe jo për hir të Allahut Teala!» Jobesimtari i prekur nga personaliteti i Aliut, (r.a.), u nderua me hyrjen në Islam.

### **“Në modesti dhe thjeshtësi bëhu si toka!”**

Toka tregohet shumë bujare ndaj çdo gjallese që e shkelë atë çdo ditë me këmbë. Sërish toka pastron mbetjet e krijesave dhe i qeras ato me lëndë ushqyese të pastra, të shijshme dhe të shëndetshme. Edhe një besimtar duhet të mbartë cilësinë e dheut në shërbim dhe në modesti.

Duhet të mendojë që;

Toka është edhe e kaluara edhe e ardhmja e njeriut... Vendi ku shkelim çdo ditë pa menduar është aq i mbushur me fshehtësi dhe të vërteta të mrekullueshme... Ashtu siç rrinë hijet njera mbi tjetrën, ashtu edhe çdo pëllëmbë e tokës është shtresëzim i fshehtësive të pafund kalimtarëve që kanë ecur në të. Në të njejtën kohë është vendi ku do të shtohen edhe fshehtësitë e kalimtarëve të se ardhmes. Në këtë tokë të këtij trualli gjenden të gjithë të vdekurit dhe të gjithë ata që do të vijnë... Ai që e percepton saktë të vërtetën që një ditë do të jetë dheu mbi të cilin do të shkelet, a ka pse të prangoset nga mendjemadhësia dhe egoizmi?

Sa bukur shprehet Rumi, (k.s.), në lidhje me marrëzinë e mendjemadhësisë dhe vetëpëlqimit:

*“Çfarë kuptimi ka gara për të qenë mbi tjetrin, pretendimi i madhësisë? Tekembramja a nuk jemi të gjithë në portën e sarajit?”*

A nuk ka thënë Allahu:

**«O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun, kurse Allahu**



***s'ka nevojë për asgjë...»*** (El Fatir, 15) ?!

**“Shfaqu siç je ose bëhu siç dukesh!..”**

Thelbi i të gjitha fjalëve të urta është sinqeriteti.

Njësimi i së jashtmes me të brendshmen realizohet duke braktisur syfaqësinë dhe duke u vetëdijësuar për praninë e kamerave hyjnore ngado.

Kjo është domosdoshmëria e edepit (edukatës) ndaj Allahut të Larëmadhëruar që di çdo gjë, madje edhe atë që na kalon në zemër.

Ndërsa edepi është domosdoshmëri njerëzore;

### **VETËM EDUKATË, VETËM EDUKATË...**

Rumi, (k.s.), ka thënë:

*“Ai që nuk është pajisur me edukatë, nuk është njeri. Sepse ndryshimi mes kafshës dhe njeriut është pikërisht edukata.*

*Hapi sytë dhe lexo librin e Allahut, Kuranin, me kujdes! Do të vëresh që ai përbëhet nga edukata ajet pas ajeti.”*

*“Pyeta intelektin çfarë është imani, ai u përkul në veshin e zemrës dhe më pëshpëriti: «Imani është edep (edukatë)»!”*

Në lidhje me urtësitë që buruan nga shpirti oqeanik i Rumiut, kujtojmë këto fjalë të thella të hoxhës sonë Nuredin Topçu:

“Ne dëgjuam ofshamat e ekzaltimit të Rumiut. Ne nuk patem mundësi të shohim thellësitë e detit të paqes ku ai u zhyt. Por ne arritëm të shohim çfarë u duk mbi ujë.

Ne nuk arritëm të përftonim dashurinë e Rumiut, por vetëm fjalët që buruan nga dashuria e tij. Kjo është e gjitha çfarë ne arrijmë të shpjegojmë me gjuhën tonë të mangët.

Në detin e prehjes vetëm ai u zhyt. Ne na mbeti vetëm jehona e tingujve që buroi nga furtuna e ekzaltimit. Ah! Ato tinguj i pandehëm





si vetë Rumiun.”

Allahu i Lartmadhëruar na e mundësoftë të kuptojmë dhe të përfitojmë!

**Allahu Teala mos na ndaftë ne nga rruga e Ehli Bejtit, familjes më të lumtur dhe më të përsosur të edukuar nga i Dashuri i Allahut të Lartmadhëruar, nga dashuria ndaj kësaj familje pjesë e së cilës nuk mund të jemi nga prejardhja, por mund të bëhemi shpirtërisht, dhe miqve të Allahut (xh.sh.) që kane marrë energji shpirtërorë nga Resulullahu (a.s.)!**

**Allahu Teala na mundësoftë marrjen e këshillave të miqve të Tij si Rumi dhe dashuri nga dashuria e Ehli Bejtit!**

**Amin!..**





NJË JETË ME DUA

Për të qenë nga të diturit e vërtetë...



# NJË JETË ME DUA

## Për të qenë nga të diturit e vërtetë...

### E VËRTETA E PRANUAR NGA TË GJITHË

Ka një të vërtetë që pranohet nga i gjithë njerëzimi.

Këtë të vërtetë e pranojnë besimtarët, por edhe jobesimtarët...

E dinë të urtët, e dinë edhe indiferentët...

E di i riu, e di edhe i vjetri gjithashtu...

E di i varfri, e di i pasuri...

E di dhunuesi, e di edhe i dhunuari...

Kjo e vërtetë që njihet nga çdokush, është fakti që kjo botë me gjithçka ka brenda është kalimtare...

Ajetet kuranore e përforcojnë këtë të vërtetë:

***“...Çdo gjë do të shkatërrohet, përveç Fytyrës (Qenies) së Tij!..”***

(Kasas, 88)

***“Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket ”*** (Rahman, 26)

***“Çdo gjallesë do ta shijojë vdekjen.”*** (Al-i Imran, 185; Enbija, 35; Ankebut, 57)



Urtësia e theksimit dhe përsëritjes së kësaj të vërtete të mirënjohur nga çdokush, bëhet për të siguruar reflektimin e kësaj diturie në vetëdije e perceptim, në jetë dhe vullnet.

Sepse indiferenca, si gjendje larg vetëdijes, bëhet pengesë që njeriu përballë të vërtetave që i di, të tronditet dhe të frikësohet. Njeriu, vetëm kur braktis vulgaritetin e egos dhe shmanget siç duhet nga gjendja e indiferencës, hyn në gjendjen e friksimit, vigjilencës dhe trishtimit, në lidhje me fundin e tmerrshëm që e pret dhe kështu fillon e vepron me frikë dhe kujdes në çdo hap të tij.

Në një hadith fisnik thuhet:

*“Nëse kafshët do ta dinin atë që ju dini (në lidhje me vdekjen dhe ahiretin), nuk do të gjenit mish për të ngrënë në trupin e tyre. (Nuk do hanin as pinin nga frika dhe do të bëheshin kockë e lëkurë.)”* (Bejhaki, Shuabu’l-Iman, XIII, 137/10073.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), të cilit i është dhuruar miraxhi, të cilit i janë shpalosur e kaluara dhe e ardhmja në miraxh, i cili ka dëshmuar ahiretin, dënimin, llogaridhënien, grumbullimin e njerëzimit në Mahsher dhe plot ngjarje që trondisin qenien e njeriut, në një hadith fisnik ka thënë:

*“Betohem në Allahun! Sikur ju të dinit atë që di unë, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë, nuk do të flinit me gratë tuaja; do të dilnit në rrugë dhe do të kërkonit shkretëtirat për t’iu lutur Zotit me përgjërëm (që të largonte fatkeqësitë nga ju).”* (Ibn Maxhe, Zuhd, 19.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), na informoi ne në lidhje me fundin që na pret, në formë paralajmërimi. Ne ashtu siç natyrshëm e dimë se do të vdesim, dimë dhe pranojmë si rezultat i besimit tonë, gjendjet dhe ngjarjet që na presin në varr, në grumbullimin e Mahsherit dhe përtej tij. Mirëpo qëllimi i vërtetë i dijes së këtyre gjërave, është frikësimi, tronditja dhe zgjimi i robërisë ndaj Zotit, brenda nesh.



## TË DISH DO TË THOTË TË NDJESH FRIKË

Njeriu, vetëm dhe vetëm duke meditar mbi përkohshmërinë dhe duke e perceptuar mirë atë, mund t'i rezistojë prirjeve dhe sulmeve të egos.

Sepse përkohshmëria është tipar i robit. Robi është nevojtar. Ndërsa Allahu i Lartmadhëruar është i Përhershëm dhe i pa nevojë.

Njeriu që percepton dobësinë e tij;

Strehohet tek Allahu Teala duke thënë: “O Zoti im sa i madh je!”

Largohet nga egoja për tek Allahu (xh.sh.); nga shejtani vrapon tek Allahu Teala; i lutet Atij; i mbështetet Atij prej vdekjes, jetës së varrit dhe përfundimit të vet në Ahiret. Sepse e di që;

Dituria është pikërisht kjo dituri. Dituria është të dish këtë, ta bësh këtë. Pjesa tjetër është fjalë boshe, gënjeshtër. Një mësim përmendësh i kotë. Të rënditësh të vërteta dhe mos t'i fusësh ato në zemër.

Në shekujt e fundit, me rritjen e rëndësisë dhe zhvillimit të shkencave pozitive, të shkollimit, të të nxënimit dituri në aspektin e kësaj dynjaje, të informohesh dhe të grumbullosh dituri jofunksionale në aspektin shpirtëror ka tendencë të ngatërrohet me diturinë e vërtetë që Allahu, (xh.sh.), kërkon kur urdhëron: “**Lexo!**” dhe që në fenë Islame është obligim dhe e lavdërueshme.

## DITURIA ËSHTË DITURIA E NJOHJES (MARIFET)

Kur Omeri, (r.a.), ndërroi jetë Abdullah bin Mesudi, (r.a.), u shpreh:

“- Ikën nëntë të dhjetat e diturisë!”

Sahabët e nderuar, pasi dëgjuan këtë, u shprehën:

“- Në mesin tonë ka akoma shumë dijetarë!”

Ibn Mesudi, (r.a.), u përgjigj:

“- Po flisja për diturinë e njohjes (marifetit).”



Marifet do të thotë të mund ta njohësh Allahun Teala në zemër. Çdo ajet të mund të fitojë një thellësi të veçantë në zemër.

Marifeti kuptohet në raport me thellësinë e zemrës. Për shembull, një zemër që është në kapacitetin e një milingone, e percepton si oqean një pikë të vetme uji; kurse një zemër që ka fituar thellësi nga njohja e Allahut të Lartmadhëruar, i percepton të gjithë oqeanet si një pikë të vetme dhe kështu ajo shuhet dhe bëhet hiç përballë madhështisë dhe fuqisë së pafundme të Allahut të Madhëruar.

Ja pra, ky është Marifeti.

Sahabët e kishin arritur këtë njohje, prandaj ata dëgjonin dhikrin e kafshatave që hanin. Kur zbriste një ajet, sikur të kishte zbritur një sofër nga qielli, ata menjëherë ushqenin shpirtin me të dhe kështu e rrisnin nivelin e njohjes në zemrat e tyre.

Dituria e pranuar është pikërisht kjo. Kjo dituri e shpie njeriun në devotshmëri. Në suren Fatir, Allahu i Lartmadhëruar i shpreh të diturit e vërtetë:

***“...Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës.”*** (Fatir, 28)

Kjo do të thotë që të dish është shkallë devocioni.

Ai që di, ndjen frikë dhe vepron me devocion. Një dituri apo informacion që nuk pasohet nga frika apo devocioni, është thjeshtë një barrë e kotë për mbajtësin e saj. Madje:

## **BARRE GOMARI!**

Kurani famëlartë i përmend dijetarët hipokritë të pasuesve të librit, të mbetur pa dashuri dhe marifet, të privuar nga sinqeriteti dhe devotshmëria, në këtë pasazh:

***“Shembulli i atyre, që iu besua Teurati, por pastaj nuk e zbatuan atë, i shëmbëllen gomarit, që vetëm sa i mbart librat...”*** (Xhumu'a, 5)





Krahasimi me gomarin është i rëndë por aq edhe reflektues. Me të vërtetë një gomar, e mban barrën mbi vete, pa i dhënë asnjë rëndësi asaj. Sado të ketë vlerë malli që ai mban, ai nuk fiton asnje nder apo vlerë për këtë. Sepse ai është vetëm hamalli i peshës.

Kjo, për një krijesë që detyrë kryesore ka mbartjen, nuk është diçka që ia zvogëlon vlerat. Mirëpo kur njeriu, që është krijesa më e nderuar, bie në këtë gjendje, atëherë kemi të bëjmë me shpërdorimin e prirjes së natyrshme të njeriut, me keqpërdorimin e dhuntisë së tij më të lartë. Të gjitha aktivitetet për nxënien e diturisë, kur janë larg marifetullahut, larg mundësisë së njohjes së Zotit në zemër, larg urtësisë dhe larg mundësisë që zemrën e njeriut ta çojnë tek Haku, pra tek Allahu, janë keqpërdorim i prirjes së njeriut për të mësuar.

Atëherë çfarë është dituria e vërtetë?

Cila është adresa e vërtetë e aftësisë dhe dëshirës për të ditur, që i është dhuruar njeriut nga Zoti dhe cila është natyra e diturisë së vërtetë? Me çfarë cilësish duhet të mbruhet dituria e dobishme për njeriun?

Në një ajet, në të cilin jepen përgjigjet e këtyre pyetjeve, thuhet:

***“A mund të krahasohet ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet prej jetës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij (me jobesimtarin)?!***

***Thuaj: «A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?» Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!”*** (Zumer, 9)

Allahu i Lartmadhëruar në Kuranin Famëlartë, më tepër se mbi emrat e personave qëndron mbi cilësitë dhe veprimet e tyre:

Ata që besuan, ata që kryen vepra të mira, ata që u frikësuan...

Ata që mohuan, hipokritët, dhunuesit, përçarësit...

Kur shqyrtohen këto koncepte në kontekste të ndryshme, atëherë ne përftojme edhe përkufizimin e Allahut Teala në lidhje me këto koncepte.



Allahu i Lartmadhëruar duke na i sqaruar me imtësi cilësitë e njerëzve, na informon se me cilat është i kënaqur dhe me cilat jo. (Shih ajetet e para të sureve Bekare, Enfal, Mu'minin.)

Në ajetin e mësipërm, kuptimi i termave “ata që dinë dhe ata që nuk dinë” nuk është vetëm ai direkt që merret nga fjalori, “pra injorantë dhe të informuar”. Këto janë koncepte kuranore kuptimet e të cilave Allahu i Lartmadhëruar në Librin e Tij i ngarkon me nuanca specifike të veçanta. Tekefundit, nëse do të shqyrtonim ajetin kuranor në kontekstin e ajeteve përreth, do të kuptonim se çfarë kuptimi ka tek Allahu Teala dituria dhe injoranca.

## CILËSITË E TË DITURVE

1. Të mund të shoqërosh zemrën me Allahun, (xh.sh.), gjatë natës, në mënyrë të veçantë në sexhde dhe në qëndrimet në kijam në paraagim.

2. Të mund të jesh në çdo çast, në çdo gjendje dhe në çdo veprim, i frikësuar dhe i shqetësuar thellësisht në lidhje me ditën e dhënies së llogarisë; pra të jesh i vetëdijshëm për përkohshmërinë tënde.

3. Të qenët vazhdimisht në gjendje duaje duke shpresuar pafundësisht në mëshirën e Allahut të Lartmadhëruar.

Për t'u perceptuar dhe jetuar siç duhet këto tre pika, duhet të zbatohen edhe këto kushte:

a. Të jetuarit me devocion, pra një jetë që e afron robin tek Zoti çdo ditë e më shumë; Ruajtja nga veçoritë negative që largojnë brendësinë tonë nga Zoti dhe përpjekja si dhe kryerja e veprave të mira për të reflektuar tek ne manifestimet e cilësive të bukura.

b. Të qenët nga të mirët, bujar, njeri me moral të bukur dhe i vetëdijshëm që je vazhdimisht nën vëzhgimin e kamerave hyjnore.

c. Bërja e çdo përpjekjeje të nevojshme për të ruajtur zemrën nga ambiciet dhe pasionet.



d. Durimi ndaj vështirësive dhe shqetësimeve gjatë rrugës së të jetuarit të fesë dhe përhapjes së Islamit.

Ndërsa veçoritë e “atyre që nuk dinë” mund të renditen kështu:

1. Mohimi dhe mosmirënjohja;

2. Përmendja e Allahut vetëm kur janë në vështirësi dhe halle; harrimi i çdo gjëje kur bien në rehati dhe braktisja e lutjes dhe robërisë.

3. Adhurimi i dëshirave të egos dhe shoqërimi ortak Zotit duke kërkuar devijimin edhe të të tjerëve. Në një ajet kuranor thuhet:

**“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot?..”** (Furkan, 43)

Allahu i Latmadhëruar, termin “të paditur”, në disa ajete kuranore e përdor në kuptimin “mushrik (jobesimtar)”. (Bekare, 113,118; Junus, 89; Rum, 59; Xhathije 18.) Për shembull në një ajet kuranor thuhet:

**“Pa dyshim, në këtë Kuran, Ne u kemi sjellë njerëzve gjithfarë shembujsh. Por, sikur ti (Muhamed) t’u sjellësh atyre çfarëdo mrekullie, jobesimtarët me siguri, do të thonë: «Ju jeni vetëm shpifës». Ja, kështu, Allahu ua vulos zemrat atyre që nuk dinë.”** (Rum 58, 59)

Sipas komentatorëve të Kuranit, shprehja “ata që nuk dinë” synon ata që nuk dinë Hakun dhe që nuk arrijnë në njohjen e Allahut të Latmadhëruar!

Periudhës së errët dhe të dhunshme paraislame, i është thënë «periudha e injorancës». Ndërsa Resulullahu, (a.s.), Amir bin Hishamin, kryetarin e armiqve të Islamit dhe atyre që bënë çka kishin mundësi për të dhunuar dhe dëmtuar myslimanët me shumë padrejtësi e ligësi, e emërtoi «Ebu Xhehil: babai, mbrojtësi dhe koka e injorancës». Kur në fakt Ebu Xhehli sa i përket kulturës dhe informacionit në lidhje me këtë dynja, absolutisht nuk ishte injorant. Përkundrazi, në mesin e komunitetit ku ai jetonte, shquhej për inteligjencën e tij.

Sipas Kuranit dhe Sunetit, një mendje që nuk percepton Hakun,



nuk është e mprehtë dhe e zhvilluar. Dituria që nuk e njeh Atë e nuk i dorëzohet Atij edhe nëse mbush me mijëra vëllime të enciklopedisë, është injorancë.

Sepse qëllimi i nxënies është;

## ARRITJA E DITURISË SË HAKUT

**Të dish** do të thotë të njohësh madhësitinë hyjnore, fuqinë e Tij, e të marrësh pjesën tënde që të takon nga frymëzimet dhe manifestimet hyjnore.

**Të dish** do të thotë të gjesh zgjidhjen e fshehtësisë dhe përgjigjen që do të të nxjerrë nga vorbulla e dynjasë. Ndërsa përgjigjen e jep ajeti në fjalë:

*“... dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”* (Al-i Imran, 102)

**Të dish** do të thotë të zgjohesh në mëngjesin e të vërtetës duke shpëtuar nga robëria e nefsit para se të vdesësh.

**Të dish** do të thotë ta marrësh veten në llogari para se të të marrë Allahu i Lartmadhëruar në llogari.

Të gjitha dituritë përbëhen nga zbulimi dhe verifikimi i ligjeve dhe rregullave që Allahu i Lartmadhëruar ka vendosur tek qeniet dhe ngjarjet. Mirëpo t'i zbulosh dhe t'i verifikosh ato, nuk është dituria e vërtetë që e çon njeriun në urtësinë e krijimit të tij. Dituria që lartësohet dhe vlerësohet në ajete dhe hadithe nuk është kjo. Sepse të dish, nuk është vetëm të vëzhgosh. Sipas Islamit, të dish është të kuptosh shkakun e ardhjes dhe ikjes nga kjo botë, të jesh i vetëdijshëm se në mbretërinë dhe pushtetin e kujt jetojmë, të kuptosh gjuhën e gjendjes së çdo krijese, të mund të zgjidhësh një sekret duke pasur njohje të urtësisë.

Rumiu, (k.s.), njëri nga fatlumët që e ka zgjidhur këtë fshehtësi, etapën e tij të kulminacionit në dituritë e jashtme, por jo në kuptimin e afimit me Hakun, e përshkruan me fjalët «isha i papjekur»; ndërsa etapën në të



cilën ai arrin ta shijojë afrimin me Allahun e Lartmadhëruar e përshkruan me frazën «u poqa»; ndërsa etapën në të cilën atij iu manifestuan sekretet e universit, ai e përmbledh me fjalën «u dogja».

Me të vërtetë, njeriut që thellohet në dituri i shtohet dhembshuria dhe ndjeshmëria. Dituria e vërtetë e bën njeriun udhëtar në luginat e mahnitjes. Njeriu, sa me shumë që thellohet në urtësi dhe në të vërtetat e universit, aq më shumë kupton dobësinë dhe kufirin e tij dhe të qenët e tij një hiç. Pra kupton nefsin e tij. Ai që kupton nefsin e vet, kupton Zotin e vet.

**Ai që di**, njeh Pronarin e vërtetë të mbretërisë së krijimit dhe për këtë arsye ai i hap krahët e mëshirës dhe dhembshurisë ndaj të gjitha krijesave, për hatrin e Krijuesit.

**Ai që di**, fal; **ai që di**, duron; **ai që di**, dashuron. **Ai që di**, kërkon pëlqimin dhe afrimin me Zotin e tij. Prejse ka merituar gjendjet e imanit, tek ai mëshira, shërbimi dhe modestia, si fryte të imanit, sjellin një kënaqësi të veçantë.

**Ai që di**, nuk lëndon kënd dhe nuk lëndohet nga askush. Gjuha e tij shpërndan mëshirë, zemra e tij gufon mëshirë.

**Ai që di**, është vazhdimisht në gjendje meditimi dhe reflektimi në lidhje me madhështinë dhe fuqinë hyjnore të shpërndarë ngado në univers. Politesa, ndjeshmëria, delikatesa janë njësuar me të dhe janë natyra e tij e vërtetë tashmë.

## AI QË DI, ËSHTË NJERI I PËRSHPIRTSHËM

**Ai që di**, kur është i detyruar të bëjë një përzgjedhje ndërmjet ahiretit dhe dynjasë, mes pëlqimit të Allahut të Lartmadhëruar dhe njerëzve, ai zgjedh pëlqimin e Zotit. Ai nuk bie në marrëzinë e përzgjedhjes së dynjasë.



**Ai që di**, është ai që ka shpëtuar nga habitja me lojrat mashtruese të kësaj dynjaje kalimtare. Ai e nxjerr jashtë nga zemra pasurinë kalimtare.

**Ai që di**, është ai që ka shpëtuar zemrën e tij nga të qenët kasafortë dhe veten nga e keqja e famës dhe epshit.

**Ai që di**, ka një nivel aq të lartë shpirtëror sa thirrjen e pasurisë, epshit, dhe famës, e percepton si përgjigjen e Jusufit (a.s.) ndaj ftesës së ngrohtë të Zulejhasë që i tha: «hejte lek» (eja tek unë). Jusufi, (a.s.), iu përgjigj me: «Maazallah : I mbështetem Allahut!». (Shih. Jusuf, 23.)

**Ai që di**, është në përpjekje të vazhdueshme për të qenë me Allahun e Lartmadhëruar në këmbë, ndenjor, në krah, pra në çdo çast me atë që është Një.

**Ai që di**, është në përpjekje të vazhdueshme për një jetë sa më shpirtërore, për të shpëtuar nga robëria e nefsit.

**Ai që di**, gjen qetesinë dhe lumturinë në çdo vend dhe në çdo gjendje.

**Ai që di**, e konsideron veten përgjegjës për shoqërinë.

**Ai që di**, është i vetëdijshëm për amanetin që ka ndaj atdheut, popullit dhe flamurit. Sepse imani, nderi, pasuria, jeta, ruhen duke ruajtur atdheun dhe popullin.

**Ai që di**, mahnitet nga mrekullitë artistike hyjnore në univers. **Ai që di**, kupton gjuhën e universit. Sepse me atë që di, ka dëshirë të flasë çdo gjë në univers.

**Ai që di**, ka në harmoni të plotë mendjen dhe zemrën.

**Ai që di**, është në emocionin e dashurisë dhe ekstazës së imanit.

**Ai që di**, pajiset me urtësi.

**Ai që di**, arrin të shkojë nga shkaku te Shkaktari, nga vepra tek Autori, nga arti te Krijuesi.



Ai që njeh dhe di Zotin e tij në zemër, di gjithçka; ai që nuk e di, nuk di asgjë.

**Ai që di**, di që nuk di. Ai percepton hiçin e vet përballë diturisë madhështore të Allahut Teala dhe i përgjërohet Atij.

Siç është shprehur edhe një mik i Hakut:

“O Zot! Çfarë humbi ai që të gjeti Ty? Çfare gjeti ai që të humbi Ty?”

Njeriu që ka perceptuar Hakun dhe hiçin e dobësinë e vet, e di që është i detyruar të jetojë vazhdimisht në gjendje lutjeje dhe përgjërimi.

Prandaj, që të konsiderohemi nga të diturit e vërtetë, që të mund të posedojmë diturinë e dobishme, duhet që çdo etapë të jetës ta kalojmë me dua. Çdo çast të jetës duhet ta kalojmë me përgjërëm dhe lutje ndaj Allahut të Lartmadhëruar.

## NË MËNYRË TË VEÇANTË PARA AGIMIT

Në ajetin kuranor të mëposhtëm përfshihet njëra nga cilësitë e besimtarëve:

**“...ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu).”** (Dharijat, 18)

Ashtu siç u përshkruan “ata që dinë”, gjallërimi i natës është fryti më i rëndësishëm i dashurisë dhe sinqeritetit të besimtarit. Ai që pretendon se e do Zotin e tij, a mundet të flejë deri në mëngjes i shkujdesur?! Gjallërimi i paraagimit shpreh dashurinë dhe respektin e sinqertë që robi ka ndaj Zotit të tij. Ndërsa një natë që kalohet në mënyrë të shkujdesur dhe që burgoset në gjumë është një humbje që nuk zëvendësohet dhe që nuk sjell begati, ashtu si shiu kur bie në gurë, në detë, në shkretëtirë.

Ndërsa istigfari është përgjërimi për falje përpara Zotit. Edhe sikur robi të mos ketë kryer asnjë gjynah, me turpin që nuk mund ta kryej siç duhet falënderimin ndaj një mijë e një mirësive që i janë dhuruar atij, sërish ai duhet të jetë në një gjendje pranimit të dobësisë së tij përballë



Allahut të Lartmadhëruar. Për këtë arsye peygamberët kanë jetuar në një gjendje istigfari dhe duaje, edhe pse ata ishin të ruajtur dhe të falur nga gjynahet.

Edhe miqtë e Allahut të Lartmadhëruar ishin në gjendje istigfari gjithnjë. Çdo zemër që ka merituar diturinë e dobishme dhe që zotëron kuptimin e vërtetë, prekë, dëgjon dhe ndjenë që çdo gjë në tokë dhe në qiej, në përrulje të plotë ndaj kaderit hyjnor, lartëson me gjuhën e gjendjes të Plotfuqishmin dhe i përgjërohet në një formë të vazhdueshme pa u ndërprerë asnjë çast.

Ai person i cili kap me intuitë të fshehtë dhe urtësinë e universit, e di që të mbështeturit tek Allahu i Lartmadhëruar është domosdoshmëri e robërisë;

## LUTJA ËSHTË LIGJ I KRIJIMIT

**Lutja** është çelësi i derës më të lartë që i hapet Allahut të Lartmadhëruar në zemër.

**Lutja**, duke u përsëritur zë vend në shpirtin e besimtarit duke u rrënjësuar thellë, shkrihet me personalitetin duke u bërë tipar i veçantë i tij, prandaj shpirtrat e lartë jetojnë vazhdimisht në gjendje duaje. Zemrat e tyre, në lidhje më rëndësishme e përqafimit me duanë, dridhen para para-lajmërimit të Zotit në ajetin kuranor:

***“Thuaj: “Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj...”***

(Furkan, 77)

Kur universi me çdo thërmijë është në gjendje sexhdeje dhe lutjeje ndaj Allahut të Lartmadhëruar dhe njeriu, të cilit i është dhënë çdo mirësi nga Allahu Teala, ndjehet i panevojë për përgjërimin ndaj Hakut, çfarë vlere mund të ketë tek Ai?

**Lutja** është një lidhje shpirtërore ndërmjet Allahut dhe robit të Tij. Fundi i robit që e këput këtë lidhje, çfarë mund të jetë tjetër veç shkatërrimit dhe mjerimit?





**Lutja** dhe adhurimi, përgjërimi i singertë dhe robëria ndaj Zotit, janë të vetmet shkaqe që ia japin vlerën e vërtetë robit. Ndërsa duatë në gjendje përshtirshmërie janë momentet kur shpirti përqafohet me mëshirën hyjnore.

**Lutja** është të drejtuarit tonë Zotit të Plotfuqishëm duke qenë të vetëdijshëm për dobësinë tonë, përlulja jonë me qetësi dhe dorëzim ndaj pranisë së Allahut të Lartmadhëruar.

**Lutja** është thirrja për ndihmë ndaj mëshirës së Allahut të Lartmadhëruar duke pranuar të metat tona dhe nevojën tonë për Të.

Njeriu i parë Ademi dhe nëna jonë Havaja, pas gabimit të tyre që i nxori nga Xheneti, i janë përgjyruar Allahut të Lartmadhëruar dhe janë falur në mënyrë të tillë:

**“Ata thanë: «O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit».”** (Araf, 23)

Të gjithë pejgamberët që nga hazreti Ademi e deri te Resulullahu, (a.s.), qetësinë dhe freskinë nga përgjegjësia e tyre e rëndë, e kanë gjetur tek përgjërimi me zemër ndaj Hakut dhe në lutjet e singerta dhe të pranuar.

Ai që na e meson në mënyrën më të bukur duanë, përmes stilit të tij të jetesës, është i Dërguari i Allahut, (a.s.). Ai, përmes lotëve, derisa i ënjtëshin edhe këmbët, faltë namaz dhe shtonte shpesh duanë:

**“Zoti im! Strehohem ndaj zemërimit Tënd, tek pëlqimi Yt; I mbështetem faljes Tënde ndaj dënimit Tënd dhe strehohem tek Ti prej Teje! Jam i pamjaftueshëm që të të lartësoj Ty aq sa Ti e meriton, ashtu siç Ti e ke madhëruar Vetën, ashtu je.”** (Muslim, Salat, 222.) Kështu Profeti, (a.s.), i përgjyerohej Allahut të Lartmadhëruar duke pranuar dobësinë e vet. Ai në lidhje me rëndësinë dhe ndikimin e duasë është shprehur:



## LUTJA ËSHTË THELBI I ADHURIMIT

*“Lutja është adhurim. Është palca dhe thelbi i adhurimit. Tek Allahu nuk ka asgjë më me vlerë se duaaja. Allahu i Lartmadhëruar i dënon ata që nuk kërkojnë asgjë prej Tij, duke u ndjere të panevojë për lutje ose neglizhentë në bërjen e saj. Ai që kërkon t’i pranohet duaaja në vështirësi dhe ngushticë, le të bëjë dua shumë në kohë rehatie dhe bollëku. Zoti juaj është i gjallë dhe bujar, kur robi i Tij hap duart, ai nuk ia lë duart bosh. Atij që i janë hapur dyert e duasë, i janë hapur dyert e urtësisë. Lutja është çelësi i dymës të mëshirës, është arma e besimtarit, shtylla e fesë dhe nuri i qiejve dhe tokës.”* (Rudani, Xhemu’l-Fevaid, 9219-20-21-22-25.)

Me të vërtetë, gjuha e shpirtrave të lartë dhe më e bukura e fjalëve, duaaja e sinqertë, lind nga drita dhe dashuria. Shenja të vërtetësisë së fjalëve në dua dhe sinqeritetit në ndjeshmëri, janë një zemër që digjet nga zjarri i pendimit dhe një sy që derdh lot. Rumi, (k.s.), tregon sekretin e pranimi të duasë:

*“Pendohu me zemër të mbushur me zjarrin e pendimit dhe me sy të lagështitur! Tekfundit lulet çelin në vende me diell dhe lagështirë.”*

Për pranimin e duasë, një besimtar me zemër të djegur dhe syrin e lagur, duhet t’i përgjërohet Allahut të Lartmadhëruar, duke u dridhur mes frikës dhe shpresës.

Teksa gjuha bën duanë, zemra dridhet nga kuptimi dhe dëshirat që mbart duaaja. Nëse lutet për falje, duhet të jetë këmbëngulëse dhe e vendosur që mos ta bëjë më atë gjynah...

Në të kundërt, nëse nuk dilet seriozisht para Allahut të Lartmadhëruar, duaaja jo vetëm që nuk pranohet, por bëhet shkak edhe për mjerim.

Transmetohet që Profeti Musa, (a.s.), takoi një burrë që po bënte dua me përgjërime dhe duke parë situatën nga jashtë kërkoi me zemër që t’i plotësohej duaaja atij. Në atë moment Musait, (a.s.), i shpallet nga Allahu i Lartmadhëruar:



**“Unë jam më i mëshirshëm ndaj atij rob i sesa ti. Mirëpo ai, teksa më bën dua Mua me gojë, zemrën e ka të zënë me kopenë e vet të dhenve! (Për këtë arsye nuk ia pranoj duanë.)”**

Kur Musai, (a.s.), e informoi personin në fjalë për gjendjen, ai e mblodhi veten dhe iu drejtua Allahut të Lartmadhëruar me zemër të singertë.

Gjatë kërkimit të faljes, mëshirës, mirësisë, të qenët e zemrës në të njëjtën gjendje me fjalën, është nga rregullat e lutjes dhe nga kushtet e pranimi të saj.

Pranimin e duasë e lehtëson dhe e përshpejton edhe një element:

## MIRËSIA E VËLLAZËRISË

Allahu i Lartmadhëruar, që u dhuron mirësi të pamatë atyre që tregojnë kujdes ndaj çështjeve të vëllazërisë, tregohen të mëshirshëm, bujarë dhe empatik, e pranon shumë shpejt lutjen në mosprani të vëllait mysliman për vëllain e tij.

Në një hadith fisnik thuhet:

*“Nuk ka dua që pranohet më shpejt se duaja që bën vëllai për vëllain e tij pa e pasur atë pranë.”* (Tirmidhi, Birr, 50.)

Në këtë pikë, më tepër se niveli shpirtëror i atij që bën duanë, ka rëndësi sinqeriteti dhe pastërtia e zemrës së tij.

Një ditë, Maruf-i Kerhi takon në rrugë një shitës uji. Shitësi iu drejtua:

“-Pini nga uji im për hir të Allahut të Lartmadhëruar.”

Maruf Kerhi, vetëm pse shitësi përmendi shprehjen **“për hir të Allahut”**, e mori ujin dhe e piu duke prishur agjërimin e tij nafile.

Pasi Maruf Kerhi ndërroi jetë, një evlija e sheh atë në ëndërr në pozitë të lartë në ahiret dhe e pyet:



“- Për cilën vepër Allahu u tregua bujar dhe të shpërbleu kaq shumë?”

Ai iu përgjigj:

“- Për duanë që bëri shitësi i ujit, duke më kërkuar t’ia blej ujin për hir të Zotit.”

Aq sa është e rëndësishme të marrësh duatë e njerëzve që u bëhen padrejtësi apo zemërthyerve, aq është edhe e rëndësishme të mos marrësh mallkimin e tyre.

Kur mbreti Selçuk Aladin Kejkubad e kreu kalanë e qytetit, kërkoi nga i ati i Rumiut, Bahaeddin Veledit, (k.s.), që të shkonte ta shikonte për mbarësi kalanë dhe të jepte mendimin e tij për të.

Bahaeddin Veledi, (k.s.), shkoi dhe vëzhgoi ndërtimin. Ai u shpreh:

## KALATË SHPIRTËRORE

“Kalaja që ju keni ndërtuar si masë mbrojtëse ndaj fatkeqësive që vijnë nga vërshimi i ujrave dhe ndaj dyndjes së armiqve, është shumë e fortë, solide dhe e bukur. Mirëpo ndaj heshtave të mallkimit të njerëzve që shtypen dhe u bëhet padrejtësi duke qenë nën drejtimin tënd, çfarë mase keni marrë? Mos harroni që heshtat e atyre mallkimeve, kapërcejnë jo thjeshtë kalanë tuaj, por qindra e mijëra bedena kalashë, dhe e kthejnë dynjanë në rrënojë.

Më mirë ndërtoni bedena drejtësie dhe mirësie dhe përpiquni të formoni ushtri me duatë e hajrit të vepërmirëve. Këta janë burim më i rëndësishëm sigurie se muret e kalasë. Sepse siguria dhe qetësia e popullit dhe e botës realizohet përmes lutjeve të ushtarëve të duasë.”

Me të vërtetë sukseset dhe triumfet e besimtarëve, përveç përpjekjeve serioze, janë mirësi edhe e duave të singerta. Të parët tanë që nuk e neglizhonin kurrë këtë, kur dilnin për ekspeditë, përgatiteshin edhe shpirtërisht për të.



Shtyrja e luftës së Malzgirtit nga ana e Sulltan Alparsllanit për në ditën e xhuma kur do të mblidheshin besimtarët e do të bënin dua për të, dhe duaja e Sulltan Murad Hanit para se të shkonte në fushë-betejën e Kosovës: «O Zot, nëse është e nevojshme bëhem unë kurban, mjafton që fitorja të jetë e jona!», janë dy shembuj nga qindra të tillë.

Ata, kur triumfonin dhe merrnin qytete dhe zona, në kthim, ngaqë donin të merrnin duatë e fukarenjve dhe nevojtarëve, ndërtonin institucione që shpërndanin ushqim, hamame ku mund të pastroheshin njerëzit, hane për udhëtarët, çezma për t'u shuar etjen kalimtarëve. Në ditët e sotme, injorantët që nuk arrijnë të kuptojnë stilin e tyre të jetesës me qëllim kënaqësinë e Zotit në ahiret, padishahët, jeta e të cilëve kaloi mbi kalë, i përshkruajnë si njerëz të qejfit që brenda sarajeve të tyre harliseshin. Kjo është tradhëti ndaj histories, mosmirënjohje dhe përkjekjet e tyre për ta bërë këtë janë thjeshtë mjerane.

Këto janë veprimtari të neveritshme që do t'ia trazojnë eshtrat të parëve tanë në varr dhe do bëhen shkak që të na zërë mallkimi i tyre. Në lidhje me ofshamën e të dhunuarit, në një hadith fisnik thuhet:

## RUAJUNI!

*“Ruajeni veten maksimalisht nga mallkimi i të dhunuarit, sepse ndër-mjet mallkimit të tij dhe Allahut, nuk ka asnjë perde.”* (Buhari, Zekat, 41, 63, Megazi 60, Teuhid 1; Muslim, Iman, 29, 31.)

Mospranimi i një lutjeje nuk buron gjithnjë nga mungesa e sinqeritetit, nganjëherë dëshira për të cilën bëhet lutja, ngaqë nuk përshtatet me caktimin e Allahut Teala, nuk pranohet; kjo do të thotë që sevapi i lutjes në fjalë dhe përgjigjja e saj, është transferuar për në atdheun më të bukur të besimtarit, pra për në ahiret. Nganjëherë për pranimin e duasë mund të mos ketë ardhur koha e përshtatshme.



Për besimtarin, lutja është përgjërëm ndaj Allahut të Lartmadhëruar, është paraqitje e gjendjes te Ai, është pranim dhe dorëzim. Atëherë është e domosdoshme që të jemi të dorëzuar si në rast pranimit të lutjes, ashtu edhe nëse lutja nuk na pranohet.

Rumiu, (k.s.), urtësinë e kësaj e tregon simbolikisht me këtë histori:

*“Ka sa e sa persona të sinqertë, duatë e të cilëve nga përlojtja, sinqeriteti dhe vuajtja e tyre e brendshme, arrijnë deri në qiej! Për këtë melekët i luten Allahut të Lartmadhëruar:*

*«O Zoti ynë që pranon çdo dua! Robi Yt besimtar të përgjërohet dhe të lutet; nuk njeh e nuk di asnjë krijesë ku mund të besojë dhe ku mund të mbështetet përveç Teje! Ti shfaq mirësinë Tënde edhe ndaj atyre që nuk të njohin Ty e që janë të huaj ndaj Teje; çdo njeri që ka një nevojë apo dëshirë, tek Ti e shpreh! Pse nuk e pranon lutjen e këtij robi? Cila është urtësia?»*

*Allahu i Lartmadhëruar u përgjigjet melekëve:*

*«Unë nuk e shtyj pranimin e duasë së robit Tim besimtar për arsye të përçimit apo për shkak të gabimeve të tij. Në vonesën e plotësimit të dëshirës së tij, ka mirësi dhe ndihmë për të!*

*Nevoja e zgjoi nga indiferenca atë; nevoja e mori atë për dore ngadalë dhe e solli tek Unë; e solli në praninë Time kur ai nuk më mendonte Mua dhe nuk kujtohej për Mua. Nëse ia heq nevojën duke ia pranuar duanë, ai më harron sërish dhe kthehet si një fëmijë në lojën e vet!*

*Ai më përgjërohet me dhimbje duke më thirrur ‘O Zoti im!’, duke qarë e duke ofsharë me plagë në shpirt e me zemër të thyer, por Mua më pëlqen shumë teksa ai m’i shpalos vuajtjet dhe sekretet e tij me ofshama dhe thirrje ‘O Zot, o Zot!’.»*

Natyra e njeriut është e tillë që shfaq teprime dhe mungesa, në temën e duasë ka tendenca për ta kapërcyer masën.

Në lidhje me këtë çështje, në një ajet kuranor bëhet paralajmërimi:



## ALLAHU I LARTMADHËRUAR NUK I DO ATA QË E TEPROJNË

***“Lutjuni Zotit tuaj përulshëm dhe ngadalë! Njëmend, Ai nuk i do ata që e kalojnë kufirin.”*** (Araf, 55)

Duatë që bëhen për arsye ceremonie, me syfaqësi, duke qenë në rol, me fjali ku nuk përfshihet zemra, më bertitje gjoja emocionale dhe me fjalë plot pompozitet, nuk pranohen.

Këto nuk kanë për qëllim thirrjen e mëshirës hyjnore, por prekjen e xhematit, dhe kur nuk janë të sinqerta e bëjnë përgjegjës personin sepse kështu dobësohet thelbi, pjesa shpirtërore dhe shenjtëria e duasë.

Resulullahu, (a.s.), në lidhje me ata që bëjnë dua në mënyrë të tillë, ka thënë:

*“Do të vijë një grup që do ta kalojë kufirin në dua.”*

Kështu Resulullahu, (a.s.), e ka paralajmëruar umetin e tij në lidhje me këtë temë. Ndërsa në një hadith tjetër fisnik ai ka thënë:

*“Ju nuk po i bëni lutje një shurdhi. Po i përgjëroheni një Zoti që është shumë afër jush dhe që dëgjon.”* (Buhari, Xhihad, 131.)

Nuk duhet ta harrojmë që nderin dhe respektin e vërtetë të të qenët njeri, mund ta arrijmë duke na u falur gjynahet. Ata që dëshirojnë të arrijnë sekretin e faljes së përjetshme pas vdekjes dhe që kërkojnë të shijojnë mirësitë e pafundme të Hakut, duhet të jenë në përpjekje të vazhdueshme me lutje dhe përgjërime...

I lutemi Zotit të mëshirshëm që ka fuqi supreme, që të na mëshirojë dhe të derdh mbi ne mirësitë e faljes.

**O Zot na ruaj ne nga të qenët indiferent, budallenj dhe injorantë. Na bëj ne nga robërit e Tu «të ditur» që e ndriçojnë natën e tyre me dua dhe istigfar dhe që bëjnë një jetë me lutje, adhurim dhe frikë ndaj ahiretit...**



**O Zot, mbështetemi tek ti nga nefsi që nuk ngopet, nga dituria e padobishme, nga zemra që nuk dridhet dhe nga duaja që nuk pranohet. Na ruaj nga e keqja e egos tonë, na dhuro dituri të dobishme, na e shto dridhjen e zemrës sonë dhe na e afro pranimin e duave tona!..**

**Amin!**





# NJË JETË ME QENDËR KURANIN DHE SUNETIN

Shpëtimi nga krizat e sistemeve njerëzore...



# NJË JETË ME QENDËR KURANIN DHE SUNETIN...

Shpëtimi nga krizat e sistemeve njerëzore...

## DREJT XHENETIT...

Vullneti hyjnor...

Allahu i Lartmadhëruar e krijoi njeriun në Xhenet. Ademi dhe Havaja u mashtruan nga kurthi i shejtanit dhe duke mos u bindur, ranë në gabim. Vullneti hyjnor dëshiroi që njeriu në jetën e kësaj bote t'i nënshtrohet provimit dhe si rezultat të meritojë xhenetin ose xhehnemin. Pra;

Dërgimi i njeriut në udhëtimin e vështirë të kësaj dynjaje, ka për qëllim fitimin e xhenetit dhe arritjen e tij në pjekurinë që të meritojë mirësitë e xhenetit.

Jeta e kësaj bote për peygamberët dhe trashëgimtarët e tyre, miqtë e Hakut, përmbledhet shumë bukur në këto fjalë të zotërisë së peygamberëve, udhëzuesit të evlijave, zotërisë së universit, Resulullahut, (a.s.):



*“Unë në jetën e kësaj bote jam si një udhëtar që është ulur nën hijen e një peme për pak kohë, më pas e braktis atë me mjetin e tij udhëtues.”*

(Tirmidhi, Zuhd, 44/2377.)

Marrëdhënia me jetën e kësaj bote që kishte i Dërguari i Allahut dhe ata që e ndjekin me sinqeritet atë, tregohet qartazi në ngjarjen që vijon:

Një ditë, Ebu Bekrit, (r.a.), i sollën shërbet mjalti për të pirë. Kur e afroi në gojë shërbetin, filloi të qante. Edhe të tjerët pranë tij u përplotën. Kur u pyet për shkakun e lotëve, Ebu Bekri, (r.a.), u përgjigj:

“(Një ditë) Isha me të Dërguarin e Allahut, (s.a.s). Në atë çast vërejta Resulullahun, (a.s.), që po largonte diçka nga vetja dhe po i thoshte: *«Largohu prej meje! Largohu prej meje!»*, mirëpo unë nuk po shihja asgjë pranë tij. Kur kërkova të informohesha në lidhje me situatën, Resulullahu, (s.a.s), më tha:

*«M'u paraqit e tërë dynjaja me gjithë qenien e saj. (Kërkoi prej meje që t'i përulesha asaj.) Asaj i thashë: 'Largohu prej meje!' Ajo u largua duke më thënë:*

*'Betohem në Allahun, edhe nëse largohesh e shpëton prej meje, ata që do të vijnë pas teje s'do të mund të largohen dot nga unë.'»*

Pastaj Ebu Bekri (r.a.) vazhdoi bisedën duke thënë:

“-Ja pra, unë pata frikë nga kaplimi i dashurisë për këtë botë, për këtë arsyë u përplota.” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 30-31.)

Ata dridheshin me perceptimin e kësaj të vërtete:

Për llogarinë që do jepet jo vetëm për filxhanin me shërbet mjalti dhe gotën e ujit, por edhe për çdo frymë... Për llogarinë se ku harxhohen ato... Për llogarinë që do jepet për falënderimin dhe mirënjohjen, pra nëse janë kryer si dhe sa duhet... Për ndarjen e të mirave me nevojtarët...

Sepse në një ajet kuranor thuhet:

***“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!”*** (Te-

kathur, 8.)



Është domosdoshmëri heqja dorë nga jeta e kësaj bote me vetëdijen se çdo gjë që vjen dhe kalon në jetën e kësaj bote është thjesht një material provimi, dhe se udhëtarët e jetës së vërtetë, ahiretit, nuk duhet ta lidhin zemrën me mirësitë e kësaj bote.

Kjo botë është skena e provimit ku do të ndahen ata që kërkojnë Hakun dhe meritojnë xhenetin, me ata që jepen pas qejfeve dhe rehatisë së gjërave kalimtare të saj. Kësaj bote i është dhënë një forcë e ulët joshëse që i flet egos së njeriut.

Ndërsa peygamberët i ftuan njerëzit që të mos mashtrohen nga kjo joshje dhe që ata të kërkojnë rrugën e xhenetit- atdheut të tyre të vërtetë. Ua kujtuan atyre se jeta e vërtetë është jeta e ahiretit. I paralajmëruan që të mos koteshin dhe binin në indiferencë në stacionet kalimtare të kësaj rruge, të mos mashtroheshin dhe habiteshin.

Historia e njerëzimit është përmbledhja e përgjigjeve pozitive apo negative që bashkëkohësit i kanë bërë ftesës së profetëve.

Kur popujt i janë përgjigjur pozitivisht ftesës së peygamberëve dhe janë orientuar drejt pëlqimit të Hakut dhe kanë ecur në rrugën e drejtë gjatë udhëtimit të kësaj bote, kanë arritur si individë apo qytetërime qetësi xheneti në këtë dynja dhe në ahiret kanë arritur si xhenetin edhe bukurinë e Allahut të Lartmadhëruar.

Mirëpo kur popujt nuk ia kanë vënë veshin dhe zemrën ftesës së profetëve dhe kanë vepruar në kundërshtim me pëlqimin dhe kënaqësinë e Hakut, janë përballur me një fund të shëmtuar, të errët dhe të tmerrshëm në të dyja botët.

Lumturinë dhe qetësinë njerëzimit ua sollën të dërguarit e Allahut të Lartmadhëruar, profetët e Tij. Ndërsa mohuesit që ia kthyen shpinën shpalljes dhe kundërshtuan profetët, e çuan njerëzimin vetëm në kriza dhe mjerim, veçanërisht;



## UDHËZUESIT E RREMË...

Përveç pejgamberëve dhe trashëgimtarëve të tyre, pra miqve të Hakut, një grup filozofësh, dijetarësh dhe burrash shteti, hodhën disa teori apo vendosën disa sisteme njerëzore me moton “Për lumturinë e njerëzimit.” Disa prej tyre patën edhe ndjekës të shumtë. Disa gjetën fushën, forcën dhe mundësinë e aplikimit të teorive të tyre. Mirëpo asnjë nga këto sisteme njerëzore nuk solli qetësinë dhe lumturinë e premtuar.

Komunizmi që i premtoi njeriut barazi dhe mirëqenie, u ndërtua mbi kokat e njëzet milion viktimave. Si përfundim, falimentoi materialisht dhe shpirtërisht, e u shemb vetvetiu duke lënë njerëzit në mjerim.

Ideologji të ndryshme si fashizmi dhe nazizmi, të cilat u ndërtuan me vizionin e shkatërrimit të popujve të tjerë dhe lumturimin e një race, u fundosën në gjakun dhe lotët e miliona viktimave.

Edhe kapitalizmi që i premtoi individit pasuri dhe mirëqenie, vazhdimisht të pasurin e pasuroi më shumë dhe të varfrin e varfëroi më tepër. Duke përdorur reklamat dhe propagandat e tregoi çdo gjë ndryshe nga ç’ ishte realisht. I ktheu masat në robotë që u shërbejnë vetëm qëllimeve të kapitalizmit. Sistemi kapitalist edhe pse akoma nuk është shembur, ka marrë trajtën e një të sëmuri me kriza të vazhdueshme.

Liberalizmi u shfaq me filozofinë “Lërinë të kalojnë, lërinë ta realizojnë...”, pra pa u dhënë rëndësi atyre që ngelin poshtë dhe shtypen. I shembi të gjitha pengesat fetare, morale, juridike dhe zakonore përballë çmendurive të egos, i dha shejtanit dhe nefsit një liri absolute duke futur zemrën dhe shpirtin në robërimin e tyre. Si përfundim, u shemb familja... morali u plagos...dhe në shoqëri nuk ngeli askush për t’ia kujtuar të tjerëve të vërtetën, mirësinë dhe të bukurën.

Atij që përhapri të keqen iu tha: «Je i lirë!», ndërsa ndaj atij që u kujtoi njerëzve të mirën dhe dëshiroi t’i largonte nga e keqja, u mbajt një qëndrim kritik duke iu thënë: «Mos u impono!».



Siç shprehej Nexhip Fazëll:

«U lidhën gurët dhe u lanë të lirë qentë!..»

Epikuri, i cili lumturinë njerëzore ua njësoi njerëzve me kënaqësinë dhe Frojdi, i cili ua njësoi me epshin, njerëzimit përveç dhimbjes, depressionit dhe fatkeqësisë, nuk i sollën asgjë tjetër njerëzimit. Ata që u njohën si të ditur dhe që u mbështetën tërësisht nëpër kooptinat e zeza e plot pluhur të librave të filozofisë të cilat kishin ngelur nëpër rafte, arritën t'i sillnin njeriut vetëm shqetësim dhe ankth.

Ndërsa dëshmitarët më të rëndësishëm të kësaj të vërtete, nga e kaluara në ditët e sotme, u bënë rrënojat mbi të cilat sot këndojnë sikur vajtojnë bufat...

Në kohët tona, në shumë vende të botës gjenden rrënoja historike dhe mbetje të qyteteve antike. Shumë prej tyre, që janë groposur në tokë, në rrërë dhe në fundin e detrave, janë nxjerrur në sipërfaqe. Qindra dhe mijëra turistë me kureshtje të veçantë bëjnë udhëtime të shumta për të vëzhguar këto gjurmë që ka lënë njerëzimi në të kaluarën.

Duhet pasur parasysh se Kurani famëlartë na fton që t'i shohim këto rrënoja me qëllim nxjerrjen mësim prej tyre.

Në një ajet kuranor urdhërohet:

## SHËTITNI DHE SHIHNI

***“Para jush kanë kaluar shumë shembuj (popujsh nga ndjekësit e profetëve që iu ndodhi ajo që po ju ndodh edhe ju). Prandaj udhëtoni nëpër botë dhe shihni si ishte fundi i atyre që i përgënjeshtroan profetët.”***

(Al'Imran, 137)

Historia është një pjesë teatrale që vendoset në skenë sa e sa herë. Aktorët mund të ndryshojnë, por skenari është gjithnjë i njëjtë. Mijëra vite përpara, ata që nuk i besuan Ibrahimit, (a.s.), dhe Musait (a.s.), dhe ata që përgënjeshtroan këta profetë, Nemrudi dhe faraonët, patën të



njëtin fund me Ebu Xhehlin dhe Ebu Lehebin, të cilët e shqetësuan dhe e fyen të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Edhe nesër përfundimi i atyre që do shfaqin armiqësi ndaj Allahut Teala, do të jetë i njëjtë. Pra provimi është gjithnjë i njëjtë.

Kamxhiku i dënimit hyjnor që ra mbi të padrejtët, është ai që përshkruhet në ajetin kuranor:

***“prandaj Zoti yt lëshoi mbi ata kamxhikun e dënimit.”*** (Fexhr, 13)

Kurani fisnik, atyre që pyesin për të ardhmen, si përgjigje u tregon të shkuarën.

Si shembull për kapitalistët dhe materialistët, të cilët i besuan materies dhe teknikës, adhuruan forcën dhe u mashtruan prej saj duke u bërë të padrejtë dhe të pamëshirshëm, u tregohet se para shumë shekujsh popujt e Adit dhe Themudit me artin e tyre gdhendnin malin dhe e kthenin në kështjella, mirëpo fundi i tyre ishte:

***“Kurse ata që bënë të këqija, i kaploi një zë i tmerrshëm dhe në shtëpitë e tyre u gdhinë të vdekur e të palëvizshëm”*** (Hud, 67)

Ja pra fundi i faraonëve mendjemëdhenj dhe arrogantë që robëronin njerëzit...

Humbja dhe fundosja në fundin e detit përballë Musait (a.s.) që nuk zotëronte asgjë tjetër përveç bastunit...

Fundi i Karunit i cili me arrogancë pandehte që malli dhe pasuria e Zotit janë të vetat...

***“Ne bëmë që Karunin dhe shtëpinë e tij t’i gëlltiste toka...”*** (Kasas, 81)

Fundi i popullit të Nuhut, (a.s.), që tallej me fenë, peygamberin dhe dënimin e Allahut Teala:

***“Ata e quajtën gënjeshtar Nuhun. Kështu që Ne shpëtuam me anë të barkës atë dhe të gjithë njerëzit që ishin me të, ndërsa ata që i mohuan shpalljet Tona, i fundosëm. Ata qenë vërtet një popull i verbër.”*** (Araf, 64)





Populli i Lutit, (a.s.), të cilët ranë në gradën fatkeqe të të qenët të parët e imoralitetit:

***“Kur erdhi urdhri Ynë, Ne e përmbysëm çdo gjë, - ato që ishin lart, i kthyem poshtë dhe mbi ata lëshuam gurë nga balta e pjekur, duke rënë vazhdimisht, si shiu.”*** (Hud, 82)

Fundi i “popullit të së shtunës”, të cilët me hile i iknin urdhrit të Allahut Teala dhe nuk kryenin obligimin e largimit të njeri-tjetrit nga e keqja:

***“Por, kur e harruan atë për të cilën ishin paralajmëruar, Ne i shpëtuam ata që këshillonin, kurse i ndëshkuam ashpër keqbërësit, për shkak të mosbindjes së tyre.”***

***“Kur ata ngulmuan me mendjemadhësi të bënin atë që u ishte ndaluar, Ne u thamë: «Bëhuni majmunë të përbuzur!».”*** (Araf, 165-166)

Gjithashtu, në një ajet kuranor thuhet:

***“Ne i kemi nisur të dërguarit Tanë njëri pas tjetrit. Sa herë që një i dërguar i shkonte ndonjë populli, atë e quanin gënjeshtar! Prandaj Ne i kemi bërë ata (popuj) të ndjekin njëri-tjetrin (në shkatërrim) dhe i kemi bërë histori që rrëfihen.”*** (Mu'minun, 44)

Pika e përbashkët e të gjithë këtyre sistemeve njerëzore që u shembën dhe u shkatërruan, është të qenët e tyre larg shpirtërores.

## TË PRIVUARIT NGA KUPTIMI...

Pika e tyre e përbashkët është mosmarrja në konsideratë e shpalljes...

Të qenët e tyra pa shpirt, pa kuptim, pa dritë, pa dashuri...

Të qenët e tyre materialistë, pragmatistë...

Këto ideologji që ne përmendëm, edhe pse duken të kundërta me njëra-tjetrën, janë kopje të njera-tjetrës për sa i përket privimit dhe ndëshkimit...



Komunizmi, kapitalizmi, nacionalizmi...

Komunizmi dhe socializmi deklamonin se «pasuria është e popullit». Por vendin e të pasurve e zunë një grup njerëzish të pavlerë që shprehehin së po vepronin në emër të popullit. Kështu nuk u formua një shoqëri me drejtësi, ndërgjegje dhe mëshirë, vlera të cilat burojnë nga besimi tek Zoti dhe ahireti.

Kapitalizmi pretendoi se «pasuria është e individit» dhe se njerëzimi mund të garojë në liri të plotë. Mirëpo ndodhën shumë krisje sociale, kriza, ndarje, prej mungesës së mëshirës dhe solidaritetit. Gara ishte mes të pasurve dhe garohej për shtypjen e të varfërve.

Nacionalizmi trumbetoi përkatësinë e pasurisë dhe pushtetit për vetëm një racë. Ai u bë shkak për mendjemadhësi kolektive dhe padrejtësi.

Asnjëri prej tyre nuk arriti të thoshte:

“Pasuria dhe pushteti janë të Zotit! Njeriu është një amanetqar që duhet ta përdorë pasurinë dhe pushtetin e Zotit, me kushtet që vetë Ai ka vendosur. Allahu i Lartmadhëruar i sprovon njerëzit dhe popujt duke i shpërndarë të mirat e Tij në mënyrë të pabarabartë, dhe si rezultat i pasuri është përgjegjës për të varfrin, i dituri për të paditurin, pra çdo person të cilit i është dhuruar diçka është përgjegjës për tjetrin, çdo njeri është nevojtar për tjetrin.”

Sepse për të arritur në këtë thënie duhen gjokse të mbushura me besim, dhe duhen zhvilluar vlera shpirtërore si mëshira, sakrifica, empatia, bujaria dhe të tjera si këto.

Në territoret islame ku janë mbajtur të gjalla këto parime shpirtërore, janë përjetuar kohë të tilla kur të pasurit nuk gjenin dot të varfër për t'u dhënë zekatin. Qëndrimi larg shpenzimit dhe të jetuarit me kujdes dhe me masë, afroi të pasurit me të varfrit. Jeta modeste, të qenët të kënaqur dhe në një gjendje pëlqimi me kaderin e tyre, afroi të varfrit me të pasurit. Zekati, dhurimi dhe vakëfet ndërhyjnë menjëherë për të sistemuar një



dramë të caktuar që përjetohej në shoqëri. Me vetëdijen e vëllazërisë, u ndanë problemet materiale dhe shpirtërore, kështu u ndërtua një qytetërim i lidhur me dashurinë dhe i njësuar si një trup i vetëm.

Si u sigurua ky nivel kaq i lartë dhe ky rregull i përsosur?

## PREJ INJORANCËS NË EPOKËN E LUMTURISË...

Katërmbëdhjetë shekuj më përpara, bota ishte në errësi të plotë privimi nga drita e kandilave të profecisë. Kishte kaluar shumë kohë nga largimi i Isait, (a.s.), dhe botës nuk i kishte ardhur akoma një peygamber tjetër. Njerëzimi po priste me padurim ardhjen e Zotërisë sonë. Kjo kohë emërtohet periudha e injorancës...

Zotëria ynë erdhi dhe për 23 vite shpalljeje, me personalitetin që shfaqti, me moralin që jetoi, me mesazhet e shpalljes së Kuranit dhe Sunetit, me sahabët që edukoi dhe me qytetërimin e virtyteve që ndërtoi, **e mbylli epokën e injorancës dhe hapi periudhën e lumturisë.**

Para se Resulullahu (a.s.) të vinte në jetën e kësaj bote, ekzistonin e drejta romake, qytetërimi bizantin, filozofia greke, traditat zoroastriane të Iranit dhe sisteme të tjera besimore të ngjashme që ishin krijuar nga njeriu ose deformuar nga ai. Drita e Islamit ua humbi shkëlqimin atyre dhe bëri që t'u binte maska.

Njëri nga themeluesit e mendimit të Revolucionit Francez, filozofi **La Fayette**, u ndie i detyruar të thoshte:

“O njeri i lartësuar dhe i madh! Sado që të të admirojmë, është pak! Ti ke gjetur drejtësinë e vërtetë. (Deri sot asnjë njeri nuk ka arritur të instalojë drejtësinë si ti.)”

Një mendimtar tjetër perëndimor, Thomas CARLYLE, ka thënë:

“Asnjë mbret që shëtiste me kurorën e tij, nuk u nderua dhe vlerësua dhe as pati dinjitet sa Muhamedi i cili arnonte vetë rrobën që mbante veshur.”



Edhe jomyslimanët ngelën të mahnitur nga edukimi që Profeti, (a.s.), iu dha sahabëve të nderuar.

Sahabët e nderuar, për të shuar errësirën e injorancës nëpër botë dhe për të përhapur dritën e imanit, u shpërndanë në çdo anë, nga oqeani Atlantik deri në Kinë e në Indi. Kështu në botë u ndërtua një qytetërim islam virtytesh në sajë të Omer bin Abdulazizëve, Alparsllanëve, Salahadin Ejubëve, Këllëçasllanëve, Fatihëve, Javuzëve dhe sulltan Sulejmanëve.

Mirëpo kur umeti u largua nga drita e profecisë, atë e pushtoi sërish errësira e injorancës dhe u përhapën ideologji, produkte të mendjes së hutuar, të cilat janë në shërbim të egos njerëzore. Fatkeqësisht shumë mysllimanë u ndikuan nga këto rryma ideologjike.

Nga periudha e Tanzimatit deri në ditët e sotme, të rinjtë që u derguan në Europë për t'u pajisur me dituri pozitiviste, u ndikuan nga kjo rrymë dhe harruan vlerat e besimit të tyre. Ata u kapluan nga mendimet primitive dhe filluan ta shihnin umetin e Islamit me përçmim, duke u armiqësuar me vëllezërit e tyre mysllimanë. Me idenë e lirisë së tepruar, rregullat e etikës dhe moralit filluan t'i perceptonin si vargonj prej të cilëve njeriu duhet të shpëtojë. Me vizionin materialist dhe kapitalist, jetën e njeriut filluan ta perceptonin si një përleshje të egër për pasuri, epsh dhe pozitë.

Familja u trondit dhe shpirti vëllazëror u plagos. U godit për vdekje mëshira në zemrën e njeriut. Dhe shkatërrim pas shkatërrimi, nga një perandori që shtrihej në tre kontinente, me vështirësi u shpëtua territori që kemi sot. Përpjekjen për shpëtim në Çanakkale dhe në luftën e Istiklalit e realizuan heronjtë e besimit të cilët vendosën jetën në rrezik për Allahun, (xh.sh.), Kuranin, fenë, nderin, atdheun, njësimin dhe vëllazërinë.

Ata që nuk e shohin këtë të vërtetë siç është, nuk shohin që:

Tek pasardhësit e osmanëve, në territorin e tyre, po hedhin valle ideologji primitive të shumta. Madje në raport me të kaluarën, sot këto ideologji janë kanceroze dhe tinzare;



## TINZISHT...

Në ditët tona ndjehen pafund ftesa tinzare që i bëhen njeriut prej ngado...

Në raport me të djeshmen, sot janë shtuar mjetet e influencës si televizioni, kinemaja, filmat, telenovelat, interneti si dhe veprat artistike të cilat janë burim joshjeje për të rinjtë.

Për ku ftohen këta të rinj?

Ata ftohen që kapitalin kryesor të ahiretit, jetën, ta harxhojnë në argëtim, në gjynah, me ideologji të shtrembëruara me përvetësimin e një diturie të akullt dhe pa respektuar kufinj, hallall dhe haram, në një liri të shfrenuar.

Ftohen drejt vulgaritetit.

Drejt egos.

Drejt unit, interesit dhe pragmatizmit.

Drejt mendjemadhësisë, vetëpëlqimit dhe paraqitjes së forcës.

Ftohen drejt një niveli që qëndron më poshtë se kafshët, «bel hum edall».

Fillimisht boshatisen e pastaj mbushen.

Bëhet një përpjekje e madhe që fëmijët e myslimanëve të jetojnë pa xhami dhe pa ezan, pa besim, pa adhurim, pa vetëdije, pa edukatë; duke qenë fizikisht fëmijët e prindërve të tyre, por shpirtërisht ndjekësit e shejtanit dhe ndjekësve të tij. Punohet që tek fëmijët dhe pasuria e njerëzve të bëhet ortak shejtani. Thirrjet mbytëse të iblisit tentohet t'i shfaqen të rinjve si argëtim. Bëhen përpjekje që njerëzit të zhyten në disa premtime boshe dhe larg të vërtetës.

Të gjithë jemi të shqetësuar nga këto rryma negative.

Edhe familjet e besimtarëve preken nga këto thirrje çoroditëse.



Sepse televizionet bëjnë propagandë vazhdimisht në çdo shtëpi. Sepse interneti në mënyrë të dukshme dhe të padukshme ndërton kurthe në çdo shteg. Mungesa e përshtirshmërisë është gangrenë për shumëkënd...

E kështu, e vërteta përballë së cilës ndodhet dynjaja është:

### RINGJALLJA E INJORANCËS...

Ilaçi i inyorancës, si dje edhe sot, ka qenë dhe është drita e Islamit. Është udhëzimi i Kuranit. Është mbushja me energjinë shpirtërore të Resulullahut, (a.s.), përvetësimi i gjendjeve të tij dhe grumbullimi rreth sunetit të tij të nderuar.

Resulullahu, (s.a.s), në hadithet e tij të nderuara, të gjitha fatkeqësitë që do të ndodhin në fundin e kohës, i ka ditur dhe na i ka treguar duke na paralajmëruar:

*“Po ju lë dy gjëra. Nëse kapeni fort pas tyre, nuk do ta humbisni rrugën:*

*Librin e Allahut, (xh.sh.), (Kuranin Famëlartë) dhe Sunetin e Resulullahut, (a.s.).” (Muvatta’, Kader, 3.)*

Për fëmijët që janë edhe e ardhmja e shoqërisë, Resulullahu, (a.s.), na tërhequr vëmendjen duke na sugjeruar:

*“Edukoni fëmijët në tri çështje:*

*Dashurinë për Profetin, dashurinë për Ehli Bejtin dhe leximin e Kuranit...*

*Sepse mbajtësit e Kuranit (hafizët), në ditën e kiametit kur nuk do të ketë asnjë hije, do të jenë nën hijen e Arshit bashkë me Profetin dhe të shpëtuarit.” (Munavi, I, 226.)*

Dihen anët negative të kësaj bote dhe të kësaj kohe ku jetojmë. Plot fatkeqësi...

Nëse fëmijët tanë i pajisim me masa shpirtërore dhe materiale, ia



bëjmë të dashur të mirën dhe ia neverisim të keqen, atëherë me ndihmë të Zotit do ta kenë të mundur të largohen nga negativiteti me të cilin do të përballen.

Jusufi, (a.s.), larg prindërve të tij, i gjendur pas dyerve të kyçura, u përball me ftesën e shëmtuar të zonjës së shtëpisë, skllav i së cilës ishte. Por Hazreti Jusufi, (a.s.), i edukuar në duart e një profeti, pa argumentin e Zotit dhe e refuzoi ftesën e shëmtuar duke iu mbështetur Allahut të Lartmadhëruar dhe duke u shprehur: “Meaza Allah!”.

Edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), në saje të edukimit të Zotit dhe hapjes së zemrës, nuk u ndot nga asnjë gjë e nevertishme dhe e shëmtuar e kohës së injorancës ku ai jetoi.

Në ditët tona, fëmijëve:

1. Duhet t’u mësojmë frikën dhe dashurinë ndaj Allahut (xh.sh.).
2. Duhet t’u japim vetëdijen që ata jetojnë të vëzhguar nga kamerat hyjnore.
3. Duhet t’ua japim thellë deri në palcë besimin në ahiret pra ndjeshmërinë që për çdo veprim ka një llogari për t’u dhënë.
4. Duhet t’u formojmë atyre kushtet që t’u ruhet pjesa e pastër dhe e pafajshme.
5. Duhet t’i shtyjme ata drejt praktikimit të adhurimit, drejt sohbetit, leximit të Kuranit, të cilat do t’ua pastrojnë atyre botën e brendshme dhe do t’i shërbejnë për t’u pasuruar me argumenta shpirtërore.

Kështu me ndihmën e Allahut Teala, pasi të marrin këtë edukim, fëmijët tanë, kur të hidhen në jetë të gjallë, të pastër dhe me zemrën të drejtuar nga Allahu (xh.sh.), do të mund të ruhen nga çdo e keqe me të cilën do të përballen, siç thotë edhe shprehja: «**Dora në qarë dhe zemra në jarë (tek Zoti).**» Si një kandil brenda fanarit, duke ruajtur dritën e tyre shpirtërore, do të ndriçojnë edhe rrethin e tyre.



Sahabët e nderuar, kur u shpërndanë në botë për të shpjeguar Islamin, u përballën me shumë sprova të vështira që ndezin nefsin, me besime dhe filozofi që mjegullojnë mendjen dhe me ngjarje që i japin zemrës dhe shpirtit shqetësim; mirëpo ishin kaq të mbushur me etikën kuranore që ata kishin mësuar nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), me personalitetin dhe nivelin shpirtëror të tij, saqë:

Ata personalitete të ndritshme ia shuan ndikimin çdo gjëje negative që u doli përpara.

Ata u bënë vetë qendër joshjeje për të tjerët. Shpërndanë të vërtetën dhe mirësinë kudo, e mahnitën këdo.

Duke jetuar në mënyrën më të bukur, më të mirë, më të përsosur, e bënë njerëzimin, i cili ishte i etur për të vërtetën, të bukurën dhe pjekurinë, të shkonte dhe të sillej rreth Kuranit Famëlartë dhe Hazreti Pejgamberit, (a.s.).

Sepse ata ishin në çdo thërrmijë plot me të vërtetën e Kuranit dhe Sunetit dhe jo vetëm që nuk u ndikuan nga jashtë, por prej shpirttrave të tyre buroi vazhdimisht mëshirë dhe dashuri.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), na informon në lidhje me rrugën për të arritur këtë nivel:

*“Atij që e mëson Kuranin që në vogëli, Kurani i bëhet mishi dhe gjaku i tij.”* (Kenzu'l-ummal, I, 532.)

Njësimi i Kuranit me mishin e gjakun e njeriut, depërtimi i tij thellë në shpirt dhe në qenie, mund të komentohet si instalimi i besimit dhe dashurisë kuranore në nënvetëdijen e njeriut.

Nga ana tjetër nuk duhet harruar që robëria e njeriut ndaj Zotit vazhdon nga djepi deri në varr. Deri në frymën e fundit. Ruajtja e zemrës nga indiferenca dhe nga shqetësimi i brendshëm, aq sa për fëmijët, është domosdoshmëri edhe për të rriturit.

Në çdo moshë dhe në çdo shekull;

Është kusht të emigrohet nga injoranca drejt Resulullahut, (a.s.)...





## NUK REALIZOHET PA HIXHRET!..

Ashtu siç emigruan sahabët për hir të Allahut (xh.sh.) dhe të të Dërguarit të Tij, për ta jetuar fenë, duke braktisur pasuri e katandi, familje e miq, ashtu edhe sot çdo besimtar duhet të jetojë me shqetësimin e ahiretit duke braktisur çdo gjë që ka ndaluar Allahu (xh.sh.) dhe duke bërë edhe sakrifica të ndryshme për këtë qëllim.

Në mënyrë të veçantë hixhreti është kusht të realizohet në fushën e edukimit dhe disiplinimit. Disa institucione edukimi që janë bërë marka, të cilat kanë vetëm dimensionin e joshjes materiale, larg shpirtërores, nuk duhet të kenë asnjë vlerë në shpirtin e besimtarit. Edukimet larg shpirtërores hedhin helm në zemrat e njerëzve, kur në fakt zemrat tona duhet të kultivojnë dashuri për shpirtëroren dhe të shenjtën dhe nuk duhet të bien në kurthin e mahnitjes ndaj adresave të mjegullta e të gabuara.

Si përfundim, në edukimin e fëmijëve tonë, fjalën duhet ta themi «**ne**». Fjala që ne themi, programi që ne zbatojmë, librat që u japim fëmijëve që të lexojnë, duhet të kenë në qendrën e vet ato burime që na japin identitetin dhe kuptimin ne, pra Kuranin dhe Sunetin.

Përballë përpjekjeve të adhuruesve të dynjasë për t'i zbukuruar rrugët e xehnemit dhe për t'i paraqitur si rrugë xheneti, duhet të përpiqemi të gjejmë rrugët e përshtatshme dhe të bukura që t'ia bëjmë të dashur fëmijëve tanë jetën islame, e cila është e vetmja e vërtetë që siguron qetësinë dhe lumturinë në të dyja botët.

Fëmijëve tanë duhet t'u mësojmë që qetësia e ndershmërisë, pasuria e mirënjohjes për atë që zotërojmë, dinjiteti i modestisë, kënaqësia përfundimtare e durimit dhe e këmbënguljes, kënaqësia e bujarisë, lumturia e mëshirës, qëndojnë në besnikërinë dhe dorëzimin ndaj Hakut dhe gjithashtu në shpëtimin nga robërimi prej vargonjëve të mijëra besimeve të gabuara. Nëse ua mësojmë atyre kënaqësinë, triumfin dhe çlirimin që sjell kryerja e detyrave tona ndaj Zotit, atëherë kjo dynja, me vatrat e saj kalimtare të joshjes, nuk do të arrijë t'i marrë ata në ndikim.



**Për t'i edukuar mirë fëmijët tanë, duhet ta shohim çdo rast si një pasuri. E në mënyrë të veçantë është domosdoshmëri që kur fëmijët kanë shumë kohë në dispozicion, në stinën e verës, të bëhen përpjekje shumë serioze për t'ia mbushur kohën me edukimin e duhur...**

Për një edukim me qendër Kuranin dhe Sunetin, nuk janë të majftueshme disa javë të stinës së verës. Në fakt duhet të përpiqemi që stinët e fëmijërisë dhe të rinisë, fëmijët tanë t'i kalojnë në frymën e Kuranit dhe Sunetit. E kemi për detyrë që t'ua krijojmë kushtet për këtë.

Mirëpo ata që për arsye të ndryshme nuk e gjejnë mundësinë për këtë, për ta çuar në vend një pjesë të përgjegjësisë së edukimit të fëmijëve të tyre, duhet që verën ta perceptojnë si një mundësi shumë të vlefshme për këtë.

Veçanërisht përkimi i verës me muajin e Kuranit, Ramazanin e ndëruar, duhet vlerësuar maksimalisht dhe duhet parë si një mundësi shumë e mirë.

Të nxehtit e verës nuk duhet të bëhet shkak për rehati, dembeli, shkujdesje, argëtime boshë; duhet mbajtur në qendër të vëmendjes përgjigjja që Kurani u dha munafikëve të cilët kërkuan të prishnin botën shpirtërore të myslimanëve duke bërë shkak të nxehtin në luftën e Tebukut:

## **ZJARRI I XHEHNEMIT ËSHTË MË I NXEHTË**

Përgatitjet për luftën e Tebukut u realizuan në një periudhë kur i nxehti ishte përvëlues dhe në një kohë fluksi pune, pikërisht kur vilesnin hurmat. Munafikët dembelë dhe frikacakë i përdorën këto kushte si justifikime. Ata filluan gënjeshttrat dhe dallaveret. Ajeti kuranor në lidhje me këtë temë shprehet:

***“Ata që mbetën në shtëpitë e tyre, pas (daljes për luftë të) të Dërguarit të Allahut, u gëzuan; nuk u pëlqente të luftonin në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre dhe thanë: «Mos shkoni në luftë, nëpër vapë!»***

***Thuaju: «Zjarri i Xhehenemit është edhe më i nxehtë!»*** (Teube, 81)



## VEÇ SIKUR TË KUPTONIN!..

Gjatë edukimit të nefsit tonë si dhe gjatë edukimit të fëmijëve dhe nxënësve, vështirësia më e madhe që hasim është moskuptimi i seriozitetit të çështjes nga ana e tyre.

Pra kjo do të thotë që hapi i parë i edukimit është të bërit e tjetrit që të perceptojë dhe kuptojë rëndësinë e çështjes. Duhet t'ia zgjojmë ndjeshmërinë fëmijëve tanë në lidhje me fenë dhe temat qiellore, në mënyrë aq të sinqertë dhe të pastër saqë, kur të kryejnë një vepër të mirë, ata të ndjehen sikur po shijojnë një mirësi të xhenetit. Dhe kur t'i afrohen një të keqeje, ta ndjejnë të nxehtin e xhehnemit.

Kjo ngjarje e jetuar në kohën e Sulltan Fatihut, që dëshmon sesi edukoheshin personalitetet heronj të nderit, është një shembull që tregon rezultatin e mrekullueshëm të edukimit të vërtetë:

Në kohën e Sulltan Fatihut, një grup priftërinjsh, për të matur nivelin shpirtëror të shoqërisë osmane, u mbledhën dhe pasi diskutuan për të provuar nderin dhe karakterin e të rinjve dërguan disa vajza në kohë akshami në një medrese. Vajzat u thanë të rinjve që hapën derën:

«-Ra nata dhe ne humbëm rrugën, a na pranoni sonte mysafir?.. Nuk kemi asnjë zgjidhje tjetër...»

Nxënësit u menduan dhe reflektuan dhe ia dhanë dhomën e tyre vajzave. Ata vendosën një perde dhe kaluan gjithë natën përreth një tangari me prush. Në mëngjes ata i përcollën vajzat.

Priftërinjtë, me shumë kuriozitet i pyetën vajzat në lidhje me sjelljen e të rinjve karshi tyre. Vajzat e shpjeguan ndodhinë:

«- Djemtë na e lëshuan ne shtratin e tyre dhe u tërhoqën në qoshen e dhomës. Ndenjën përreth zjarrit gjithë natën duke afuar duart afër prushit dhe duke i thënë njeri-tjetrit 'Na ruajttë Zoti nga zjarri i xhehnemit! Mos na bëftë Zoti nga budallenjtë që këmbejnë të ardhmen për një çast.' Ata nuk u kthyen nga ne as për të na parë!»



Ja pra perceptimi siç duhet i faktit se zjarri i xhehnemit është më i tmerrshëm dhe më i papërmbajtshëm se çdo zjarr i kësaj dynjaje. Përballë këtij perceptimi as zjarri i epshit i cili mund ta shkërmoqë vullnetin e njeriut, nuk influencon dot; e as fryma e zjarrtë ftuese e shejtanit, nuk ia del...

E vërteta më e rëndësishme që do të na bëjë ta fitojmë këtë perceptim, janë fjalë pa zë të vdekjes. Mbajtja në kujtesë vdekjen që pret çdo krijesë të përkohshme, meditimi për të në çdo paraagim, mendimi për të lënë pas fëmijë të hajrit e shërbime prej të cilave do të burojnë sevape edhe pasi të ndërrojmë jetë... këto e nxisin njeriun për mirë dhe e largojnë nga e keqja.

**O Zot!**

**Na bëj nga robërit e tuaj që e perceptojnë të vërtetën!**

Mos na ndaj nga përshpirtshmëria dhe energjia e Zotërisë sonë, të Dërguarit të Allahut, trëndafililit të trëndafilishtes së profecisë. Mos na lejo që të jepemi mbas luleve të rreme, mbas esencave të gënjeshtëra dhe nga shkëlqimi artificial!.. Na bëj nga vepërmirët që lyhen me bojën e Allahut (xh.sh.)!..

Na bëj të sigurt ne dhe trashëgimtarët tanë nga përçarjet e fundit të kohës dhe nga përçarja e dexhalit që tregon rrugën e xhehnemit si xhenet dhe rrugën e xhenetit si xhehnem!.. Na bëj të mundur që të jetojmë në rrugën e drejtë dhe na ringjall me grupin e të mirëve!..

**Amin!..**





# Përmbajtja

|                     |   |
|---------------------|---|
| Darafjala . . . . . | 5 |
|---------------------|---|

## PJESA 1

|                                                                         |    |
|-------------------------------------------------------------------------|----|
| Kushti për të qenë i sigurt nga frika dhe trishtimi në Ahiret . . . . . | 9  |
| DUNJAJA DHE AHIRETI                                                     |    |
| Në syrin e miqve të Allahut . . . . .                                   | 31 |
| BESIMTARI DHE DYNJAJA -1- . . . . .                                     | 59 |
| BESIMTARI DHE DYNJAJA -2- . . . . .                                     | 77 |
| NATA E DASMËS . . . . .                                                 | 95 |

## PJESA 2

|                                                           |     |
|-----------------------------------------------------------|-----|
| E vërteta dhe shpëtimi në dynja dhe ahiret arrihen        |     |
| VETËM DUKE E DASHUR ATË . . . . .                         | 115 |
| Në Klimën e Ramazanit të nderuar                          |     |
| TRE MIRËSI... TRE RREZIOQE... . . . . .                   | 133 |
| TË QENËT UMET I TIJ                                       |     |
| Me përgjegjësi dhe vlera... . . . .                       | 155 |
| Të qenët bashkë me profetin                               |     |
| NË TË DYJA BOTËT . . . . .                                | 175 |
| TË JESH PJESË E FAMILJË SË NDERUAR TË RESULULLAHUT (A.S.) |     |
| Me prejardhje ose me zemër . . . . .                      | 197 |

## PJESA 3

|                                                      |     |
|------------------------------------------------------|-----|
| NJË JETË ME DUA                                      |     |
| Për të qenë nga të diturit e vërtetë... . . . .      | 219 |
| NJË JETË ME QENDËR KURANIN DHE SUNETIN...            |     |
| Shpëtimi nga krizat e sistemeve njerëzore... . . . . | 241 |